



REPUBLIKA E KOSOVËS  
QEVERIA E KOSOVËS  
MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT



INSTITUTI PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR

DRAFT

PLANI HAPËSINOR  
Parku Kombëtar  
“Bjeshkët e Nemuna”





**REPUBLIKA E KOSOVËS**

QEVERIA E KOSOVËS

MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT



INSTITUTI PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR

**PARKU KOMBËTAR  
“BJESHKËT E NEMUNA”**

**PLANI HAPËSINOR**



**PARKU KOMBËTAR**

**“BJESHKËT E NEMUNA”**

**PLANI HAPËSINOR**



Dokument i hartuar nga Instituti për Planifikim Hapësinor në bashkëpunim me strukturat relevante të sektorëve të Qeverisë së Kosovës, qeverive komunale dhe strukturave të niveleve të ndryshme të shoqërisë kosovare.

**Vërejtje:**

Versioni kompetent i dokumentit është versioni në gjuhën shqipe

Prishtinë

Shtator, 2020



*Të nderuar qytetarë,*

*Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” është njëra nga pasuritë më të çmuara natyrore që ka Kosova, vlerat e të cilit duke përfshirë llojlojshmërinë biologjike dhe peisazhore i tejkalojnë kufijtë e vendit tonë. Prandaj, me qëllim të mbrojtjes së kësaj bukurie dhe trashëgimie natyrore, para jush keni dokumentin e planit hapësinor, në të cilin janë dhënë orientimet themelore në drejtim të mbrojtjes dhe shfrytëzimit racional të parkut. Jemi të sigurtë se rekomandimet dhe zhvillimet e propozuara do të ndikojnë drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë e kësaj zone, duke e bërë të mundur përjetimin e saj nga ne dhe nga gjeneratat që do të vijnë pas.*

*Puna e realizuar deri më tash është e lidhur ngushtë me hulumtimin dhe analizimin e gjendjes ekzistuese. Qëllimi kryesor ka qenë konstatimi i shkaqeve për problemet e shfaqura, njohja me rrezikun që na kanoset nëse dukuritë negative vazhdojnë, njohja me resurset dhe potencialet reale në hapësirën e Parkut dhe përpjekja jonë e përbashkët që të gjitha këto t’i orientojmë në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm të Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”.*

*Instituti për Planifikim Hapësinor ka përfunduar procesin e hartimit të Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, përmes një procesi transparent, gjatë të cilit janë organizuar një mori takimesh me pjesëmarrës të fushave, profesioneve dhe strukturave të ndryshme. Bashkëpunim i rëndësishëm është realizuar në takimet me Grupin Punues Ndërministror, si dhe me anëtarë të sektorëve të rëndësishëm të Qeverisë së Kosovës. Pjesë e veçantë e kësaj pune ishin takimet me autoritetet e komunave pjesëmarrëse dhe komunitetin që jeton në territorin e Parkut. Kontributi i të gjithëve ka qenë shumë i vlefshëm, duke na mundësuar të mbledhim informatat e nevojshme, pa përjashtuar marrjen e sugjerimeve dhe vërejtjeve të rëndësishme, me ndihmën e të cilave kemi arritur të përfundojmë këtë dokument shumë të rëndësishëm për këtë park kombëtar.*

*Të nderuar qytetarë, shumë shpejtë do të fillojë faza më e rëndësishme e dokumentit - implementimi i zhvillimeve të parapara. Ajo që fillimisht kërkohet nga të gjithë ne, është ndryshimi i qasjes tonë ndaj veprimeve që e degradojnë edhe më tej hapësirën e parkut, ndërsa ne, si bartës të procesit në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse komunale ju sigurojmë se do t’i ndërmarrim të gjitha masat që veprimet dhe aktivitetet e parapara të realizohen sipas planit. Në këtë drejtim, kemi nevojë për përkushtimin dhe ndihmën e të gjithëve, në mënyrë që bashkërisht t’i bëjmë ndryshimet e nevojshme.*

---

Ministër i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit



## PJESËT E PLANIT

- I** PROFILI  
I ZHVILLIMIT HAPËSINOR
- II** VIZIONI,  
PARIMET DHE CAQET
- III** KORNIZA  
E ZHVILLIMIT HAPËSINOR
- IV** STRATEGJIA  
DHE VEPRIMET PËR ZBATIM
- V** DISPOZITAT  
PËR ZBATIM



## PËRMBAJTJA

### KONTEKSTI

Parqet kombëtare në Evropë.....	7
Parqet kombëtare në Kosovë .....	9
Hyrje.....	10
Roli dhe bazueshmëria e planit .....	10

### I. PROFILI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR

MJEDISI DHE SHFRYTËZIMI I TOKËS .....	13
Biodiversiteti .....	14
Karakteristikat pedologjike .....	16
Gjendja e mjedisit .....	16
Veçoritë geomorfologjike .....	17
Karakteristikat gjeologjike.....	18
Karakteristikat hidrogeologjike .....	18
Veçoritë hidrologjike .....	20
Veçoritë klimatike .....	21
Erozioni .....	21
Zonat sizmike.....	22
Shfrytëzimi i tokës.....	23
Trashëgimia kulturore .....	26
Trashëgimia natyrore .....	30
POPULLËSIA DHE ZHVILLIMI SOCIAL .....	31
Vendbanimet dhe banimi .....	34
ZHVILLIMI EKONOMIK .....	36
Veprimtaria bujqësore dhe blegtorale .....	36
Bletaria .....	36
Industria .....	37
Tregëtia dhe zejtaria .....	37
Turizmi dhe potencialet turistike në Park .....	38
INFRASTRUKTURA FIZIKE.....	44
Infrastruktura e transportit dhe transporti .....	44
Telekomunikacioni .....	44

Infrastruktura e energjisë elektrike.....	45
Menaxhimi i mbeturinave.....	45
Infrastruktura ujore.....	45
Analiza SWOT .....	46
Sfidat kryesore.....	46
Administrimi dhe menaxhimi i parkut .....	46
Mbrojtja dhe ruajtja e mjedisit, peizazhit, biodiversitetit dhe vlerave natyrore e kulturore te parkut .....	47
Shfrytëzimi racional i resurseve natyrore në dobi të zhvillimit ekonomik në parkun kombëtar .....	49
Rigjallërimi i aktiviteteve tradicionale në vendbanimet e parkut dhe ruajtja e traditës si faktorë ndikues .....	50

### II. VIZIONI, PARIMET DHE CAQET

Vizioni .....	51
Synimet dhe objektivat .....	51

### III. KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR

Koncepti i zhvillimit hapësinor .....	53
Ndarja në zona sipas regjimit të mbrojtjes .....	54
Skenarët e zhvillimit .....	57

### IV. STRATEGJIA DHE VEPRIMET PËR ZBATIM

S1. Administrimi, menaxhimi efikas i parkut dhe bashkëpunimi në shërbim të parkut .....	60
S2. Mbrojtje, ruajtje dhe shfrytëzim racional i vlerave të trashëgimisë natyrore e kulturore në park dhe për rreth tij .....	60
S3. Zhvillimi socio-demografik në vendbanimet brenda dhe për rreth Parkut .....	62
S4. Ngritja ekonomike e parkut dhe zhvillimi i turizmit.....	63
S5. Sigurimi i qasjes dhe i shërbimeve publike në park.....	64

### V. DISPOZITAT PËR ZBATIM

Dispozitat e përgjithshme .....	68
Dispozitat për përgjegjësitë e Ministrisë .....	68
Dispozitat për përgjegjësitë e autoriteteve komunale .....	68
Dispozitat për përgjegjësitë e autoritetit përgjegjës për administrimin e Parkut .....	68
Dispozitat dhe kushtet për përcaktimin dhe përkufizimin e hapësirave/objekteve publike .....	69
Ndarja e zonave .....	69
Procedura për marrjen e lejes së ndërtimit .....	70
Procedura për marrjen e pronës publike në shfrytëzim .....	70
Dispozitat dhe kushtet e ndërtimit .....	70
Kushtet specifike të ndërtimit .....	70
Qendrat turistike/rekreative .....	71
Fshatrat turistik .....	71
Vend kampingjet .....	71
Objektet hoteliere .....	72
Motelet .....	72
Vend piknikët .....	72
Stanet .....	73
Hyrjet në Park .....	73
Infrastruktura fizike .....	73
Trashëgimia natyrore .....	74
Trashëgimia kulturore .....	74
Trajtimi i mbeturinave .....	75
Ndikimet sociale .....	75
Zbatimi i planit .....	75
Hulumtimet e mëtutjeshme .....	75
Pjesëmarrësit në hartimin e planit .....	76
Literatura .....	76

### SHTOJCAT

Plani i veprimit .....	78
Tabela me kuotat e brendëshme të kufirit sipas komunave .....	83



## PERKUFIZIMET

Shprehjet e përdorura në këtë dokument kanë kuptim si në vijim:

**Zonë e Veçantë** - është hapësira e caktuar territoriale e shpallur për shkak të vlerave, pasurive, karakteristikave dhe veçorive tjera unike e specifike me interes të përgjithshëm kombëtar, për të cilën duhet përcaktuar një organizim administrativ e territorial dhe menaxhim të rregullimit hapësinor efikas, përfshirë regjimin përkatës të mbrojtjes dhe të shfrytëzimit të tyre;

**Planet Hapësinore për Zona të Veçanta** - janë me interes të përgjithshëm për vendin, hartohen dhe miratohen për pjesë të caktuar të territorit të përfshirë në një ose më shumë komuna, duke marr parasysh edhe kontekstin e gjerë hapësinor dhe çështjet ndërkufitare;

**Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”** - Pjesa e territorit të Bjeshkëve të Nemuna si tërësi hapësinore e cila veçohet me vlera dhe raritete natyrore, me numër të madh të ekosistemeve të rëndësishme pyjore dhe ekosisteme të tjera të ruajtura, me numër të konsiderueshëm të llojeve endemike dhe relikte, me karakteristika të pasura gjeomorfologjike, hidrologjike dhe peizazhore që kanë rëndësi shkencore, edukativo – arsimore, kulturore – historike, rekreative - turistike dhe veprimtaritë që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik;

**Zonë** - një grup të parcelave kadastrale fqinje me përcaktim të njëjtë të shfrytëzimit të tokës, zhvillimit apo të mbrojtjes dhe ruajtjes, duke përdorur përkufizimet e zonave në këtë ligj;

**Zona e parë** - përfshinë pjesët e territorit të Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” me veçori natyrore të jashtëzakonshme, me lloje të rralla, të rrezikuara të bimëve dhe shtazëve dhe tipave të vendbanimeve në kushte të natyrës së egër. Kjo zonë gëzon karakterin e mbrojtjes strikte;

**Zona e dytë** - menaxhimi aktiv - përfshinë pjesët e territorit të Parkut kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” që karakterizohen me ekosisteme, vlera peizazhore dhe vlera tjera të natyrës ku mund të ushtrohen ekoturizmi, bujqësia tradicionale dhe veprimtaritë të cilat nuk janë në kundërshtim me qëllimet e mbrojtjes;

**Zona e tretë** - e shfrytëzimit të qëndrueshëm përfshinë pjesët e territorit të Parkut kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” ku mund të bëhet: ndërtim, rindërtim, mbrojtje të objekteve tradicionale dhe rekreacion, turizëm dhe nevoja të banorëve në territorin e Parkut Kombëtar si dhe shfrytëzim të kullsave dhe shfrytëzim ekonomik i të mirave të natyrës sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës si dhe në harmoni me ligjet përkatëse dhe Planin Hapësinor të Parkut Kombëtar;

**Zona III-të A** apo zona e vendbanimeve -përveç aktiviteteve që lejohen në zonën e dytë, lejohen edhe ndërtime në funksion të banimit, arsimit, shëndetësisë dhe zhvillimit ekonomik, me theks të veçantë në zhvillimin e turizmit;

**Zona III-të B** apo zona ku gjenden stanet - me kushte të veçanta lejohet vetëm ndërtimi i staneve dhe objekteve përciellëse për zhvillimin e blegtorisë, me theks të veçantë në zhvillimin e turizmit rural;

**Zona III-të C** apo zona e zhvillimit - përveç aktiviteteve që lejohen në zonën e dytë, lejohen edhe ndërtime në funksion të banimit, arsimit, shëndetësisë dhe zhvillimit ekonomik, me theks të veçantë në zhvillimin e turizmit;

**Zona III- të P** apo zona e pyjeve private – e cila përfshinë pyjet në pronësi private zhvillimi apo ndërtimi mund të ndodhë nëse dëshmohet se në kuadër të zonës pyjore përkatëse ka hapësirë të mjaftueshme për ndërtimin apo zhvillimin e planifikuar;

Në përgjithësi, në zonën III-të nuk lejohet ndërtimi i kapaciteteve industriale të cilat e ndotin mjedisin, duke përfshirë impiantet hidroenergetike dhe shfrytëzimin e paautorizuar të inerteve. Ndërtimet duhet të jenë të bazuara në këtë plan hapësinor e poashtu të jenë në harmoni të plotë me mjedisin natyror;

**Zona e ndikimit** - përfshinë hapësirën prej pesëdhjetë(50) metra nga kufiri i Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” që shërben për parandalimin e ndikimeve të dëmshme në Parkun kombëtar;

**Zonat e Veçanta të Mbrojtura (ZVM)** - Këto zona janë të definuara sipas Ligjit për ZVM-të (Ligji Nr. 03/L-039) dhe paraqesin vlerat e trashëgimisë kulturore me mbrojtje të veçantë;

**Jo konformitetet** - Jo konformiteti nënkupton një shfrytëzim ekzistues, ndërtesë ose parcelë kadastrale që nuk është në harmoni me kërkesat aktuale të zonimit dhe trajtohet në pajtim me nenin 39 të UA HZKos;

## SHKURTESAT

<b>ASK</b>	Agjencia e Statistikave të Kosovës;
<b>AMMK</b>	Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës;
<b>MEA</b>	Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit;
<b>MBPZHR</b>	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
<b>HZKos</b>	Harta Zonale e Kosovës;
<b>HZKom</b>	Harta Zonale e Komunës;
<b>IPH</b>	Instituti për Planifikim Hapësinor;
<b>KE</b>	Këshilli i Evropes;
<b>NVM</b>	Ndërmarrjet e Vogla dhe te Mesme;
<b>PHK</b>	Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+;
<b>PZHK</b>	Plani Zhvillimor Komunal;
<b>PRrH</b>	Plani Rregullues i Hollësishëm;
<b>PK</b>	Parku Kombëtar;
<b>TK</b>	Trashëgimia Kulturore;
<b>UA</b>	Udhëzim Administrativ;
<b>WTTC</b>	Këshilli Botëror i Udhëtimit dhe Turizmit;
<b>ZVM</b>	Zonat e Veçanta të Mbrojtura;
<b>KFOS</b>	Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur;
<b>REC</b>	Qendra Rajonale e Mjedisit;
<b>IUCN</b>	Unioni Botëror për Ruajtjen e Natyrës;
<b>WTO</b>	World Trade Organization;
<b>RIO</b>	Konventa e Rios mbi Biodiversitetin, Ndryshimet e Klimës dhe Shkretëtirat.



## KONTEKSTI

### Parqet Kombëtare në Evropë<sup>1</sup>

Në kontinentin e Evropës, që përfshinë shtetet në mes Oqeanit Atlantik dhe Maleve Urale, deri në vitin 1995 ekzistonin 220 parqe kombëtare (PK), nga 2000 sosh në gjithë botën. Ndër shtetet e para, që filluan krijimin e PK-ve, ishin: Suedia që nga viti 1909 me “Abisko National Parks”, “Garphyttan”, “Sarek”, “Stora ose Sjöfallet”, duke e pasuar Zvicra në vitin 1914 me “Säiss National Park”, pastaj Spanja më 1918 me “Odesa” dhe “Covadonga”, Islanda më 1928, Finlanda etj.

Në përgjithësi, territoret e parqeve kombëtare kuptohen si tërësi homogjene të pa shfrytëzuara nga njeriu, të cilat kanë formacione hidro-morfologjike, peizazhe, ekosisteme si dhe specie bimore e shtazore me vlera të çmuara natyrore dhe kulturore. Menaxhimi i këtyre PK-ve, me qëllim të mbrojtjes dhe ruajtjes së vlerave të cekura, sigurohet nga autoritetet më të larta shtetërore.


Në Evropë, për ndryshim nga Amerika Veriore, PK-të janë fusha të konservimit të vlerave kontinentale, në të cilat kanë ndodhë evoluime të ndryshme qysh nga periudha e Neolitit, p.sh. zhvillimet (me pakësim apo rritje të vegjetacionit) në pyje janë të lidhura më shumë me aktivitetet njerëzore – kulturore se sa me fenomenet dhe ndryshimet klimatike - natyrore.

Ndonëse kanë ndodhur luftëra, migrime, ndryshime drastike në demografi dhe zhvillime socio – ekonomike, transferime të pronave, etj, deri kah fundi i shekullit nëntëmbëdhjetë disa nga zonat kanë ngelur akoma të paprekura. Tërësitë e tilla natyrore janë më të afërta me konceptin Amerikan për parqe kombëtare, siç kemi rastin e Parkut “Yellowstone”, të krijuar që në vitin 1872. Aktualisht, koncepti i ditëve të sotme është se parqet kombëtare janë zona që kanë mbetur si tërësi më të egra natyrore dhe janë sa më larg e më pak miqësore ndaj ndikimit njerëzor. Kështu, formacionet hidro – morfologjike, pyjet, kullosat, kënetat, shpellat, luginat e lumenjve dhe të kanjonit të tyre si dhe liqenet natyrore ose artificiale, sikur që janë edhe tundrat e bregdetit Skandinav edhe pse goditen nga stuhitë e ishujve verior të Skocisë dhe akullnajat e Islandës e po ashtu edhe shkëmbinjtë e rrëpirë të Alpeve apo të Pirinejeve, janë Parqe më të paprekura natyrore se sa që mund të jenë ato të Evropës Lindore.

Më në jug, me lulëzimin e qytetërimit greko-romak, njeriu Evropian kishte një marrëdhënie tjetër dhe më të ndryshme me natyrën. Pas luftërave dhe vuajtjeve të shumta, ai përpigj të pushtonte dhe të konvertonte popujt dhe pasuritë e territoreve që sundonte. Kjo është edhe arsyeja pse zonat më prestigjioze të natyrës së egër, në vendet e Mesdheut, janë në lartësi më të larta mbidetare dhe sa më larg aktiviteteve njerëzore. Megjithatë, në këto parqe natyrore, nuk kemi shkatërrim sistematik të specieve, habitateve dhe të llojllojshmërisë biologjike (biodiversitetit), porse ky ndikim vërehet kryesisht në shpërndarjen dhe rrezikimin e arealit të tyre.

→ Parqet Kombëtare në Evropë

(me ngjyrë të gjelbër tregohet shtrirja gjeografike e parqeve kombëtare evropiane, në mesin e të cilave shihen edhe dy parqet kombëtare të Kosovës)



<sup>1</sup>Parc National des Cevennes, “Atlas du Parc National des Cevennes”, GIP ATEN, Morgen Multimedia, EDATER 2002 MATE (<http://atlas.parcnationaux.org/cevennes/Default.asp>)



Shumë më vonë, në vitin 1972, përkufizimi i parqeve kombëtare është forcuar dhe zgjeruar edhe me shfrytëzimin e hapësirave të këtyre zonave nën mbrojtje, duke përfshirë me raste edhe peizazhet kulturore dhe lokalitetet arkeologjike. Së fundi, në Kongresin Botëror në Caracas më 1992, ruajtja dhe shfrytëzimi i PK-ve është vendosur në qendër të strategjive për zhvillim të qëndrueshëm. Nga njëra anë, çështja më thelbësore për ruajtjen e larmisë biologjike (ekosistemeve, llojeve dhe variacioneve gjenetike) është mbrojtja e larmisë së specieve të egra dhe të kultivuara si dhe të mundësuarit e dhënies së hapësirës së nevojshme për jetën e tyre dhe nga ana tjetër, përmes mbrojtjes së zonave me vlera dhe bukuri të jashtëzakonshme natyrore si dhe të rëndësisë kulturore, PK-të ofrojnë shërim dhe ngritin cilësinë e jetës njerëzore të 70% të popullsisë urbane në Evropë.

Parqet Kombëtare në Evropë, nuk janë sipërfaqe të izoluara dhe nuk zgjidhin vetëm problemin e shfrytëzimit të tokës apo të rritjes së përdorimit të burimeve natyrore, të cilat edhe ashtu nuk mund të kapërcejnë këto pengesa përmes vetëm një mënyre dhe kohe të caktuar. Duke u mbështetur në programet kërkimore si dhe në shpërndarjen teknike të menaxhimit adekuat të ruajtjes së vlerave natyrore e kulturore dhe të peizazheve, PK-të janë duke kontribuar për një përdorim sa më të mirë të hapësirës natyrore.

Kështu, nga kjo që u tha, rezulton se në politikën e parqeve kombëtare të zhvilluar në Evropë, dallohen dy boshte kryesore. Njëri për të ruajtur atë që mbetet natyrore dhe e pa shqetësuar nga njeriu dhe tjetri për të ruajtur llojshmërinë e krijuar nga shoqëritë tradicionale rurale. Vetëm përcaktimi i saktë i objektivave të menaxhimit, të bazuara në zhvillimet e zonave përreth, mund të lejojnë që PK-të të ofrojnë zgjidhje të rëndësishme për ruajtjen e larmisë jetësore (biologjike) në pesëdhjetë vitet e ardhshme.

Parqet Kombëtare, të cilat, sipas shpërndarjes dhe karakterit dominues, mund të ndahen në mënyrë skematike në 12 biomasa, njësi të mëdha të vegjetacionit të përcaktuara kryesisht nga klima, kushtet e temperaturës dhe reshjeve, janë të renditura në vazhdim<sup>2</sup>:

- |   |          |
|---|----------|
| 1. Brigjet Atlantike dhe Baltike:           | 20 (9%)  |
| 2. Brigjet Mesdhetare:                      | 7 (3%)   |
| 3. Tundër:                                  | 3 (1%)   |
| 4. Pyjet Halorë verior:                     | 31 (13%) |
| 5. Pyjet e Përziera:                        | 15 (6%)  |
| 6. Pyjet Gjetherënëse:                      | 27 (11%) |
| 7. Pyjet Mesdhetare:                        | 8 (3%)   |
| 8. Pellgje dhe moçalet:                     | 18 (8%)  |
| 9. Stepat dhe moçalet kripore kontinentale: | 6 (3%)   |
| 10. Malet Skandinave (Evropë veriore):      | 24 (10%) |
| 11. Malet e Përmbajtura (Evropë qendrore):  | 31 (13%) |
| 12. Malet e Evropës jugore:                 | 47 (20%) |

<sup>2</sup> IBM Evropa


→ PK “Pirini” – Bullgari



→ PK “Haute Savoie” – Francë



→ PK “Cheile” – Rumani







### Parqet kombëtare në Kosovë

Aktualisht, Republika e Kosovës ka 2 parqe kombëtare: Parkun Kombëtar "Sharri" me pozicionim në Jug dhe Jug-perëndim të vendit, është pjesë e Maleve të Sharrit të cilat shtrihen në tri shtetet fqinje, në R. Kosovës, R. Shqipërisë dhe Ish R. F. J. të Maqedonisë. Në Kosovë, PK "Sharri" shtrihet në komunat Dragash, Prizren, Suharekë, Shtërpçë dhe Kaçanik dhe mbulon një sipërfaqe prej 53272 hektarësh; dhe Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", me pozitën e vet në Veri-perëndim të vendit, është pjesë e bjeshkëve me të njëjtin emër (apo të njohura edhe si Alpet Shqiptare), të cilat po ashtu shtrihen në tri shtetet fqinje, në R. Kosovës, R. Shqipërisë dhe R. Malit Zi. Në Kosovë ky park shtrihet në komunat Istog, Pejë, Deçan, Junik dhe Gjakovë dhe ka një sipërfaqe prej 63028 hektarësh.

Pa dyshim, këto dy Parqe Kombëtare, që së bashku mbulojnë mbi 10 % të sipërfaqes së përgjithshme të vendit, shtrihen në pjesët më malore duke përfshirë edhe pikat më të larta në Kosovë. Një vend-shtrirje e tyre është për faktin se atje gjendet një numër shumë i gjerë i llojeve bimore dhe specieve shtazore të nivelit të lartë të larmisë biologjike (biodiversitetit), të cilat janë në bashkëjetesë të harmonizuar me njerëzit ose qëndrojnë larg ndikimeve të tyre negative të shkaktuara nga aktivitetet zhvillimore.

### Misionet e Parqeve


Përnjohja, mbrojtja, ruajtja dhe menaxhimi aktiv i vlerave të trashëgimisë natyrore duke siguruar ruajtjen e larmisë biologjike (biodiversitetit) dhe të mirëqenies së publikut janë misione të mirëpritura dhe tradicionale të parqeve kombëtare. Përveç kësaj, specifikat e të dy Parqeve në Kosovë lejojnë udhëheqjen e zhvillimit të një sërë aktivitetsesh origjinale, që kanë për qëllim ruajtjen e vlerave natyrore, kulturore dhe të peizazhit.

Gjithashtu, edhe përkujdesja për një bashkëpunim të fortë ndërkombëtar, binjakëzim dhe zhvillim të qëndrueshëm, sjellin partneritete dhe marrëdhënie kontraktuese që promovojnë përfshirjen e popullsisë lokale dhe të palëve të interesit në menaxhimin e ekuilibrit ekologjik dhe të vlerave të trashëgimisë natyrore dhe kulturore brenda dhe përreth Parkut.

→ Sipërfaqet në Parqet Kombëtare në Kosovë

Parku Kombëtar	Sipërfaqe totale e Parqeve (në ha)	Zonë e I-rë (në %)	Zonë e II-të (në %)	Zonë e III-të (në %)	Sipërfaqja e PK në Komuna (në %)
Sharri	53.272 ha	17.6 %	75.3 %	7.1 %	Dragash (45%) Prizren (22%) Suharekë (4.7%) Shtërpçë (24.2%) Kaçanik (4.1%)
Bjeshkët e Nemuna	63.028 ha	13.3 % 1.2% ZVM	65.0 %	20.5 %	Istog (8.1%) Pejë (52.1%) Deçan (26.6%) Junik (8.4%) Gjakovë (4.8%)

→ Parqet Kombëtare në Kosovë



Parqet Kombëtare në Kosovë



Plani Hapësinor i PK Bjeshkët e Nemuna

Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor  
Agjencia për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës  
Instituti për planifikim hapësinor



### Legjenda:

- Kufiri i Kosovës
- Kufinj të komunal
- Kufijtë e parqeve
- Zona I-rë
- Zona e II-të
- Zona III-të
- Qendrat komunale
- Rrugë magjistrale
- Rrugë regjionale
- Lumi



## HYRJE

Iniciativa për shpalljen e “Bjeshkëve të Nemuna” park kombëtar ka nisur në vitin 1970 nga Enti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës dhe ka vazhduar përsëri në vitin 1985 nga Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.

Sipas kësaj iniciative Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” do të përfshinte pjesë të territorit të Komunës së Pejës dhe Deçanit. Meqë Komuna e Deçanit nuk e dha pëlqimin për këtë, u vendos që vetëm pjesa që i takon Komunës së Pejës të shpallej dhe njëherësh u përgatit “Studimi për arsyeshmërinë e shpalljes së Bjeshkëve në Komunën e Pejës për Park Kombëtar”. Edhe kjo iniciativë nuk ka pasur sukses në finalizimin e shpalljes.

Në vitin 2002 Instituti i Kosovës për mbrojtjen e Natyrës përsëri inicioi shpalljen e “Bjeshkëve të Nemuna” park kombëtar. Sipas kësaj iniciative ishte paraparë që në parkun kombëtar të përfshihen pjesë të territorit të komunës së Pejës, Istogut, Deçanit dhe Gjakovës. Kuvendet komunale përkatëse e kanë dhënë pëlqimin<sup>3</sup> për këtë nismë .

Në vitin 2003 është përgatitur “Studimi për arsyeshmërinë e shpalljes së “Bjeshkëve të Nemuna park kombëtar dhe njëherësh është përgatitur edhe projektligji për të. Iniciativën e ka përkrahur Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës në seancën e mbajtur më 03.04.2003, mirëpo më vonë projektligji nuk e ka gjetur përkrahjen e duhur.

Përpjekjet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit kanë vazhduar edhe më tutje. Në vitin 2009 përsëri e ka formuar grupin punues për hartimin e projektligjit për shpalljen e “Bjeshkëve të Nemuna” park kombëtar. Gjithashtu nuk ka munguar as iniciativa e shoqërisë civile për Bjeshkët e Nemuna. Në dhjetor, 2009 ka filluar projekti “ Bjeshkët e Nemuna - Park Kombëtar, pro et contra”. Projekti është mbështetur financiarisht nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të hapur KFOS dhe është zbatuar nga Qendra Rajonale e Mjedisit – REC, zyra në Kosovë.

Përfundimisht pas një sërë konsultimesh dhe diskutimesh në nivel qendror dhe lokal të pushtetit e edhe me komunitetin, hartohet projektligji dhe Kuvendi i Kosovës, në dhjetor të 2012-ës e miraton Ligjin për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” me çka edhe hapet rruga për hartimin e planit hapësinor për këtë park.

## Gjendja

Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” paraqet një regjion gjeografik me bukuri të rrallë, me pasuri të madhe të elementeve të peizazhit si: bjeshkë të larta të çveshura me dëborë në maja, pyje mbresëlënëse me lloje të ndryshme drunjsh ku me bukuri dominojnë pishat e larta, lugina magjepsëse e gryka të thella mahnitëse, kullosa e livadhe me lule të gjitha ngjyrave, burime e rrjedha të shumta ujore që formojnë përrocka e lumenj, shpella të bukura dhe liqene përrallore në vende të larta.

Gjendja e mjedisit, përkundër cenimit të tij me prerjen e pyjeve, mund të thuhet se ende, në përgjithësi është e mirë. Ajri dhe uji janë të pastër, kurse degradimi i tokës nuk është në masën që do të quhej shumë shqetësuese. Gjendja e mirë e mjedisit duhet të ruhet e edhe të avancohet në të ardhmen, por kjo nuk mund të ndodhë nëse nuk ndalohen disa dukuri negative që tani janë prezente në zonën e parkut e të cilat paraqesin një kërcënim serioz për mjedisin dhe për të ardhmen e parkut. Këto dukuri janë prerja e pakontrolluar e pyjeve dhe ndërtimet pa mbështetje në plane hapësinore dhe rregulluese.

Vazhdimi i prerjes së pakontrolluar të pyjeve do të kishte pasoja të pariparueshme që përveç humbjes së masës drunore, reflekton drejtpërdrejtë edhe në çrregullimin e ekosistemeve, kërcënimin e botës shtazore, prishjen e peizazhit, paraqitjen e erozionit etj.

Ndërtimet që nuk janë bërë në bazë të planeve hapësinore dhe atyre rregulluese e të cilat kryesisht përfaqësohen me objekte hoteljere dhe të banimit, janë më të shprehura në zonat që vizitohen më shumë si në: Grykën e Rugovës, Bogë, Leqinat etj. Ndërtimet e këtilla kanë ndodhur për shkak të mungesës së planeve. Momentalisht gjendja nuk është shumë shqetësuese, por nëse kjo dukuri do të vazhdonte dhe do të shpeshtohet në të ardhmen, ajo natyrisht se do ta degradonte hapësirën e parkut kombëtar, sepse njerëzit do të ndërtonin edhe aty ku nuk duhet me çka do të dëmtohej peizazhi, vegjetacioni dhe do të cenoheshin habitatet shtazore.

Parku ka potenciale të mëdha për zhvillimin e turizmit, si të atij dimëror ashtu edhe të atij veror. Shpatijet e Bogës, ato në Bjeshkët e Belegut etj janë shumë të përshtatshme për sportin e skijimit gjatë dimrit, kurse gjatë verës, hapësira e parkut, për turistët ofron mundësi të jashtëzakonshme për shijimin e bukurive të peizazheve, për rekreim dhe rehabilitim, qoftë duke shetitur, ecur (hiking), duke qëndruar në ajër të pastër apo mënyra tjera.

Potencialet ekzistojnë, por infrastruktura dhe përmbajtjet tjera që mundësojnë shfrytëzimin e këtyre potencialeve, janë të mangëta. Në shumë vende ato nuk ekzistojnë. Vetëm në Bogë ka patur ndërtim të infrastrukturës për zhvillimin e skijimit dhe ajo nuk është e mjaftueshme, sepse kapaciteti i ski-liftave atje, është i vogël dhe shtigje të rregulluara të skijimit ka pak krahasuar me mundësitë që i ka ai vend.

Infrastruktura në nivel jo të kënaqshëm dhe në përgjithësi niveli i ultë i zhvillimit ekonomik në hapësirën e parkut, kanë shkaktuar braktisjen e vendbanimeve të atjeshme nga popullata dhe sot një numër i vendbanimeve është plotësisht i boshatisur.

Dukuritë negative që u përmendën, pastaj gjendja sa i përket infrastrukturës dhe zhvillimit ekonomik në përgjithësi, kanë krijuar nevojën për angazhimin e segmenteve përkatës të shoqërisë tonë në mënyrë që të gjitha të kthehen në një gjendje të kënaqshme, në të cilën parku kombëtar do të përfitonte në të gjitha aspektet. Ky angazhim konsiston në planifikimin e hapësirës së parkut, pra hartimin e planit hapësinor të parkut, planeve rregulluese, pastaj në investimet për zhvillim të bazuar në këto plane dhe në përkujdesjen e përditshme në mënyrë që parku të ruhet. Disa hapa janë bërë në këtë drejtim. Tani, siq është thënë, Bjeshkët e Nemuna janë të shpallura me ligj, park kombëtar, me kufi të definuar, është themeluar Drejtoria e Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” dhe është në proces hartimi i planit hapësinor për Parkun.

## Roli dhe bazueshmëria e planit

Hartimi i Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” ka për bazë legjislacionin në fuqi që përbëhet nga: Ligji për Planifikim Hapësinor, Ligji për shpalljen e Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, Ligji për Tokën Bujqësore, Ligji për Banim dhe Ndërtim, Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ligji për Ujëra.

Plani hapësinor i Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” është dokument i cili duhet të promovojë interesat e përbashkëta të banorëve të Kosovës, për një zhvillim më të shpejtë ekonomik, me qëllim të përmirësimit të kualitetit të jetës, por njëkohësisht edhe të mbrojtjes së resurset, trashëgiminë natyrore dhe kulturore. Plani përcakton parimet dhe qëllimet afatgjate të planifikimit hapësinor për periudhën të paktën 10 vjeçare, përcakton afatet kohore reale dhe implikimet buxhetore. Plani hapësinor duhet të:

- Udhëzojë sektorët dhe agjencitë e Qeverisë në hartimin dhe implementimin e politikave dhe vendimeve për shfrytëzimin sa më të drejtë të kësaj pasurie natyrore;
- Përcaktojë kategorizimin e hapësirave apo zonave sipas regjimit të mbrojtjes dhe shfrytëzimit të tyre në: zona që do të mbeten të tilla si janë, të ruajtura nga çdo zhvillim; zona me një gamë të vogël, të kufizuar të zhvillimeve hapësinore; dhe zona me një gamë më të gjërë të zhvillimeve hapësinore

Plani hapësinor do të shërbejë si udhëzues për:

- Identifikimin e lokacioneve të parkut me potenciale të zhvillimit;
- Aprovimin e politikave lidhur me vendosjen e zhvillimeve të mundshme në territorin e parkut që kanë të bëjnë me zhvillimin e turizmit, ofrimin e shërbimeve të nevojshme, gjithnjë duke ruajtur në maksimum trashëgiminë dhe vlerat natyrore dhe kulturore;
- Identifikimin e rolit të vendbanimeve (fshatrave) përreth dhe rolin e qyteteve të mëdha që ndodhën në afërsi të parkut;
- Identifikimin e rolit të vendbanimeve (fshatrave) përreth, si dhe
- Identifikimin e rolit të infrastrukturës së rëndësishme dhe të lidhjeve me territorin e parkut

<sup>3</sup> KK Pejë- Vendimi nr.352-5339/2002; KK Deçan-01/63, 3 shtator 2002; KK Gjakovë- vendimi 01Nr. 372/2002; KK Istog-Burim- Pëlqimi 01 nr. 41/2002



Plani hapësinor i Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" bazohet në:

- Parimet e përcaktuara me Ligj,
- Vizionin dhe caqet strategjike,
- Raportet e sektorëve të rëndësishëm,
- Strategjitë zhvillimore të sektorëve të ndryshëm,
- Elemente tjera të përcaktuara me akt te veçantë

### Procesi, pjesëmarrja publike, burimi i të dhënave

Pas miratimit të Ligjit për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" nga Kuvendi i Kosovës, Instituti për Planifikim Hapësinor (IPH) në atë kohë pjesë e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës e ka marrë iniciativën për hartimin e planit hapësinor të këtij parku. Puna rreth hartimit të planit ka filluar me shqyrtimin dhe sistemimin e të dhënave që IPH i ka patur në dispozicion para se ta fillojë punën. Paralelisht me këtë, IPH e ka inicuar themelimin e dy grupeve punuese: grupit punues ndërmisor (GPN) dhe grupit të ekspertëve për zonimin e territorit të parkut. Grupet janë themeluar me vendimet e Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK). Grupi punues ndërmisor kishte në përbërje të tij pjesarë nga sektorë të ndryshëm të Qeverisë së Kosovës dhe nga qeveritë lokale të komunave, në territoret e të cilave shtrihet parku. Detyra e tij ka qenë ta mbështesë stafin e IPH për hartimin e këtij plani. Grupi i ekspertëve për zonimin e territorit të parkut përbëhej nga ekspertë të lëmive të biologjisë dhe gjeografisë, nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe nga Ministria. Grupi e ka patur për detyrë që në terren t'i identifikojë dhe t'i caktojë kufinj të zonave sipas regjimit të mbrojtjes strikte dhe të bëjë ndarjen fillestare të zonave tjera.


Procesi i hartimit të planit ka kaluar nëpër 5 faza të punës si rezultat i të cilave përpilohen 5 pjesët (kapitujt) e planit hapësinor:

1. Profili i zhvillimit hapësinor dhe analiza e gjendjes;
2. Vizioni, parimet dhe caqet;
3. Korniza e zhvillimit hapësinor;
4. Strategjitë dhe veprimet për zbatim;
5. Dispozitat për zbatim

Tek pjesa e parë e planit, "Profili i zhvillimit hapësinor dhe analiza e gjendjes" paraqitet dhe analizohet gjendja ekzistuese në hapësirën e parkut, e vështruar në katër fusha tematike: mjedisi dhe shfrytëzimi i tokës, demografia dhe zhvillimi social, zhvillimi ekonomik, dhe infrastruktura. Paralelisht me mbledhjen e të dhënave për paraqitjen e gjendjes ekzistuese nga stafi i IPH-së i mbështetur nga GPN, gjatë kësaj faze të punës, grupi i ekspertëve në terren i ka caktuar kufinj të tri zonave sipas regjimit të mbrojtjes dhe shfrytëzimit të tyre.

"Vizioni, parimet dhe caqet" është pjesë e dokumentit të planit hapësinor ku jepet një vizion për të ardhmen e parkut dhe tregohen synimet dhe objektivat që dëshirohet të arrihen në park.

Në fazën e tretë të punës është përpiluar "Korniza e zhvillimit hapësinor". Në të jepen konceptet kryesore të zhvillimeve të ardhshme hapësinore në park, ndërkaq synimeve dhe objektiveve u jepet dimension hapësinor,



→ Skema e procesit

tregohet në mënyrë më të përgjithshme se ku dhe çka dëshirohet të arrihet sa i përket fushave tematike të përmendura më lartë.

Ajo se si është menduar të arrihen të gjitha ato që janë paraqitur tek pjesa e kornizës, tregohet në pjesën e katërt të planit "Strategjitë dhe veprimet për zbatim". Kjo përmban masat, veprimet konkrete dhe projektet që duhet të realizohen në mënyrë që të arrihen synimet dhe objektivat për parkun kombëtar.

Gjatë fazës së pestë është hartuar pjesa e fundit e planit hapësinor "Dispozitat për zbatim". Në këtë dokument renditen të gjitha kushtet që detyrimisht duhet të plotësohen gjatë zbatimit të planit.

Gjatë procesit, çdoherë pas përfundimit të pjesës së caktuar të planit, ajo u është shpërndarë anëtarëve të GPN që ta analizojnë dhe komentojnë me qëllim të përmirësimit eventual të dokumentit. Procesi ka qenë gjithëpërfshirës, transparent dhe me pjesëmarrje publike në vendimmarrje.

Pjesëmarrja publike nënkupton involvimin e ministrive të Qeverisë së Kosovës, autoritetet komunale, institucionet shkencore dhe hulumtuese, organizatat e shoqërisë civile, agjencitë e KB-ra, agjencitë e huaja zhvillimore, zyret ndërlidhëse në Kosovë, institucionet e BE-së, etj.

Gjatë procesit të hartimit të Planit, është zhvilluar një proces i suksesshëm dhe shumë transparent i diskutimeve, në të cilin janë përfshirë të gjitha grupet e interesit. Qëllim dhe fokus i takimeve ka qenë përfshirja e komunitetit dhe njohja e tyre me procesin dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në këtë proces. Përshtypja e përgjithshme e këtyre diskutimeve ishin keqkuptimet dhe keqinterpretimet për procesin, të cilat te një pjesë e konsiderueshme e popullatës kanë shkaktuar ndjenjën e refuzimit të procesit si të tillë. Me kalimin e kohës, me takime dhe diskutime të shpeshta, është tejkaluar kjo situatë, komuniteti ka filluar të jetë pjesë aktive e takimeve me ide dhe projekte konkrete për zhvillim. Ndikim pozitiv në këtë drejtim kanë treguar autoritetet komunale, të cilat me përkushtim maksimal kanë ofruar të gjitha të dhënat e mundshme dhe përkrahjen shumë të nevojshme në proces.

Për herë të parë, pjesë e diskutimeve kanë qenë edhe përfaqësues të institucioneve të Shqipërisë, me të cilat është diskutuar për fillimin e iniciativës në hartimin e një plani të përbashkët hapësinor, duke përfshirë edhe Malin e Zi si pjesë e rëndësishme e kësaj zone.

Procesi i planifikimit është i vazhdueshëm. Ai duhet t'i nënshtrohet monitorimit, vlerësimit dhe në bazë të kërkesave edhe ndryshimeve të nevojshme. Më poshtë është dhënë skema e mobilizimit institucional apo e pjesëmarrjes publike në procesin e hartimit të planit hapësinor.



Materiali i planit hapësinor është i bazuar në të dhëna të marrura drejtpërdrejt nga terreni, nga komunat në territoret e të cilave shtrihet Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", nga planet zhvillimore të këtyre komunave, nga sektorët relevant të ministrive të Qeverisë së Kosovës, dokumentacioni ekzistues për arësyeshmërinë e shpalljes së Bjeshkëve të Nemuna park kombëtar dhe nga dokumentet e agjencive zhvillimore ndërkombëtare që kanë punuar dhe punojnë në çështje të ndryshme lidhur me pyjet, zhvillimin rural, turizmin, e tj.

### Funksionet themelore të Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"

Me planin hapësinor të Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" si dhe në bazë të ligjit për mbrojtjen e natyrës duhet të sigurojmë:

- mbrojtjen, ruajtjen, përtëritjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të natyrës dhe burimeve të përtëritshme të natyrës;
- rivalizimin e territoreve të dëmtuara të natyrës ose pjesëve të saj dhe kompensimi për dëmet e shkaktuara;
- ruajtjen dhe restaurimin e baraspeshës ekologjike në natyrë;
- vendosjen e sistemit për planifikim, udhëheqje, inventarizim, monitorim, informim dhe financim, për mbrojtjen e natyrës;
- realizimin e qëllimeve, të përcaktuara në politikat e mbrojtjes së natyrës;
- zvogëlimin e shfrytëzimit tejmase dhe rrezikimit të llojeve të florës dhe faunës e sidomos i atyre me rëndësi të veçantë, të rralla dhe të rrezikuara, si dhe i habitateve të tyre.
- e drejta për informim publik dhe pjesëmarrje të publikut në lëmin e mbrojtjes së natyrës;

- sigurimin e së drejtës së qytetarëve për mjedis të shëndoshë, pushim dhe rekreacion në natyrë.
- sigurimin e biodiversitetit përmes ruajtjes së habitateve të rëndësishme natyrore dhe llojeve me rëndësi të florës dhe faunës në statusin e favorshëm të ruajtjes.


Sipas ligjit për mbrojtjen e natyrës, parku nacional është territor natyror me funksione për:

- mbrojtjen e tërësisë ekologjike, të një apo më shumë ekosistemeve, për brezat e sotëm dhe të ardhshëm;
- përrjashtimin e shfrytëzimeve apo uzurpimet me qëllim të ndryshimit dhe dëmtimit të natyrës;
- sigurimin e bazave për qëllime shpirtërore, shkencore, arsimore, rekreative, kulturore dhe mundësi vizitash, në pajtim me parimet e mbrojtjes së mjedisit, përderisa ai duhet të menaxhohet me qëllime si:
  - mbrojtja e territoreve natyrore me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare për qëllime shpirtërore, shkencore, arsimore, rekreative dhe turistike;
  - ruajtja e gjendjes burimore, të shembujve reprezentativ të zonave fiziografike, bashkësive biotike, resurseve gjenetike dhe llojeve për sigurimin e biodiversitetit dhe të stabilitetit ekologjik;
  - sigurimi i shfrytëzimit në aspektin inspirues, shkencor, arsimor, kulturor dhe rekreativ që ta mbajë zonën në gjendjen natyrore ose afërsisht natyrore;
  - përrjashtimi i shfrytëzimeve ose i vizitave të cilat mund të shkaktojnë ndryshime dhe dëmtime të natyrës;
  - mbajtja e veçorive ekologjike, gjeomorfologjike dhe estetike për të cilat territori është shpallur i mbrojtur.

Funksionet e parkut nacional përcaktohen në atë mënyrë që ato të sigurojnë në radhë të parë mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave themelore të parkut nacional, e pastaj rregullimin dhe shfrytëzimin e këtyre vlerave:

- Ruajtja dhe mbrojtja e vlerave dhe rariteteve natyrore prezente burimore dhe pjesërisht të ndryshuara;
- Mbrojtja dhe përparimi i pejzazhit të rajonit në tërësi;
- Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturo-historike;
- Zhvillimi dhe përparimi i vlerave natyrore dhe të krijuara, si dhe zhvillimi i aktiviteteve prezente dhe të reja;
- Ekonomizimi dhe përparimi i vlerave natyrore dhe ekonomike;
- Shfrytëzimi i vlerave të parkut nacional me qëllim të hulumtimeve shkencore, arsimore, edukative dhe kulturore;
- Shfrytëzimi i vlerave të parkut nacional për nevojat e ekonomisë, para së gjithash për nevojat e veprimtarive turistike-rekreative, pastaj për shfrytëzimin e pyjeve, kullosave malore, tokës bujqësore dhe tjera;
- Ngritja e vetëdijes së qytetarëve për vlerat e natyrës.

→ Skema e pjesëmarrjes publike





# PROFILI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR

## PROFILI DHE ANALIZA E GJENDJES

### 1.1. POZITA GJEOGRAFIKE DHE KUFINJT E PARKUT

**Bjeshkët e Nemuna** janë vazhdimësi e Maleve Dinaride, të cilat shtrihen në perëndim të Kosovës, në veri të Shqipërisë dhe në jug-lindje të Malit të Zi. Këto male me majat e larta e të thepisura hyjnë në radhën e maleve më të "egra" jo vetëm të vendit tonë, por edhe të Evropës.

Bjeshkët e Nemuna në Kosovë kanë një shtrirje në drejtim veri-jug me gjatësi 50 km dhe gjerësi 26 km. Në anën e Kosovës ngriten kah fundi i fushës (500-600 m) dhe arrijnë lartësinë mbi 2000 m, në disa vende prehen nga lugina të thella lumore, të lumit të Bisticës (Lumbardhit) së Pejës, Deçanit, Erenikut dhe kanë si kufi jugor Drinin. Masivi malor i Bjeshkëve të Nemuna ndahet në tri pjesë:


**Pjesën veriore** e përbëjnë malet që ndodhen në veri dhe verilindje të Bisticës (Lumbardhit) të Pejës, e cila butësisht fillon në Malin e Thatë mbi fushëgropën e Dukagjinit dhe Moknës. Prej Moknës, ky brez malor shmanget në drejtim të jugperëndimit dhe shkon deri te Maja e Re (1812m), e nga këtu zgjatet në perëndim dhe vazhdon përmes majës Pogled (Shiqimi, 2155m) në Zhleb me majën e Rusolisë (2381m). Këtij grupi malesh, më tutje në perëndim i takojnë edhe Shtedimi (2272 m), Hajla (2400m), Mali i Shishkës, me majën e Hasanit (1871 m), Mali i Begut me majën e Velekutit (2015) dhe Pokleni (1376).

**Pjesën qendrore** e përbëjnë malet ndërmjet Bisticës (Lumbardhit) të Pejës dhe Deçanit: Koprivniku me Kërshin e Çvrlanit (2460m), Bjeshkët e Strellcit me Majën e Strellcit (2377m), Qafa e Nekut dhe Mylishevcit. Më në perëndim, kësaj pjese i takojnë Malet e Lumbardhit me Majen Guri i Kuq (2522m), Malet e Nexhinatit (2341m) dhe Staraci (Plaku, 2426 m).

**Pjesa jugore** shtrihet në jugperëndim të Bisticës së Deçanit dhe përbëhet nga Malet e Deçanit, Malet e Vokshit (1641m), Bjeshka e Junikut me majën Rrasa e Zogut (2296m), Gjeravica (2656 m), Bogiçevica (2103m), Maja e Ropës (2505m), Maja e Qenit (2406m) dhe Marjashi (2530m).

Bjeshkët e Nemuna me lartësinë, strukturën e relievit, ndërtimin gjeologjik, elementet klimatike dhe botën organike na përkujtojnë Alpet. Bjeshkët e Nemuna dallohen me një numër të madh të majave të larta mbi 2000m, dhe majën absolute më të lartë të Kosovës, Gjeravica (2656m). Morfologjia e Bjeshkëve të Nemuna cilësohet me shpate të thepisura, me lugina të thella, me gryka të ngushta, që paraqesin bukuri të rralla natyrore jo vetëm në Kosovë por edhe në Evropë. Sipas Ligjit për PK "Bjeshkët e Nemuna" të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 13 Dhjetor 2012, Parku ka një sipërfaqe prej 62488 Ha, e cila pas matjeve dhe analizave të detajuara ka pësuar ndryshime. Sipas këtyre ndryshimeve sipërfaqja e Parkut është 63028 Ha dhe shtrihet në territorin e komunave: Pejë (me 32847 Ha apo 52%); Deçan (me 16786 Ha apo 27%), Junik (me 5273 Ha apo 8%), Istog (me 5074 Ha apo 8%) dhe Gjakovë (me 3048 Ha apo 5%). Të dhënat detaje për kufirin janë paraqitur në Shtojcën 2.

→ Pozita gjeografike e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"





## 1.2. MJEDISI DHE SHFRYTËZIMI I TOKËS

Gjendja në Park sa i përket ajrit dhe ujit nuk është e keqe, ndërkaq kur flitet për tokën, aty ka degradim që shprehet në formën e prerjes ilegale të pyjeve;

Në kuadër të zonave alpikë dhe subalpikë të parkut janë prezente 33 lloje bimore endemike, 6 subendemike, 128 lloje endemike të Ballkanit;

Në park jetojnë 8 lloje të peshqëve, 13 të ujëtoksorëve, 10 të zvarranikëve, 148 lloje të shpezëve, 37 të gjetarëve dhe 129 lloje të fluturave;

Në pjesën e poshtme të parkut shtrihen pyjet e dushkut dhe ahut, në pjesën e epërme janë pyjet me halorë si pyjet e rrobullit dhe arnenit, kurse në lartësitë më të mëdha shtrihet vegjetacioni i kullosave;

Karakteristikat gjeomorfologjike kryesore janë: Gurra e Drinit të Bardhë, Kanjoni i Grykës së Rugoves, Maja e Gjeravices, cirqet malore etj;

Parku ka një klimë tipike malore me verëra të freskëta e te nxehta dhe dimra te ftohtë e me reshje të mëdha bore. Temperatura mesatare vjetore është 10.2°C. Karakterizohet me numër të madh të ditëve me reshje (mbi 130 ditë);

Parku është i pasur me ujëra rrjedhëse sipërfaqësore me një sasi mesatare vjetore 30m<sup>3</sup>/s. Karakteristike janë burimet: Gurra e Radavcit (1900-6500 l/s), Vrella-Istog(1400-4500l/s), Vrella-Vrellë(1800-2000l/s) etj;

Është zonë me erozion të lartë ku rreth 84% të sipërfaqes është nën ndikimin e erozionit të lartë dhe shumë të lartë;

Seizmika: V-VII shkallë të merkalit.


Sipërfaqja e Parkut është 63028ha. Në të, pyjet e përbëjnë strukturën hapësinore më të madhe me 45166ha (71.66%), ndërsa struktura hapësinore, e dytë për nga madhësia, është kullosa me 15520ha (24.62%). Strukturat tjera hapësinore janë më të vogla, siç janë shkrepat (hapësirat e zhveshura) me 1883ha (2.99%), vendbanimet me 438ha (0.70%), guroret 9ha (0.01%) dhe liqenet me 9ha (0.01%).

### 1.2.1. Biodiversiteti

Teritori i parkut përbëhet prej pjesëve të begatshme të cilat përmbajnë vlera natyrore e të krijuara dhe që janë të pasura me biodiversitet shumë të zhvilluar e të rëndësishëm në aspektin shkencor, arsimor, kulturor, estetik dhe turistik-rekrativ. Në kuadër të tij dallojmë zona dhe objekte natyrore të cilat gëzojnë statusin e mbrojtjes. Ato janë paraqitur në tabelën në vijim.

→ Zonat e mbrojtura para shpalljes së Parkut Kombëtar

Zona/objekti	Sipërfaqja në ha	Viti i vënies nën mbrojtje	Rëndësia e mbrojtjes	Kategoria
Maja e Ropsit	25	1955 nr.277/55	Rëndësi botanike me llojet e ruajtur të molikës, bredhit, pishës dhe ahut	Rezervat bimor
Kozhnjari	161	1955 nr. 337/58	Rezervat faunistike, rezervat ku jeton dhia e egër (Rupicapra rupicapra)	Rezervat shtazor
Malet e Prilepit	0.92	1963 nr. 05-6/9/63	Rëndësi botanike, përbërje e paster e panjës malore (Acer heildreichii)	Rezervat bimor
Gubavci	38	1959	Rëndësi botanike, jeton lloji endemorelikt boshtra (Forsythia europeae)	Rezervat bimor
Gryka e Rugovës	4301	1988	Rëndësi gjeologjike, hidrologjike, peisazhore, speleologjike, botanike	Monument natyre
Burimi i Drinit të Bardhë dhe shpella e Radavcit	89.94	1983, GZK 2/83	Rëndësi hidrologjike, peisazhore, gjeologjike, speleologjike	Monument natyre



→ Mjedisi në Park


#### 1.2.1.1. Flora

Sa i përket florës, Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" karakterizohet me praninë e 1000 llojeve bimore relikte, endemorelikte dhe endemike autoktone të Ballkanit dhe Europës, pa përfshirë myshqet, likenet dhe kërpudhat. Në kuadër të zonave alpikë dhe subalpikë janë prezente 33 lloje endemike, 6 subendemike, 128 lloje endemike të Ballkanit, me vlerë shkencore, ekonomike dhe mjekësore. Derisa 26 lloje janë dominante, lloje endemike të Kosovës brenda parkut janë 11. Llojet endemike të Ballkanit janë 18. Bazuar në Librin e Kuq të Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës, 126 lloje janë të rrezikuara nga zhdukja kurse 6 lloje janë në Listen e kuqe Europiane të UNESCO - New York, 1991.

→ Mëlaka bullgare-*Geum gulgaricum*→ Sanza - *Gentiana lutea*

### 1.2.1.2. Fauna

Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” karakterizohet me faunë të pasur me lloje endemike dhe relikte. Ajo përbëhet prej: 8 lloje të peshqëve, 13 ujëtoksorë, 10 zvarranik, 148 shpezë, 37 gjitarë, të cilat janë paraqitur në grafikonin në vazhdim, si dhe 129 lloje të fluturave vetëm nga rendi Lepidoptera.



Përbërja e faunës së Bjeshkëve të Nemuna sipas numrit të llojeve

Deri më sot janë vrojtuar 148 lloje të shpezëve, por mendohet të ketë mbi 200 lloje me rëndësi ndërkombëtare dhe për këtë arsye Bjeshkët e Nemuna janë evidentuar në listën ndërkombëtare IBA<sup>4</sup>.

Për familjet dhe llojet e ornitofaunës në Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” shih shtojcën 1

### 1.2.1.3. Vegjetacioni

Klima dhe kushtet ekologjike në park kanë mundësuar ekzistencën e florës dhe vegjetacionit të begatshëm me prani të formave drunore, shkurre dhe barishtore, relikte, endemorelikte dhe endemike autoktone, të Ballkanit dhe Europës. Në aspektin e shtrirjes vertikale të vegjetacionit pjesën më të madhe në pjesën e poshtme e përfshinë vegjetacioni gjethërenës, në atë të epërme ai halor, ndërsa mbi kufirin e epërm pyjor gjendet edhe vegjetacioni i kullosave. Në pyjet gjethërenëse dominojnë Dushku (*quercus*) dhe Ahu (*fagetum montanum*), kurse prej halorve Bredhi (*abies alba*), Hormoqi (*picea abies*), Rrobulli (*pinus heldreichii*) dhe Arneni i bardhë (*pinus peuce*). Vegjetacioni ka pësuar ndryshime gjatë procesit të zhvillimit historik të tij, kështu që të gjitha llojet bimore të cilat e mbijetuan periudhën e akullnajave së bashku me lloje të reja të krijuara pas diluviumit ndërtojnë fitocenoza të ndryshme dhe karakteristike. Këtu dallohen tre breza vegetativ:

1. Brezi i ulët malor
2. Brezi i mesëm malor
3. Brezi i lartë malor

→ Ahu – *Fagetum montanum*

Në kuadër të Bjeshkëve të Nemuna deri më tani janë konstatuar këto asociacione:

1. *Ass. Abieti – Fagetum moesiaca*
2. *Ass. Fagetum subalpinum scardo – pindicum*
3. *Ass. Picetum abietis bertisceum montanum*
4. *Ass. Picetum abietis bertisceum subalpinum*
5. *Ass. Wulfenio – Pinetum peucis*
6. *Ass. Pinetum peucis typicum*
7. *Ass. Pinetum heldreichii bertisceum*
8. *Ass. Wulfenio – Pinetum mugo*
9. *Ass. Bruckenthalio – Juniperetum*
10. *Ass. Nardetum subalpinum montenegrinum*
11. *Ass. Salicetum herbaceae balcanicum*
12. *Ass. Pinguiculo – Narthecium scardici*
13. *Ass. Carici Crepidetum dinaricae*
14. *Ass. Festucetum albanicae*
15. *Ass. Senecio – Rumicetum alpini*

### Radhitja vertikale e bashkësive pyjore

Vegjetacioni pyjor brenda territorit të parkut mund të vërehet qartë në profilin vertikal nëpërmes disa brezave të cilët ndërtojnë brezat e ekosistemeve me fitocenoza përkatëse karakteristike siç janë:

- Brezi i pyjeve të Dushkut
- Brezi i pyjeve të Ahut
- Brezi i pyjeve të përziera të Dushkut dhe Halorve
- Brezi i pyjeve të errëta Halore
- Brezi i pyjeve të Rrobullit dhe Arnenit
- Brezi shkurror me Pinus Mugo

<sup>4</sup> Important Bird Area (Zonat e rëndësishme të zogjëve)



### Brezi i pyjeve të Dushkut

Përfshinë pjesën e poshtme me pyje termofile me lartësi mbidetare 800 metra. Katin e drurëve e ndërtojnë llojet edificatore si Qarri (quercus cerris), Bungu (Quercus Petraea), Shpardhi (quercus frainetto), Ahu (fagetum montanum), Vodhëviçja (sorbus torminalis), Bliri gjethegjerë (tilia platophyllos).

### Brezi i pyjeve të ahut

Kati i pyjeve të ahut është në vazhdim të atyre të dushkut dhe shtrihet në lartësi mbidetare 900-1320 metra në të gjitha ekspozicionet, me mbulesë të përgjithshme pyjore prej 80-100 %. Katin e drurëve në përgjithësi e përbënë këto lloje: Ahu (fagetum montanum) më rrallë Panja e malit (acer pseudoplatanus), kurse katin e drurëve të poshtëm e ndërtojnë llojet: Frashëri (Fraxinus ornus), Bredhi i bardhë (abies alba), Panja e malit (acer pseudoplatanus), Rrobulli (pinus heldreichii).

### Brezi i pyjeve të përziara të dushkut dhe halorëve

Shtrihet mbi katin e ahut në lartësi mbidetare 1200-1540 metra, mbulesa pyjore është 80-100% ndërsa lartësia e katit drunor sillet prej 25-32 metra. Katin e drurëve e përbëjnë më së shpeshti Ahu (fagetum montanum), Bredhi (abies alba) dhe Hormoqi (picea abies) si dhe lloje tjera, ndërsa katin e drurëve të poshtëm e ndërton Shkoza e bardhë (carpinus betullus).

### Brezi i pyjeve të errëta halore

Në këtë brez dominojnë llojet gjethore dhe halore. Pyjet e errëta halore në numër më të vogël përbëhen nga Bredhi (abies alba) si në katin e drunjëve poashtu edhe në katin e shkurreve. Kjo përbërje shtrihet në 1750 metra lartësi mbidetare, ekspozicioni veriperendimor. Bazën gjeologjike e përbëjnë shkëmbinjtë e mermerit, mbulesa pyjore është rreth 80 %, lartësia e katit drunor sillet rreth 40 metra, kurse vjetërsia rreth 90 vite. Pjesën tjetër të pyjeve, me shtrirje shumë më të gjerë, e përbëjnë pyjet e Arnenit të bardh (pinus peuce) në lartësi mbidetare prej 1460-1800 metra. Mbulesa e vegjetacionit është nga 60-100 % ndërsa lartësia e tij është 25-45 metra, me bazë gjeologjike shkëmbore dhe silikate. Katin e drurëve të lartë e përbëjnë: Hormoqi (picea abies), Arneni i bardh (Pinus peuce), më pak Bredhi (Abies alba), Ahu (Fagetum montanum), Rrobulli (pinus heldreichii).

### Brezi i pyjeve të rrobullit dhe arnenit

Ky brez pyjor shtrihet në lartësi mbidetare 1850-1930 metra, në ekspozicionin juglindor, verilindor dhe veriperendimorë. Bazën gjeologjike e përbëjnë karbonatet dhe dollomitet, ndërsa mbulesa pyjore është 60-80 %, me lartësi të katit drunor 20-35 metra. Katin e drurëve të epërm e përbëjnë Arneni i bardh (pinus peuce), rrallë shfaqet edhe Hormoqi (picea abies).

Në këtë brez dallohen edhe pyjet me Rrobull (pinus heldreichii), në lartësi mbidetare 1450-2000 metra, bazën gjeologjike e përbëjnë karbonatet, mbulesa e përgjithshme pyjore është 60-70 %, ndërsa lartësia e katit drunor 15-25 metra. Katin drunor e ndërton Rrobulli (pinus heldreichii) dhe Arneni i bardhë (pinus peuce).

### Brezi shkurre me Pinus Mugo

Brezi i shkurreve shtrihet në lartësi mbidetare 1850-2050 metra, në të gjitha ekspozicionet, bazën gjeologjike e ndërtojnë karbonatet si dollomite, mermerë etj. Mbulesa pyjore sillet prej 30-100 % me lartësi 2.5 metra. Në brezin e Arnenit të bardh (pinus peuce) lartësia arrinë deri në 20 metra, si edificator është lloji i Kërlekës (pinus mugo). Në katin e bimëve barishtore gjenden 55 lloje më të shpeshta janë: Luzula pyjore (Luzula sylvatica), Drdhëza (Fragaria vesca), Haraqina malore (Valeriana montana), Lulja e balsamit alpin (Hypericum alpinum), Kamarosha e pyllit (Geranium sylvaticum), Mëlaka bullgare (Geum bulgaricum), Homogjini alpin (Homogyne alpin), Gentiana e As-klepiti (Gentiana asclepiadea), Lulemiza pyjore (Myosotis sylvatica) etj.

### 1.2.2. Karakteristikat pedologjike

Tokat janë zhvilluar nga depozitimet morenike, koloviumi, diabazet, gabrot, granitet, gëlqerorët, brekçiet gëlqerore, dollomitet dhe rreshpet kristalike. Me rritjen e lartësisë, krahas ndërrimit të tipit të vegjetacionit, ndërrojnë edhe llojet e tokave. Në brezin kodrinor me pyje të gështenjës së butë, mbi shkëmbinjtë silikatë janë zhvilluar varietete të ndryshme të tokave acide ngjyrë gështenje. Në pyjet e pastra të Dushkut (quercus), janë krijuar varietetet e tokave gështenjë acidike skeletore. Në shkëmbinjtë gëlqerorë janë krijuar tokat gështenjë, ndërsa në shkëmbinjtë silikatë tokat gështenjë acidike ku ka edhe pyje të Ahut (fagetum montanum). Me ndërrimin e karakteristikave bioklimatike në brezin e ahut me bredh sasia e humusit në tokë rritet dhe kështu krijohen tokat humusore gështenjë acidike dhe humusore (renkeret). Mbi gëlqerorët kompakt të brezit të ahut me bredh, formohen tokat e tipit terra fusca (tokat ngjyrë të verdhë).

Në lartësinë mbidetare 1.400-1.900 metra, në pyjet e përziara të ahut dhe hormoqit, ahut-bredhit-hormoqit, pastaj të bredhit-hormoqit, si dhe të hormoqit, në shkëmbinjtë acid silikat janë krijuar tokat podzolike ngjyrë gështenje. Tokat podzole gështenjë janë karakteristike edhe për pyjet e Rrobullit (Pinus heldreichii). Redzina gëlqerore acide është karakteristike për brezin pyjor më të lartë të llojit Kërleka (pinus mugo). Substratet kryesore mbi të cilat janë zhvilluar tokat janë: substrati gëlqeror, serpentin dhe shkëmbinjtë silikatë. Në shkëmbinjtë gëlqeror janë krijuar tipe të ndryshme të tokave si: sirozemi (tokat gurore), protoredzina dhe tokat e zeza organogjene, redzina organogjene në karbonate (redzina e vërtetë) me shumë varietete, mandej terra fusca (tokat ngjyrë të verdhë) etj. Në serpentine tokat nuk kanë ndonjë përhapje të madhe dhe në këtë substrat



janë të zhvilluara sirozemi, redzina serpentinore, silikate humusore dhe tokat ngjyrë gështenje në serpentine.

### 1.2.3. Gjendja e mjedisit

Gjendja në park sa i përket ajrit dhe ujit nuk është e keqe, ndërkaq kur flitet për tokën, aty ka një degradim që kryesisht shprehet në formën e prerjes ilegale të pyjeve. Përdorimi i pyjeve është bërë me qëllim të përmbushjes së interesave aktuale shoqërore, duke mos e respektuar parimin e ruajtjes dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm. Kjo, në një masë, ka ndikuar në ndryshimin dhe përbërjen e llojeve pyjore, kualitetin e bashkësive dhe shtrirjen horizontale e vertikale të tyre. Dëmtimet e shkaktuara nga faktori antropogjen vërehen posaqërisht në bashkësitë e dushkut (quercus) dhe gështenjës. Disa nga këto bashkësi, si pasojë e degradimit, janë shndërruar në cungishte, shkurre apo sipërfaqe të zhveshura të potencialit të ulët prodhues. Bashkësitë pyjore të gështenjës, nën ndikimin e faktorëve biotikë dhe antropogjen, kanë pësuar degradime dhe janë shndërruar në bashkësi pyjore të cungishteve me produktivitet të dobët kualitativ dhe kuantitativ. Ndryshe nga këto bashkësi e ahut i hasim në gjendje të mirë, me dendësi të plotë. Prej tyre ka edhe cungishte të kualitetit të lartë teknik e poashtu disa nga këto bashkësi janë dëmtuar nga prerjet ilegale, kështu që janë me dendësi të rrallë me produktivitet të ulët kualitativ dhe kuantitativ.

Bashkësitë e pastra të hormoqit, si dhe ato të përziara të bredhit dhe hormoqit janë kategoria më e dëmtuar e halorëve në këtë rajon, kjo shihet në foton në vazhdim.



→ Pyjet e dëmtuara të Hormoqit – Picea abies dhe Bredhit – abies alba

→ Djegia e pyjeve në Park





#### 1.2.4. Veçoritë gjeomorfologjike

Bjeshkët e Nemuna paraqesin njërin nga masivet malore më të mëdha, më kompleks, më interesant dhe më të bukur në Ballkan dhe më gjërë. Këto bjeshkë në territorin e Kosovës fillojnë në JP të Gjakovës (Shishmani i Bokës-Çerret) dhe vazhdojnë në VL deri në afërsi me Mitrovicën. Kufiri Lindor shtrihet në Rrafshin e Dukagjinit .

Për shkak të prerjeve tërthore të formave kanjonike të dy lumejve Lumbardhit të Pejës dhe lumbardhit të Deçanit, Bjeshkët e Nemuna në territorin e Kosovës ndahen në tri regjione malore:

- Regjioni Verior
- Regjioni Qendror dhe
- Regjioni Jugor

**Regjioni Verior** – Masivet malore shtrihen në veri dhe veri-lindje të Lumbardhit të Pejës dhe fillojnë në Malin e Thatë mbi fushgropen e Dugagjinit deri tek Mokna.

Prej Moknës, ky brez malor shmanget në drejtim të jug-perëndimit dhe shkon deri te Maja e re (1812 m/lmb), vazhdon në drejtim të perëndimit dhe përmes Majes Pogled (Shiqimi 2155 m/lmb) deri në Zhleb me Majen e Ruselis (2138 m/lmb).

Këtij grupi malor, në perëndim i takojnë edhe Shtedimi (2172 m/lmb), Hajla (2400m/lmb), Mali i Shishkës me Majen e Hasanit (1871m/lmb), Mali i Bregut me Majen e Velekutit (2015m/lmb) dhe Pakleni (1376 m/lmb)

**Regjioni Qendror** – Këtë regjion e përbëjnë malet ndërmjet Lumbardhit të Pejës dhe Lumbardhit të Deçanit, Koprivniku me Kërshin e Çvrlenit (2460 m/lmb), Bjeshkët e Strellcit (2377 m/lmb), Qafa e Nekut dhe Milisheveci. Më në perëndim të tij gjenden Bjeshkët e Lumbardhit me majen Guri i kuq (2522 m/lmb), Malet e Nexhinatit (2341 m/lmb) dhe Staraci (Plaku 2426 m/lmb).

**Regjioni Jugor** – Shtrihet në jug dhe jug-perëndim të Lumbardhit të Deçanit. Atë e përbëjnë: Bjeshkët e Deçanit, Bjeshkët e Vokshit (1641 m/lmb), Bjeshkët e Junikut me Majen Rrasa e Zogut (2296m/lmb), Gjeravica(2656m/lmb), Bogiçevica (2103m/lmb), Maja e Ropës (2505m/lmb), Maja e Qenit (2406m/lmb) dhe Marjashi (2530m/lmb).


Malet, luginat, grykat, kanjonet, shpellat etj janë elemente morfologjike kryesore të cilat e përcaktojnë fizionominë e pejsazheve të Bjeshkëve të Nemuna. Në morfologjinë e Bjeshkëve të Nemuna janë të sintetizuara gati të gjitha proceset vepruese të faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm gjatë të kaluarës gjeologjike .

Relievin e Bjeshkëve të Nemuna, si një kompleks gjeomorfologjik, e karakterizojnë forma të shumta e të ndryshme tektonike, glaciale, fluviale, karstike dhe te denudacionit. Këto forma gjenetikiisht të ndryshme shpeshherë kombinohen dhe plotësohen në mes vete duke i dhënë pejsazhe të ndryshme Bjeshkëve të Nemuna dhe pamje të veçanta me cirçe, lugina akullnajore, morena, liçej, etj si pasojë e proceseve glaciale në pleistocen.

Gryka e Rugovës është gryka më e bukur e më atraktive e Kosovës, prej Pejës e deri në Bjelluhë, në gjatësi prej afër 22 km, e thellë dhe me shpate të pjerrta shkëmbore dhe fund (shtratë) të ngushtë. Në pjesën e poshtme

në gjatësi prej afër 6 km, është e thelluar në shkëmbinjë gelqeror (mbi 1200 m thellsi) në formë të kanjonit tipik, shpate gati vertikale që drejt zbrezin në shtratin e ngushtë të lumit. Burimet ujore karstike në lartësi afer 30 m në shpatet e luginës dhe derdhja e tyre në formë ujëvarash, rrjedhjet e shpejta të ujit si dhe vorbullat (thellimet rrethore në shkëmbinjë të shtratin – „kazanat“) ia shtojnë edhe më tepër atraktivitetin Grykës së Rugovës.

→ Hipsometria e terrenit





Nga format karstike, për nga rëndësia veçohet Shpella e Radavcit, me hyrje në lartësi 750 m, nga e cila fillon kanali kryesor i cili degëzohet në kanalet anësore. Në shpellë janë zbuluar galeri, salla, kada, liqenj etj. Pjesa më e madhe e shpellës është e stolisur me draperi dhe stalagmite e stallagmite. Në Grykën e Rugovës dhe Bisticës së Deçanit ekzistojnë shpella dhe zgavra në anët e thikta të luginës, në ato pjesë të cilat janë të ndërtuara nga shkëmbinj të gëlqeror.

### 1.2.5. Karakteristikat gjeologjike

Bjeshkët e Nemuna për nga ndërtimi gjeologjik-gjeomorfologjik janë male të reja. Ato karakterizohen me ndërtim gjeologjik shumë të larmishëm dhe kompleks të përbërë kryesisht nga shkëmbinjtë sedimentarë dhe metamorfik e më pak nga ata vullkanik. Formacionet më të vjetra janë ato të Paleozoikut të përhapura kryesisht në malet e Deçanit, Gjeravicës, Kozhnjerit, Maja Ropës. Në masë më të vogël përhapen edhe në pjesën veriore, si dhe në anën e majtë të Lumbardhit të Pejës, Shtupeqit të Madh dhe Rekës së Allagës. Përfaqësohen nga rreshpe, ranor, shiste etj.

**Triasiku** – formacionet shkëmbore të Triasikut përhapen në Malin Hajla, Malet e Lumbardhit dhe Grykën e Rugovës. Përfaqësohen nga ranorët, brekçiet, konglomeratet, gëlqerorët, dolomitet, diabazet, gabrot, peridotitet, kuarckeratofiret, granitet dhe rreshpet kristalike. Triasiku i Poshtëm-Mesëm është i përhapur në vendbanimin Batushë (jug) dhe në Malet e Junikut, Vokshit dhe Strellcit (veri). Përfaqësohet nga seria vullkanogjeno-sedimentare, gëlqerorë, dolomite, serpentinite, diabaze, granite dhe kuarçporfire. Triasiku i Mesëm përhapet në Malet e Zhlebit, Hajles dhe në Grykën e Rugovës. Përfaqësohet me formacione vullkanogjeno-sedimentare, gëlqerorë, brekçie etj. Triasiku i Sipërm përhapet në Bjeshkë e Lumbardhit, Koprivnik, Malin e Thatë dhe Grykë të Rugovës. Përfaqësohet me gëlqerorë shtresor dhe masiv ngjyrë hiri dhe kuqrrëmët.

**Jurasiku** – formacionet e Jurasikut janë të përhapura në rrethinën e vendbanimit Kuqishtë.

Ndërtimi gjeologjik i nëntokës në zonën e Bjeshkëve të Nemuna është i llojlojshëm, mirëpo mungojnë studime të thella sa i përket pasurive minerare. Në bazë të Autoritet të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerare të Kosovës (KPM), supozohet se në territorin e PK "Bjeshkët e Nemuna", kryesisht në pjesën jug-lindore të Parkut janë të identifikuar mineralet kryesore të përfaqësuara nga: gëlqerja, mermeri, rëra, zhavori, azbesti, piriti, talku dhe sientiti.



### 1.2.6. Karakteristikat hidrogjeologjike

Karakteristikat hidrogjeologjike të zonës së Parkut Kombëtar „Bjeshkët e Nemuna“ janë trajtuar në bazë të të dhënave të disponueshme dhe hulumtimit të terrenit gjatë procesit të hartimit të profilit të Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar „Bjeshkët e Nemuna“. Duke u bazuar në dokumentacionin arkivor (projekte, elaborate, harta dhe profile) dhe vlerësimeve të bëra direkt në terren, njëkohësisht duke pasur parasysh

ndërtimet gjeologjike, litologjike, strukturore e tektonike, në zonën e parkut janë dalluar katër tipe të akuiferëve (horizonteve ujëmbajtëse) ujore:

- Akuiferët me porozitet intergranular
- Akuiferët me porozitet të çarjeve
- Akuiferët me porozitet karstik
- Terrenet pa ujë

→ Ndërtimi gjeologjik



→ Pasuritë nëntokësore



**Akuiferët me porozitet intergranular** – Akuiferët që lidhen me depozitimet e këtij kompleksi janë përgjithësisht të tipit poroz dhe përmbajnë kryesisht ujëra të tipit freatik. Ky tip i akuiferit ka përhapje të kufizuar në zonën e parkut, kryesisht është i lokalizuar në pjesën jugore dhe jugperëndimore. Vlerësohet të jetë me ujëpërshkueshmëri të lartë dhe të mesme, me koeficient filtrimi „Kf”  $>10^{-5}$  m/s. Në aspektin litologjik përbëhet nga rëra, rëra dhe zhavori, zhavori, zhavori ranor gjysëm i lidhur, rëra argjilore dhe lymi. Në profil vertikal dominojnë zhavoret, ranoret me granulime të ndryshme. Po ashtu vërehen edhe anëtarë të tjerë në kompleksin aluvial siç janë: argjilat, rërat argjilore me kalime graduale në ranor dhe zhavorr. Rezervat e shfrytëzueshme të këtij akuiferi formohen në llogari të infiltrimit të ujërave sipërfaqësore dhe si të tilla paraqesin interes për shfrytëzimin e tyre për ujë të pijshëm dhe kërkesa tjera. Këta akuiferë karakterizohen nga këto veti kryesore:

- Janë ujëra pa presion (nivel të lirë)
- Lulatja e nivelit të ujit varet kryesisht nga reshjet atmosferike
- Regjimi i tyre varet nga pozita gjeografike, klima, relievi, rrjeti hidrografik, mbulesa e tokës etj.
- Shtrirja e horizontit ujëmbajtës përputhet me zonën e ushqimit
- Kanë përgjithësisht lidhje hidraulike me ujërat e lumenjve
- Ushqehen nga lumi dhe ushqejnë lumin me ujë, respektivisht gjatë stinëve të thata dhe me reshje.


**Akuiferi me porozitet të çarjeve** – Ky tip i akuiferit është i përhapur në shkëmbinj të me çarje (gëlqerorë, ranor, mermere, konglomerate, shkëmbinj plutonik etj). Përhapen në malet e Kozhnjerit, Deçanit, Kuqishtës, Gjeravices dhe Vokshit. Formacionet shkëmbore që përbëjnë këtë akuifer paraqiten me veti të dobëta akumuluese të ujërave nëntokësore. Koeficienti i filtrimit luhetet nga  $10^{-5}$  deri  $10^{-9}$  m/s. Shkëmbinjet e këtij akuiferi janë kompakt, me shkallë të plasaritjes relativisht të lartë dhe duke iu nënshtruar ndryshimeve mekanike dhe fiziko-kimike, këta shkëmbinj në sipërfaqen e tyre pësojnë prishje dhe kanë një përhapje të dobësimit ndërkokrrizor. Kjo shkallë e prishjes (degradimit) gjatë plasaritjeve mundëson futjen e ujit në brendi të tyre nëpër sistemet e çarjeve të cilat ndërmjet veti janë të lidhura dhe në këtë mënyrë favorizojnë formimin e akuiferëve të tipit të çarjeve. Burimet e ujit që drenojnë nga ky akuifer kanë kapacitet ujëdhënjeje të vogël, nga 0.1 deri 1 lit/s e rralë herë deri në 10 lit/s. Mund të thuhet që tipi çarës është një tip i akuiferit mjaft specifik në pikëpamje të rezervave të burimeve ujore dhe kushteve të formimit të tyre. Nga aspekti i resurseve ujore, ky tip i akuiferit nuk ka ndonjë rëndësi të konsiderueshme brenda zonës së parkut.

**Akuiferi me porozitet karstik** – Në aspektin hidrogeologjik, gëlqerorët dhe mermeret që përbëjnë këtë akuifer, karakterizohen nga resurse të bollshme të ujërave nëntokësore të tipit karstik. Ka përhapje mjaft të madhe në zonen e parkut, kryesisht në pjesët perëndimore të zonës së parkut në: Bjeshkët e Pejës, Maja e Hasanit, Rusolia, Mokna. Gëlqerorët janë mjaft të karstifikuar dhe dallohen nga forma karakteristike (kanale, kaverna, shpella etj), ç’ka ka kushtëzuar formimin e rezervuarve të mëdhenj të ujërave nëntokësore. Koeficienti i filtrimit luhetet nga  $10^{-3}$  deri  $10^{-9}$  m/s. Numri më i madh i burimeve nëntokësore të ujit lidhet me këtë akuifer të cilet kanë prurje/ kapacitet të lartë dhe të qëndrueshëm. Burimet dalin në prerjet erozionale të shkëmbinjve karbonatikë - luginat e lumenjve, ose në kontaktet e gëlqerorëve me formacionet shistozë apo flihoodalë të

papërshkueshme, në nivele të ulëta hipsometrike. Prurjet e këtyre burimeve luhaten prej 20-100 l/s deri në 10 m<sup>3</sup>/s.

Karakteristike e veçantë e burimit të tipit karstik është amplituda e madhe e luhatjes së prurjes.

→ Njësitë hidrogeologjike





Duke u nisur nga karakteristikat e përgjithshme gjeologjike dhe hidrogjeologjike, si dhe pozicionit hapësinor ku janë të vendosura akuiferët karstikë në zonën e parkut, konstatohet se ky tip akuiferi ushqehet kryesisht nga reshjet atmosferike (shi dhe borë). Tip i akuiferit karstik paraqet akuiferin më të rëndësishëm sa i takon ujërave nëntokësorë në zonën e Parkut Kombëtar „Bjeshkët e Nemuna”. Sot nga burimet e ujit që dalin nga ky akuifer furnizohen me ujë të pijshëm shumë vendbanime brenda dhe jashtë zonës së parkut kombëtar. Valorizimi ekonomik dhe shfrytëzimi racional i ujit nga ky akuifer do ta rriste vlerën jo vetëm të parkut por edhe të rrethinës.

**Terrenet pa ujë** – Pjesët e terrereve pa ujë (akuiferë me ujëmbajtje shumë të vogël) kanë përhapje relativisht të madhe në zonën e parkut. Shtrihen nga jugu deri në perëndim. Në aspektin litologjik janë të ndërtuara në formaconet e Paleozoikut, të përfaqësuara me rreshpet, rreshpet epidotike, filite, shiste, ranore, meta-konglomerate, meta-gabro, diabaze, meta-bazalte, serinë metamorfike, porfiridet, straloret, diabazat, serinë strallore, shkëmbinjë magmatik, flish dhe seritë e ngjashme me to, të cilat sipas vetive të tyre hidrogjeologjike paraqiten si izolator hidrogjeologjik. Kanë koeficient filtrimi  $< 10^{-9}$  m/s. Poroziteti i këtyre shkëmbinjve, si ai primar ashtu edhe ai sekondar, në kuadër të këtyre shkëmbinjve s'mund të formojnë rezervoarë të rëndësishëm të ujit. Në pjesët sipërfaqësore të terrenit, për efekt të një shkatërrimi intensiv të masave shkëmbore mund të vijë deri të akumulimi i sasive të caktuara të rezervave ujore të cilat do të tërheqin vëmendjen për hulumtime hidrogjeologjike detale.

### 1.2.7. Veçoritë hidrogjike

Ujërat në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" mund të trajtohen si :

- Resurse natyrore
- Dukuri ose objekte unike me vlera atraktive burimore
- Pjesë përbërëse ose komponentë e ekosistemeve, objekteve, dukurive dhe hapësirave me vlerë të veçantë për mbrojtje.

Zona e parkut kombëtar ka rrjet hidrografik mjaft të dendur. Parku përvijohet nga disa lumenj si: Lumi Istog, Lumbardhi i Pejës, Deçanit, Lloqanit, Ereniku etj. Ai ka edhe disa lumenj me të vegjël, si dhe disa përrokca me rrjedhje të përhershme dhe të përkohshme. Të gjitha ujërrjedhat e parkut kanë drejtim të rrjedhjes perëndim – lindje dhe juglindje të cilët shkarkohen në lumin Drini i Bardhë i cili paraqet ujëmbledhësin kryesor të Basenit të Dukagjinit. Të gjitha burimet e lumenjve ndodhen në lartësi mbidetare mbi 1000 m, duke rrjedhur nëpër lugina të thella dhe të ngushta të komplekseve malore të parkut.

Pjesa e sipërme e lumenjve karakterizohet me rrjedhje të shpejtë dhe të vrullshme dhe duke rrjedhur në drejtim të ultësirës së Rrafshit të Dukagjinit (rrjedha e mesme dhe e poshtme), shtrati i këtyre lumenjve fillon të zgjerohet, shpejtësia e rrjedhjes së tyre zvogëlohet dhe depozitohet materiali eroziv të cilin ata e bartin. Uji i këtyre lumenjve nga burimi e deri në rrjedhën e mesme, vlerësohet të ketë cilësi të mirë. Lumenjve nga të dy krahët (anët) i bashkohen numër i madh i ujërrjedhave (lumenj të vegjël dhe përrokca). Ujërrjedhat me veprimtarinë dinamike të tyre kanë pasur dhe kanë edhe sot rol të rëndësishëm në formësimin dhe modelimin e relievit brenda zonës së parkut duke i shtuar edhe më tej vlerat e këtij parku.



→ Burimi i Drinit të Bardhë

**Lumbardhi i Pejës** buron në Usovishhtë, në lartësi mbidetare 1932m. Formon rrjedhën e tij duke prerë në formë kanioni formacionet gëlqerore të Grykës së Rugovës. Pellgu ujëmbledhës i këtij lumi është 503,5km<sup>2</sup>. Matjet në stacionin hidrometrik Gryka kanë treguar se prurjet - rrjedhja (dalja - largimi) e ujit janë: Qmes.vjet.=6.21 m<sup>3</sup>/s. Prurja e ujit prej 6,21 m<sup>3</sup>/s, tregon për një vëllim të ujit në dalje (largim) përmes rrjedhjeve sipërfaqësore (lumi) prej: 195.83\*10<sup>6</sup> m<sup>3</sup>. Matjet në stacionin hidrometrik Drelaj kanë treguar se prurjet- rrjedhja (dalja- largimi) e ujit janë: Qmes.vjet.=4,33 m<sup>3</sup>/s. Prurja e ujit prej 4,33 m<sup>3</sup>/s, tregon për një vëllim të ujit në dalje (largim) përmes rrjedhjeve sipërfaqësore (lumi) prej: 136.55\*10<sup>6</sup> m<sup>3</sup>.

**Lumbardhi i Deçanit** formohet prej dy lumenjve; Kozhnjerit (djathtas) dhe Marjashit (majtas). Ka sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës prej 278,3 km<sup>2</sup>. Është lum malor dhe formon luginë të ngushtë dhe të thellë me pjerrësi mesatare në rrjedhën e sipërme 80 m/km. Matjet në stacionin hidrometrik të Deçanit kanë treguar se prurjet-rrjedhja (dalja-largimi) e ujit janë: Qmes.vjet.=4,64 m<sup>3</sup>/s. Prurja e ujit prej 4,64 m<sup>3</sup>/s, tregon për një vëllim të ujit në dalje (largim) përmes rrjedhjeve sipërfaqësore (lumi) prej 146,32\*10<sup>6</sup> m<sup>3</sup>.

**Lumbardhi i Lloqanit** buron nga shpatet e Kurvallës, Dervishkomit, Stanishtës së Zogut dhe nga Gurrat e Hasanagës në lartësi mbidetare 2100m. Pellgu i lumit të Lloqanit përkrahon fshatrat Hulaj, Lloqan, Carrabreg i Epër, Prejlep Rastavicë, Baballoq, Gramaqel dhe Jasiq. Ky lumë përveç që ujit fushat e këtyre fshatrave, uji i tij shpenzohet për ujitje të fushave edhe të shume fshatrave tjera si: Pobergjë, Voksh, Sllup, Dranoc etj. Shtrati i Lumit të Lloqanit pjesërisht është i rregulluar. Janë ngritur diga në Hulaj dhe Lloqan për pengimin e erozionit të shtratit të lumit dhe brigjeve të tij.



→ Liqeni i zemres

**Lumi Erenik** buron në bjeshkët e Junikut dhe të Vokshit nën Majën Dervish Kom (2256 m). Ka gjatësi rreth 51 km dhe sipërfaqe të pellgut 515,5 km<sup>2</sup>. Pjesa e sipërme karakterizohet me shkallë të lartë erozive duke bartur dhe depozituar material eroziv në pjesën fushore të tij. Matjet në stacionin hidrometrik të Deçanit kanë treguar se prurjet - rrjedhja (dalja - largimi) e ujit janë: Qmes.vjet.=2.04 m<sup>3</sup>/s. Prurja e ujit prej 2.04 m<sup>3</sup>/s, tregon për një vëllim të ujit në dalje (largim) përmes rrjedhjeve sipërfaqësore (lumi) prej 386.3\*10<sup>6</sup> m<sup>3</sup>.

**Lumi Istog** buron në rrëzat e maleve të Moknës, ka sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës prej 446,7 km<sup>2</sup>. Është lumë kryesisht fushor me pjerrtësi mesatare 14m/km. Në pjesën e sipërme shtrati i lumit arrin gjëresi rreth 4 m, ndërsa në pjesën e mesme dhe të poshtëm gjëresia luhet nga 1-6 m.

Në kompleksin malor të Bjeshkëve të Nemuna paraqitet një numër i madh i liqeneve me origjinë glaciale të njohur në mënyrë popullore si "sytë e maleve". Liqenet për nga gjëresa e tyre kanë rëndësi të madhe shkencore dhe edukative.

Gurrat dhe degët e Drinit të Bardhë të cilat formohen në kompleksin malor të Bjeshkëve të Nemuna disponojnë me predispozita natyrore për ngritjen e minihidrocentraleve me fuqi instaluese me rëndësi lokale.



**Burimet e ujit** - Bazuar në të dhënat ekzistuese brenda kufirit të Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" ekzistojnë rreth 730 burime uji. Prurjet e ujit (kapaciteti ujëdhënës) luhatet nga 0,03 deri në 3000 l/s. Vlera e pH luhatet nga 5 deri në 7. Uji nga këto burime ka cilësi të lartë dhe nuk kërkon masa trajtuese dhe përpunuese me kosto të lartë.

**Burimi „Drini i Bardhë”** është burim i kontaktit në mes të gëlqerorëve dhe formacionit diabaz - strallor. Temperatura e ujit është 7°C, ndërsa vlera e pH është 6,5. Matjet sistematike të kryera në periudhën 1954-1970, kanë treguar se vlera mesatare mujore variron nga 1.0 m<sup>3</sup>/s deri 21 m<sup>3</sup>/s, ndërsa vlera mesatare vjetore variron prej 3.5 m<sup>3</sup>/s -8m<sup>3</sup>/s. Uji nga ky burim shfrytëzohet për ujëfurnizim, ujitje dhe gjenerim të energjisë elektrike.

**Burimi i Istogut** del në lartësinë mbidetare 530 m, në kontakt të gëlqerorëve, formacioneve diabaz-strallore dhe rreshpeve. Pellgu ujëmbledhës i burimit vlerësohet të jetë 76 km<sup>2</sup>. Matjet sistematike të rrjedhjeve ujore në këtë burim janë bërë në dy periudha: prej vitit 1933-1941 dhe 1953-1959. Është konstatuar se prurjet mesatare vjetore sillen nga 2.4 deri në 4 m<sup>3</sup>/s. Uji nga ky burim shfrytëzohet për furnizim me ujë të pijshëm, ujitjen e tokave bujqësore, gjenerim të energjisë elektrike, rritje të peshkut etj.

**Burimi i Vrellës** del në gëlqeror të karstifikuar dhe formacionit diabaz-strallor. Prurjet janë matur në periudhën 1961-1963 dhe është konstatuar një prurje (kapacitet) nga 0.12 deri 1.5 m<sup>3</sup>/s. Që është karakteristik e burimeve karstike. Uji nga ky burim shfrytëzohet për furnizim me ujë të pijshëm, ujitjen e tokave bujqësore, rritje të peshkut etj.

**Burimet "Uji i Bardhë" dhe "Uji i Zi"** ndodhen në pjesën jugore të Malit Rusolija dhe Burimit të Hasanit. Kufirin lindor e përfaqësojnë sedimentet e Miocenit, të cilat transgresivisht janë të shtrira mbi gëlqerorët e Triasikut. Kufirin lindor dhe perëndimor e përbëjnë formacionet diabaz – stallore. Sipas të dhënave të gjetura prurjet minimale të burimit "Uji i Bardhë" janë;  $Q_{min} = 64$  l/s, ndërsa "Uji i Zi", ka prurje  $Q = 245$  l/s. Prurjet maksimale ; burimi "Uji i Bardhë"  $Q_{max} = 252$  l/s dhe "Uji i Zi",  $Q = 413$  l/s. Uji nga këta burime shfrytëzohet për furnizim me ujë të pijshëm dhe për ujitjen e tokave bujqësore.

**Burimi mineral Manastirit të Deçanit** - Ky burim mineral është në masivin gëlqeror, në pjesën e majtë të lumit. Është burim i tipit karstik. Uji nga këta gëlqerorë del nga disa çarje dhe plasa në sipërfaqen e tokës dhe një pjesë në aluvionet e lumit. Pompimi testues kishte vërtetuar gjatë pompimit kapacitet  $Q = 16$  l/s, 180 metra më poshtë nuk kishte rrjedhje të ujit, ndërsa në metrin 175 m rrjedhja e ujit ishte  $Q = 1,4$  l/s. Mbi metrin 170 m, ritet kapaciteti në  $Q = 5,6$  l/s, në metrin e 80 m,  $Q = 7,0$  l/s dhe mbi 31 m, prurja e ujit ishte  $Q = 16$  l/s.

### 1.2.8. Veçoritë klimatike

Parametrat klimatike të kompleksit malor Bjeshkët e Nemuna mund të vlersohen nga aspekti i pozitës klimatike, rolit të kushteve orografike si faktor klimëformues, vlerave mesatare dhe ekstreme të elementeve klimatik, ndikimi i klimës në katëzimin e vegjetacionit, formsimin e pejsazheve autentike, si komponent e ekosistemeve, dukurive dhe hapësirave me vlerë të vaçantë si dhe rëndësia rekreativo-turistike e klimës.

Kompleksi malor Bjeshkët e Nemuna diferencohet me laryshi të theksuar të kushteve klimatike, morfo-hidrike dhe biodiversitet. Bjeshkët e Nemuna me rolin e tyre orografik ndikojnë që në një hapësirë relativisht të vogël të krijohen tipe të ndryshme klimatike.

Përthyeshmëria e theksuar vertikale e Bjeshkëve të Nemuna kushtëzon ndryshime të dalluara të elementeve klimatike me rritjen e lartësisë mbidetare.

Bjeshkët e Nemuna cilësohen me sasi më të madhe të reshjeve atmosferike dhe numër më të madh të ditëve me reshje (mbi 130 ditë). Bjeshkët e Nemuna poashtu cilësohen edhe me pjesëmarrje të madhe të reshjeve atmosferike në formë bore. Derisa në pjesët e ulëta të Kosovës mesatarisht paraqiten 20-30 ditë me reshje bore, në Bjeshkët e Nemuna, varësisht nga lartësia mbidetare, paraqiten 40-80 ditë. Mbulesa e borës në Dukagjin mesatarisht zgjat 40 ditë, kurse në Bjeshkët e Nemuna varësisht nga lartësia mbidetare prej 60-210 ditë.

Elementet kryesor klimatik në kompleksin malor Bjeshkët e Nemuna kanë këto vlera: Diellosja, sipas gjerësisë gjeografike, lartësisë mbidetare dhe shkallës së vrërësive diellosja reale është përafërsisht 44% e vlerës potenciale (4459 orë me diell). Kjo vlerë ndryshon nga rreza malore (1945 orë) deri në afro 2200 orë me diell në lartësitë mbidetare mbi 2000m.

Temperatura, vlera mesatare vjetore e temperaturës të ajrit në zonën rrezë malore është rreth 10.2 °C, kurse në lartësi mbi 2000 rreth 5 °C, amplitudat vjetore zvoglohen me rritjen e lartësisë mbidetare nga 21.3 °C, në rrëzën malore, deri në 17 °C, në pjesët më të larta, muaji më i ngrohtë është koriku kurse më i ftohtë janari.

Reshjet atmosferike, lëkundën nga 1000 mm në zonën rrezë malore deri në 1500 mm në terrenet mbi 2000m, duke arritur vlerën maksimale në skajin perëndimor të pjesës burimore të Bistricës së Deçanit. Mbulesa e borës në lartësitë mbidetare mbi 2000 m zgjatë afërsisht 60% të vitit.

Në pjesën më të madhe të Bjeshkëve të Nemuna frekuencë më të theksuar kanë erërat nga kahu perëndimor, jugperëndimor dhe verilindor. Në

përgjithësi komponenta verilindore e erërave ka frekuencë më të madhe dimrit, kurse ajo jugperëndimore verës dhe në vjeshtë.

### 1.2.9. Erozioni

Erozioni shtrihet në hapësirat e tokave bujqësore, të kultivuara apo braktisura, në tokat pyjore e livadhore, shtretërit e lumenjve, përrrenjtë dhe tokat përreth tyre. Dëmet e shkaktuara prej tij ndjehen jo vetëm në bujqësi, pylltari por dhe në fusha të tjera të ekonomisë, sikurse urbanistikë, transport, ndërtim dhe energjetikë.

Efekti shkatërues i erozionit është rezultat i faktorëve klimatik natyror, kryesisht i ndikuar nga sasia, lloji, intenziteti dhe kohëzgjatja e reshjeve, lloji dhe shkalla e mbulueshmërisë së tokës, pjerrtësia e terrenit dhe përbërja pedologjike si dhe nga faktori njeri (prerja ilegale e pyjeve, nxjerrja e zhavorit, mbikullotja, veprat ndertimore pa kriter etj).

Tabela në vazhdim prezanton modelimin e 4 shkallëve të erozionit në bazë të disa parametrave hipotetik, të cilët prezantojnë shkallët potenciale të erozionit brenda parkut kombëtar.

Nr	Shkalla	ha	%
1	Erozion i Ultë	4816	8
2	Erozion i mesëm	5242	8
3	Erozion i lartë	6471	10
4	Erozion shumë i lartë	46405	74


→ Llogaritet sipas SES (ALUP)

Në bazë të të dhënave studimore sipërfaqe të rrezikuara nga erozioni i fortë dhe shumë i fortë në PK, "Bjeshkët e Nemuna" janë 52876 ha ose 84% e sipërfaqes së përgjithshme .

Llogaritjet janë bërë sipas SES (sasisë së reshjeve, pjerrtësisë së terrenit dhe përbërjes pedologjike).

→ Erozioni ne Park





→ Ndjeshmëria e tokave nga erozioni

### 1.2.10. Zonat sizmike


Bazuar në hartën sizmotektonike për periudhën 500 vjeçare, maksimumi i intensitetit në zonën e parkut dhe rreth saj është 8 shkallë Merkali në rrethinën e Pejës, ndërsa në pjesën më të madhe të territorit të parkut është VI shkallë Merkali e në skajin me perëndimor V shkallë Merkali.

Rezultatet e analizave të bëra ofrojnë të dhëna të domosdoshme për kalkulime strukturale bazuar në rregullat e standardeve teknike për ndërtimin e konstruksioneve në zona sizmike. Nëse kalkulimet bazuar në eurokode 8 zbatohen, studimi IZIS do të përdoret për të përkrahur dokumentacionin në baza ku forcat sizmike mund të kalkulojnë sipas eurokodit 8.

Në bazë të pikës së nxitimit PGA të llogaritur, gjendja sizmike është me sa vijon:

- Pjesa veriore dhe veri-perendimore shtrihet në zonën me shkallë të rrezikshmerisë prej V shkallësh të Merkali dhe përfshinë të gjitha fshatrat e Rugovës si dhe pjesët e territorit të komunës së Istogut. Në shkallën VI të Merkali përfshihet një pjesë e territorit të komunës së Pejës dhe Decanit.
- Pika e nxitimit është për një nuancë më e lartë në komunën e Junikut dhe në një pjesë të Decanit, kurse zona me rrezikshmëri më të lartë është në Koshare në komunën e Gjakovës.

→ Shkallët sizmike





### 1.2.11. Shfrytëzimi i tokës

Këtu janë dhënë 6 kategori (klasa) kryesore të shfrytëzimit ose mbulueshmërisë së tokës në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna". Ato janë pyjet, kullosat, shkrepat, liqenet, vendbanimet dhe gurthyesit. Kategoritë tjera, si rrugët dhe rrjedhjet ujore nuk janë pjesë e kategorizimit të shfrytëzimit të tokës, ato prezantohen vetëm si vija në hartën e shfrytëzimit të tokës. Janë dhënë kategoritë dominuese në mënyrë të përgjithshme si dhe proporcioni në mes të këtyre kategorive.

Pyjet - janë kategori e veçantë në nomenklaturën e shfrytëzimit të tokës dhe paraqesin vegjetacionin drunor i cili përbëhet kryesisht nga halorët, pyjet e dushkut dhe vegjetacioni tjetër drunor ose shkurret. Në metodologjinë e dizajnuar janë përfshirë të gjitha llojet e pyjeve pa dallim e të cilat përbëjnë një strukturë hapësinore unike.

Kullosat - janë kategori e veçantë e vegjetacionit barishtor dhe përbëhen kryesisht nga kullosat dhe livadhet. Në këtë kategori janë të përfshira të gjitha kullosat, pavarësisht nëse janë të shfrytëzueshme momentalisht ose jo, por të cilat paraqesin potencial për shfrytëzim të tyre.

Shkrepat - janë majat më të larta malore dhe terrenet tjera të thepisura ose edhe hapësirat tjera më material të eroduar, alternuara, shembura që nuk janë të mbuluara me vegjetacion ose janë fare pak të mbuluara. Në këto hapësira zakonisht mbizotëron mikroklimë dhe kushte tjera të faktorëve ekzogjen që nuk mundësojnë shfrytëzimin e tyre për nevojat e aktiviteteve humane.

Liqenet - janë objekte hidrografike me ujë të ëmbël dhe të cilat kufizohen me tokë. Liqenet në hapësirën e PK "Bjeshkët e Nemuna" janë kryesisht liqene glaciale të cilat janë krijuar si rezultat i aktivitetit të akullnajave. Për nga dimensionet liqenet janë të ndryshme, qoftë në madhësi, thellësi dhe në qëndrueshmëri. Disa nga këto liqene gjatë kohës së verës, dhe sidomos gjatë verërave të thata edhe shterojnë.

Vendbanimet - në këtë rast përbëhen kryesisht nga objektet e banimit, stanet dhe objektet tjera me zhvillime të caktuara (aktivitetet industriale, komerciale ose shërbyese). Në territorin e parkut kombëtar ndodhen gjithsejtë 21 vendbanime zyrtare (sipas regjistrimit të popullsisë të viti 2011).

Gurthyesit - janë vendet ku zhvillohen aktivitetet ekonomike të ekstraktimit dhe përpunimit të gurit gëlqeror ose zhavorit në sipërfaqe të tokës.

→ Kategoritë e shfrytëzimit të tokës.

Kategoria	ha	%	Njësia e fragmentimit hapësinor
<b>Pyje</b>	45,166.63	71.66	734
<b>Kullosa</b>	15,520.18	24.62	879
<b>Shkrepa</b>	1,883.57	2.99	47
<b>Liqene</b>	9.35	0.01	16
<b>Vendbanime</b>	438.77	0.70	1006
<b>Gurthyes</b>	9.40	0.01	4
<b>Totali</b>	63,027.90	100.00	2686

Tabela e mësipërme tregon kuantitetin e shfrytëzimit të tokës në park. Pyjet mbulojnë hapësirën dërmuese të parkut, me një pjesëmarrje me 45,166ha ose 71.6% dhe me një shtrirje gjithandej parkut. Pyjet njëherit janë edhe resursi më i madh natyror dhe struktura më e madhe hapësinore në park. Ato përbëhen kryesisht nga pyjet e dushkut (qarri, bungu, shpardhi), ahu, etj. dhe halorët (rrobulli, arneni, kërrleka, hormoqi, etj). Pyjet duke qenë resursi kryesorë natyror në territorin e parkut, njëkohësisht janë edhe më të kërcënuarat nga shfrytëzimi i pa kontrolluar dhe keq menaxhimi i tyre. Kjo strukturë hapësinore mjedisore është e rrezikuar, dëmtime shihen gjithandej parkut. Në bazë të vëzhgimeve në terren, të ndihmuara edhe nga analiza fotogrametrike në GIS, vërehet se dëmtimi më i madh i pyjeve bëhet për qëllime të sigurimit të drurit për ngrohje dhe përdorimit të tij në ndërtimtari e më pak në industri.

Së bashku me arealin e pyjeve shoqërohen edhe shumë bimë të tjera aromatike dhe fruta malore të cilat kanë përdorim të gjerë, duke filluar nga amvisëria e deri në industrinë ushqimore dhe farmaceutike. Një ndër këto bimë e cila ka rëndësi shumë të madhe edhe në vet ekonominë e banorëve që jetojnë në park është boronica, mjedra dhe bimë të tjera të ngjashme.

Ndër fatkeqësitë më të pranishme në territorin e parkut, të cilat lidhen direkt me sipërfaqet nën pyje janë zjarret dhe rrëshqitjet e dheut. Për shkak të mungesës së informatave të sakta ose ndonjë hulumtimi, nuk dihet saktësisht shkalla e dëmtimit të pyjeve nga këta faktorë, por ajo që dihet është se pyjet herë pas here dëmtohen nga zjarret e qëllimshme dhe nga rrëshqitjet e dheut, si rezultat i gërmimeve nga hapja e rrugëve të reja apo zgjerimi i tyre, si dhe nga ndërtimet tjera.

Kullosat për nga pjesëmarrja i pasojnë pyjet me 15,520ha ose 24.6%, dhe janë jo më pak të rëndësishme se pyjet. Ato paraqesin gjithashtu një potencial të mirë zhvillimi për bujqësinë dhe veçanërisht për blegtorinë në territorin e parkut. Livadhet dhe kullosat, edhe pse për nga fondi janë të konsiderueshme, jo të gjitha prej tyre shfrytëzohen. Ujërat ose burimet ujore janë po aq të rëndësishme për shfrytëzim sa edhe vetë kullosat. Meqë terreni është kryesisht i përbërë nga shkëmbinjtë gëlqerorë, ujërat sipërfaqësor humbin në thellësi dhe kështu në disa raste krijojnë kushte shumë të pafavorshme edhe për formimin e burimeve ujore permanente.

Shkrepat për nga pjesëmarrja në raport me kategoritë e tjera të shfrytëzimit të tokës në park, vijnë pas kullosave. Kjo kategori merr pjesë me 1883ha ose 2.9%. Shkrepat kryesisht shtrihen në lartësi të mëdha mbidetare dhe kanë pjerrtësi të mëdha. Në shumicën e rasteve janë pjesë e zonave me terrene më të ashpra. Për nga shfrytëzimi, duke marrë në konsideratë shtrirjen e tyre gjeografike dhe karakteristikat e tyre fiziografike, shkrepat janë të pashfrytëzueshëm, por paraqesin veçanti në aspektet tjera faunistike ose floristike si pjesë e biotopeve të veçanta dhe si pjesë përbërëse e ekosistemit në tërësi në park.

Numri i vendbanimeve në park është gjithësejt 21, ndërsa numri i strukturave hapësinore urbane ose rurale të identifikuar është 1006 njësi fragmentimi. Pjesëmarrja e tyre në shfrytëzimin e tokës është 438.7ha ose 0.70% nga totali. Në këtë kategori përveç vendbanimeve hyjnë edhe stanet ose format tjera të strehimit sezonal, objektet hoteliere, komerciale, industriale, shërbyese, fetare dhe të tjera. Raporti në mes të madhësisë kuantitative të vendbanimeve me numrin e njësive të fragmentimit është shumë i madh, ndër më të mëdhenjtë që tregon për shpërndarjen e madhe

të kësaj strukture në njësi sipërfaqeje, e kjo është më e theksuar në vendbanimet që shtrihen në pellgun e lumit Lumbardhi i Pejës gjegjësisht në anën veriore të Luginës së Rugovës.


Në vazhdim do të trajtojmë raportin në mes të kullosave dhe vendbanimeve me faktorët tjerë fiziko-gjeografik që kanë të bëjnë me topografinë e terrenit. Arsyeja e veçimit të këtyre dy klasave të shfrytëzimit të tokës bëhet për shkak që, këto dy tipologji kanë karakteristika më të veçanta të shfrytëzimit në raport me faktorët fiziko-gjeografik të relievit dhe nevojave humane. Dallimi i sipërfaqeve të kullosave në mes të tabelës së përgjithshme të shfrytëzimit të tokës dhe tabelave tjera në vazhdim është për shkak të mospërputhjes së shkallës dhe ndërtimit të bazës rasterike të topografisë dhe vektorit të kullosave.

Raporti në mes të kullosave dhe hypsometrisë së terrenit tregon për mundësit dhe kufizimet që paraqesin faktorët topografik në shfrytëzimin e tyre gjatë vitit. Sa më e madhe të jetë lartësia mbidetare aq më e kufizuar është koha e qëndrimit të bagëtive në kullota dhe anasjelltas.

→ Raporti në mes të kullosave dhe hypsometrisë së terrenit

Nr.	Gradienti hypsometrik	ha	%
1	Nën - 600m	1.00	0.01
2	600.1 - 700m	39.50	0.25
3	700.1 - 800m	85.75	0.55
4	800.1 - 900m	99.00	0.64
5	900.1 - 1,000m	70.00	0.45
6	1,000.1 - 1,250m	354.75	2.28
7	1,250.1 - 1,500m	1681.25	10.80
8	1,500.1 - 1,750m	3401.50	21.84
9	1,750.1 - 2,565m	9795.25	62.90
<b>Totali</b>		<b>15528.00</b>	<b>100.00</b>

Siç shihet edhe nga tabela e mësipërme ekziston një ndërlidhje në mes të lartësisë mbidetare dhe kullosave, sa më madhe lartësia mbidetare aq më e madhe do të jetë sipërfaqja nën kullosa.




→ Shfrytëzimi i tokës

Siç shihet edhe nga tabela e mësipërme ekziston një ndërlidhje në mes të lartësisë mbidetare dhe kullosave, sa më madhe lartësia mbidetare aq më shumë sipërfaqe nën kullosa ka. Shumica dërmuese e sipërfaqeve nën kullosa ose 63% e kullosave (9826ha) shtrihen mbi lartësinë mbidetare 1750m, ndërsa me uljen e hypsometrisë zvogëlohet edhe fondi i sipërfaqeve nën kullosa. Në lartësinë mbidetare në mes të 1500-1750m ndodhën 22% e sipërfaqeve nën kullosa, derisa në lartësinë nga 1000m deri në 1500m ndodhën rreth 12% të sipërfaqeve nën kullosa ose 2040.75ha. Në lartësinë mbidetare 1000m ndodhën 1.9% e kullosave në park ose 295.57ha.

Raporti në mes të pjerrtësisë së terrenit dhe kullosave tregon mundësinë e shfrytëzimit të kullosave të kushtëzuar nga shkalla e pjerrtësisë së terrenit. Dihet që me rritjen e shkallës së pjerrtësisë së terrenit kufizohet mundësia e shfrytëzimit të kullosave për shkak të energjisë që e humb bagëtia gjatë kullotjes. Gjithashtu te kullotat përveç pjerrtësisë rëndësi ka edhe distanca deri te burimet e ujit.

Nr	Shkallë	ha	%
1	0.00 - 2.0°	76	0.49
2	2.0 - 5.0°	430.5	2.77
3	5.0 - 8.0°	937.75	6.04
4	8.0 - 15.0°	4468	28.77
5	15.0 - 30.0°	8610	55.45
6	mbi 30°	1005.75	6.48
<b>Totali</b>		<b>15528</b>	<b>100.00</b>

→ Raporti në mes të pjerrtësisë së terrenit dhe kullosave







Më tepër se gjysma e kullosave shtrihen në pjerrtësinë 15<sup>o</sup>-30<sup>o</sup> gjë që nuk paraqet ndonjë problem të madh, ndërsa kufizon deri diku potencialin prodhues të bagëtive duke mos e rrezikuar atë. 39% të kullosave ose 5912.25ha e tyre shtrihen në shpatet me pjerrtësi deri në 15<sup>o</sup>. Kullosa të pashfrytëzuara shtrihen në shpatet me pjerrtësi mbi 30<sup>o</sup> dhe kapin pjesëmarrje jo më shumë se 6% ose 1005.75ha.

Krahasimi tjetër me rëndësi sa i përket kullosave është edhe raporti i tyre me ekspozicionin. Kjo ndërlidhet me kohëzgjatjen e qëndrueshmërinë të borës mbi kullota dhe shfaqjen e këtyre të fundit për shfrytëzim nga bagëtia. Dihet që ekspozicionet veriore kanë prirje të mbajnë borën më shumë se sa ekspozicionet jugore, por edhe ato perëndimore dhe lindore. Tabela në vazhdim tregon raportin në mes të kullosave dhe ekspozicionit.

Nr.	Ekspozicioni	ha	%
1	Veri	1066	6.87
2	Verilindje	1976	12.73
3	Lindje	3017.25	19.43
4	Juglindje	2873.25	18.50
5	Jug	2695.75	17.36
6	Jugperëndim	1934	12.45
7	Perëndim	1178	7.59
8	Veriperëndim	787.75	5.07
<b>Totali</b>		<b>15528</b>	<b>100.00</b>

→ Raporti në mes të kullosave dhe ekspozicionit



→ Raporti në mes të kullosave dhe ekspozicionit

Nga të dhënat e tabelës dhe grafikonit shihet se rreth 55% e kullosave ose 8681ha e tyre shtrihen në shpatije me ekspozicion jugor dhe perëndimor, derisa rreth 45% ose 6847ha e tyre shtrihen në ekspozicione veriore dhe lindore.

Përveç kullosave, edhe vendbanimet është me rëndësi të trajtohen në raport me hypsometrinë, pjerrtësinë dhe ekspozicionin e terrenit. Brenda parkut kemi kryesisht vendbanime kodrinore-malore dhe vendbanime të përkohshme ose stane të cilat shtrihen mbi 1500m lartësi mbidetare. Vendbanimet janë të tipit të shpërndarë, ku njësitë e të njëjtit vendbanim karakterizohen me ndryshime të theksuara topografike, prandaj është e rëndësishme që kalkulimet të bëhen për njësi hektari dhe strukturë hapësinore fragmentimi të vendbanimeve, ku ka njësi të veçuara të kësaj kategori që janë nën një ha. Në kalkulime përfshihen të gjitha karakteristikat e specifikuar në tipologjinë e klasifikimit që është më lartë.

Nga analizat e bëra me GIS vërehet që shumica e vendbanimeve ose e hapësirës së ndërtuar që përfshihet në klasën e vendbanimeve ndodhet në lartësinë mbidetare mbi 1000m, 68.07% ose 299.5ha e tyre ndodhen në lartësinë mbidetare mbi 1500m, kurse vetëm 6.77% ose 19.25ha e tyre ndodhen nën lartësinë 1000m.

Nr.	Gradianti hypsometrik	ha	%
1	< 600	0.25	0.06
2	600.1 - 700	3.25	0.74
3	700.1 - 800	7	1.59
4	800.1 - 900	5	1.14
5	900.1 - 1,000	14.25	3.24
6	1,000.1 - 1,250	36.25	8.24
7	1,250.1 - 1,500	74.5	16.93
8	1,500.1 - 1,750	128	29.09
9	1,750.1 - 2,565	171.5	38.98
<b>Totali</b>		<b>440</b>	<b>100.00</b>


→ Raporti në mes sipërfaqes dhe hypsometrisë

Përveç hypsometrisë, rëndësi ka të tregohet edhe raporti në mes të vendbanimeve ose shputës së vendbanimit dhe pjerrtësisë së terrenit. Ligjërisht, me rritjen e shkallës hypsometrike ashpërsohen edhe kushtet dhe faktorët fiziko-gjeografik duke dhënë më pak mundësi për terrene më të rrafshëta dhe me pjerrtësi më të butë. Nga tabela e mëposhtme kuptohet që 48.47% e vendbanimeve ose 213.25ha e tyre shtrihen në terrene ose shpatije që kanë pjerrtësi 15<sup>o</sup> deri 30<sup>o</sup>, ndërsa 4.45% ose 178ha të tyre shtrihen në terrene me pjerrtësi 8<sup>o</sup>-15<sup>o</sup>. Në 8<sup>o</sup> pjerrtësi shtrihen 10.8% ose 47.5ha të sipërfaqes së vendbanimeve.

→ Raporti në mes pjerrtësisë së terrenit dhe vendbanimeve

Nr.	%	Shkallë	ha	%
1	0.12 - 3.5	< 2	1.75	0.40
2	3.6 - 8.8	2 deri 5	14.25	3.24
3	8.9 - 14	5 deri 8	31.5	7.16
4	15 - 27	8 deri 15	178	40.45
5	28 - 58	15 deri 30	213.25	48.47
6	59 - 360	mbi 30	1.25	0.28
<b>Totali</b>			<b>440</b>	<b>100.00</b>

**Raporti në mes të pjerrtësisë së terrenit<sup>(o)</sup> dhe vendbanimeve**



→ Shtrirja e vendbanimeve sipas pjerrtësisë së terrenit

Faktorë tjetër fiziko-gjeografik i topografisë së terrenit me shumë rëndësi në shtrirjen dhe vendosjen e vendbanimeve është edhe ekspozicioni. Ekspozicioni është gjithashtu faktor determinant i mikroklimës së një lokaliteti ose edhe të një vendbanimi. Vendbanimet që kanë ekspozicion jugor, juglindor ose jugperëndimor kanë kushte më të përshtatshme mikroklimatike, me ç'rast krijohen lehtësira në menaxhimin e infrastruktur-turës së tyre, ka më pak shpenzime për ngrohje, pranverat janë më të hershme, rendimentet bujqësore më të mira, si dhe rritet mundësia e kultivimit të llojllojshmërisë më të madhe të pemëve dhe bimëve.

Nr.	Ekspozicioni	ha	%
2	Verior	44.25	10.06
3	Verilindor	102.75	23.35
4	Lindor	99.5	22.61
5	Juglindor	42.5	9.66
6	Jugor	55.75	12.67
7	Jugperëndimor	40.5	9.20
8	Perëndimor	31.25	7.10
9	Veriperëndimor	23.5	5.34
<b>Totali</b>		<b>440</b>	<b>100.00</b>

→ Raporti në mes vendbanimeve / ekspozicionit të terrenit

Tabela e mësipërme prezanton që 38.75% ose 170.5ha e hapësirës së vendbanimeve shtrihen në ekspozicion verior, veriperëndimor dhe verilindor. Në këto kushte dhe në lartësi mbidetare mbi 1000m, kushtet për të jetuar gjatë sezonit të dimrit janë me kushtëzime dhe vështirësi të shumta, si në mundësinë e qarkullimit ose mobilitetit, mirëmbajtjen e infrastrukturës teknike, në koston e energjisë së shpenzuar për ngrohje etj. Pjesa tjetër ka ekspozicion të favorshëm, duke filluar nga ekspozicioni lindor me 22.61% ose 99.5ha, juglindor, jugor dhe jugperëndimor me 31.53% ose 138.75ha të tyre dhe në ekspozicion perëndimor kemi vetëm 5.34% ose 23.5ha të shputës së vendbanimeve.



### 1.2.12. Trashëgimia kulturore

Parku është relativisht i pasur me trashëgimi kulturore. Dëshmi e një civilizimi të hershëm historik e kulturor janë veshjet me karakteristika të vendit, vallet, doket, zakonet, ritet fetare, festat, janë lokalitetet arkeologjike, kishat, xhamitë, varrezat, shtëpitë me arkitekturë tradicionale, kullat, dhe punimet artizanale me të cilat janë të pasura vendbanimet që shtrihen në brendësi dhe në afërsi të parkut.

Monumentet brenda parkut me status të mbrojtjes janë: Patrikana e Pejës dhe Manastiri i Deçanit<sup>5</sup>, gërmadha të një vendbanimi "gradina" në grykën e majes së Gjeravicës, gërmadha të fortifikatës në fshatin Lipë dhe Koshare, shpella e murgjve në grykën e Rugovës (e njohur për vendas si shpella e mbretneshës), gërmadhat e kishës së Katarinës në Lipë dhe kisha në Kuqishtë të komunës së Pejës. (Për më shumë informata shiko në shtojcën e këtij dokumenti ku është lista e trashëgimisë kulturore me mbrojtje të përkohshme, brenda parkut dhe në afërsi të tij.)

Për nga vlera, arkitektura dhe rëndësia historike, janë definuar dy monumente kulturore brenda parkut, të shpallura si "Zona të veçanta të mbrojtura" (ZVM). Ato janë: Patriarkana e Pejës dhe Manastiri i Deçanit;



→ Patrikana e Pejës

**Patriarkana e Pejës** është një ndër monumentet (ZVM) më të rëndësishme, me kulturë të lartë kishtarë që i takon periudhës Bizantino-Romanike shek.XIII-XIV. Ajo ka një sipërfaqe prej 231 ha, nga e cila 111.12 ha (48%) e sipërfaqes së saj gjendet brenda "parkut" gjegjësisht pranë Lumbardhit të Pejës, në hyrje të grykës së Rugovës. Është kompleks i përbërë nga katër kisha: kisha e Shën Apostolit, Shën Dhimitrit, Shën Mërisë dhe e Shën Nikollës. Kishat kanë formën e kubit dhe me një arkitekturë të stilit tipik Bizantin.

**Manastiri i Deçanit** (ZVM) shtrihet rrëzë shpatit të Bjeshkëve të Nemuna, në pjesën perëndimore të Kosovës, është ndërtuar në mes të shek. XIV. Stili i arkitekturës së këtij manastiri është Romano - Gotik, e pasur me freska në të cilat janë bërë përshkrime individuale të shenjtorëve, skulptura dhe ikona të shumta të shek. XIV-XVII. Manastiri ka një sipërfaqe prej 791 ha, nga e cila 638.83 ha (81%) e sipërfaqes së saj gjendet mbrenda territorit të "Parkut".



→ Manastiri i Deçanit



### 1.2.13. Trashëgimia kulturore në afërsi të parkut

Pjesa dërmuese e pasurisë me trashëgimi kulturore gjendet në vendbanimet që shtrihen në afërsi të parkut. Vlerat kulturore reflektojnë historinë e këtyre anëve, krijojnë atmosferë të veçantë dhe tërheqin turistët e shumtë nga vise të ndryshme.

#### 1.2.13.1. Vendbanimet dhe objektet e tyre të trashëgimisë kulturore

Vendbanimet në afërsi të parkut janë burim i begatshëm i trashëgimisë kulturore dhe historike, materiale dhe shpirtërore të periudhave të ndryshme, të cilat veçohen për nga vlera, cilësi, dhe rëndësia historike. Zbulimet arkeologjike tregojnë se në këto hapësira është organizuar jeta urbane qysh nga kohërat e lashta që nga periudha ilire, romake, bizantine, sllave e turke e deri sot. Tipologjia e fshatrave është zhvilluar në varshmëri prej kushteve natyrore e sidomos prej pozitës gjeografike ku ato shtrihen. Fshatrat në afërsi të zonës urbane janë kryesisht vendbanime të grumbulluara, me dendësi më të lartë të banimit krahas fshatrave të tipit malor të cilat janë të karakterit të shpërndarë dhe me dendësi më të vogël të banorëve.

<sup>5</sup> Si ndërtesa, edhe patrikana edhe manastiri janë jashtë parkut, por si zona të veçanta të mbrojtura ato hyjnë në territorin e parkut.



→ Gjendja ekzistuese e TK dhe TN

Në hartën "Gjendja ekzistuese e TK dhe TN" janë të paraqitura shtrirjet e tyre hapësinore në park dhe në vendbanimet afër parkut. Parku është i përfshirë nga territori i pesë komunave si: Komuna e Istogut, Pejës, Deçanit, Junikut dhe Gjakovës. Më poshtë janë hartat më detaje me pjesët e territoreve të komunave të cilat marrin pjesë në territorin e parkut kombëtar ku janë paraqitur vendbanimet në afërsi të parkut me objektet dhe tërësitë e trashëgimisë kulturore që ato i kanë.

**Pjesa e Istogut – vendbanimet në afërsi të parkut, të pasura me trashëgimi kulturore:**

1. Kaliçani është i pasur me lokalitet arkeologjik - vendbanim Romak i shek.III (Periudha antike), një xhami, kullë dhe një trung me vlera natyrore;
2. Në Studenicë janë gërmadhat e bazilikës paleokristiane dardane të shek.V (Periudha bizantine - mesjetë e hershme);
3. Vrella është vendbanimi më i pasur me TK, ku janë gjetur gjurmë të VB antik-mesjetë shek. V-VI (Periudha antike) - lokaliteti "Krye" te burimi i Vrellës, manastiri i Hvosnos (ZVM), kisha paleokristiane, kalaja, xhamia, mullinjt, kulla, burimi i ujit natyral dhe qendra termale;
4. Lubozhda ka 3 tuma ilire, shek. VIII-V p.e.s (Periudha parahistorike), poashtu janë evidentuar gjurmë të VB të periudhës iliro-romake të ndërtuar me gurë të palidhur me emrin "Shkëmbi i kroit" te kroni i Lubozhdës. Supozohet se mbi Lubozhdë gjendet Gjyteti me themelet e kalasë së Perandorit Justinian;
5. Në Cercë janë lokaliteti antic i shek. V-VI, themelet e kishës paleokristiane dhe shtëpia e Ibrahim Rugovës.



→ Ttrashëgimia kulturore - Istog

**Pjesa e Pejës – vendbanimet në afërsi të parkut, të pasura me trashëgimi kulturore:**

1. Jabllanica e vogël i ka fortifikimin e antikitetit të vonë - "Gradina" të shek. IV-VI dhe kullën e Imer Rexhepit të shek.XVIII;
2. Në Radac gjenden: Shpella e Radacit, fortifikimi i antikitetit të vonë "Gjyteti" shek.IV-VI;
3. Në Sigë është Kisha e Shën Gjergjit (mesjetë);
4. Lëvosha është vendbanim i pasur kryesisht me gërmadha të kishave mesjetare si: gërmadhat e kishës së Shën Dhimitrit, të kishës varrezore të Shën Gjergjit, të kishës së Shën Nikollës, të mureve mesjetare në Duarinje, të mureve të Shën Markut, varret mbi livadhet e Savës, gërmadhat e kullave;
5. Në Bellopojë gjendet kisha e zojës së bekuar.




→ Ttrashëgimia kulturore - Pejë



**Pjesa e Deçanit – vendbanimet në afërsi të parkut, të pasura me trashëgimi kulturore:**

1. Strellci i Epërm – Gërmadha të antikitetit të vonë të shek. IV-VI, kulla e Sh.Cenit, karakteristike- shumë kulla (fshat relativisht i madh);
2. Lëbushë – Vendbanim i vogël dhe i hershëm, kryesisht i pasur me kulla, një qardak nën mbrojtje;
3. Isniq – Vendbanim i madh , 3 kulla, 1 xhami (kryesisht e pasur me kulla);
4. Deçan – 2 kulla, 1 mulli dhe 1 xhami.



→ Trashëgimia kulturore - Deçan




→ Trashëgimia kulturore - Junik

**Pjesa e Junikut**

Juniku si qytet ka pozitë të përshtatshme gjeografike, me ndikim në park, me lidhje të shkurtë me vendbanimet Gjocaj e Jasiq që gjenden në brendi të parkut, me qytetet si Gjakova, Deçani dhe Peja dhe me shtetin e Shqipërisë. Pjesa e Junikut është e pasur me:

- pyje, livadhe, kullosa dhe ujëra;
- 10 objekte të banimit të tipit kullë me vlera të trashëgimisë kulturore dhe objekte tjera të trashëgimisë kulturore si: 2 tyrbe, 2 xhami, 1 teqe dhe varrezat e fshatit.

**Pjesa e Gjakovës – Batusha - fortifikata, kisha e varreza dhe 2 kulla, Mulliqi - xhami fshati**



→ Trashëgimia kulturore - Gjakovë

Banimi si funksion kryesor i çdo vendbanimi është poashtu elementi kryesor i gjendjes së qëndrueshme sociale, ekonomike dhe mjedisore. Nëpër fshatrat e zonave afër parkut kemi tipin e banimit individual i cili është dominant pothuajse në 90% të tyre dhe që në kohrat e hershme është identifikuar "Kulla" si shtëpi karakteristike.

**Kullat** - Rajoni i Dukagjinit apo vendbanimet që janë në afërsi të parkut karakterizohen me objekte të banimit apo të ashtuquajturat "Kullat e Dukagjinit" që paraqesin rëndësi të veçantë për trashëgiminë kulturore të këtyre anëve. Kulla si banesë shqiptare, përveç që prezantohet si e vetme, atë mund t'a gjejmë edhe në formë kompleksi apo si ansambël fshati. Koncentrimi më i madh i tyre është në vendbanimet Hulaj, Isniq, Lëbushë, Lloqan, Strellci i Epërm, Voksh, Pobërgjë, Vrellë, Junik, Batushë etj. Ndërtimi i tyre daton që nga fillimi i shekullit XIX.



→ Kulla të Dukagjinit



→ Kulla e Mazrekajve, Dranoc

Roli i kullës ka qenë i shumfishtë. Përveç funksionit të banimit që ka pasë, kulla ka luajtur rol edhe në aspektin fortifikues, ngritjes arsimore, kulturore, edukative, shoqërore dhe mes tjerash ka luajtur rol të rëndësishëm politik të vendit.

→ Kulla e Berishajve, Junik





Disa nga këto kulla janë restauruar dhe adoptuar për turistë, ku është munduar të ruhet origjinaliteti i tyre, me përdorimin e materialit autokton, përdorimit të elementeve përcjellëse si: sofrat, qeshmja, djepi, koshi, hambari etj. Kulla e Mazrekajve - Dranoc (e restauruar në formë bujtine me hapësira për mbajtje të takimeve); Kulla e Ramë Zyberit - Junik (e restauruar në formë bujtine, me ushqim tradicional dhe hapësirë për takime); Kulla e Isufajve - Junik (e restauruar në Zyre të informimit turistik), Kulla e Brahim Hoxhës - Oda e Junikut (e restauruar në bujtinë) etj.

Kjo është një mënyrë shumë e mirë e ruajtjes së trashëgimisë kulturore përveç asaj arkitektonike edhe trashëgimisë së luajtshme, shpirtërore dhe historike të këtyre anëve.

**Mullinjët me ujë**, janë objekte karakteristike për këto treva të cilat dikur kanë pasë numër të madh të tyre, ndërkaq sot kemi një numër shumë të vogël të mullinjëve aktiv dhe të cilët përdoren kryesisht për bluarjen e misrit. Disa nga këta mullinjë kanë vlera historike, të cilat bartin një lloj identiteti të kësaj ane por përdorimi i tyre është kryesisht për përfitime ekonomike. Vrella është vendbanim që është karakterizuar me numër më të madh të mullinjëve. Mulliri i Qelë Bicajt është njëri ndër t'a që është i vjetër gati treqind vjeç dhe funksionon edhe sot. Mulliri i Shabanajve në Deçan sot shfrytëzohet nga shoqata e grave Jeta për shitje të artizanateve dhe është një shembull i mirë i ruajtjes së mullinjëve në këtë rast nga shkatërimi i tyre.

**Koshat dhe Hambarët** janë objekte ndihmëse me ornamentikë të pasur që gjenden kryesisht në vendbanimet ku lavërtaria është veprimtari kryesor.



→ Kosh i trevës së Dukagjinit



**Stanet** paraqesin shtëpi sezonale për strehim të fshatarëve, që shfrytëzohet për kullotjen e bagëtive dhe veprimtarive tjera si: për pemtari, bletari, bimë mjekuese etj. Stanet shtrihen kryesisht në lartësi më të mëdha në bjeshkë dhe shfrytëzohen gjatë sezonës së verës. Disa prej tyre sot shfrytëzohen edhe në formë të bujtinave, për pushim rekreues gjatë tërë vitit dhe paraqesin potencial për zhvillim të turizmit malor e njëherit edhe atij ekonomik të vendit.



→ Stanet në Park

### 1.2.13.2. Pasuria etnologjike dhe aktivitetet tradicionale

Përveç "Kullave" të vjetra dhe disa lokaliteteve arkeologjike, këto anë kanë laramani dhe vlera me pasuri të shumta etnologjike. Ato pasqyrohen me veshje tradicionale, valle, muzikë, doke dhe zakone, vegla të punës, punime

artizanale (stoli nga argjendi), armë të periudhave të ndryshme, ushqim tradicional etj.



→ Veshjet tradicionale

**Veshja tradicionale** është njëra ndër motivet që është ruajtur në mënyrë origjinale dhe vazhdon të ruhet edhe në ditët e sotme. Ngjyra bardhë e zi është karakteristikë të veshjet e meshkujve, ndërsa tek gjinia femërore dominon edhe ngjyra e kuqe. Është mjaft me rëndësi të përmendet edhe ruajtja e traditave të martesave në stilin e vjetër që ende edhe sot aplikohet, rendi dhe rregulli shtëpiak, vallja tradicionale, pregatitja e ushqimit tradicional dhe rituali i barinjëve lidhur me qethjen e deleve.

**Zejet tradicionale** janë karakteristikë e këtyre anëve dhe shumë atraktive për turistë si: farkatarët, qeleshepunuesit, mjeshtrit e punimit të samarëve, gdhendja e veglave muzikore nga druri etj.

**Plisi** është pjesë e veshjes kombëtare të burrave, i cili dallon në rajon për nga forma dhe ngjyra e tij që është e bardhë. Materiali që punohet plisi është nga leshi. Punimi i plisave është zanat në rënie dhe i rrezikuar nga zhdukja, prandaj duhet tentuar që të ruhet kjo traditë edhe më tutje.

Një zeje tjetër tradicionale që praktikohet në këto anë është edhe thurja e tekstilit në gjergjef (Shamitë e qëndisura, shamitë e mëndafshit dhe të pambukut, të cilat mbahen në kokë dhe zakonisht punohen me shumë dekorime dhe ngjyra më të ngrohta.

**Pregatitja e ushqimit** është prezentë pothuajse në çdo shtëpi, restorane që ofrojnë ushqim të shumëllojshëm, që karakterizohet edhe si rajon me meny të pasur të gastronomisë. Ushqimet më të preferuara dhe karakteri-stike janë: Buka kollomoqe, leqeniku, kryelana, kaqamaku, flia, pogaqa, revanija, gurabija mjalti, qumshti, kosi, djathi, maza, si dhe pregatitja e mishit të qengjit. Nga pijet është e njohur birra e Pejës, verërat lokale si "Merlot", "Rizling", si dhe pjekja e rrakisë së rrushit. Ushqimi dhe mikpritja e turistëve nga vendasit është pjesë e traditës shekullore.



"Zhdjergat" janë element i folklorit dhe traditës së këtyre anëve, ku përmes darkës së zhdjergës shprehet një formë e solidaritetit, shpërblimit, skrificës dhe mirënjohjes për gjithë bereqetin që e kanë për një vit.



→ Vallja e Rugoves – pjesë e lojrave tradicionale

**Manifestimet vjetore** që organizohen përmes ngjarjeve me karakter të veçantë janë një element i rëndësishëm dhe ndikojnë në ngritjen e vetëdijes, informimit dhe promovimit të trashëgimisë kulturore dhe natyrore të kësaj treve. Manifestime të tilla janë: Takimi ndërkombëtar i bjeshkatarëve; Organizimi i lojërave tradicionale "Rugova"; Panairi turistik; Panairi "Ditët e mjaltit"; Panairi i punimeve artizanale; Karavani i prodhimeve vendore, Darka e Lamës, që kremton sezonin e suksesshëm dhe bereqetin në blegtori dhe bujqësi anekënd rajonit etj.

#### Vallja e Rugoves

Vallja e Rugoves është pjesë e kulturës, traditës dhe historisë së këtyre anëve, ku përfshihet kërcimi tradicional në raste të ndryshme festash. Vallja Rugovase hyn në kategorinë e valleve epike, e cila karakterizohet me burrëri, trimëri, me karakter luftarak dhe madhështi. Vallja luhet kryesisht



nga burrat si: loja me jatagan dhe valle dyluftimi, si dhe valle tjera ku janë të kombinuar edhe me lojën e grave.

#### 1.2.14. Trashëgimia natyrore

Bjeshkët e Nemuna paraqesin njërin nga masivet malore më të mëdhenj, më kompleks, më interesant dhe më të bukur të Ballkanit. Pasuria natyrore e Bjeshkëve të Nemuna konsiston me shumëllojshmërinë dhe veçantitë gjeomorfologjike të objekteve si: malet, grykat, kanjonet, shpellat.

**Lokalitete të rëndësishme** me vlera natyrore në park janë: Koproaniku, Rusolia, Zhlebi, Maja e Leqinës, Radavci, Lokaliteti Jedova, Rrasa e Zogut, Lokaliteti Burimi i Erenikut, Liqejtë e Gjeravicës.

**Peizazhet** janë pjesë e territorit me karakteristika të veçanta të relievit, formuar nga një kompleks ekosistemesh të integruar në mënyrë funksionale duke përfshirë edhe elementet e qytetërimit. Peizazhi i mbrojtur është zonë natyrore ose artificiale me vlerë të madhe peizazhore dhe larmi biologjike ose me vlerë kulturo-historike ose peizazh me veçori të ruajtura unikale karakteristike për zonën e caktuar i dedikuar për pushim dhe rekreacion. Parku i Bjeshkëve të Nemuna është i pasur me lloje të ndryshme të peizazheve të cilat varësisht nga rëndësia, karakteristikat dhe veçoritë e tyre janë: Peisazhe natyrore, hidrografike, malore, kulturore, fshatare.

Zonat dhe monumentet natyrore të mbrojtura janë:



Maja e Ropsit, Deçan – rezervat bimor i llojeve të molikës, bredhit, pishës dhe ahut;

Kozhnjeri, Deçan – rezervat shtazor i llojit të dhisë së egër;

Malet e Prelepit, Deçan – rezervat bimor me përbërje të panjës malore;



→ Peisazhet në Bjeshkët e Nemuna

**Qendrat termale** - Burimet e shpeshta termo-minerale në Kosovë janë pasojë e aktivitetit intenziv vullkanik dhe proceseve të shumta tektonike në të kaluarën e saj gjeologjike. Burim i tillë është edhe ai në Banjë - 12 km në verilindje të Pejës. Temperatura e ujit të burimeve të nxehta është 46-48 °C, kurse sasia e përgjithshme e ujërave të tyre është 17,5 l/sec. Burimi i tillë i ujit termal shëron disa lloje të sëmundjeve dhe supozohet që është shfrytëzuar që nga periudha romake, mesjeta dhe më vonë edhe nga turqit.

**Burimet e ujërave natyral** – Këto gjenden në afërsi të Vrellës (K.Istogut) dhe afër Manastirit të Deçanit.

**Shpellat** – Edhe pse shpellat nuk janë hulumtuar sa duhet, duket se kanë qenë vende banimi gjatë kohës së paleolitit dhe mezolitit (zbulime të tilla priten të bëhen në shpellën e Radavci afër burimit të Drinit). Përpos kësaj shpelle janë të njohura edhe Shpella e Hoxhës dhe Shpella e gurit që gjenden në afërsi të fshatit Vrellë.

Si pjesë e trashëgimisë natyrore janë edhe grykat/kanjonet, ku si më të rëndësishmet janë: Gryka e Rugovës, Gryka e Vrellës etj.





### 1.3. POPULLËSIA DHE ZHVILLIMI SOCIAL

Nga 4743 banorëve të regjistruar në vitin 1971, me regjistrimin e vitit 2011 në Park jetojnë vetëm 476 banorë.

Shkalla e natalitetit është 18 promil apo 1.8%, shkalla e mortalitetit është 4 promil apo 0.44%, ndërsa shtimi natyror është 13.6 promil apo 1.3%.

Sa i përket moshës së popullsisë, moshja 0 – 19 vjeç përfaqësohet me 35%, moshja 20 – 64 vjeç merr pjesë me 57 %, dhe grup moshja mbi 65 vjeç ka pjesëmarrje më të vogël apo 8% në numrin e përgjithshëm të popullsisë.

Në aspektin etnik vendbanimet brenda Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", kanë një popullësi mjaft homogjene ku 97.5 % (2011) e popullsisë janë shqiptarë, kurse pakicat tjera janë egjiptian etj.

55% nga popullësia e përgjithshme e vendbanimeve brenda Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" është popullësi aktive.

Brenda parkut, në Drelaj gjendet një shkollë fillore, kurse në Haxhaj është shtëpia e shëndetit ku momentalisht nuk ka mjek.

Të dhënat për numrin e popullsisë dalin nga regjistrimet e popullsisë. Për periudhën kohore 1948–2011 janë paraqitur të dhënat për numrin e popullsisë sipas regjistrimeve të popullsisë. Gjithashtu janë shfrytëzuar të dhënat e regjistrimit të vitit 1991 që japin një vlerësim për popullësinë sepse popullësia shqiptare në atë kohë e pati bojkotuar pjesëmarrjen në regjistrim. Të dhënat, megjithatë konsiderohen si relativisht të sakta.

#### 1.3.1. Numri i përgjithshëm i popullsisë

Popullësia e këtij regjioni është e shpërndarë në gjithsej 47 vendbanime të cilat janë të shpërndara në pesë komuna të Kosovës: Pejë, Deçan, Istog, Junik dhe Gjakovë. Nga gjithsej 47 vendbanime sa ka ky regjion gjeografik, 20 prej tyre janë brenda kufirit të parkut, ndërsa 27 të tjera janë jashtë Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna". Numri i popullsisë në këtë regjion është 87800<sup>6</sup> banorë.

Brenda viteve 1948-2011 pati një rritje të lehtë të numrit të popullsisë për 48872 banorë. Nga viti 1991 e deri në vitin 2011 popullsia e kësaj ane karakterizohet me një rënie të numrit të saj prej 26060 banorëve. Kjo ishte si pasojë e shumë rrjedhave politiko-ekonomike që ndodhën në këtë periudhë, duke mos harruar edhe luftën e fundit (1999). Sipas treguesve në tabelën e më poshtme numri i popullsisë është shtuar për 48872 banorë, nga 38928 banorë sa kishte në vitin 1948 në 87800 banorë në vitin 2011.

→ Nr.pop. sipas regjistrimeve dhe indeksi bazik dhe vargor brenda dhe jashtë Parkut.

Vitet	Nr. i popullsisë	Indeksi bazik	Indeksi vargor
Regjistrimi 1948	38928	100	100
Regjistrimi 1953	44935	115	115
Regjistrimi 1961	55632	143	124
Regjistrimi 1971	75669	194	136
Regjistrimi 1981	94259	242	125
Vlerësimi 1991	113860	292	121
Regjistrimi 2011	87800	226	77

Shkalla e natalitetit arrin deri në 18 promil apo 1.8 %, ndërsa shkalla e mortalitetit është 4 promil apo 0.44 %. Në bazë të këtyre shkallëve të natalitetit dhe mortalitetit del se shtimi natyror i popullsisë është 13.6 promil apo 1.36 %.



Me 57 % të popullsisë së përgjithshme në hapësirën e kësaj ane dominon moshja 20 - 64 vjeç, pastaj me 35% të popullsisë së përgjithshme radhiten popullsia e moshës së re 0 - 19 vjeç, ndërsa, grup-moshat mbi 65 vjeç kanë pjesëmarrje të vogël, 8% të popullsisë së përgjithshme.

Nga gjithësej 87800 banorë, gjinia mashkullore është e përfaqësuar me 49.7%, ndërsa, gjinia femërore merr pjesë me 44154 apo me 50.3 %.

#### 1.3.2. Numri i popullsisë brenda Parkut

Që nga viti 1948 e deri më 1971, vendbanimet brenda Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", kanë pasur një rritje të vazhdueshme të popullsisë. Nga viti 1971 e deri në vitin 2011 këto vendbanime pësojnë rënie drastike të numrit të popullsisë dhe disa prej tyre sot janë të pa banuara. Në vitin 1948 këto vendbanime kishin 4046 banorë, ndërsa në regjistrimin e fundit (2011) këto vendbanime kishin 476 banorë, që do të thotë se për këtë periudhë kohore 63 vjeçare numri i popullsisë është zvogëluar gati për tetë herë.

→ Numri i popullsisë sipas regjistrimeve brenda Parkut.



→ Numri i popullsisë sipas indeksit bazik dhe vargor në vendbanimet brenda parkut sipas regjistrimit

Nga gjithsej 20 vendbanime sa ka kjo hapësirë, 16 prej tyre i takojnë komunës së Pejës, dy vendbanime komunës së Junikut, një të Deçanit dhe një vendbanim komunës së Gjakovës. Këto vendbanime kanë dallime të theksuara sa i përket numrit të popullsisë. Vendbanimi me numër më të madh të popullsisë është Cerovërhë (Breg i Zi) me 234 banorë, apo me 49.1 % të numrit të përgjithshëm të popullsisë së këtyre vendbanimeve.


#### 1.3.3. Dendësia e popullsisë<sup>7</sup>

Të gjitha vendbanimet e Parkut karakterizohen me dendësi të vogël të popullsisë dhe janë kryesisht vendbanime të thella malore që gjenden larg qendrave urbane, me një zhvillim të ulët ekonomik dhe me kushte jo të favorshme.

Vendbanimet brenda Parkut shtrihen në lartësi të mëdha mbidetare. Lartësinë mbidetare më të madhe e kanë vendbanimet: Malaj (1925m), Pepiq (1813m), Koshutan (1708m), Bogë (1610m).

<sup>6</sup> Agjencioni i Statistikave të Kosovës, Regjistrimi i Popullsisë Ekonomike Familjare dhe Banesave 2011.

<sup>7</sup> Sipas regjistrimit të vitit 2011, dendësia e popullsisë në Park është 0.75 b/km<sup>2</sup>.



→ Vendbanimet brenda dhe në afërsi të Parkut (Bufer zona)

### 1.3.4. Shtimi natyror i popullsisë

Gjatë periudhës 1971 – 1981, krahas rënies së natalitetit, bie dukshëm edhe mortaliteti, e me këtë zvogëlohet edhe shtimi natyror i popullsisë. Përkundër zvogëlimit, shkalla e natalitetit mbetet ende shumë e lartë (rreth 37.7<sup>8</sup> promil), ndërsa rënia rapide e mortalitetit ndikoi që shtimi natyror dhe rritja e përgjithshme e popullsisë në hapësirën e kësaj ane të mbetet e lartë. Pas viteve të 90-ta, ndodhë një thyerje e madhe lidhur me natalitetin, kur shkalla e natalitetit zbret deri në rreth 20 promil në vitet 1995 – 1996, ndërsa shtimi natyror rreth 16 promil. Kjo thyerje ndodh si pasojë e rrethanave të vështira socio-ekonomike dhe politike që ishin krijuar. Gjatë vitit 2011, në komunat Pejë, Deçan, Gjakovë, Istog dhe Junik janë shënuar 5010 lindje<sup>9</sup> dhe 1240 vdekje<sup>10</sup>. Shkalla e natalitetit në komunat e lartpërmendura është 18 promil apo 1.8%. Shkalla e mortalitetit është 4 promil apo 0.44%, ndërsa shtimi natyror është 13.6 promil apo 1.3%.

### 1.3.5. Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë

Vendbanimet brenda Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" në aspektin e zhvillimit demografik kanë veçoritë e saj edhe në përbërjen e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë. Në këto struktura kanë ndikuar shumë faktorë demografik dhe socio-ekonomik dhe janë krijuar shumë karakteristika dhe efekte të tjera në zhvillimin demografik. Moshë 0 – 19 vjeç përfaqësohet me 35%, moshë 20

– 64 vjeç merr pjesë më 57 %, dhe grup moshë mbi 65 vjeç me pjesëmarrje më të vogël (8%) të popullsisë së përgjithshme.

Sa i përket dallimeve gjinore, ekziston një deballanc shumë i vogël gjinor, ku popullsia femërore dominon me 50.8 %, në krahasim, me popullsinë mashkullore (49.2%).

Në aspektin etnik vendbanimet brenda Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", kanë një popullsi mjaft homogjene ku 97.5 % (2011) e popullsisë janë shqiptarë, kurse pakicat tjera janë egjiptian etj.

Sa i përket popullsisë sipas religjionit, 99.8% e popullsisë i takojnë religjionit Islam.

### 1.3.6. Popullësia bujqësore-blegtorale dhe karakteristikat e saj<sup>11</sup>

Hapësira gjeografike e kësaj ane e në veçanti edhe regjioni i grykës së Rugovës, menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore trashëgoi një përqindje të lartë të popullsisë bujqësore-blegtorale, si pasojë e lënies krejtësisht pasdore të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror. Në periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore kalimi i popullsisë bujqësore-blegtorale në veprimtari jo bujqësore-blegtorale vazhdimisht rritej, gjë që është ligjësi e përgjithshme në kuadër të zhvillimit ekonomik. Transferimi i popullsisë nga bujqësia dhe të shumtën edhe nga fshati në veprimtari jo bujqësore dhe në qytet zhvillohej në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa përgatitje profesionale dhe arsimore, në një anë, dhe në mënyrë indirekte, përmes shkollimit të gjeneratës së re dhe të ndryshimit të pozitës socio-ekonomike të popullsisë, në anën tjetër.

Sa i përket strukturës agrare të popullsisë së kësaj hapësire, ajo shënon një rënie të konsiderueshme deri në vitin 1981 me 49.8% të popullsisë aktive në veprimtarinë primare. Ndërsa, në ditët e sodit popullsia është e koncentruar në sektorin terciar në zhvillimin e turizmit duke i kushtuar një rëndësi të veçantë objekteve hoteliere, vikend shtëpizave, dhe në promovimin e turizmit malor. Pjesa tjetër e popullsisë kryesisht merret me veprimtari primare apo më mirë të themi me veprimtari bujqësore-blegtorale, pasi që vetë konfiguracioni i terrenit ja përcakton një gjë të tillë. Është e vështirë për të prezantuar sot se sa është numri i popullsisë bujqësore-blegtorale dhe ai i popullsisë jo bujqësore-blegtorale, por në bazë të këtyre trendëve të zhvillimit përqindja e popullsisë jo bujqësore është zvogëluar dukshëm.

### 1.3.7. Popullësia aktive

Popullësia aktive paraqet një element tjetër demografik që ka rëndësi të veçantë në zhvillimin shoqëroro-ekonomik të një vendi. Në vitin 1971 pjesëmarrja e popullsisë në veprimtari primare ka qenë 58.2%. Ndonëse numri në veprimtari primare është zvogëluar për këtë periudhë (1971-1981) për 8.4%, ende Rrafshi i Dukagjinit cilësohet më tepër si hapësirë gjeografike agrare. Sipas regjistrimit të vitit 2011, del se 54.5% nga popullsia e

<sup>8</sup> R. Çavolli, Gjeografia regionale e Kosovës, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës, Prishtinë 1997, f. 267.

<sup>9</sup> ASK, Statistikat e lindjeve në Kosovë, 2011.

<sup>10</sup> ASK, Statistikat e vdekjeve në Kosovë, 2011.

<sup>11</sup> Sqarim: Të gjitha shifrat dhe përqindjet deri në vitin 1981 janë marrë nga, Burimi: Komunitet e KSAK më 1987, Enti krahnor i statistikës, Prishtinë, 1989.





përgjithshme e vendbanimeve brenda Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" janë popullsi aktive.

### 1.3.8. Familja dhe karakteristikat e saj

Vendbanimet e kësaj ane kryesisht karakterizohen me numër të madh të anëtareve të familjes, që është karakteristikë për disa vise të pa zhvilluara dhe kryesisht rurale. Mesatarja e madhësisë së familjes në këtë regjion (vendbanimet brenda parkut) është rreth 6.9 anëtar (2011).

### 1.3.9. Lëvizja mekanike e popullsisë – Migrimet

Migrimet e popullsisë sot paraqesin një problem shumëdimensional hapësinor, demografik, ekonomik, social dhe politik, ndërsa i nxisin një varg faktorësh të ndërlikuar dhe shpeshherë reciprokisht të lidhur e të kushtëzuar. Mungesa e të dhënave për migrimet, vështirëson bërjen e analizave për migrimet mirëpo, ajo që u kuptua si më lartë, e bënë të njohur fenomenin e migrimit të popullsisë nga vendbanimet rurale në ato urbane në shkallë të gjerë. Në përgjithësi numri i popullsisë është zvogëluar përrreth 8 herë ndërsa, 9 vendbanime janë shpopulluar pothuajse tërësisht.

### 1.3.10. Papunësia

Një ndër çështjet akute për shoqërinë kosovare është shkalla e lartë e papunësisë. Papunësia është bërë pjesë e pandashme e shoqërisë e veçmas ka zënë vend të theksuar në vendbanimet rurale, kodrinore – malore, me largësi të theksuar nga zonat urbane. Shkalla e papunësisë në nivel vendi sillet aty te 40% dhe më së shumti atakon grup moshat e reja sidomos popullësinë e gjinisë femërore.

Nga analiza e të dhënave për vendbanimet të cilat shtrihen në brezin kufitar të Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" dhe vendbanimet brenda parkut, del se shkalla e papunësisë është mjaft e përhapur në këtë territor.


Të dhënat për punëkërkuesit e regjistruar në zyrën e punësimit flasin për 13500 persona që presin për të gjetur një vend pune. Ky numër nuk do të thotë se është real, mund të jetë edhe shumëfish më i madh sepse nuk janë të gjithë të papunët të regjistruar. Papunësia më e theksuar është të vendbanimet e thella rurale.

**Pasojë e shkallës së lartë të papunësisë është edhe varfëria.** Varfëria ka prekur pothuajse të gjitha portet e jetës shoqërore në këtë anë. Niveli i ulët i zhvillimit ekonomik, shkalla e ulët e arsimimit, shkatërrimet e shtëpive, bizneseve dhe ndërmarrjeve nga lufta e fundit në Kosovë ('99), shpëputja nga përpunimi i tokës – de agrarizimi etj., kanë ndikuar në rritjen e varfërisë. Parcializimi i tokave, kreditë jo të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë, mungesa e subvencioneve (farëra, plehra artificiale,) etj, janë në disfavor të bujqësisë (bujkut). Për këtë arsye dhe arsye të tjera, nuk ka interesim të popullatës të merret në mënyrë aktive me bujqësi, sektor ky i cili do të mund të ulte shkallën e papunësisë dhe varfërisë.

Varfëria është një fenomen kompleks social i cili është vështirë të matet. Për matjen e varfërisë kërkohen të dhëna si: të ardhurat për kokë banori, niveli i arsimimit, kushtet e banimit, shëndetësia, etj.

Natyrshëm, viset rurale me largësi të theksuar nga zona urbane, zona kodrinore malore, ku shkalla e arsimimit është më e ulët, shëndetësia e pa zhvilluar dhe ku kushtet e banimit nuk janë të mira, janë të përfshira në shkallë më të lartë të papunësisë dhe varfërisë. Të dhënat flasin për 2500 familje në asistencë sociale. Gjendja më e rëndë (keqe) është në familjet brenda parkut, në vendbanimet e thella dhe kodrinore – malore.

→ Popullësia dhe zhvillimi shoqëror në Park





### 1.3.11. Arsimi

Arsimi është themeli i një shoqërie të shëndoshë. Ai garanton perspektivë për të ardhmen shoqërore, ekonomike, kulturore dhe politike të një vendi. Në sistemin arsimor të Kosovës, pas vitit 2000 kanë ndodhur zhvillime të theksuara në realizimin e programeve mësimore bashkëkohore.

Struktura organizative e sistemit arsimor në vendbanimet brenda dhe ato rreth Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" është e organizuar në katër nivele: arsimin parashkollor (5 - 6 vjeçar), arsimin fillor (I - V), dhe arsimin e mesëm të ulët (VI - IX). Numri i objekteve shkollore është gjithësej 14 prej të cilave vetëm një është brenda parkut, në fshatin Drelaj. Në procesin arsimor në këto vendbanime janë të përfshirë rreth 4000 nxënës. Në shumicën e këtyre shkollave procesi mësimor zhvillohet në 2 turne. Numër i madh i vendbanimeve nuk kanë objekt shkollor dhe mësimin e ndjekin në objekte shkollore në afërsi (fshatin tjetër). Distanca shkollë – shtëpi shkon deri në 4 km.

Çerdhe dhe kopshte për fëmijët e moshës nën 5 vjet brenda vendbanimeve të trajtuara nuk ka asnjë.

Arsimi parafillor zhvillohet në një numër të shkollave fillore që ofrojnë edukim njëvjeçar parashkollor për fëmijët e moshës 5 dhe 6 vjeç.

Raporti nxënës-mësimdhënës është mesatarisht 20 nxënës për 1 mësimdhënës me dallime të theksuara nga njëra shkollë në tjetrën.

Sa i përket kushteve fizike të objekteve shkollore, ato ndryshojnë nga njëri vendbanim në tjetrin. Në aspektin e përgjithshëm të mësim-nxënies kushte jo të kënaqshme na paraqiten në vendbanimet e thella rurale. Për të pasur analiza edhe më të hollësishme kërkohen të dhëna esenciale për secilën shkollë veç e veç.

### 1.3.12. Shëndetësia

Shëndetësia kosovare, përkundër investimeve të mëdha të bëra pas vitit '99, është në gjendje jo të mirë. Këtu ka dobësi të natyrës organizative gjegjësisht implementimit të ligjit të shëndetësisë, pastaj paralelizmi i strukturave serbe, mosekzistimi i sigurimit shëndetësor, mungesa e kuadrit të mjaftueshëm, mungesa e mjeteve për investime të reja në pajisje, hulumtime shkencore etj. Aktualisht në Kosovë sistemi shëndetësor është i organizuar në tri nivele: a) niveli parësor b) niveli dytësor dhe c) niveli tretësor. Përveç në sektorin publik, shëndetësia është e organizuar edhe në sektorin privat në një shkallë mjaft të gjerë.

Në vendbanimet në park dhe përreth tij ofrohen vetëm shërbimet publike shëndetësore, me përjashtim të ndonjë mini ordinance të vogël private. Shumica prej këtyre vendbanimeve nuk ka ambulantë – shtëpi të shëndetit. Shërbimet shëndetësore ofrohen në rreth 4 objekte shëndetësore. Vetëm një objekt i tillë është brenda territorit të parkut kombëtar, në fshatin Drelaj. Sa i përket gjendjes fizike të objekteve shëndetësore kjo ndryshon nga njëri objekt në tjetrin, por në përgjithësi kanë një gjendje jo dhe aq të mirë.

### 1.3.13. Vendbanimet dhe banimi

Në hapësirën brenda Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" janë 20 vendbanime, kurse rreth parkut si vendbanime që kanë ndikim më të drejtpërdrejtë në park janë 26. Të gjitha vendbanimet brenda parkut janë vendbanime rurale – fshatra, ndërkaq prej atyre rreth parkut, tri janë urbane kurse të tjerat janë poashtu rurale. Prej fshatrave brenda parkut, 16 shtrihen në territorin e komunës së Pejës, 2 në komunën e Junikut, 1 në komunën e Deçanit dhe 1 në komunën e Gjakovës. Sa u përket vendbanimeve rreth parkut, 11 ndodhen në komunën e Pejës, 8 në komunën e Deçanit, 4 në komunën e Istogut, 2 në komunën e Gjakovës dhe 1 në komunën e Junikut.

Vendbanimet brenda parkut janë të vogla për nga numri i banorëve. Prej tyre 9 madje janë fare të boshatisura, kurse të tjerat, me përjashtim të fshatit Cerovërhë që i ka 234 banorë, nuk e arrijnë as numrin 80. Vendbanimet rreth parkut janë më të mëdha dhe, duke mos e llogaritur Pejën si qytet më i madh që është, madhësia e tyre sillet prej 27 banorë sa janë në Zagërme deri në 6053 që i ka Juniku, me një mesatare të banorëve për këto vendbanime që kapë shifrën 1484.

Brenda parkut, vendbanimet janë të tipit të shpërndarë, ndërkaq ato në hapësirën rreth parkut janë kryesisht vendbanime të tipit të koncentruar. Vendbanimet e shpërndara paraqesin tërësinë e objekteve banuese dhe ekonomike të prodhuesve bujqësorë dhe njëkohësisht i takojnë kategorive më të vogla të fshatrave. Shumica e këtyre vendbanimeve janë të vendosura më larg qendrave urbane dhe janë vise rurale, fshatra tipike bujqësore dhe blegtorale. Karakteristika të këtyre vendbanimeve janë transformimi i vogël, lidhja jo e mirë me qendrat urbane dhe shpopullimi më i theksuar.

Vendbanimet e koncentruara janë më të mëdha. Aty hyjnë vendbanimet urbane dhe gjysmëurbane, si dhe vendbanime tjera me numër më të madh të popullsisë.

Funksionet e vendbanimeve brenda parkut janë banim, bujqësi dhe blegtori, ndërsa viteve të fundit vërehet një tendencë në rritje edhe e veprimtarisë së turizmit. Ngritja e interesimit për turizmin rural, për ekoturizmin mund të ndikojë në ndryshimin e qasjes së vet popullatës së këtyre vendbanimeve. Një numër i këtyre vendbanimeve, duke iu referuar gjendjes momentale, kanë predispozita që të ofrojnë kushte për zhvillimin e turizmit fshatar, duke ofruar shërbime tradicionale për vizitorët e parkut. Për këtë më shumë spikatet fshati Bogë ku tashmë përveç që ofrohen këto shërbime, në dispozicion të vizitorëve është edhe shtegu i skijimit.

Shumë vendbanime rreth parkut, pa i përmendur këtu vendbanimet urbane Pejën dhe Deçanin të cilat kanë më shumë funksione, përveç funksioneve të banimit, bujqësisë dhe blegtorisë, e kanë edhe tregtinë apo edhe ndonjë biznes tjetër të vogël.

Në vendbanimet brenda parkut ka vetëm banim individual apo banim në ndërtesa njëbanesore me etazhitet kryesisht P+N dhe P+1+N. Me përjashtim të Pejës dhe Deçanit ku banimi është kolektiv (banim në ndërtesa shumëbanesore) dhe individual, në vendbanimet tjera rreth parkut banimi është vetëm individual me etazhitet kryesisht P+0, P+1 dhe P+2.


Kur flasim për kualitetin e banimit, me përjashtim të pastërtisë së ajrit dhe madhësisë së zhurmës, të gjithë treguesit tjerë flasin për një kualitet më të lartë të banimit në vendbanimet rreth parkut se sa në ato brenda parkut.

Qasja në vendbanimet rreth parkut mundësohet me rrugë kryesisht në terren të rrafshët dhe të asfaltuara, kurse rrugët që të shpiejnë në shumë vendbanime brenda parkut janë të paasfaltuara dhe në terrene të vështira të pjerrta. Transporti publik është më i zhvilluar dhe me kualitet më të lartë në vendbanimet rreth parkut sepse qarkullimi është më i shpeshtë dhe më i lehtë në rrugë më të mira, kurse përfshirja e banorëve në këtë shërbim është më e madhe. Në disa vendbanime brenda parkut, madje nuk ka fare transport publik.

Në të gjitha vendbanimet rreth parkut janë instaluar sistemet e ujësjellësit e në disa prej tyre edhe ato të kanalizimit të ujërave të zeza, ndërkaq vetëm në dy vendbanime brenda parkut ka ujësjellës, kurse sisteme të kanalizimit nuk ka askund.

Sa u përket treguesve të tjerë të kualitetit të banimit, banorët e vendbanimeve rreth parkut janë poashtu në gjendje më të mirë se sa ata të fshatrave brenda parkut. Ata i kanë shkollat, objektet shëndetësore, postare, bankare, dyqanet, shtëpitë e kulturës, objektet fetare, ofiçinat e automjeteve më afër dhe më lehtë të arritshme. Në vendbanimet urbane rreth parkut ka edhe hapësira të rregulluara enkas për sport dhe rekreacion e që mungojnë në vendbanimet brenda parkut.

→ Vendbanim në Park





### 1.3.14. Ndërtimet në Park

Në kuadër të procesit të hartimit të këtij dokumenti është hartuar edhe "Raporti i incizimit të gjendjes faktike, fotografimit, evidentimit të objekteve të ndërtuara dhe verifikimit të lejeve të ndërtimit në territorin e PK Bjeshkët e Nemuna". Bazë për të prezantuar të dhënat e kërkuara kanë qenë Ortofotot e ndryshme dhe raportet/analizat e tjera hapësinore, sipas të cilave numri i përgjithshëm i ndërtimeve brenda Parkut është gjithsej 5.131.


Komuna	Numri i objekteve	%
Peja	2.875	56.00
Deçani	1.491	29.00
Istogu	396	7.70
Juniku	246	4.80
Gjakova	123	2.50
Gjithsejtë	5.131	100.00

Sipas kësaj analize, vendbanimet me numer më të madh të ndërtimeve janë: Boga, Jashanica e Shtupeqi i Madh, në të cilat kryesisht dominojnë objektet e banimit, pas të cilave vijnë objektet ekonomike dhe objektet e staneve.

Sa i përket pronës, këto objekte kryesisht janë të ndërtuara në pronë private, ndërsa në aspektin hapësinor objektet në fjalë shtrihen në Zonën e dytë dhe të tretë sipas zonimit preliminar të Parkut, të përcaktuar nga komisioni profesional.

Rezultat i kësaj analize është harta e shtrirjes hapësinore të ndërtimeve, në të cilën mund të shihet shtrirja hapësinore dhe dendësia e ndërtimeve në territorin e Parkut.

→ Shtrirja hapësinore e ndërtimeve në kuadër të Parkut.





## 1.4. ZHVILLIMI EKONOMIK

Aktivitetet kryesore ekonomike që zhvillohen në Park ndërlidhen kryesisht: me shfrytëzimin e drurit, shfrytëzimin e kullosave, me aktivitete turistike-rekreative, me kultivimin e bimëve mjekësore dhe mbledhjen e frutave të imëta.

Trendi aktual i zhvillimit është përqëndruar në turizëm, në ndërtime të reja dhe adoptimin e objekteve ekzistuese. Vlerësohet se pjesa më e madhe e këtyre aktiviteteve është realizuar në mënyrë stihike, pa ndonjë plan paraprak.

Zhvillimi ekonomik është i përqëndruara në zonën e ndikimit, në vendbanimet përreth parkut ku dominojnë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme si: tregtia, ndërtimtaria dhe bujqësia.

### 1.4.1. Veprimtaria bujqësore dhe blegtorale

Bujqësia është veprimtari e rëndësishme për vendbanimet që ndodhen brenda dhe jashtë kufirit të PK "Bjeshkët e Nemuna". Sektorët primarë të ekonomisë lokale: bujqësia dhe blegtoria janë traditë e banorëve të zonave brenda dhe jashtë kufirit të parkut.

Sipërfaqet e pyjeve, livadheve dhe kullosave malore, frutave të imëta dhe bimëve mjekësore në kuadër të parkut, kanë ndikuar në zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë ekstensive.

Resurset natyrore të volitshme, pasuritë ujore si dhe toka e përshtatshme kanë mundësuar që të kultivohen prodhime eko-bujqësore të cilat arrijnë rendimente cilësore të kulturave bujqësore: bimët mjekësore aromatike dhe pemët me fruta të imëta, prodhimeve blegtorale (qumështi, djathi, kosi, gjiza, gjalpi) si dhe të prodhimet e mjaltës dhe dyllit.

#### 1.4.1.1. Bujqësia

Në bazë të kushteve agroekologjike që ka zona e ndikimit rreth parkut, në komunat: Pejë, Istog, Deçan, Junik dhe Gjakovë, arrihen rendimente cilësore të llojeve të ndryshme: pemë dhe perime që bëjnë furnizimin e tregut me produkte të freskëta, drithëra dhe bimë foragjere. Kulturat bujqësore në zonën e ndikimit kultivohen në tokat cilësore, në formë të serave, ku

kushtet janë më të favorshme, sidomos rreth rrjedhave të lumenjëve (Lumbardhit të Deçanit dhe Lumbardhit të Lloqanit). Në komunën e Junikut perimekultura kultivohet në kopshte shtëpiake. Në venbanimet Batushë dhe Mulliq të komunës së Gjakovës, arrihen rendimente të larta të kulturave bujqësore (pasuli i Mulliqit) që i plotësojnë kërkesat e banorëve dhe më gjërë.

**Pemëtaria** – Pemëtaria kultivohet në masë mesatare në fshatrat brenda kufirit të parkut, në Jasiq dhe Gjoçaj të komunës së Junikut. Karakteristikë e pjesës malore të Junikut dhe Deçanit është zona e pasur me gështenja që ka rëndësi të madhe si për frytin ashtu edhe për lëndën drunore.

Pemët e larta si: molla, dardha, vishnja dhe pemët të imta (dredhëza, mjedra) kultivohen rreth kufirit të parkut në fshatrat Pobërgjë dhe Voksh të komunës së Deçanit si dhe në fshatrat e komunës së Istogut, Pejës, Junikut dhe Gjakovës. Këto veprimtari kultivohen për konsum familjar, për të plotësuar kërkesat e banorëve lokal në kuadër të vendbanimeve në territorin e parkut dhe jashtë tij, si dhe për përfitime ekonomike.

#### 1.4.1.2. Blegtoria

Zhvillimi i sektorit të blegtorisë ekstensive si veprimtari sezonale, është traditë që kultivohet në zonën kodrinore malore (bjeshkë) brenda parkut dhe në zonën e ndikimit duke i shfrytëzuar livadhet dhe kullosat e lira në natyrë që janë më afër vendbanimeve. Kushtet agroekologjike, përkatësisht sipërfaqja e madhe e kullosave (24.6%), si resurs potencial për blegtori dhe resurset ujore në të gjithë territorin e parkut, janë faktorë që ndikojnë në zhvillimin e blegtorisë dhe prodhimin e produkteve blegtorale.



Kullosat ekzistuese në viset kodrinore-malore të: Rugovës, Bjeshkëve të Junikut dhe Deçanit, Istogut dhe Gjakovës brenda kufirit të parkut, shfrytëzohen për kultivimin e lopëve, kuajve, deleve dhe dhive. Ky aktivitet është traditë e kahmotshme e zonës. Stanet janë prezente në tërë territorin e parkut, por kryesisht janë të koncentruara në bjeshkët e Deçanit dhe të Rugovës. Janë të njohura: stanet e Bellopojës (që gjenden në lartësi gati 1800 m), të Belegut, të Isniqit, Shtupeqit të Vogël dhe të fshatit Prelep në lartësi prej 1900m.

Produktet blegtorale, kultivohen vetëm nga ekonomitë familjare me metoda të vjetra, ndërsa shitja e tyre bëhet pa ndonjë organizim të veçantë, në tregun e brendshëm. Kryesisht këto prodhime mblihen nga tregtarë të cilët i plasojnë në tregun e qendrave më të afërta: Pejë, Gjakovë, Istog Junik dhe Deçan.

Kultivimi i veprimtarive blegtorale është në ulje për shkak të humbjeve të mëdha të bagëtisë gjatë luftës, braktisjes së vendbanimeve rurale, braktisjes së kultivimit të tokës si dhe mungesës së mbështetjes institucionale të fermerëve për arritje më të mira në blegtori.



→ Blegtoria në Bjeshkët e Rugovës

#### 1.4.2. Bletaria

Zhvillimi i bletarisë në kuadër të parkut, është ngushtë i lidhur me bujqësinë. Ekziston një numër i konsiderueshëm i ekonomive familjare që merren me bletari - prodhimin e mjaltës, si aktivitet sekondar i cili nuk kërkon shumë kohë.

Regjioni i Deçanit, Junikut dhe Istogut ka kushte të mira për zhvillimin e bletarisë. Kosheret e bletëve janë të vendosura pranë shtëpive, resurseve të polenit dhe ujit të freskët, ku kushtet klimatike janë më të volitshme, duke pasur parasysh edhe faktin se territori është ekologjik dhe rezulton me prodhime cilësore.



→ Bletaria ne Deçan

Në Komunën e Istogut dhe të Deçanit ekziston një numër i konsiderueshëm i koshereve me bletë, ku kultivohet mjalta e cilësisë së lartë.

#### 1.4.3. Bimët mjekësore dhe frutat e imëta

Hapësira e PK "Bjeshkët e Nemuna" përfshinë një territor mjaft të gjërë dhe të pasur me bimë mjekësore aromatike (BMA) dhe pemë frutore të egra (PFE), që është një potencial në aspektin e ekonomik.

Gjatë vitit 2007 është bërë hulumtimi dhe inventarizimi i këtij rajoni, në bazë të cilit në territorin e Bjeshkëve të Nemuna gjinden këto lloje të BMA dhe PFE me rëndësi ekonomike, si: boronica, dëllinja, agulicja, shtogu, molla e egër, murrizi, thana, lule basami, gështenja, barpezmi, hithra, listra, trëndafil i egër, etj.

Bjeshka e Istogut, ana veriore e Rugovës, bjeshkët qëndrore, Gjeravica, Juniku karakterizohen me kulturat e bimëve me veti mjekuese si lincuri, rrudhani dhe disa lloje të kërpudhave.

Popullata që merret me grumbullim e këtyre bimëve është e vogël, ndërsa mundësitë për përfitime ekonomike janë shumë të mëdha. Grumbullimi i këtyre produkteve deri me tani ka qenë spontan, i pa organizuar dhe i pa kontrolluar nga institucionet përkatëse shtetërore, që si pasojë ka ndikim në zvogëlimin e fondit të BMA.



→ Pemët frutore të imëta

Në periudhën e hartimit të profilit është konstatuar se, në komunën e Junikut është në përfundim "Fabrika për përpunimin e frutave të pyllit" – që shërben për grumbullimin, deponimin, përpunimin, marketingun dhe shitjen e tyre. Fabrika do të furnizohet nga 5-së pika grumbulluese të Regjionit Ekonomik Perëndimor të Kosovës<sup>12</sup> dhe një nga Kukësi (Shqipëri), ku janë të angazhuar rreth 300 mbledhës.

Në Komunën e Istogut, në fshatin Syne, vepron kompania private, e cila merret me grumbullimin e bimëve të malit dhe përpunimin e frutave të malit, por që furnizimi bëhet nga 33 qendra e tërë teritorit të Kosovës<sup>13</sup>.

#### 1.4.4. Industria

Në regjionin e Bjeshkëve nuk ka ndonjë industri të zhvilluar por vlen të ceket kompania private në Drelaj të Rugovës, që merret me ambalazhimin e ujit (i cili mbushet direkt nga burimi) dhe me përpunimin e qumështit (bylmetit). Këto produkte plasohen në tregun e Kosovës dhe jashtë saj.

Në komunën e Deçanit është në funksion Hidrocentrali i Kozhnjerit - Lumbardhit që prodhon një sasi të vogël të energjisë deri në 8 MW/h.

Përgjatë kufirit të parkut në zonën e ndikimit, ndodhen edhe disa veprimtari ekonomike si: kooperativa bujqësore në Irzniq, një kompani e cila merret me përpunimin e asfaltit dhe zhavorit në Junik dhe gjashtë kompani për shfrytëzimin e gurit të fortë që operojnë në: Qafën e Shkozës, Vrellë, Lubozhdë, Isniq dhe dy në Strelc të Epërm.

Në kuadër të parkut kombëtar, pyjet janë potencial prodhues që radhiten ndër burimet më me rëndësi të zhvillimit ekonomik dhe social. Sipas vlerës teknike, bëjnë pjesë në pyjet me potencialin më të lartë të prodhimit të drurit teknik të halorëve dhe gjethorëve në Kosovë. Masa drunore shfrytëzohet për përfitime ekonomike të popullatës, për nevoja të ngrohjes dhe për përpunimin e drurit që kanë ndikuar në zvogëlimin e resurseve pyjore. Shfrytëzimi i resurseve pyjore është i pakontrolluar për shkak të mungesës së organizimit të mirëfilltë të menaxhimit të pyjeve dhe prerjeve ilegale që po i dëmtojnë ato.


#### 1.4.5. Tregtia dhe zejtaria

Në vendbanimet e Parkut dhe përreth ti, tregtia si degë e ekonomisë është e përqëndruar jashtë kufirit të parkut. Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automobilave dhe artikujve shtëpiak është forma më e përhapur e koncentrimit të kapitalit në sektorin privat, ku shumica e ndërmarrjeve janë biznese familjare, kryesisht si ndërmarrje të vogla dhe të mesme.

Zejtaria përfaqësohet nga zejtarët tradicionale por pak nga ato kanë mbetur: tradita e qethjes së deleve për përpunimin e leshit, përpunimi i pëlthurave, thurja e rrobave tradicionale, qëndisja, zdrukthëtaria, farkëtaria, saraçët etj. Në komunën e Pejës dominon tradita familjare e tjerrjes dhe e punimit të lidhëseve e mërhamave, ndërsa në komunën e Junikut ka zanatlinjë që ende punojnë dhe dekorojnë djep prej druri, etj. Kanë mbetur pak nga përpunuesit e zejeve të vjetra dhe kultivuesit e tyre, në qytetin e Gjakovës mund të haset ende në Mëndafsh - punues (Kazaz); Saraç – përpunues të lëkurave; Zdrukthtarë – përpunues të drurit, por që fatkeqësisht interesimi për përpunimin e këtyre zejve është në rënje. Këta zejtarë i hasim në Pejë në Qarrshinë e Gatë dhe Gjakovë në Qarrshinë e Madhe, njëherit këto zeje paraqesin një atraksion për turistët vendas dhe të huaj. Prandaj, zejtaria me prodhimet dhe shërbimet e veta paraqet një segment të veçantë të zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

<sup>12</sup> REPK – Gjakovë, Junik, Deçan, Pejë, Istog dhe Klinë

<sup>13</sup> <http://m.telegrafi.com/ekonomi/program-per-bimet-mjekesore-dhe-aromatike-46-11783.html>



→ Qarshia e Madhe në Gjakovë dhe Mulliri në Deçan

#### 1.4.6. Turizmi dhe potencialet turistike në Park

Teritori i Bjeshkëve të Nemuna që shquhet për natyrorën cilësore dhe monumente kulturore-historike është hapësira kapitale për zhvillimin e turizmit të Kosovës. Territori i shpallur për park kombëtar në kuadër të rajonit turistik të Bjeshkëve të Nemuna, posedon kushte të jashtëzakonshme të zhvillimit të aktiviteteve turistike - rekreative për sporte dimërore, për pushim dhe rekreacion të qytetarëve gjatë gjithë vitit. Qendra më e madhe është Peja, ndërsa qendra më të vogla janë Deçani, Juniku, Istogu dhe Gjakova, njëherit edhe pikënisje për kapacitetet turistike.



→ Rugovë




Bjeshkët e Nemuna ndahen në tri regjione si qendra potenciale për zhvillimin e turizmit në tërësi e sidomos atij dimëror:

- **Regjioni, Bjeshka e Belegut** në lartësi mbidetare prej 2200-2300m, si qendër (me mundësi për zhvillimin e skitarisë me kapacitet të vizitorëve 17000/ditë);
- **Regjioni, Bjeshka e Lumbardhit, Milishevës dhe livadhet e Tiganëve** në lartësi mbidetare 850m, (me kapacitet të vizitorëve 10000/ditë);
- **Regjioni, Bjeshka e Rusolisë**, Shtedimi, Hajla dhe Gropa e Madhe .

**Skijimi** – Kushtet e volitshme klimatike, lartësia dhe gjatësia kohore e mbajtjes së mbulesës së borës bëjnë të mundur zhvillimin e periudhës mjaft të gjatë të shfrytëzimit të tereneve për skijim. Studimet e viteve të 70-ta tregojnë se lokalitetet në Bjeshkët e Nemuna mund ti përballojnë deri në 30.000 skitarë. Terene potenciale kryesore për skitari janë lokalitetet si: Maja e Rusolisë, Maja e Kurvalës, Bjeshka e Belegut, Koprnik, Rrasa e Zogut, Starac, Maja e Strellcit, Hajla, Maja e Liqenatit, Maja e Moknes.

**Alpinizmi** – Alpinizmi zhvillohet në masivin shkëmbor, në regjionin e dytë të Bjeshkëve të Nemuna, maja e Gjeravicës, Boriq, Maja e Ropsit, Maja e Rusolisë, Kurvalla, Maja e Strellcit, Maja e Qenit, Koprivnik (Kërshi i Çverlës), Marjashi (Bagdash), Leqinati, Maja e Lumbardhit, Hajla, Gusan, Kota, Maja e Bajrakut, Mali Kozhnjer dhe në majet shkëmbore në veri të Shqipërisë si: Maja e Hekurave dhe Shkëlzeni.

**Shpellat** – Shpellat kanë vlera të larta turistike dhe studimore. Në park gjenden: Shpella e Radavcit, Shpella e Karamakazit, shpellat e vogla të Princshës, shpellat përgjatë Gërles së Koshutanit, Shpella afër Gurrës së Rutës etj. Në të ardhmen këto shpella mund të jenë edhe si qendra të studimeve nga spelologët.



→ Alpinizmi- "Guri i Kuq" dhe Shpella "Gryka e Madhe"

**Gjuetia dhe peshkataria**<sup>14</sup> janë prezente në zonat kodrinore dhe malore, në regjionin e Deçanit: në Kozhnjer, Roshkodol dhe në bjeshkët e Prilepit,

ndërsa në pjesën e Pejës është Rezervati i Rusolisë që njihet me llojet e shtazëve: "Gjahu i lartë" si: ariu, kaprolli, derri, dhelpra, çjapi i egër, rrëqebulli, kunalja e artë, kunalja e bardhë etj, dhe "Gjahu i ultë" që e përbëjnë: lepuri, thëllëza, fazani, pula e egër, gjeli i pyjeve etj.

Peshkimi në lumenjtë e Bjeshkëve të Nemuna zhvillohet në rrjedhat ujore malore, në të cilat gjendet trofta - Salmo truta.

Zhvillimi i aktiviteteve turistike-rekreative është i mundur në tri forma themelore:

- stacionar,
- vikend-shetitje dhe
- tranzit.

#### 1.4.6.1. Potencialet turistike në Park sipas komunave

##### Potencialet turistike – Pjesa e Istogut


**Zona turistike e Bjeshkëve** - Lokaliteti Lugu i Butë, Gurrat e bardha, Radusha, Bajsha;



→ Potencialet turistike - Pjesa e Istogut

##### Potencialet turistike – Pjesa e Pejës


Zona turistike e Koprnikut: Lokaliteti turistik Bjeshka e Isniqit; Zona turistike e Rugovës: Lokaliteti turistik: Grykës së Rugovës, Bjeshkës së Lumbardhit, Liqenatit, Bogës dhe Drelajve; Zona turistike e luginës së Drinit: Lokaliteti turistik i Burimit të Drinit – Radavci



→ Potencialet turistike - Pejë

##### Potencialet turistike – Pjesa e Deçanit

Zona turistike e Deçanit me rrethinë; Lokaliteti i Luginës së Lumbardhit, Radoniqit dhe Podit të Gështenjave; Zona turistike e Grykës së Deçanit: Lokaliteti Pishave të Deçanit, Bellesë dhe Pleqës, Kozhnjerit, Lugina e Lumbardhit, Bjeshka e Belegut, Prelepit, Roshkodolit, Milishevci, Zllonopoja, Baballoqit dhe Lokaliteti Bjeshka; Zona turistike e Bjeshkëve të Strellcit: Lokaliteti i bjeshkëve të Strellcit.



→ Potencialet turistike - Decan

<sup>14</sup> Sipas rregullave në fuqi kjo veprimtari është e ndaluar.



**Potencialet turistike – Junik**


Zona e Junikut me rrethinë: Lokaliteti Moronica dhe Lugina e Erenikut, Zona e Grykës së Junikut – Lokaliteti i Gradinës, Jedova, Lugu i Gatë dhe Rrasa e Zogut; Burimi i Erenikut dhe Liqejtë e Gjeravicës; Zona e Grykës së Batushës – Gjocaj, Jasiq dhe Zharra;



→ Potencialet turistike - Junik

**Potencialet turistike – Pjesa e Gjakovës**

Rrasa e Zogut, Maja e Zezë dhe Gomuret; Braha, Pjesë e Livadhit të Shabanit dhe Rrasa e Koshares; Oplazi dhe Fshati Koshare; Lugina e lumit Gusha; Kodra e Shkozës me Babushin dhe Bokën.



→ Potencialet turistike - Gjakovë

**Turizmi në Park – Pjesa e Pejës**

Rugova është qendra më e frekuentuar e masivit të Bjeshkëve të Nemuna. Aktivitetet që zhvillohen gjatë gjithë vitit janë të shumëta: qëndrimi në natyrë të lirë, gjuetia, peshkimi, turizmi fshatar, turizmi shëndetësor, ngjitjet në shkëmbinjë - alpinizëm, ecjet malore, eksplorimet në shpella, çiklizmi malor, ecjet me shputa bore, skijimi, kampingjet, aventurat e ndryshme, ekskursionet ditore dhe vikendore, etj. Vizitat dhe qëndrimi bëhet në shumë lokalitete e sidomos në Kuqishtë, Liqenat, Shtupeq i Madh, Bogë, Radavc - burimi i Drinit Bardhë, liqejtë e Liqenatit dhe disa lokalitete të tjera.

Në hyrje të Grykës së Rugovës pranë Patrikanës së Pejës është "Qendra për vizitorë", që ofron shërbime dhe informacione për turistët si: harta, broshura informuese, suvenire tradicionale si dhe biçikleta për të vizituar Grykën e Rugovës dhe Bjeshkët e Nemuna në përgjithësi.



→ Tabelat informative

Janë të definuara shtatë zona për ngjitje (10 - 300 m), njëra prej tyre është te Guri i Kuq ku gjindet edhe shpella "Gryka e Madhe". Grupet e vizitorëve të interesuar për ngjitje (*Alpinizëm*) dhe hulumtim në shpella udhëhiqen nga udhëheqës profesional.

Në kuadër të parkut ekzistojnë shtigjet për ecje dhe çiklizëm malor, të cilat janë të paisura me tabela informuese, në të cilat përshkruhet kategoria e vështirësisë së shtegut, të cilat përshkohen në këmbë ose me biçikleta. Janë të njohura shtigjet si:

- Drelaj – Liqeni i Vogël – Liqeni i Madh – Kuqishtë;
- Rekë e Allages-Stanishte e epërme ;
- Drelaj-Dugaive;
- Drelaj-Liqenat-Lugu i Shkodrës.




→ Liqeni i Madh

Turistët në parkun kombëtar që janë kryesisht turistë vendorë (rreth 5000 vizitorë/vit) janë të fokusuar më tepër për qëndrim gjatë vikendeve. Numri i vizitorëve të huaj është më i vogël (rreth 2000 vizitorë/vit) të cilët vijnë në mënyrë të organizuar sipas ofertave turistike.

Fuksi më i madh i vizitorëve gjatë sezonit veror është në periudhën qershor – shtator; ndërsa gjatë sezonit dimëror, prej muajit dhjetor deri në shkurt. Gjatë verës numri i vizitorëve arrin deri 20000<sup>15</sup>, ku shumica prej tyre janë bashkëatdhetarë nga diaspora.

Numri i turistëve është në rritje, këtë mund ta shohim edhe ne grafikun e më poshtëm i cili tregon numrin në rritje të turistëve sipas viteve:



→ Numri i turistëve të informuar në zyrën për turizëm

Destinimet më të kërkuara për vizita janë: pjesa e Rugovës (aktivitetet malore), Radaci - Ujëvara e Drinit dhe ato kulturore ku vizitohet qyteti i

<sup>15</sup> Sipas Zyrës së Informimit Turistik në Pejë.





Pejës. Dimrit interesimi më i madh i turistëve kryesisht është për qendrën e skijimit në fshatin Bogë, ku ekziston edhe një infrastrukturë modeste, ski-ashensor me gjatësi rreth 1km.



→ Fshati Bogë dhe shtegu i skijimit

Gjatë sezonës së verës mundësitë për akomodim në park janë më të mëdha, pasi që janë në dispozicion edhe lokacionet tjera si: Drelaj, Pepaj, Reka e Allagës, Shtupeq, etj.

Mundësi të akomodimit për turistët ofrohen në: 2 hotele, 11 motele dhe 14 restorane, 2 kampe të organizuara nga dy shoqata dhe 8 ekonomi familjare aktive dhe fshati turistik, Liqenat me kapacitet akomodues për 200 persona.

Kapacitetet akomoduese nuk janë të mjaftueshme në krahasim me kërkesat e vizitorëve.

Kërkesat për të investuar në këto lokalitete janë të mëdha, kryesisht janë të përqëndruara në vila për qiradhënje, hotele dhe motele.



→ Liqeni i Vogël



→ Gryka e Rugovës

#### Turizmi në Park - Pjesa e Istogut

Malet mbi Istog ku gjenden: Lugu i Butë, Gurrat e bardha, Radusha, Bajsha etj, llogariten vendet më të mira për pushim dhe rehabilitim. Në këtë pjesë të parkut nuk ka objekte hoteljere shërbyese, prandaj vizitat kryesisht janë

në formë të vizitave ditore. Në këto lokalitete arrihet përmes rrugëve të cilat janë vështirë të kalueshme, por mund të arrihet me vetuara të terrenit. Aktualisht nuk mund të thuhet për numrin e vizitoreve, pasi që vizitat kryesisht janë individuale dhe nuk ka të dhëna lidhur me numrin e vizitorëve në këtë zonë.



→ Lugu i butë

#### Turizmi në Park - Pjesa e Deçanit

Resuret të mëdha natyrore që ka pjesa e Deçanit janë tërheqëse dhe interesante për adhuruesit e natyrës së paprekur dhe hulumtuesit e interesuar për zonën. Në bjeshkë ekziston një numër i madh i gurrave, liqejve të njohuri: "Sytë e maleve" dhe lumi i Deçanit përgjatë rrugës për në Bjeshkët e Belegut, që ofrojnë kushte të mira për zhvillimin e turizmit, ndërsa burimi i ujit të thartë dhe pishat e Deçanit si pasuri e rrallë me veti shëruese, shfrytëzohen për turizëm shëndetësor.



→ Bjeshkët e Belegut



Aktivitetet rekreative në këtë pjesë zhvillohen përgjatë shtigjeve të ecjes, ndërsa atraktiviteti më i madh arrihet gjatë lundrimit (*Rafting-ut*) në Drinin e Bardhë, që udhëhiqet nga cicëronët me përvojë.

Kullat, si pjesë e vendbanimeve tradicionale shqiptare në fshatin Dranoc, të cilat janë adaptuar në bujtina ofrojnë shërbime për turistë.

Në lokalitetet e zonave: Grykës së Deçanit Belegut, Grykës së Lloqanit dhe Bjeshkëve të Strellcit vitet e fundit janë ngritur shtëpi malore nga banorët vendas për pushime, ku disa prej tyre ofrohen për shfrytëzim të vizitorëve. Gjithashtu ekzistojnë kapacitetet hotelierike të cilat momentalisht nuk janë në shfrytëzim: pushimorja e fëmijëve "Pishat e Deçanit" me kapacitet rej 550 - 600 shtretër dhe kompleksi hoteljer me kapacitet deri në 243 shtretër.

#### Turizmi në Park - Pjesa e Junikut

Lokalitetet më të vizituara nga turistët vendas dhe të huaj në pjesën e Junikut janë: Maja e Gjeravicës me dy liqejtë natyror, lumi Erenik, Moronica, kullat dhe teqet, etj. Turistët mund të paisen me informata përmes Qendrës rajonale të turizmit në Junik. Numri më i madh i të interesuarve është për të vizituar liqejtë dhe Majen e Gjeravicës, e cila arrihet përmes dy shtigjeve (njëri shteg ka gjatësi 7.4 km dhe shtegu tjetër 7.0 km). Shtigjet janë të paisura me tabela informuese që tregojnë: drejtimin, lokacionin, burimet për ujë të pijshëm, lartësinë mbidetare, etj.



→ Maja e Gjeravicës

Numri i vizitorëve që kërkojnë informata në zyrën e Qendrës rajonale të turizmit - Junik arrin rreth 6000 vizitorë/vit. Vizitat nga turistët vendor dhe të huaj janë në rritje e sipër, sidomos është në rritje numri i vizitave në formë të ekskurzioneve nga shkollat e mesme dhe fillore.

Turistët të cilët e vizitojnë pjesën e Junikut, akomodohen kryesisht në kulla dhe shtëpi të vjetra, të restauruara dhe të shëndrruara në bujtina, ku ata kanë mundësinë që të njihen me traditat e kësaj ane. Numri i turistëve të cilët mund të akomodohen në këto bujtina arrin në 50.



→ Qendra rajonale e turizmit Junikut & Kulla -Bujtina

#### Turizmi në Park - Pjesa e Gjakovës

Lokalitetet e pjesës së Gjakovës që i përkasin Pakut Kombëtar shquhen si për nga vlerat e trashëgimisë natyrore poashtu edhe ato kulturore – historike. Në kuadër të Pakut Kombëtar- Pjesës së Gjakovës është edhe ZIV "Beteja e Koshares", zonë me rëndësi të trashëgimisë historike dhe kulturore (në të cilën hasim gjurmë arkeologjike të qytetërimit të lashtë si Fortesa e Jerinës, etj).



→ Rrasa e Koshares

Turizmi apo vizitat realizohen në formë të ekskurzioneve ditore. Forma më e shprehur e vizitave është ajo individuale për në varrezat e dëshmorëve si dhe vizitat e organizuara në përkujtim të të rënëve në zonën e Koshares gjatë luftës së fundit në Kosovë. Aktivitetet më të shpeshta rekreative janë ato të shoqatave të bjeshkatarëve.



→ Koshare

#### 1.4.6.2. Zhvillimi i turizmit ndërkufitar Kosovë-Mali i Zi-Shqipëri në Bjeshkët e Nemuna

Bashkëpunimi ndërkufitar konsiston në turizmin malor, ecjen nëpër shtigjet që lidhin këto tri shtete nëpër viset më të larta dhe fshatrat e largëta malore të Bjeshkëve të Nemuna.

Shtegu turistik "Majat e Ballkanit" është i gjatë 192 km që krijon një rreth të mbyllur në të trija shtetet, Shqipëri (Theth), Mali i Zi (Plavë) dhe Kosovë (Pejë). Vizita mund të fillojë nga cilido shtet. Këto shtigje mund të kalohen për 10-13 ditë varësisht nga interesimi, kërkesat dhe kondicioni i vizitorëve, shetitja është e organizuar dhe shoqërohet me udhëheqës turistik.



→ Shtegu i shetitjes – Shqipëri, Kosovë, Mali i Zi<sup>16</sup>


Këto aktivitete kanë ndikim direkt në ngritjen ekonomike të banorëve të fshatrave të këtyre zonave, përmes ofrimit të bujtinave (shtëpive malore të adaptuara për akomodim të turistëve), ushqimit etj.

Mundësitë për bashkëpunim ndërkufitar mes tri shteteve-Kosovë, Shqipëri, Mali i Zi janë të mëdha, pasi që këtë mundëson pozita e cila i lidh ato me zonat përtej kufijëve si:

- Lugu i Shkodrës (lidhë Rugovën me Tropojën dhe Shkodrën);
- Qafa e Çakorrit që të qon në Plavë e Guci (Mali i Zi);
- Qafa e dasmorëve në veri të fshatit Bogë që lidhë Rugovën me Buxhovin e Rozhajen (Mali i Zi);
- Qafa e Hajles është rruga kryesore që lidhë Malësinë e Rugovës (fshatrat Dacaj dhe Husaj) me Rozhajën (Malin e Zi);
- Guri i Ndre Nikës (Shtedim) me gjatësi prej 5 km si vend i përshtatshëm për skijim shtrihet në dy hapësira territoriale të Kosovës dhe Malit të Zi.

→ Gjendja aktuale e turizmit në Park

<sup>16</sup>[http://www.peaksofthebalkans.com/index.php?option=com\\_content&view=article&id=15&Itemid=219&lang=en](http://www.peaksofthebalkans.com/index.php?option=com_content&view=article&id=15&Itemid=219&lang=en)



PLANI HAPËSINOR I PARKUT KOMBËTAR "BJESHKËT E NEMUNA"  
 MINISTRIA E MJEDISIT DHE E PLANIFIKIMIT HAPËSINOR  
 AGJENCIA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS  
 INSTITUTI PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR



## 1.5. INFRASTRUKTURA FIZIKE

### Gjendja momentale e infrastrukturës fizike:

Rruga nacionale M9 Pejë-Kuqishtë-kufiri me Malin e Zi, e asfaltuar – brenda parkut 21.5 km;

Rruga regjionale R106 Pejë-Rozhajë(Malin e Zi), e asfaltuar – brenda parkut 9.6 km;

Rruga regjionale R108 Deçan-kufiri me Malin e Zi, e pa asfaltuar – brenda parkut 23 km;

Të gjitha vendbanimet përreth parkut mbulohen nga shërbimi i transportit publik të udhëtarëve, kurse brenda parkut ato që mbulohen janë: Shtupeq i Vogël, Shtupeq i Madh, Drelaj, Kuqishtë, Haxhaj dhe Bogë. Fshatrat tjerë brenda parkut, në zonat më të thella të Rugovës mbulohen nga furgonët;

Brenda parkut, sinjal të telefonisë mobile GSM ka në vendbanimet: Haxhaj, Bogë, Jashanicë, Drelaj, Shtupeq i Madh, Shtupeq i Vogël, Lipë, Cerovërhë, Kuqishtë, Gjocaj dhe Jasiq. Sinjal ka pjesërisht në: Pepiq, Rekë e Aliagës, Malajt dhe Shkrel. Asnjë vendbanim brenda parkut nuk mbulohet nga sinjali televiziv ajror e poashtu nuk ka as televizion kabllovik. Programet televizive, në zonën e parkut kombëtar mund t'i shikojnë vetëm banorët të cilët i kanë pajisjet për pranimin e signalit televiziv nga sateliti;

Brenda territorit të parkut kombëtar gjenden hidrocentralet e vegjël, ai i Kozhnjerit në lumin Lumbardh të Deçanit dhe ai i Radacit afër grykës së burimit të lumit Drini i Bardhë, komuna e Pejës. Këta hidrocentrale sot janë në funksion dhe kanë kapacitet prej 8.3 MË ai i Kozhnjerit dhe 1 MË ai i Radacit;

Brenda parkut, vetëm dy vendbanime, Lipa dhe Cerovërha kanë të instaluar sistemet e ujësjellësit, kurse sisteme të kanalizimit të ujërave të zeza nuk ka të instaluar në asnjë vendbanim brenda parkut;

Asnjë vendbanim brenda parkut nuk përfshihet nga shërbimi i largimit të mbeturinave.

Kur flitet për infrastrukturën fizike, zakonisht flitet për infrastrukturën e transportit (infrastruktura rrugore, hekurudhore, aeroportet dhe limanet), infrastrukturën e energjetikës (të energjisë elektrike, asaj termale, etj), infrastrukturën ujore (hidroteknike), infrastrukturën e telekomunikacionit dhe infrastrukturën e menaxhimit të mbeturinave. Zhvillimi apo siguri i infrastrukturës fizike nënkupton mundësimin e lëvizjes së njerëzve dhe mallrave, furnizimin me energji elektrike, furnizimin me ujë dhe menaxhimin e ujërave të ndotura, komunikimin midis njerëzve, menaxhimin e mbeturinave etj. Rëndësia e këtyre funksioneve që u përmendën, pa të cilat nuk mund të paramendohet jeta në shekullin 21, flet bindshëm për rëndësinë e madhe që e ka zhvillimi i infrastrukturës fizike.

### 1.5.1. Infrastruktura e transportit dhe transporti

**Rrugët** – Rruga nacionale M9 kalon nëpër pjesën qendrore të parkut kombëtar dhe të shpie tek fshati Kuqishtë i komunës së Pejës dhe më tutje tek kufiri me Malin e Zi. Kjo rrugë deri në Kuqishtë është në gjendje kryesisht të mirë fizike, gjë që nuk mund të thuhet për pjesën në vazhdim, deri në kufi. Gjatësia e rrugës M9 brenda parkut është 21.5 km. Rruga regjionale R106 Pejë-Rozhajë (Mali i Zi) e përshkon parkun kombëtar me një gjatësi prej 9.6 km në pjesën veriperëndimore të tij. Kjo rrugë e asfaltuar është në një gjendje relativisht të mirë. Mirëmbajtja dimërore dhe verore e saj është e vazhdueshme. Një rrugë tjetër që kalon nëpër territorin e parkut, në pjesën që i takon komunës së Deçanit, është rruga regjionale R108 Deçan-kufiri me Malin e Zi. Kjo rrugë që brenda parkut ka një gjatësi prej 23 km, është e paasfaltuar dhe në gjendje të keqe. Vendbanimet përreth parkut të cilët si zona kadastrale hyjnë në territorin brenda kufirit të parkut janë të lidhur me rrugë të asfaltuara regjionale.

Duke filluar nga komuna e Istogut, nëpër Lubozhdë dhe Vrellë kalon rruga R103, fare pranë saj është edhe Studenica, kurse Kaliqani që është pak më larg lidhet me këtë rrugë përmes një rruge lokale. Rruga R103 tek Banja në komunë të Pejës lidhet me rrugën R101, e cila në vazhdim, në periferi të Pejës lidhet me rrugën R106. Me R106, përmes rrugëve lokale lidhen vendbanimet përreth parkut, të cilat i takojnë komunës së Pejës si: Jabllanica e Madhe, Jabllanica e Vogël, Radavci, Novosella, Siga dhe Brestoviku. Rruga R106 përfundon në Pejë dhe nga këtu vazhdon kah territori i komunës së Deçanit rruga regjionale R107. Rruga R107 në komunën e Pejës i lidhë fshatrat Bellopojë, Zagërme dhe Lybeniq të cilat gjenden përreth parkut kombëtar. Në vazhdim kjo rrugë regjionale, në komunën e Deçanit i lidhë fshatrat përreth parkut si: Strellci i Epërm, Lëbushë, Isniq dhe Deçan. Në Deçan kjo rrugë lidhet me rrugën R109 e cila i lidhë fshatrat e Deçanit si: Hulaj, Pobërgjë, Lloqan dhe Voksh, të gjitha përreth parkut kombëtar. Duke vazhduar kah jugu, rruga R109 kalon nëpër Junik, i cili poashtu si zonë kadastrale hyn në territorin brenda kufirit të Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" dhe më tutje në komunën e Gjakovës ajo kalon nëpër Batushë dhe Mulliq.

Derisa vendbanimet përreth parkut janë të lidhura me një rrjet të rrugëve relativisht të mira dhe lehtë të qarkullueshme, këtë fat nuk e kanë patur shumë vendbanime që janë brenda kufinjve të parkut. Fshatrat e komunës së Pejës si: Stankaj, Dugaivë, Koshutan, Pepaj, Shkrel, Rekë e Allagës, Malaj, Llaz-Bellopaq, Lipë dhe Cerovërhë (Breg i Zi) janë të lidhur me rrugë, të cilat nuk janë në gjendje të mirë, ku qarkullimi i automjeteve realizohet me vështirësi që për pasojë ka qasjen jo të lehtë deri tek këto vendbanime. E njëjta vlen edhe për fshatrat Belle dhe Irzniq 2 të komunës së Deçanit dhe Gjocaj e Jasiq të komunës së Junikut.

**Transporti** – Shërbimi i transportit publik të udhëtarëve i mbulon të gjitha vendbanimet përreth parkut. Transporti realizohet me autobusë dhe furgonë. Sa i përket vendbanimeve brenda parkut, transporti publik e mbulon tërë trevën e Rugovës. Autobusi nga Peja në Kuqishtë qarkullon nëpër rrugën nacionale M9, destinacion të fundit e ka fshatin Bogë. Rrugës ai ndalet në Shtupeq të Vogël, Shtupeq të Madh, Drelaj, Kuqishtë dhe Haxhaj. Fshatrat tjerë, në zonat më të thella të Rugovës mbulohen nga furgonët. Transporti publik nuk mbulon vendbanimet tjera brenda parkut si: Belle dhe Irzniq 2 të komunës së Deçanit, Gjocaj dhe Jasiq të komunës së Junikut dhe Koshare të Komunës së Gjakovës.



→ Rrugë regjionale (siper) dhe rrugë lokale në park

### 1.5.2. Telekomunikacioni

Brenda kufirit të Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" nuk ka rrjet të telefonisë fikse, mirëpo në disa vendbanime përreth ku ndërtesat janë jashtë parkut, por si zona kadastrale hyjnë në territorin e parkut, siq janë Deçani, Isniqi dhe Juniku rrjeti ekziston.

Sinjal të telefonisë mobile GSM brenda kufirit të parkut, sa i përket komunës së Pejës, ka në vendbanimet: Haxhaj, Bogë, Jashanicë, Drelaj, Shtupeq i Madh, Shtupeq i Vogël, Lipë, Cerovërhë dhe Kuqishtë. Pjesërisht ka sinjal në: Pepiq, Rekë e Aliagës, Malajt dhe Shkrel, kurse sinjali mungon në: Dugaivë, Koshutanë dhe Llaz-Bellopaq. Sa i përket vendbanimeve të komunës së Pejës përreth parkut, sinjal GSM ka në Jabllanicë të Madhe, Jabllanicë të Vogël, Radavc, Novosellë, Sigë, Brestovik, Lëvoshë, Bellopojë, Zagërme dhe Lybeniq. Në vendbanimet e komunës së Deçanit që janë brenda parkut kombëtar, Bellej dhe Irzniq 2 nuk ka sinjal, gjë që nuk është rast me vendbanimet përreth si: Deçani, Strellci i Epërm, Lëbusha, Isniqi, Hulaj, Pobërgja, Lloqani dhe Vokshi. Në të dy vendbanimet e komunës së Junikut brenda parkut, Jasiq dhe Gjocaj e natyrisht edhe në Junik që shtëpitë i ka jashtë parkut, ka sinjal të telefonisë mobile GSM. Në Koshare që është brenda parkut dhe në dy vendbanimet përreth parkut Batushë dhe Mulliq, të trija të komunës së Gjakovës ka sinjal GSM, kurse sa i përket komunës së Istogut që nuk ka vendbanime brenda parkut, sinjal të telefonisë mobile ka në vendbanimet përreth: Kaliqan, Studenicë, Vrellë dhe Lubozhdë.



Internet, brenda kufirit të parkut ka në Bogë dhe Kuqishtë, e ka edhe në vendbanimet përreth parkut si: Jabllanicë e Madhe, Jabllanicë e Vogël, Radavc, Novosellë, Sigë, Brestovik, Lëvoshë, Bellopojë, Zagërme, Lybeniq, Deçan, Strellci i Epërm, Lëbushë, Isniq, Hulaj, Pobërgjë, Lloqan, Voksh, Junik, Batushë, Mulliq, Kaliqan, Studenicë, Vrellë dhe Lubozhdë, kurse GPRS (Internet) ka në ato vendbanime ku ka sinjal të telefonisë mobile GSM.

Sa i përket televizionit, asnjë vendbanim brenda parkut nuk mbulohet nga sinjali televiziv ajror e poashtu nuk ka as televizion kabllovik. Programet televizive, në zonën e parkut kombëtar mund t'i shikojnë vetëm banorët të cilët i kanë pajisjet për pranimin e signalit televiziv nga sateliti. Të gjitha vendbanimet përreth parkut kombëtar që u përmendën më lart mbulohen nga sinjali televiziv ajror i tri televizioneve kombëtare RTK, TV21 dhe KTV.

### 1.5.3. Infrastruktura e energjisë elektrike

Vendbanimet brenda parkut kombëtar dhe ato në kufi me të furnizohen me energji elektrike nga largpërçuesit 10 kV, nga 4 Dalje: Dalja 10 kV Radavci nga TS 110/35/10 kV Peja 1, Dalja 10kV Rugova nga TS 35/10 kV Peja 2, Dalja 10kV Manastiri i Deqanit nga TS 35/10 kV Isniq dhe Dalja 10 kV Bletaria nga TS 35/10 kV Isniq. Në Daljen 10 kV Radavci që është në gjendje të mirë, janë gjithësejt 11 trafostacione TS 10/0.4 kV të cilët përnga kapaciteti variojnë prej 50 kVA deri në 630 kVA duke e përbërë një total prej 2360 kVA.

Dalja 10 kV Rugova nuk është në gjendje të mirë. Në të, brenda parkut janë të lidhur gjithësejt 27 trafostacione TS 10/0.4 kV. Prej tyre, 2 janë në Shtupeq të Vogël, 1 në Llaz-Bellopaq, 2 në Shtupeq të Madh, 1 në Llotovë, 1 në Rekë të Allagës, 1 në Malaj, 1 në Pepaj, 1 në Koshutan, 1 në Shkrel, 1 në Dugaivë, 4 në Drelaj, 5 në Kuqishtë, 1 në Haxhaj, 2 në Stankaj dhe 3 në Bogë, me kapacitet total prej 3460 kVA.

Dalja 10 kV Manastiri i Deqanit është në gjendje të mirë. Në të është i lidhur trafostacioni TS 10/0.4 kV Manastiri me kapacitet 400 kVA.

Dalja 10 kV Bletaria është në gjendje të mirë. Në këtë largpërçues janë të lidhur 5 trafostacione TS 10/0.4 kV të cilët përnga kapaciteti variojnë prej 100 kVA deri në 630 kVA dhe së bashku kanë kapacitet prej 1680 kVA.

Sa u përket kapaciteteve për prodhimin e energjisë elektrike, brenda territorit të parkut kombëtar gjenden hidrocentralet e vegjël, ai i Kozhnjerit në lumin Lumbardh të Deqanit dhe ai i Radacit afër grykës së burimit të lumit Drini i Bardhë, komuna e Pejës. Këta hidrocentralet sot janë në funksion dhe kanë kapacitet prej 8.3 Më ai i Kozhnjerit dhe 1 Më ai i Radacit.

### 1.5.4. Infrastruktura ujore

Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" është i pasur me burime dhe rrjedha ujore nga të cilat e marrin ujin e pijes banorët e vendbanimeve përreth parkut dhe ata që janë brenda në park. Në vazhdim janë të dhënat për infrastrukturën ujore për vendbanimet brenda parkut dhe për ato përreth parkut të cilat kanë ndikim në park dhe si zona kadastrale hyjnë në brendësi të parkut.


**Ujësjellësit** – Në komunën e Pejës, vendbanimet brenda parkut ku janë të instaluar sistemet e ujësjellësit janë Lipa dhe Cerovërha, kurse mungojnë në Haxhaj, Bogë, Stankaj, Dugaivë, Koshutan, Pepiq, Drelaj, Shkrel, Rekë e

Allagës, Malaj, Shtupeq i Madh, Shtupeq i Vogël dhe Llaz-Bellopaq. Sa u përket atyre përreth kufirit të parkut, ujësjellës ka në të gjitha pra në: Jabllanicë të Madhe, Jabllanicë të Vogël, Radavc, Novosellë, Sigë, Brestovik, Lëvoshë, Bellopojë, Zagërme dhe Lybeniq. Vendbanimet tjera përreth parkut që kanë ujësjellës por që i takojnë komunës së Deqanit janë: Deçani, Strellci i Epërm, Lëbusha, Isniqi, Hulaj, Pobërgja, Lloqani dhe Vokshi. Ujësjellësit mungojnë në vendbanimet brenda parkut, Belle dhe Irzniq 2 të cilat janë pothuajse tërësisht të depopulluar. Në komunën e Istogut, vendbanimet përreth parkut që kanë ujësjellës janë: Lubozhda, Vrella, Studenica dhe Kaliqani, kurse në komunën e Junikut vetëm Juniku ka ujësjellës, ndërkaq vendbanimet që janë brenda kufirit të parkut kombëtar si Gjocaj dhe Jasiq, nuk kanë. Kosharja e komunës së Gjakovës që gjendet brenda parkut, nuk ka ujësjellës, ndërsa në dy vendbanimet përreth parkut, të komunës së Gjakovës si Batushë dhe Mulliq, ujësjellësit janë duke u instaluar.

**Kanalizimet e ujërave të zeza** – Sistemet e kanalizimit të ujërave të zeza janë pjesërisht të instaluar në fshatrat Lubozhdë, Vrellë, Studenicë dhe Kaliqan të komunës së Istogut. Në asnjërin nga fshatrat brenda parkut dhe përreth parkut të cilët i takojnë komunës së Pejës e që janë përmendur më lartë, nuk ka tubacione për kanalizimin e ujërave të zeza. Sa i përket komunës së Deqanit, prej vendbanimeve të trajtuar këtu, kanalizim ka vetëm Deçani dhe pjesërisht fshati Hulaj, kurse në komunën e Junikut, vetëm në Junik ka sistem të kanalizimit. Fshatrat e komunës së Gjakovës, Batushë dhe Mulliq që janë përreth parkut, kanë kanalizime, kurse fshati Koshare, brenda parkut nuk ka.

### 1.5.5. Menaxhimi i mbeturinave

Shërbimi i largimit të mbeturinave i mbulon të gjitha vendbanimet përreth parkut që po i trajtojmë këtu e që i përkasin komunës së Istogut, pra Lubozhdën, Vrellën, Studenicën dhe Kaliqanin. Vendbanimet e komunës së Deqanit që janë brenda parkut nuk mbulohen nga ky shërbim, kurse sa u përket atyre përreth parkut, Deçani, Pobërgja dhe Lloqani mbulohen plotësisht, ndërkaq Strellci i Epërm, Lëbusha, Isniqi, Hulaj dhe Vokshi vetëm pjesërisht. Në komunën e Junikut gjendja është si në vazhdim: shërbimi i largimit të mbeturinave përfshin Junikun, por jo edhe vendbanimet brenda parkut, Gjocaj dhe Jasiq. Vendbanimet Koshare dhe Batushë, i pari brenda dhe i dyti pranë kufirit të parkut kombëtar nuk përfshihen nga ky shërbim, kurse Mulliqi përfshihet pjesërisht.



→ Infrastruktura teknike



## 1.6. ANALIZA SWOT

### Përparësitë

1. Ekzistenca e autoritetit të parkut – drejtorisë së parkut;
2. Mjedis i pastër;
3. Biodiversitet i pasur;
4. Park i pasur me pyje dhe kullosa;
5. Pasuri peizazhore;
6. Burime të fuqishme ujore;
7. Park i pasur me bimë mjekësore aromatike dhe pemë frutore të egra;
8. Potenciale të mëdha për zhvillimin e turizmit;
9. Kushte të përshtatshme për zhvillim të blegtorisë dhe bletarisë;
10. Pozitë e mirë gjeografike – shtrirja e Bjeshkëve të Nemuna në tri shtete;
11. Bashkëpunimi ndërkufitar ekzistues me ç’rast organizohet aktiviteti i ecjes në bjeshkët e trekëndshit kufitar Kosovë – Mali i Zi – Shqipëri;
12. Rrjeti ekzistues i rrugëve dhe shtigjeve;
13. Trashëgimi i pasur kulturor;
14. Ekzistenca e Qendrës Informative – Rugovë që ofron shërbime dhe informacione për turistët;
15. Popullësi në moshë të re;
16. Vendi i parë i projektit ndërkufitar Kosovë – Mali i Zi – Shqipëri që ka të bëjë me aktivitetin e ecjes, me emrin “Peaks of the Balkans”, i dhënë nga Këshilli Botëror për Udhëtim dhe Turizëm (World Travel and Tourism Council);
17. Shenjëzimi ekzistues dhe qasja në informata përmes ëeb faqes;
18. Prania e staneve

### Dobësitë

1. Mungesa e planit menaxhues të parkut;
2. Monitorim dhe ruajtje e pamjaftueshme e parkut;
3. Zhvillime të paplanifikuara;
4. Degradimi i pyjeve si pasojë e zjarreve, sëmundjeve dhe prerjeve të pakontrolluara;
5. Dëmtimi i bimëve endemike dhe endemorelike;
6. Mbledhja e pakontrolluar e bimëve mjekësore dhe pemëve frutore të egra;
7. Erozion i theksuar në park;
8. Mungesa e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit;
9. Marketing i pamjaftueshëm për parkun;
10. Rënja e numrit të popullsisë;
11. Kapacitetet akomoduese nuk i mbulojnë kërkesat e vizitorëve;
12. Mungesë e pikave grumbulluese për produktet blegtorale

### Mundësitë

1. Përfshirja e parkut në iniciativa ndërkombëtare;
2. Nënshkrimi i konventave ndërkombëtare;
3. Përfshirja e parkut në listat e parqeve ndërkombëtare;
4. Bashkëpunimi ndërkufitar për realizimin e projekteve të përbashkëta;
5. Konkurrimi me projekte që do të financohen nga investitorët e jashtëm;
6. Shfrytëzim i përvojave të vendeve të zhvilluara për mënyrën e menaxhimit të parkut;
7. Promovimi i vlerave turistike, kulturore dhe natyrore;
8. Zhvillimi i ekoturizmit, turizmit rural, turizmit sportiv, turizmit rekreacional dhe turizmit aventurier;
9. Rritja e ofertës turistike të Kosovës përmes parkut;
10. Zhvillimi i aktiviteteve hulumtuese-shkencore, kulturore dhe edukativo-arsimore;
11. Mbështetje institucionale për zhvillimin e mëtejshëm të blegtorisë dhe bletarisë;
12. Ngritja e kualitetit të jetesës të popullsisë brenda dhe rreth parkut duke i shfrytëzuar mundësitë për përfitime ekonomike që i ofron parku;
13. Ngritja e vetëdijes për vlerat dhe rëndësinë e parkut

### Rreziqet

1. Mospërfshirja e parkut në konventa, iniciativa dhe organizata ndërkombëtare (IUCN, WTO, RIO etj);
2. Vendet fqinje më atraktive për investime;
3. Parku kombëtar jo konkurrent me parqet e vendeve tjera;
4. Mungesa e investimeve;
5. Menaxhimi i dobët i parkut;
6. Përhapja e zhvillimeve kaotike në mungesë të planeve hapësinore dhe rregulluese;
7. Mosmenaxhimi i situatave në rastet e fatkeqesive natyrore;
8. Prezenca e minave në vendbanimet Gjocaj, Jasiq dhe në kufirin me Shqipërinë

## 1.7. SFIDAT KRYESORE

Institucionet përgjegjëse për parkun dhe grupet e ndryshme të interesit, në rrugën e tyre për ta ruajtur por edhe zhvilluar parkun, padyshim se do të ballafaqohen me sfida të ndryshme të cilat lidhen pikërisht me këto dy synime kryesore: mbrojtjen dhe ruajtjen e parkut, nga njëra anë dhe zhvillimin e tij, nga ana tjetër. Gjatë hartimit të këtij plani hapësinor, duke u bazuar në gjendjen ekzistuese në park dhe në zhvillimet e dëshiruara në të ardhmen, janë identifikuar këto sfida:

1. Administrimi dhe menaxhimi i parkut;
2. Mbrojtja dhe ruajtja e mjedisit, peizazhit, biodiversitetit dhe vlerave natyrore e kulturore të parkut;
3. Shfrytëzimi racional i resurseve natyrore në dobi të zhvillimit ekonomik në park;
4. Rigjallërimi i aktiviteteve tradicionale në vendbanimet e parkut dhe ruajtja e traditës si faktorë ndikues në ndaljen apo zvogëlimin e migrimit;
5. Zhvillimi i planifikuar i infrastrukturës

### 1.7.1. Administrimi dhe menaxhimi i parkut

#### Pse dhe çka është sfiduese?

Territori i Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” ka vlera natyrore të rëndësishme së jashtëzakonshme për Republikën e Kosovës dhe më gjerë, prandaj, mbrojtja, ruajtja, ngritja dhe shfrytëzimi i këtyre vlerave janë të interesit të veçantë vendor dhe të përbashkët rajonal e ndërkombëtar. Nisur nga kjo, pajtimi në mes të gjitha palëve të interesit për shpalljen e zonës së përcaktuar për park kombëtar nga Qeveria e Kosovës, është shumë i rëndësishëm.

Sfida e administrimit dhe menaxhimit të parkut ngërthen në vete realizimin e detyrave që i ka organi administrues dhe menaxhues i parkut dhe zgjidhjen e të gjitha problemeve që lidhen me planifikimin, rregullimin, udhëheqjen dhe kontrollin e zhvillimeve në park.

Ekzistimi dhe funksionimi i shumë subjekteve që menaxhojnë me asete të caktuara të parkut paraqet sfida më vete sa i përket bashkëpunimit në mes tyre dhe koordinimit të punëve. Në rast të moskoordinimit të veprimtarisë së tyre, do të krijohet hapësira dhe mundësia për veprime degraduese apo arsytetime për mosveprime në dobi të parkut që lidhen me ndarjen e përgjegjësisë. Momentalisht, për shembull për menaxhimin e pasurive pyjore të parkut, përgjegjës janë tri subjekte që kanë “hise”: Drejtorja e Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” që është pjesë e AMMK-së pranë MEA-së, Agjencia e Pyjeve pranë MBPZHR-së - e cila praktikisht i menaxhon të gjitha pyjet e Kosovës dhe në fund komunat - të cilat sipas Ligjit për Pyjet janë përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve në territoret e tyre. Këtu me të drejtë shtrohet pyetja: A është më mirë që parku të menaxhohet nga një apo më shumë subjekte?

Administrimi dhe menaxhimi i parkut nga Drejtorja e Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” në cilësinë e koordinatorit të veprimeve të subjekteve me “hise”, duke u bazuar në një rregullore të brendshme dhe duke qenë nën mbikqyrjen e Qeverisë, i parandalon konfliktet eventuale midis këtyre subjekteve në çështjet e menaxhimit dhe ato nuk vijnë në pozitë që ta



fajësojnë njëra tjetrën për mosmbarëvajtjen eventuale të punëve. Në këtë rast gjasat janë më reale që administrimi dhe menaxhimi i parkut kombëtar të jetë më i lehtë dhe më praktik.

Administrimi dhe menaxhimi është i suksesshëm atëherë kur zhvillimet në park janë konform me planin hapësinor dhe menaxhues të parkut dhe me planet rregullues.

#### Lista e çështjeve të identifikuar

- Pajtueshmëria e palëve të interesit për shpalljen e zonës së Bjeshkëve të Nemuna për park kombëtar;
- Bashkëpunimi dhe koordinimi i veprimeve në mes të subjekteve që menaxhojnë me asetet e parkut;
- Hartimi i Planit Hapësinor për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna";
- Krijimi i bazës së të dhënave për tërë atë që e posedon Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna";
- Hartimi i Planit për Menaxhim të Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna";
- Hartimi rregullores për administrimin dhe menaxhimin e parkut;
- Promovimi i vlerave huluntuëse, shkencore-arsimore, edukative, rekreative dhe turistike të parkut;
- Inicimi i shpronësimit dhe ndërimi i titullarit të pronës në rast të zbatimit të domosdoshëm të zhvillimeve të nevojshme për Parkun.

→ Prerja e pa kontrolluar e pyjeve



### 1.7.2. Mbrojtja dhe ruajtja e mjedisit, peizazhit, biodiversitetit dhe vlerave natyrore e kulturore te parkut

#### Çka është sfiduese?

Çështja e mjedisit është një ndër çështjet kryesore për shoqërinë tonë. Është shumë i rëndësishëm angazhimi në zbulimin e mistereve të jetës, tokës, ujit dhe ajrit që na rrethon. Poashtu duhet të bëhen gjithnjë e më të qarta pasojat e ndikimit të njerëzimit në mjedis, kur dihet se shumë aktivitete individuale apo kolektive që po ndodhin në hapësirën tonë jetësore, janë të pakontrolluara dhe nuk janë në harmoni me normat dhe standardet evropiane të mjedisit. Kjo dukuri, përveç tjerash, në vendin tonë paraqitet edhe si pasojë e mungesës së planeve hapësinore dhe të menaxhimit për zonat e caktuara, të nivelit qendror dhe të atij lokal.

Parku i Bjeshkëve të Nemuna ka një pozitë shumë të përshtatshme gjeografike, me relief të pasur, male të larta, gryka, lumenj, peisazhe të llojllojshme dhe kullosa, florë dhe faunë të pasur që së bashku paraqesin një vend atraktiv për tu zhvilluar dhe vizituar në të ardhmen.

Sfidë e jona është se si mund ta shfrytëzojmë këtë pozitë dhe potencial natyror e kulturor në favor të bashkëpunimit dhe zhvillimit të parkut, komunave që janë pjesë e parkut, të Kosovës dhe të shteteve (Shqipëri dhe Mali i Zi) që janë pjesë e masivit malor - Bjeshkëve të Nemuna?

Sfiduese në PK "Bjeshkët e Nemuna" është si duhet të mbrohet parku nga degradimet antropogjene dhe natyrore, ndotja e ekosistemeve, me fjalë të tjera mundësia e shfrytëzimit të pasurive të parkut për zhvillimin e sotëm, duke mbajtur përgjegjësi për ardhmërinë e parkut edhe për gjeneratat e ardhshme.

**Peisazhet** - Parku është i pasur me peisazhe natyrore si ato hidrografike, malore, fshatare, kulturore etj. Mbrojtja e peisazheve të parkut paraqet një sfidë. Shkatërrimi i pyjeve dhe zhvillimet e pakontrolluara ia humbin vlerën dhe rëndësinë peisazheve, prandaj ato duhet të parandalohen. Në këtë aspekt element i rëndësishëm është krijimi i programeve ndërkufitare (Kosovë, Shqipëri, Mali i Zi) për identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen, menaxhimin dhe planifikimin e peisazheve që i kalojnë kufijtë, në përputhje me parimin e subsidiaritetit të Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore. Peisazhi luan një rol të rëndësishëm në rrafshin kulturor, ekologjik, mjedisor dhe shoqëror e poashtu është burim për veprimtaritë ekonomike, të cilat mundësojnë hapjen e vendeve të reja të punës.

**Trashëgimia kulturore** - Parku dhe vendbanimet rreth tij janë të pasura me vlera të trashëgimisë kulturore e sidomos me shtëpi, kulla, lokalitete arkeologjike dhe manastire. Ruajtja, shfrytëzimi, promovimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i këtyre vlerave paraqet një sfidë të veçantë për zhvillimin e ardhshëm të parkut. Shumëllojshmëria e pasurisë me trashëgimi kulturore, etnografike, gastronomike dhe peisazhore paraqet potencial dhe mundëson zhvillimin e turizmit rural, eko-turizmit dhe turizmit kulturor, mundëson bashkëpunimin ndërkombëtar në mes të komunave që janë pjesë e parkut si dhe bashkëpunimin ndërshtetëror, me harmonizimin e planeve të zhvillimit të turizmit për Bjeshkët e Nemuna në mes të Kosovës, Shqipërisë dhe Malit të Zi.

Me anë të rekonstruimit dhe revitalizimit të shtëpive dhe kullave në park dhe në afërsi të tij do të mund të ruheshin vlerat e arkitekturës tradicionale, të shtëpive dhe kullave nga degradimet dhe me ofrimin e bujtinave,

ushqimit tradicional, shitjes së prodhimeve vendore dhe artizanale për turistë dhe vizitorë do të favorizohej zhvillimi ekonomik i parkut dhe më gjerë.

**Prerja ilegale e pyjeve** brenda parkut dhe zonës buferike në pronën shoqërore dhe atë private është dukuri aktuale në park. Ruajtja e resurseve pyjore ka rëndësi të madhe për një zhvillim të qëndrueshëm i cili ndikon pozitivisht edhe në ruajtjen e botës shtazore.

**Dëmtimi i biodiversitetit** nënkupton reduktimin e numrit të llojeve bimore e shtazore. Ruajtja e biodiversitetit, e posaçërisht e llojeve endemike të bimëve është e nevojshme për ruajtjen e ekuilibrit ekologjik. Keqpërdorimi i botës bimore dhe shtazore, llojeve të bimëve endemike dhe llojeve të shtazëve të egra që janë në Park sjell deri te zvogëlimi i numrit të tyre e madje edhe deri tek humbja e tyre që do të thotë humbja e vlerave natyrore. Ndërtimi i Hidrocentralit në Lumbardhin e Decanit i cili ka filluar para shpalljes së Parkut Kombëtar është njëri ndër aktivitetet më sfiduese ndaj biodiversitetit dhe mjedisit në përgjithësi. Ndërhryjet që janë duke u bërë në lum dhe në dy brigjet e tij janë argumente të mjaftueshme që një gjë e tillë në territorin e Parkut të mos lejohet në të ardhmën.

**Fatkeqësitë natyrore** që paraqiten në forma të ndryshme, si gërryerje sipërfaqësore e tokës, sëmundje të pyjeve, zjarre, ortiqe që shkaktohen nga faktorë natyror dhe antropogjen, rrezikojnë begatitë e krijuara dhe të planifikuara. Si mund të menaxhohen ato, cilat janë mundësitë? Cilat janë masat paraprake që do të ndikojnë në zvogëlimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore?

**Ndotja e ujit, ajrit dhe tokës** – Edhe pse nuk ka ndotje të madhe në park, kjo megjithatë ka filluar të ndodhë. Këtu nuk kemi zhvillim industrial dhe transport të dendur, si shkakton më me ndikim negativ në mjedis prandaj cilësia e ajrit është e mirë, mirëpo, aktivitetet tjera si për shembull hedhja e mbeturinave, prerja e drunjve, gërryerja e sipërfaqeve për ndërtimin e objekteve ilegale turistike e hoteljere dhe shfrytëzimi pa kriter i pyjeve që janë prezentë në zonë, ndikojnë në ndotjen dhe degradimin e mjedisit. Menaxhimi eventual jo i mirë me parkun në të ardhmen dhe mungesa e kontrollit të zhvillimeve në të do të kishin për pasojë rritjen e ndotjes. Tek zhvillimet e tilla do të hapeshin deponi të mbeturinave dhe ujërat e zeza do të derdreshin ashtu të patrajtuara dhe në mënyrë të pa kontrolluar.

#### Çfarë thonë konventat dhe direktivat në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe të trashëgimisë kulturore?

Ekziston një varg politikash ndërkombëtare dhe konventash në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe të trashëgimisë kulturore që janë të aplikueshme për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna". Ato përfshijnë:

- Konceptet themelore të UNESCO-s thonë që secili send i trashëgimisë kulturore dhe natyrore është unik dhe zhdudka e cilitdo send përbën një humbje definitive dhe varfërim të pakthyeshëm të trashëgimisë. Trashëgimia natyrore është pronë e përgjithshme që duhet të shfrytëzohet nga të gjithë dhe të mbrohet në mënyrë që t'i dorëzohet gjeneratave të ardhshme, ta shfrytëzojnë edhe ato.
- Unioni botëror për Ruajtjen dhe Konservimin e Natyrës (shkurt në anglisht IUCN) ka bërë kategorizimin e zonave të mbrojtura të natyrës. Pas kategorisë së parë ku hyjnë rezervatet strikte natyrore vjen kategoria e dytë në të cilën janë parqet nacionale. Parku Kombëtar "Bjeshkët e



Nemuna" mbrohet me ligj dhe si i tillë zë një vend meritor në këtë familje.

- Në Samitin për Tokën, të mbajtur në vitin 1992 në Rio de Janeiro, liderët botëror u morën vesh për një strategji gjithëpërfshirëse për „zhvillimin e qëndrueshëm”. Njëra prej marrëveshjeve kryesore që kanë dalë nga Samiti ka qenë Konventa për Diversitetin Biologjik. Kjo konventë i obligon shtetet që e kanë ratifikuar atë që të nxjerrin ligje dhe akte të tjera juridike përmbajtësore për mbrojtjen e mjedisit dhe të aplikojnë sistematikisht përgjegjësinë ndaj shkatërruesve dhe përgjegjësve për mjedisin jetësor.
- Konventa Europiane për Peisazhin - Firenca 2000 ka për qëllim kryesor mbrojtjen, menaxhimin dhe planifikimin e peisazheve në Europë. Ajo është pjesë e punës së Këshillit të Europës për trashëgiminë natyrore dhe kulturore, planifikimin hapësinor, mjedisin dhe vetëqeverisjen vendore. Shqetësimi për zhvillim të qëndrueshëm, i shprehur në konferencën e Rio de Janeiro, e bën peisazhin element shumë të rëndësishëm në krijimin e një bilanci ndërmjet ruajtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore si reflektim i identitetit dhe diversitetit evropian dhe përdorimit të saj si burim ekonomik i aftë të gjenerojë vende pune në kuadrin e zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm.
- Konventa për mbrojtjen e trashëgimisë arkitekturore të Europës - Granada 1985, ka për qëllim mbrojtjen e trashëgimisë arkitekturore e cila përbën shprehjen e pazëvendësueshme të pasurisë dhe diversitetit të trashëgimisë kulturore të Europës, është njëra nga dëshmitë e së kaluarës sonë dhe bartjes tek gjeneratat e ardhshme. Përveç kësaj konventa synon përmirësimin e mjedisit urban dhe rural me përfshirjen e trashëgimisë në politikat e planifikimit urban dhe rregullimit të mjedisit që do të rezultojë me zhvillim ekonomik, social dhe kulturor të shteteve të Europës.
- Konventa e Espoos e vitit 1991 që ka hyrë në fuqi në vitin 1997 e që ka të bëjë me vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekstin ndërkufitar, i obligon shtetet që e kanë ratifikuar atë, që ta bëjnë këtë vlerësim për aktivitete të caktuara qysh në fazat e hershme të planifikimit. Shtetet duhet ta njoftojnë njëra tjetrën dhe të konsultohen nëse implementimi i ndonjë projekti do të mund të kishte ndikim të pafavorshëm në mjedisin e hapësirës ndërkufitare.
- Konventa e Lluganos e vitit 1993 për detyrimet civile për dëmet që rezultojnë nga aktivitetet e rrezikshme për mjedisin jetësor i obligon ratifikuesit e kësaj konvente për kompensimet që palët dëmtuese duhet t'ua bëjnë palëve të dëmtuara për dëmet në mjedisin jetësor e gjithashtu i obligon për sigurimin e mjeteve për mbrojtje dhe për kthimin në gjendjen e mëparshme.
- Direktiva e Këshillit të Evropës për ruajtjen e habitateve natyrore dhe florës e faunës së egër e vitit 1992 i përcakton masat që duhet t'i ndërmarrin shtetet anëtare të Këshillit të Evropës në mënyrë që të ruhen habitatet natyrore, flora dhe fauna e egër.
- Sipas koncepteve të UNESCO-s, konventave dhe standardeve të BE-së, zhdukja e llojeve bimore dhe shtazore si dhe prerjet ilegale të pyjeve janë humbje e trashëgimisë natyrore të parkut.

Në drejtim të mbrojtjes, ruajtjes dhe zhvillimit të një trashëgimie të pasur natyrore, autoritetet duhet të punojnë në rritjen e vetëdijes për vlerat saj.

Ligji për Planifikim Hapësinor përmban parimin për zhvillimin e qëndrueshëm dhe tani është koha që të gjitha parimet që përmban ky ligj, pastaj standardet, konventat dhe agjendat e ndryshme të përkthehen në veprime konkrete dhe të reflektohen në menaxhim.

Zbatimi i ligjeve në fuqi dhe i konventave ndërkombëtare do të kontribuojë në zvogëlimin e problemeve mjedisore dhe të trashëgimisë kulturore në Parkun Kombëtar „Bjeshkët e Nemuna”. Ligjet relevante me sfidën në fjalë e të cilat duhet të zbatohen janë:

- Ligji për mbrojtjen e mjedisit,
- Ligji për mbrojtjen e natyrës,
- Ligji për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna",
- Ligji për pyje,
- Ligji për mbrojtjen e tokave bujqësore,
- Ligji për mbrojtjen e ujërave,
- Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja,
- Ligji për mbeturina,
- Ligji për kimikate,
- Ligji për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes,
- Ligji për vlerësimin strategjik mjedisor,
- Ligji për mbr. nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe sigurinë nukleare,
- Ligji për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësive tjera,
- Ligji për mbrojtje nga zjarri,
- Ligji për trashëgiminë kulturore,
- Ligji për zonat e veçanta të mbrojtura

#### Cilat janë mundësitë e identifikuara?

**Konteksti i ngushtë** – Për mbrojtjen e mjedisit dhe të të gjitha vlerave të parkut do të duhej të ndërmerren hapa konkret si:

- Ndarja e qartë e përgjegjësive në menaxhimin e parkut;
- Përpilimi i planit menaxhues të parkut;
- Hulmimet për gjendjen aktuale të biodiversitetit, prerjeve ilegale, fatkeqësive, ndotjeve në park;
- Nënshkrimi i konventave ndërkombëtare për mbrojtjen e natyrës;
- Zbatimi i legjislacionit relevant në park

**Konteksti i gjerë** - Parku dallohet me zona me vlera të veçanta natyrore, hidrografi, pyje, kullosa, livadhe dhe biodiversitet jo vetëm në Kosovë por edhe më gjërë.

Zonat e ndjeshme natyrore dhe zonat tjera të vlefshme nuk mund të trajtohen në izolim, meqë ndikimi i këtyre zonave është më i gjërë.

Përveç trendeve lokale nga komunat ku ka shtrirje Parku dhe dinamikës rajonale (shtrirja e Bjeshkëve të Nemuna edhe në shtetet fqinje Shqipëri dhe Mal të Zi), ndryshimet globale në Ballkan dhe më gjërë, gjithashtu ndikojnë në mjedisin e hapur, si dhe menaxhimin e mbrojtjen natyrore, në veçanti në zonën a parkut.

Si do t'i qaset Kosova ndryshimeve globale me ndryshimin fiziko-geografik, biologjik etj. dhe si do të mund të ndihmojë në përpjekjet ndërkombëtare për të trajtuar këtë problem, është sfidë në kontekst më të gjërë?

#### Lista e çështjeve të identifikuara

- Mungesa e menaxhimit dhe koordinimit të masave dhe aktiviteteve në park;
- Degradimi i pyjeve;
- Rrezikimi i biodiversitetit;
- Fatkeqësitë natyrore (erozioni, ortiqet, zjarri, smundjet);
- Shfrytëzimi joracional i kullosave;
- Mungesa e inventarizimit të llojeve bimore dhe shtazore;
- Mungesa e publikimit të llojeve specifike natyrore;
- Gjetja dhe shfrytëzimi i masave hidroteknike, bujqësore dhe biologjike si mundësi;
- Ndotja e ujit në zonat me potencial të zhvillimit të turizmit;
- Objektet me trashëgimi kulturore brenda dhe në afërsi të parkut;
- Prezenca e Zonave të veçanta të mbrojtura në kudër të parkut si: Patriarkana e Pejës dhe Manastiri i Deçanit;
- Prezenca e vendbanimeve në park dhe rreth tij;

→ Ndërtimet e paplanifikuara







### 1.7.3. Shfrytëzimi racional i resurseve natyrore në dobi të zhvillimit ekonomik në Park

#### Pse dhe çka është sfiduese?

Rregullimi dhe shfrytëzimi i parqeve kombëtare brenda një shteti ofron mundësi për përfitime ekonomike. Territori i Bjeshkëve të Nemuna si tërësi hapësinore karakterizohet me vlera dhe llojlojshmëri peisazhore me rëndësi shkencore, edukativo – arsimore, kulturore – historike, rekreative – turistike që janë potencial për zhvillim ekonomik.

Si të ruhen dhe të shfrytëzohen në mënyrë racionale resurset natyrore në dobi të zhvillimit ekonomik, duke pasur parasysh se në një masë janë evidente: prerja e pakontrolluar e pyjeve, ndërtimi i paplanifikuar, shfrytëzimi i pakontrolluar i peizazheve për aspekte komerciale, që kanë pasoja në degradimin e mjedisit dhe në zhvillimin e ardhshëm të parkut?

Sfiduese janë çështjet praktike dhe teknike të lidhura me shfrytëzimin e PK "Bjeshkët e Nemuna" sikur që janë:

- Ngritja e njohurive të përgjithshme për vlerat natyrore dhe kulturore të PK "Bjeshkët e Nemuna", për mundësitë e përfitimit ekonomik;
- Parandalimi i ndikimeve të dëmshme në parkun kombëtar;
- Shfrytëzimi i kullosave, bimëve mjekuese aromatike si dhe pemëve frutore të egra në harmoni me ligjin për mbrojtjen e natyrës dhe ligjeve përkatëse;
- Zhvillimi i ekoturizmit dhe bujqësisë tradicionale të cilat nuk janë në kundërshtim me mbrojtjen e natyrës por kërkojnë një menaxhim aktiv;
- Planifikimi i zhvillimeve në park: ndërtimi, rindërtimi dhe mbrojtja e objekteve tradicionale si dhe zhvillimi i turizmit në park;
- Ngritja e ofertës turistike në dobi të zhvillimit ekonomik të parkut;
- Përgatitja e programeve të përshtatshme për grupet e ndryshme të vizitorëve;
- Përgatitja e programeve për aktivitete rekreative, hulumtuese shkencore;
- Bashkëpunimi ndërkomunal, ndërkufitar dhe ndërkombëtar lidhur me zhvillimin e PK "Bjeshkët e Nemuna";
- Njohja e PK "Bjeshkët e Nemuna" në WTTC-Këshillin botëror për turizëm (sikurse që është rasti me projektin "Majat e Ballkanit"- të organizuar nga komuna e Pejës;
- Konkurrimi i Kosovës me resurset e veta natyrore në turizëm në rajon dhe më gjerë;

#### Cilat janë mundësitë e identifikuar?

**Konteksti i ngushtë** – PK "Bjeshkët e Nemuna" mund të jetë i vetëqëndrueshëm financiarisht, përderisa të hyrat mund të përdoren për mbrojtje dhe zhvillim të tij. Komunitetet përreth PK "Bjeshkët e Nemuna" mund të përfitojnë nga zhvillimi i qëndrueshëm dhe mund të investojnë bashkarisht në ngritjen e ofertës turistike që do të rezultonte me rritje ekonomike të banorëve brenda dhe jashtë parkut.

Është e nevojshme mbështetja (financiare, institucionale, morale, edukative), për ruajtjen e origjinalitetit të traditave lokale, arkitekturës, mënyrës së jetesës, gatimit, ushqimit, sepse këto ofrojnë mundësi të shumta për zhvillimin e kapaciteteve të turizmit fshatar, eko-turizmit dhe

mundësi për përfitime ekonomike të krijuara nga vizitorët të cilët i kanë për destinacion këto vende.

Stimulimi i banorëve për shfrytëzimin e kullosave për kultivimin e blegtorisë, për mbledhjen e bimëve mjekuese aromatike dhe frutave të imta si prodhime me shenjë identifikuese të parkut, mundëson përfitim ekonomik të tyre nga plasimi i prodhimeve në tregun vendor dhe më gjërë.

**Konteksti i gjerë** – Ndikimi ekonomik i Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" në ekonominë e Kosovës mund të vlerësohet me të hyrat në BPV-në e Kosovës si dhe me gjenerimin e punësimit. Punësimi do të mund të kategorizohet si: i) punësim direkt në park; ii) indirekt në park dhe iii) indirekt jashtë parkut.

Parku ofron punësim direkt të vogël mirëpo ndikimi i tij në punësimin indirekt brenda dhe jashtë kufijve të tij është i madh. Shembuj specifik janë prodhimet vendore dhe mikpritja tradicionale e cila rritë ofertën turistike.

Vlerat e parqeve kombëtare duhet të mbrohen dhe të ruhen, kështu që aktivitetet e turizmit dhe aktivitetet tjera duhet të jenë të atilla që nuk i dëmtojnë këto vlera. Aktivitetet e varura nga kualiteti i mjedisit siç është turizmi dhe rekreacioni, janë shfrytëzues intensiv të mjedisit dhe si të tillë nuk bën ta dëmtojnë mjedisin prej të cilit varen.

Punësimi brenda dhe përreth parkut kombëtar, perspektivën e ka në turizëm dhe bujqësi.

Me rregullimin e parkut kombëtar do të duhej të tentohet të arrihet ajo që në mënyrë sa më të organizuar dhe të menaxhuar të ofrohet qarkullimi i sa më shumë vizitorëve, me qëndrim sa më të shkurtër, bazuar në qëllimet e planifikimit hapësinor të parkut, duke mundësuar vizita të shumta, gjithnjë në pajtim me rregullat e aplikueshme për zonat e ndryshme të mbrojtjes në kuadër të parkut dhe me synimin e përhershëm për ruajtjen e vlerave të parkut.

Parqet nacionale nuk duhet të jenë pjesë e industrisë turistike, por mund të jenë pjesë kualitative e ofertës turistike. Parqet nacionale dhe parqet natyrore janë hapësira të vlerave dhe potencialeve të larta brenda një shteti, prandaj nuk duhet trajtuar si pjesë të zhvillimit të nivelit lokal.<sup>17</sup>

Oferta turistike mund të rritet nëse zhvillimet janë të planifikuar duke e ditur se:

- Parqet kombëtare janë ikona të turizmit brenda dhe jashtë kufijve shtetëror,
- Parku krijon imazhin apo shenjën identifikuese kombëtare,
- Përfitimi ekonomik është më i madh jashtë parkut,
- Parku mbështetë jo vetëm ekonominë lokale por të Kosovës në tërësi.

Mundësitë që, ato që u thanë në pikat më lartë të jetësohen, do të rriteshin nëse parku kombëtar do të njihet nga organizma ndërkombëtarë për arsye të mbrojtjes së vlerave të parkut dhe njohja pastaj do të krijonte mundësi për mbështetje financiare nga po të njëjtit organizma financiarë.

Joshja e tregut më të gjerë me një frymë më konkurruese në turizmin botëror është një sfidë dhe kjo mund të arrihet përmes ofertës më të specializuar si: turizmi malor dimëror dhe veror, ekoturizmi, turizmi rural,

turizmi kulturor, turizmi shëndetësor, turizmi për mirëqenie, turizmi aventurier, etj.

#### Lista e çështjeve të identifikuar:

- Arritja e standardeve evropiane për turizëm në të ardhmen;
- Kapacitetet e pamjaftueshme në krahasim me kërkesat e turistëve/Ngritja e ofertës turistike;
- Kthimi i banorëve në traditat lokale;
- Konkurrimi i Kosovës me resurset e veta natyrore për ofertë turistike, në raport me rajonin;
- Bashkëpunimi në mes të Kosovës, Shqipërisë dhe Malit të Zi në funksion të ruajtjes dhe zhvillimeve të planifikuara në hapësirën gjeografike të Bjeshkëve të Nemuna;

→ Mbledhja e pakontrolluar e bimëve mjekuese dhe frutave të egra



<sup>17</sup> Johannesburg, 2002; <http://www.eoearth.org/sustainable/essd/final-report.pdf>



#### 1.7.4. Rigjallërimi i aktiviteteve tradicionale në vendbanimet e parkut dhe ruajtja e traditës si faktorë ndikues në ndaljen apo zvogëlimin e migrimit

Brenda pakut dhe rreth tij, ekzistojnë një numër i konsiderueshëm i vendbanimeve autoktone, të cilat me shtrirjen, funksionimin, organizimin e jetës në përgjithësi dhe peizazhin e bukur, japin shumë mundësi të favorshme për zhvillimin e turizmit në përgjithësi e në veçanti të turizmit rural. Këto vendbanime janë kryesisht të tipit të shpërndarë, në kodra të larta dhe të rrethuara me peizazhe natyrore. Në shumicën prej këtyre vendbanimeve, sidomos vendbanimet të cilat shtrihen në territorin e Pejës dhe atë të Deçanit, kanë një kulturë të veçantë veshje dhe manifestime, të cilat janë mjaftë joshëse për turistët vendor dhe të huaj. Ky rajon njihet edhe për veshje karakteristike, këngë dhe valle të veçanta për dallim nga pjesët tjera të Kosovës, të cilat me endje do të duhej ti ruajmë dhe kultivojmë. Këtë kulturë, brez pas brezi e kanë trashëguar gjenerata të tëra por, tendencat janë që këto tradita të zëvendësohen me zhvillime bashkëkohor duke bërë që, traditat apo kultura e lashtë e kësaj anë ti takoj së kaluarës. Kjo është një çështje mjaftë sfidues për të cilën do të duhej institucionet vendore dhe shoqëria në përgjithësi të mendonin mirë në ruajtjen dhe kultivimin e mirëfilltë të vlerave të kësaj ane.

Ruajtja dhe kultivimi i traditave të sipërpërmendura, kanë efekt pozitiv në zhvillimin e parkut dhe anasjelltas. Bashkimi i vlerave kulturore dhe atyre natyrore të cilat ka kjo anë, janë atraktive për turistët, andaj, do të duhej të bëhej gjithçka që është e mundur nga akterët e ndryshëm që asnjëra vlerë e lartpërmendur të mos e lërë vetëm tjetrën. Kombinimi i këtyre të dyjave, pa dyshim do të ketë ndikim reciprok pozitiv për parkun dhe përfitimet për komunitetin lokal dhe institucionet vendore do të shumëfishoheshin.

Karakteristikë tjetër e këtyre vendbanimeve është kultura e ndërtimit të shtëpive dhe organizimi i jetës familjare, të cilat në të shumtën e rasteve, i ngjajnë kulturës tradicionale të ndërtimit dhe hapësirës përcjellëse. Kjo e fundit si duket, nga dita në ditë po përjeton një transformim të madh drejt zëvendësimit të shtëpive apo kasolleve nga materiali natyror në material të fortë, me zëvendësimin e shtëpive të vjetra (tradicionale) me ndërtimin e shtëpive moderne, kështu duke bërë që të humb modeli i shtëpive tradicionale dhe organizimi i jetës familjare me tërë komponentët e saj.

Gjithashtu, kjo anë njihet edhe me zhvillimin e degëve ekonomike siç janë blegtoaria, bletaria, pemëtaria, mbledhja e frutave natyror etj. Të gjitha këto degë ekonomike dikur ishin mjaftë profitabile nga të cilat familje të shumta fshatare, arrinin të siguronin mirëqenien familjare. Këto veprimtari ekonomike në dekadën e fundit kanë shfaqur mos interesim të theksuar nga komuniteti lokal për arsye të ndryshme, duke bërë që shumë nga familjet fshatare, të hjekin dorë (interesim) për zhvillimin e këtyre veprimtarive dhe sigurimin e mirëqenies familjare nga veprimtaritë e lartcekura. Dikur (para '99 – ës), në këto vendbanime rurale dhe bjeshkët e lartë, me mundësi të mëdha për zhvillimin e degëve ekonomike veçanërisht të blegtorisë, shkëlqenin nga frekuentimi i madh i blegtorëve, me kope të shumta etj., e të cilat përveç anës së medaljes së përfitimit të ekonomive familjare nga zhvillimi i këtyre degëve, ishin edhe mjaftë atraktive për turistët e shumtë. Të kujtojmë ditët apo javët tradicionale, në pranverën e hershme kur blegtorët ngiteshin në bjeshkë për t'iu kthyer staneve, sa madhështore ishin dhe sa interesante manifestimi i tyre për



banorët lokal dhe për shumë turist, pastaj kthimi në vjeshtë nga stanet drejt vendbanimeve rurale për shkak të përkeqësimit të motit, të cilat po ashtu shoqërohen me këngë e me valle dhe me aktivitete të tjera përcjellëse. Të gjithë i gëzoheshin kësaj ngjarje për faktin se familje të tëra veçmas atyre rurale jetoni nga zhvillimi i degëve bujqësore të përmendura si më lartë.

Marrja me bujqësi e veçanërisht me blegtori dhe sigurimi i të ardhurave familjare nga këto të fundit, aktualisht është një sfidë e madhe sepse interesimi ka rënë në masë të madhe krahasuar me periudhat e mëhershme.

Këtë e dëshmon më së miri migrimi i popullsisë nga viset rurale drejt viseve urbane dhe lënia bosh e shumë shtëpive dhe vendbanimeve rurale të asaj ane. Sot, migrimet fshat qytet janë shëndrruar në përditshmëri ku akëcilit i jepet mundësia e bënë atë, kështu duke boshatisur vendbanimin rural ku kanë jetuar gjyshërit dhe stërgjyshërit e tyre. Thua se të gjitha strukturat e popullsisë në dekadën e fundit janë përfshirë në migrim, e më së shumti bëjnë pjesë gjeneratat e reja. Motivet e migrimeve të popullsisë fshat qytet janë të shumta dhe të ndryshme sa që vështirë të thuash se është ky apo ai motivi parësor mirëpo, kryesisht motivet në përgjithësi ndërlidhen me kërkimin e një jete më të mirë në njërin anë, dhe mos përkushtimi i institucioneve vendore për ti përkrahur në nivelin e dëshiruar qoftë përmes krijimit të infrastrukturës adekuate si dhe mungesa e subvencionimit në anën tjetër, ka bërë që të heqin dorë nga punësimi dhe marrja me degët ekonomike të sipërpërmendura dhe ardhja në shprehje e migrimeve fshat qytet, gjë që, është një sfidë shumë e madhe për institucionet për të rikthyer interesimin përsëri të komunitetit lokal për tu marr me veprimtari e lartcekura dhe sigurimin e punësimit dhe zbutjen e varfërisë përmes kësaj.

Mungesa e infrastrukturës arsimore dhe shëndetësore në vendbanimet e thella kodrinore – malore të kësaj ane, paraqet një rrezik permanent të shpërnguljes masive të popullsisë gjë që, në këtë drejtim do të duhej në të ardhmen të bëhen zgjidhje adekuate për parandalimin e migrimeve masive të popullatës dhe depopullimin e vendbanimeve.

Veprimtaritë ekonomike të lartcekura por edhe të tjera, jo vetëm që i jepnin mundësi punësimi dhe përmes kësaj edhe gjeneroni të ardhura dhe shumë familje gëzonin një jete të rehatshme, larg skamjes dhe varfërisë të ditëve të sotme por, edhe i bënin vendbanimet rurale mjaftë atraktive apo joshëse për shumë turist të huaj dhe vendor. Gjithashtu, këto vendbanime ja shtonin vlerën parkut kombëtar dhe anasjelltas përmes bujtinave e shujtave tradicionale, nga bereqeti vendor dhe i dorës së parë.

#### Çështjet që duhet adresuar janë:

1. Zhvillimi i infrastrukturës fizike;
2. Subvencionimi për bujqit në mënyrë që përmes kësaj të rritet interesimi i komunitetit për t'iu kthyer përsëri fushës tradicionale;
3. Organizimi i ngjarjeve kulturore nga komuniteti lokal dhe mbështetja institucionale, me qëllim të të bërit sa më të lehtë dhe atraktive jetën;
4. Sigurimi i tregut për plasimin e produkteve bujqësore;
5. Përkrahja e bujqut në raste të dëmtimit nga fatkeqësitë natyrore apo të tjera.

#### 1.7.5. Zhvillimi i planifikuar i infrastrukturës

Funksionimi i parkut në masë të madhe varet nga ekzistenca e infrastrukturës së duhur fizike në të. Për këtë arsye, në park duhet të sigurohet kjo infrastruktura sepse sigurimi (zhvillimi) i saj nënkupton mundësimin e lëvizjes së njerëzve dhe mallrave, furnizimin me energji elektrike, furnizimin me ujë dhe menaxhimin e ujërave të ndotura, komunikimin midis njerëzve, menaxhimin e mbeturinave etj.

Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" ka potencial të madh për zhvillimin e turizmit, por ai nuk mund të zhvillohet pa u zhvilluar paraprakisht infrastruktura e duhur fizike, e cila është bazë për çdo lloj zhvillimi ekonomik. Aktualisht infrastruktura fizike nuk është në nivelin që do ta mundësonte zhvillimin e dëshiruar të turizmit, por edhe plotësimin e nevojave të banorëve brenda parkut, prandaj shtrohet nevoja që të investohet në zhvillimin e saj. Këtë e mbështetë fakti se qasja në disa vendbanime brenda parkut është mjaftë e vështirë për shkak të rrugëve të këqija ku me vështirësi mund të qarkullojnë vetëm automjetet e terrenit. Poashtu është i nevojshëm rregullimi i shtigjeve për ecje. Infrastruktura që mbështetë zhvillimin e sportit të skijimit në park është në nivel jo të duhur të zhvillimit dhe nuk i kënaq kërkesat e adhuruesve të skijimit. Në asnjë vendbanim brenda parkut nuk është i instaluar sistemi publik i ujësjellësit e as ai i kanalizimit të ujërave të zeza. Brenda parkut nuk ka rrjet të telefonisë fikse e në disa vendbanime nuk ka as sinjal të telefonisë mobile GSM. Vetëm në dy vendbanime brenda parkut ka Internet, kurse asnjë vendbanim brenda parkut nuk mbulohet nga sinjali televiziv ajror e poashtu nuk ka as televizion kabllovik.

Meqenëse parku ka vlera të larta natyrore, ruajtja e këtyre vlerave del si nevojë dhe objektiv për të ardhmen. Në mënyrë që këto vlera të ruhen, çdo zhvillim këtu, pra edhe ai i infrastrukturës duhet të bëhet sipas planit, sepse zhvillimet e pabazuara në plan do t'i devalvonin vlerat natyrore.

Të gjitha mangësitë e lartpërmendura në infrastrukturë, natyrisht që duhet të eliminohen. Çka duhet të bëhet fillimisht? Cilat janë prioritetet investuese në infrastrukturën rrugore, infrastrukturën energjetike, infrastrukturën ujore, në telekomunikacion dhe si të sigurohen mjetet financiare? Si të arrihet zhvillimi i infrastrukturës sipas planit dhe eliminimi i mangësive? Të gjitha këto paraqesin një sfidë, aq më parë që në Kosovë, në periudhën pas vitit 1999 ka pasur shumë zhvillime hapësinore të pabazuara në plane, sepse autoritetet përgjegjës nuk kanë pasur mundësi por edhe vullnet që t'i ndalojnë e në anën tjetër dihet se infrastruktura zhvillohet me investime, kurse Kosova sipas standardeve evropiane ende është shtet i varfër me mundësi të kufizuara për investime.



## VIZIONI, PARIMET DHE CAQET

### 2. VIZIONI, PARIMET DHE CAQET

#### 2.1. VIZIONI

Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" vend me biodiversitet të pasur ku të gjitha habitatet dhe llojet janë të ruajtura;

Park me një shfrytëzim të qëndrueshëm të tokës, në funksion të ruajtjes dhe zhvillimit socio-ekonomik të tij, me theks të veçantë në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, i cili mbronë interesat dhe rritë mirëqenjen e banorëve brenda dhe përreth Parkut;

Park me numër të madhe të vizitorëve të cilët aty gjejnë mikpritjen, inspirimin dhe kënaqësinë duke i shfrytëzuar mundësitë që i ofron për pushim e rekreacion dhe binden për trajtimin shembullor të Pparkut;

Banorët brenda dhe rreth parkut ruajnë dhe avansojnë trashëgiminë dhe traditat kulturore.

#### 2.2. SYNIMET DHE OBJEKTIVAT

##### 2.2.1. Synimi – Administrimi, menaxhimi efikas dhe bashkëpunimi në shërbim të parkut

Në mënyrë që të mund ta kryejë funksionin e vet, Parku duhet të jetë nën mbikqyrjen dhe përgjegjësinë e një subjekti (organi) të caktuar, i cili do ta administrojë dhe menaxhojë atë park që në thelb do të thotë kujdes për ruajtjen dhe zhvillimin e tij. Rrjedhimisht një park që nuk do ta kishte këtë kujdes nuk do të mund t'i ruheshin vlerat e tij natyrore, kurse zhvillimet, qofshin ato ndërtime, qofshin vizita të turistëve do të ishin të paplanifikuara, stihike dhe të paorientuara dhe natyrisht kjo do të rezultonte me devaluimin dhe dëmtimin e hapësirës së parkut si dhe humbjen e atraktivitetit të tij për ta vizituar. Për këtë arsye, ky plan hapësinor, si synim të rëndësishëm e vë administrimin dhe menaxhimin efikas të parkut si dhe bashkëpunimin në shërbim të parkut.

Objektivat për arritjen e këtij synimi janë:

##### Objektivat:

1. Administrimi i mirë dhe transparent;
2. Menaxhimi efikas i zhvillimeve;
3. Bashkëpunimi vendor dhe ndërkombëtar

##### 2.2.2. Synimi – Mbrojtje, ruajtje dhe shfrytëzim racional i vlerave të trashëgimisë natyrore e kulturore në park dhe për rreth tij

Një zonë e caktuar nuk do të mund të shpallej park kombëtar, nëse mjedisit atje nuk do të ishte i pastër dhe nëse ajo nuk do ta kishte një trashëgimi të pasur natyrore. Trashëgimia e pasur kulturore do të ishte një arsye më shumë për shpalljen e parkut kombëtar. Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" i ka këto vlera, por kuptohet, në mënyrë që ai të vazhdojë të jetë park kombëtar dhe të funksionojë, është e nevojshme që këto vlera të ruhen. Funksionimi i parkut konsiston në krijimin e rrethanave që ai të vizitohet, të frekuentohet nga turistët e kjo në radhë të parë e nënkupton

ruajtjen e vlerave natyrore dhe kulturore të tij. Për këto arsye planifikimi hapësinor i parkut kombëtar e ka për synim mbrojtjen, ruajtjen dhe shfrytëzimin racional të vlerave të trashëgimisë natyrore e kulturore në park dhe për rreth tij. Trashëgimia natyrore dhe kulturore është faktor i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik dhe parakusht themelor për zhvillimin e turizmit. Përmes menaxhimit të matur të pasurive të parkut do të kontribuohet në ruajtjen dhe thellimin e identitetit dhe llojllojshmërisë natyrore e kulturore. Janë caktuar disa objektiva që duhet të arrihen dhe në këtë mënyrë të arrihet edhe ky synim, të cilët janë:

1. Vetëdijesimi dhe informimi për parkun kombëtar;
2. Inventarizimi i biodiversitetit;
3. Publikimi i llojeve specifike natyrore;
4. Mbrojtja dhe ruajtja e llojeve bimore në përgjithësi dhe e bimëve relikte, endemorelikte, endemike autoktone të parkut dhe endemike të Ballkanit në veçanti;
5. Ruajtja e faunës në përgjithësi dhe llojeve të gjitarëve dhe shpezëve endemike, relikte në veçanti;
6. Ruajtja e llojeve të shpezëve të cilat për shkak të rrezikut që iu kanoset gjenden në regjistrin e Librit të Kuq të Evropës;
7. Mbrojtja e të gjitha llojeve të vegjetacionit pyjor nga degradimi dhe prerja ilegale e tyre;
8. Mbrojtja e elementeve mjedisore (ajri, uji dhe toka) nga ndohta dhe degradimi;
9. Mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore dhe të shkaktuara nga faktori njeri;
10. Monitorimi vazhdueshëm i burimeve ujore, pellgjeve lumore, liqeneve, dukurive morfologjike dhe mbrojtja e tyre nga ndohta dhe degradimi;
11. Aplikimi i regjimit të shfrytëzimit të resurseve dhe vlerave të parkut;
12. Vetëdijesimi dhe informimi mbi rolin dhe rëndësinë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore;
13. Shfrytëzim racional i vlerave të trashëgimisë natyrore e kulturore të parkut;
14. Sigurimi i infrastrukturës së nevojshme për zonat dhe objektet e TK;
15. Rikonstruktimi i objekteve me vlerë të TK-së duke ruajtur autenticitetin e plotë të tyre;
16. Bashkëpunimi ndërinstitucional në mes të organizatave qeveritare dhe joqeveritare të nivelit qendror dhe lokal;
17. Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë së luajshme dhe shpirtërore

##### 2.2.3. Synimi – Zhvillimi i turizmit dhe ngritja ekonomike e parkut

Zhvillimi i turizmit dhe ngritja ekonomike e parkut është njëri prej synimeve më të rëndësishëm për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna". Hartimi i strategjisë për zhvillimin ekonomik, me theks të veçantë zhvillimin e turizmit në kuadër të parkut dhe rreth tij është sfidë e rëndësishme që të siguroj turizëm cilësor duke pasur parasysh që burimet natyrore janë të kufizuara. Për të, jo vetëm që duhet minimizuar efektet negative në mjedis, por përfitimet ekonomike prej turizmit duhet të kontribuojnë në mbrojtjen, përdorimin e qëndrueshëm e të planifikuar të burimeve natyrore.

Resurset natyrore të kësaj zone janë të lidhura së bashku edhe me trashëgiminë kulturore dhe historike të banorëve vendas, duke formuar kështu baza të rëndësishme për zhvillimin e turizmit.



Resurset natyrore si kullosat, shfrytëzohen për nevojat ekonomike të banorëve të parkut dhe për banorët e vendbanimeve rreth parkut. Ruajtja dhe fuqizimi i mënyrës tradicionale të kultivimit të bujqësisë, blegtorisë dhe organizimi i fermerëve në një shoqatë si dhe plasimi i produkteve në treg me llogo të përbashkët, që do të rrisë dukshëm mundësitë për përfitime ekonomike.

PK"BN" si dhe komplekset tjera natyrore të mbrojtura në botë, duhet të jenë së pari në shërbim të kënaqësive të vizitorëve, rekreacionit dhe mbi të gjitha ngritjes kulturore. Kjo hapësirë posedon vlera të veçanta natyrore, shkencore, arsimore, estetike, trashëgimi kulturor por edhe vlera turistike. Kjo është hapësira ku mund të bashkohen interesat shkencore, të turizmit dhe rekreacionit por njëkohësisht edhe të ruhet natyra si pasuri e qëndrueshme.

Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit në PK" Bjeshkët e Nemuna" do të arrihet duke i parashtruar kushtet për shfrytëzimin e qëndrueshëm duke planifikuar të gjitha zhvillimet në park. Zhvillimet e parapara në sektorin të turizmit dhe bujqësisë do të jenë gjenerues kryesor i të hyrave në park për banorët lokal dhe për vendin në përgjithësi ndërsa ngritja e nivelit të vetëdijës së komunitetit për vlerat e parkut e rritë dhe e kompletton ofertën turistike.

Sa i përket ofertës turistike për PK" Bjeshkët e Nemuna", parashihen llojet e ofertës, në bazë të të cilave do të përcaktohen kushtet për qëndrimin e vizitorëve, akomodimin dhe shërbimet. Prandaj, objektet: hoteliero-turistike, të shërbimeve, infrastrukturës e të tjerë, do të planifikohen si faktor nxitës të lëvizjeve turistike me ndikim minimal në mjedisin natyror si dhe të respektohet arkitektura autoktone e zonës.

E rëndësishme është që PK" Bjeshkët e Nemuna" si destinacion turistik të njihet dhe pranohet në rrjetin turistik ndërkombëtar, ku si rezultat i kësaj do të jetë rritja ekonomike për zonën për rreth parkut, po ashtu edhe për Kosovën.

Objektivat me arritjen e të cilëve do të mund të arrihej synimi për ngritjen ekonomike të parkut janë:

#### Objektivat:

1. Zhvillimi i bujqësisë tradicionale, blegtorisë dhe bletarisë me qëllim të përfitimit ekonomik dhe zhvillimit të ekoturizmit;
2. Shfrytëzimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore, BMA (bimët mjekuese dhe aromatike) dhe PFE (pemët frutore të egra) për përfitime ekonomike;
3. Planifikimi i zhvillimeve sipas regjimit të mbrojtjes për zonat brenda dhe rreth parkut;
4. Aftësimi i burimeve njerëzore për industrinë turistike dhe për mundësitë e përfitimit ekonomik për banorët lokal;
5. Arsimimi dhe trajnimi për zhvillimin e burimeve njerëzore në industrinë turistike;
6. Krijimi i imazhit të parkut dhe promovimi i turizmit;
7. Bashkëpunimi ndërkufitar, njohja ndërkombëtare e PK " Bjeshkët e Nemuna" dhe lidhja e produktit turistik me rrjetet turistike ndërkombëtare

#### 2.2.4. Synimi – Zhvillimi socio-demografik në vendbanimet brenda dhe për rreth parkut

Numri i popullsisë në vendbanimet brenda parkut kombëtar gjatë dyzet vjetëve të fundit ka vazhduar të bie. Derisa sipas regjistrimit të vitit 1971 në park jetonin 4743 banorë, sipas regjistrimit të vitit 2011, në park jetojnë 476 banorë që do të thotë rreth 10 herë më pak. Është stagnimi i zhvillimit socio-ekonomik që e ka shkaktuar në masën më të madhe këtë rënje drastike. Do të ishte fatkeqësi e madhe nëse me vazhdimin e kësaj rënje, këto vendbanime do të boshatiseshin plotësisht nga popullata. Kjo popullatë i ka traditat e veta dhe identitetin kulturor që i ka përcjellur brez pas brezi e të cilat mund t'i ruajë vetëm si e bashkuar duke qëndruar në këtë trevë, prandaj nëse kjo trevë do të boshatiset, identiteti i saj, identiteti i banorëve të saj do të vëhej në pikëpyetje. Me këtë do të humbiste edhe një pjesë shumë e rëndësishme e identitetit të parkut kombëtar. Në mënyrë që të mos lejohet të ndodhë kjo, është caktuar synimi i zhvillimit socio-demografik në vendbanimet brenda dhe për rreth parkut, i cili do të ndikojë në ndalimin e shpopullimit. Ky synim konsiston në zhvillimin e qëndrueshëm shoqëror dhe tenton t'i ruajë traditat dhe identitetin kulturor të trevës. Kultivimi i vlerave tradicionale dhe zhvillimi i veprimtarive tradicionale do të ketë impakt në rigjallërimin e kësaj ane. Realizimi i këtij synimi do të bëhet i mundshëm përmes zbatimit të objektivave si në vazhdim:

#### Objektivat:

1. Ngritja e cilësisë së edukimit – arsimimit;
2. Ngritja e cilësisë së shërbimit shëndetësor;
3. Rigjallërimi i vendbanimeve të shpopulluara

#### 2.2.5. Synimi – Sigurimi i qasjes dhe i shërbimeve publike në Park

Njëri nga synimet e identifikuar për parkun kombëtar është sigurimi i qasjes dhe i shërbimeve publike në park. Në mënyrë që të arrihet ky synim dhe kështu asnjë vendbanim të mos mbetet me mundësi të vështirë të qasjes e poashtu banorët t'i kenë të gjitha shërbimet e nevojshme publike, duhet të ndërtohet dhe përmirësohet infrastruktura përkatëse fizike. Ndërtimi i kësaj infrastrukture, rrjedhimisht arritja e synimit e mundëson funksionimin e duhur të parkut dhe kështu e formon bazën apo e plotëson parakushtin për zhvillimin ekonomik, në veçanti zhvillimin e turizmit, i cili natyrisht nuk do të mund të ishte një zhvillim i duhur, nëse vendbanimet dhe përmbajtjet e ndryshme të parkut nuk do të ishin të lidhura mirë me anë të rrugëve, nëse transporti publik nuk do të ishte i rregulluar apo nëse nuk do të kishte furnizim të rregullt me energji elektrike, me ujë dhe nëse mjetet e komunikimit masiv do të mungonin. Ky synim mund të arrihet duke i arritur objektivat si më poshtë:

#### Objektivat:

1. Sigurimi i infrastrukturës rrugore dhe transportit;
2. Sigurimi i infrastrukturës së energjisë elektrike;
3. Sigurimi i infrastrukturës ujore;
4. Sigurimi i infrastrukturës së telekomunikacionit;
5. Sigurimi i infrastrukturës për menaxhimin e mbeturinave

### 2.3. PRIORITETET STRATEGJIKE

1. Mbrojtja e elementeve mjedisore (ajri, uji dhe toka) nga ndohta dhe degradimi;
2. Mbrojtja e të gjitha llojeve të vegjetacionit pyjor nga degradimi dhe prerja ilegale e tyre;
3. Mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore dhe të shkaktuara nga faktori njeri;
4. Zhvillimi i bujqësisë tradicionale, blegtorisë dhe bletarisë me qëllim të përfitimit ekonomik dhe zhvillimit të ekoturizmit;
5. Krijimi i imazhit të parkut dhe promovimi i turizmit;
6. Ngritja e cilësisë së arsimimit;
7. Ngritja e cilësisë së shërbimit shëndetësor;
8. Sigurimi i infrastrukturës rrugore dhe transportit;
9. Sigurimi i infrastrukturës së energjisë elektrike;
10. Sigurimi i infrastrukturës ujore;



## KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR


### 3. KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR

Korniza e zhvillimit hapësinor shpreh parashikimin e dëshiruar hapësinor për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna". Ajo përmban konceptin e zhvillimit të ardhshëm hapësinor dhe strukturën hapësinore për zhvillimin dhe organizimin e ardhshëm.

#### 3.1. KONCEPTI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR

Bazuar në konceptin kryesor të zhvillimit hapësinor, të definuara në Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2020+, territori i Kosovës ndahet në zona sipas karakteristikave dhe potencialeve të ngjashme zhvillimore. Në këtë drejtim, Rajoni i Pejës, pjesë e të cilit është edhe Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", ndodhet në hapësirën me ngjyrë portokalli, në pjesën perëndimore të Kosovës. Kjo zonë për shkak të përmbajtjeve dhe vlerave dominuese dhe të dëshmuara natyrore, ka qenë arsyeja kryesore që të përkufizohet me epitetin "Kopshti i Kosovës". Ky përkufizim është themeli nga i cili është filluar ndërtimi i konceptit zhvillimor hapësinor për vet zonën e Parkut.

Kosova e ndarë në hapësira sipas karakteristikave dhe potencialeve të ngjashme zhvillimore



→ PHK – Koncepti i zhvillimit hapësinor



Vizioni për zhvillimin e ardhshëm hapësinor për këtë hapësinë, i dhënë në Planin Hapësinor të Kosovës është:

*Zonë e zhvilluar kulturore e turistike, agro-industriale dhe tregtare, zhvilluar në rrënjët dhe traditat e lashta, me qeverisje lokale të përgjegjshme dhe efikase, në bashkëpunim me qytetarët e saj dhe akterët për zbatim të qëllimeve zhvillimore, me shfrytëzim të resurseve natyrore dhe njerëzore, posaçërisht në fushën e turizmit, afarizmit e bujqësisë.*

Shpallja e Bjeshkëve të Nemuna park kombëtar dhe realizimi i zhvillimeve hapësinore që janë paraparë në Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2020 është një hap shumë i rëndësishëm për jetësimin e vizionit për "Kopshtet e Kosovës".

Sipas konceptit të zhvillimit hapësinor të Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" hapësira e Parkut ndahet në disa zona të bazuara në regjimin e mbrojtjes, shfrytëzimit dhe sipas strukturave hapësinore të Parkut.

### 3.1.1. Ndarja në zona sipas regjimit të mbrojtjes dhe shfrytëzimit

Kjo ndarje është bërë duke u respektuar Ligji për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" i cili kërkon që hapësira e parkut t'i ketë 4 zona të cilat dallojnë përnanga regjimi i mbrojtjes së tyre. Ato janë:

1. Zona e parë – mbrojtja strikte;
2. Zona e dytë – menaxhimi aktiv;
3. Zona e tretë – shfrytëzimi i qëndrueshëm;
4. Zona e ndikimit – jashtë parkut, 50 metra nga kufiri i parkut. dhe
5. Zonat e Vecanta të Mbrojtura.

Identifikimi dhe definimi i kufinjve të zonave I, II dhe III është bërë përmes ekspeditave në terren të grupit të ekspertëve duke u bazuar në vlerat natyrore me ç'rast janë përdorur kriteret si:

- Biodiversiteti i vlerave natyrore (florës, faunës, ekosistemeve, habitateve etj.);
- Karakteri endemo-relikt i vlerave natyrore;
- Rrezikshmëria e vlerave natyrore;
- Vlerat biogeografike, gjeologjike, geomorfologjike, hidrologjike dhe peisazhore;
- Kufiri natyror dhe fizik i zonave (luginat, kurrizet malore, prrockat dhe lumenjtë, kufiri i vegjetacionit pyjor, shkëmbinjtë, rrugët etj.)

#### Zona e parë

Si zonë e parë e mbrojtjes në territorin e PK "Bjeshkët e Nemuna" janë propozuar disa hapësira me gjithësejt 8.425 ha që përbëjnë 13.3% të sipërfaqes së parkut kombëtar. Zona e parë paraqitet me vlera të veçanta natyrore të cilat karakterizohen me biodiversitet të pasur të florës, faunës, habitateve dhe të ekosistemeve. Ajo në përbërjen e saj karakterizohet me ekosistemet me potenciale autentike të pandryshuara ose pak të ndryshuara si rezultat i praktikave tradicionale të menaxhimit. Kjo zonë poashtu karakterizohet me dendësi të lartë të llojeve tipike, të rralla dhe endemike të bimësisë, me dendësi të lartë të bimëve që janë vënë nën mbrojtje, me shkëmbinj të veçantë dhe është zonë me rëndësi të madhe

për linjat e migrimit të dhive të egra, arinjve dhe rrëqebujve. Këtu, jeta e lirshme e habitateve të botës bimore (flora me speciet pyjore, barishtore, etj) dhe shtazore (fauna me speciet e sisorëve, rrëshqitësve, shpezëve, etj), duhet të zhvillohet në kushte krejtësisht natyrore. Hapësirat e identifikuar në terren si zonë e parë do të shpallen rezervate të natyrës të cilat janë nën mbrojtje strikte. Rezervatet e natyrës mund të shfrytëzohen vetëm për nevojat shkencore dhe arsimore.

#### Zona e dytë

Si zonë e dytë në territorin e PK "Bjeshkët e Nemuna" është propozuar sipërfaqja prej 40.617 ha që përbën 64.5 % të sipërfaqes së parkut kombëtar. Pjesë e konsiderueshme e cila i takon zonës së dytë mbulohet me pyje dhe kullosa. Kullosat janë të përhapura mbi vegjetacionin barishtor ku mbizotëron klima e maleve të larta (alpine dhe subalpine).

Zona e dytë është me sipërfaqe më të madhe në krahasim me dy zonat e tjera dhe karakterizohet me ekosisteme pyjore dhe barishtore. Në këtë zonë janë të pranishme llojet e rralla e të rrezikuara si dhe endemike të florës, faunës, por në krahasim me zonën e parë, prania e tyre është më e kufizuar. Kjo zonë, përveq biodiversitetit të pasur natyror, posedon edhe vlera të rëndësishme biogeografike, gjeologjike, geomorfologjike, hidrologjike, pedologjike dhe peisazhore.

Zona e dytë është zonë me mbrojtje të orientuar, më pak rigoroze se sa në zonën e parë dhe ku njeriu mund të intervenojë, por në mënyrë të kontrolluar. Zona është e dedikuar për pushim aktiv dhe rekreacion të popullsisë. Aktivitetet e lejuara në këtë zonë janë:

1. Aktivitetet bujqësore siç është kultivimi i drithërave dhe kulturave të tjera bujqësore, por me norma të caktuara të përdorimit të pesticideve, herbicideve dhe plehrave azotike;
2. Prerja e pyjeve për qëllime sanitare, për plotësimin e nevojave të banorëve rezident për ngrohje dhe për evitim të shpërndarjes së zjarreve;
3. Ripyllëzimi në hapësira që shërbejnë si mbrojtës dhe rregullues të dëmtimeve mjedisore pa ndikim në pyjet ekzistuese;
4. Aktivitetet për një blegtori ekstenzive, mbajtja e lopëve, deleve dhe kuajve, kullotja e kontrolluar e tyre, mbajtja dhe kullotja e dhive në tufa jo të mëdha;
5. Bletaria;
6. Vjelja e frutave të imta dhe bimëve mjekuese në periudha të caktuara kohore gjatë vitit;
7. Kultivimi i frutave, por jo i frutave dhe bimëve komplementare që u bëjnë konkurrencë frutave ekzistues;
8. Ndërtimi i shtigjeve të skijimit në vendet ku nuk dëmtohen ose ku shumë pak dëmtohen pyjet, ndërtimi i shtigjeve për shetitje me punkte për çlodhjen e vizitorëve;
9. Instalimi i ski liftave, teleferikëve dhe shtyllave për shpërndarjen e energjisë elektrike;
10. Aktivitetet rekreative sportive si shetitja, ngasja e biçikletës, skijimi, etj;
11. Ndërtimi i rrugëve që lidhin territoret të cilët i përkasin zonës së tretë;
12. Nuk lejohet transportimi i derivateve dhe materieve të tjera të dëmshme;
13. Shfrytëzimi i resurseve ujore të rrjedhshme që ndodhen deri në lartësinë prej 2.000 metrash me qëllim të furnizimit të banorëve me ujë;

14. Shfrytëzimi i resurseve ujore me qëllim të furnizimit të banorëve me ujë përmes puseve duke e ndërtuar infrastrukturën e tyre përcjellëse;
15. Për nevoja të blegtorisë dhe rasteve emërgjente lejohet formimi i akumulacioneve ujore të përmasave të vogla;
16. Me leje të autoriteteve përgjegjëse mundësohet hulumtimi i resurseve minerare, ndërsa nuk lejohet operimi i minierave sipërfaqësore si guroret dhe i atyre nëntokësore, apo xeheroret;
17. Me leje të veçantë mund të ndërtohen spitale me karakter specifik sic janë spitalet për sëmundjet kardiovaskulare, të mushkërive etj., por nuk lejohen aktivitetet që shkojnë në kundërshtim me traditën dhe kulturën e banorëve të parkut.

Përveç ndërtimeve që u përmendën më lartë, ndërtime tjera nuk lejohen në këtë zonë. Aktivitetet që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e pasurive të natyrës në zonën e dytë, më hollësisht rregullohen me planin e menaxhimit të parkut kombëtar.

#### Zona e tretë

Zona e tretë në territorin e PK "Bjeshkët e Nemuna" përfshinë territorin prej 13.236 ha që përbën 21.5 % të sipërfaqes së parkut. Zona e tretë i përfshinë të gjitha sipërfaqet barishtore dhe gurore të cilat nuk kanë vlera të veçanta të biodiversitetit as vlera të veçanta kulturore-historike. Zona III-të, në krahasim me zonat I-rë dhe të II-të, ka kushte të volitshme gjeografike, relievo dhe klimatike për zhvillimin e turizmit. Zona e tretë ndahet në katër nënzona: zona III-të A apo zona e vendbanimeve, zona III-të B apo zona ku gjenden stanet, zona III-të C apo zona e zhvillimit dhe zona e III-të P apo zona e pyjeve private.

Në nënzonat III A dhe III C, përveç aktiviteteve që lejohen në zonën e dytë, lejohen edhe ndërtime në funksion të banimit, arsimit, shëndetësisë dhe zhvillimit ekonomik, me theks të veçantë në zhvillimin e turizmit.

Në nënzonën III B zona e staneve, me kushte të veçanta lejohet vetëm ndërtimi i staneve dhe objekteve përcjellëse për zhvillimin e blegtorisë, me theks të veçantë në zhvillimin e turizmit rural.

Në nënzonën e III-të P, e cila përfshinë pyjet në pronësi private zhvillimi apo ndërtimi mund të ndodhë nëse dëshmohet se në kuadër të zonës pyjore përkatëse ka hapësinë të mjaftueshme për ndërtimin apo zhvillimin e planifikuar.

Në përgjithësi, në zonën III-të nuk lejohet ndërtimi i kapaciteteve industriale të cilat e ndotin mjedisin, duke përfshirë impiantet hidroenergjetike dhe shfrytëzimin e paautorizuar të inerteve. Ndërtimet duhet të jenë të bazuara në këtë plan hapësinor e poashtu të jenë në harmoni të plotë me mjedisin natyror.

#### Zona e ndikimit (ZN)

Kjo zonë shtrihet jashtë territorit në largësi prej 50 metrave nga kufiri i parkut. Zona në fjalë do të shërbejë si pengesë fillestare në drejtim të mbrojtjes së vlerave natyrore në brendi të Parkut.

#### Zonat e Veçanta të Mbrojtura (ZVM)


Këto zona janë të definuara sipas Ligjit për ZVM-të (Ligji Nr. 03/L-039) dhe paraqesin vlerat e trashëgimisë kulturore me mbrojtje të veçantë, në të cilën zhvillimet realizohen sipas dispozitave të Ligjit në fjalë.



→ Lista e rezervateve strikte të natyrës (Zona e parë)

Nr	Emri	Komuna	Statusi i mbrojtjes	Sipërfaqja (Ha)
1	Zhlebi	Pejë	E propozuar	253.00
2	Rusolia	Pejë	E propozuar	771.00
3	Burimi i Drinit të Bardhë	Pejë	E propozuar	245.00
4	Gryka e Sushicës	Pejë	E propozuar	924.00
5	Gryka e Rugovës	Pejë	E propozuar	632.00
6	Guri i verdhë	Pejë	E propozuar	900.00
7	Gubavci	Pejë	E shpallur më 10.02.2016	77.00
8	Bjeshkët e Koprivnikut	Pejë/ Deçan	E propozuar	982.00
9	Bjeshka e Lumbardhit 2	Deçan	E propozuar	276.00
10	Bjeshka e Lumbardhit 1	Deçan	E propozuar	60.00
11	Mariashi	Deçan	E propozuar	696.00
12	Bjeshka e Preilepit	Deçan	E shpallur më 10.02.2016	106.00
13	Bjeshka e Strelcit	Deçan	E propozuar	898.00
14	Bjeshka e Kozhnjerit	Deçan	E shpallur më 10.02.2016	1.112.00
15	Bjeshka e Kurvallës	Deçan	E propozuar	988.00
16	Kërshi i Jodovës	Deçan	E propozuar	24.00
17	Rasa e zogut	Junik	E propozuar	173.00
<b>Totali</b>				<b>9.117.00</b>

→ Zonimi në Park



→ Maja e Ropsit



### 3.1.2. Ndarja në zona sipas strukturave hapësinore

Pjesë e konceptit të zhvillimit hapësinor është edhe ndarja e hapësirës së parkut në zona të cilat i kanë veçoritë dhe identitetin e tyre të veçantë si struktura hapësinore të caktuara që janë. Ato janë:

- Zonat me pyje;
- Zonat me kullosa;
- Fshatrat dhe zonat e zhvillimit;
- Zonat e lumenjve dhe liqeneve;
- Hyrjet në park;
- ZIV "Beteja e Koshares"

#### Zonat me pyje

Pyjet janë pasuri e vlefshme natyrore e parkut kombëtar dhe gjenden pothuajse tërësisht në zonat I, II dhe një pjesë tjetër edhe në zonën e III-të, prandaj planifikimi theksin kryesor e vë tek mbrojtja e tyre, por pa i përjashtuar zhvillimet e caktuara në to, të cilat kryesisht konsistojnë në aktivitetet e banorëve për shfrytëzimin e masës drusore në pyjet që janë në pronësi të tyre. Këto janë aktivitete në funksion të plotësimit të nevojave elementare të banorëve pronarë, por edhe në funksion të disa përfitimeve ekonomike të tyre. Aktivitetet duhet të jenë të bazuara në këtë plan hapësinor dhe në planin e menaxhimit të parkut.

#### Zonat me kullosa

Pjesa më e madhe e kullosave gjendet në zonën II sipas regjimit të mbrojtjes, por ka edhe në zonat I dhe III. Me përjashtim të atyre që gjenden në zonën I, në zonat me kullosa mund të ketë intervenime të caktuara varësisht nga ajo se a përputhen këto zona me zonën II apo zonën III dhe këto intervenime apo aktivitete janë në funksion të zhvillimit ekonomik që do të thotë të turizmit, bujqësisë, blegtorisë dhe bletarisë.

#### Fshatrat dhe zonat e zhvillimit

Fshatrat dhe zonat e zhvillimit jashtë fshatrave përputhen vetëm me zonën III sipas regjimit të mbrojtjes. Në zonën III sipas ligjit ka më së paku kufizime sa i përket intervenimit të njeriut dhe rrjedhimisht më së shumti zhvillim. Këtu mund të ketë ndërtime në funksion të zhvillimit të turizmit dhe zhvillimit të ekonomive familjare të cilat nuk e ndotin dhe degradojnë mjedisin. Disa zona të zhvillimit jashtë fshatrave kanë potencial të madh për zhvillimin e turizmit, sidomos atij që lidhet me sportet e dimrit, kurse fshatrat kanë potencial për zhvillimin sidomos të turizmit rural, pastaj zhvillimit të bujqësisë, blegtorisë dhe bletarisë. Në fshatra dhe në zonat e zhvillimit mund të ketë edhe zhvillim të industrisë së lehtë përpunuese të prodhimeve bujqësore, blegtoriale, të drurit etj. Natyrisht në parkun kombëtar nuk lejohet asnjë zhvillim që e ndotë apo e degradon atë.

### Zonat e lumenjve dhe liqeneve

Këtu bëhet fjalë për lumenjt dhe zonat përgjatë lumenjve Lumbardhi i Pejës, Lumbardhi i Deçanit, Ereniku por edhe përgjatë rrjedhave tjera të rëndësishme ujore brenda parkut e poashtu për liqenet e parkut dhe zonat rreth tyre. Lumbardhi i Pejës, para hyrjes në qytet kalon nëpër grykën e njohur, Grykën e Rugovës, e cila në vitin 1985 është shpallur monument i natyrës. Për shkak të këtij monumenti i cili mbrohet me ligj nga çdo cenim i vlerave natyrore që mund t'i vie nga dora e njeriut, por edhe për shkak se rrjedhat ujore dhe liqenet në park kanë një vlerë shumë të lartë natyrore dhe janë atraksion peizazhor dhe shumë të nevojshëm për njeriun, planifikimi hapësinor i këtyre zonave theksin kryesor e vë tek mbrojtja e tyre. Pra rrjedhat ujore dhe liqenet duhet të mbrohen nga çdo formë e ndotjes dhe nga ndërtime afër tyre. Natyrisht që ky planifikim nuk e përjashton zhvillimin e në kuadër të tij edhe ndërtimin afër lumenjve, por ndërtime mund të ketë vetëm aty ku këto zona përputhen me zonën III sipas regjimit të mbrojtjes dhe sipas Ligjit për Ujërat e Kosovës dhe udhëzimeve administrative përkatëse.

#### Hyrjet në Park


Ajo, të cilën në kuptimin e objekteve të ndërtuara dhe funksioneve e përmbajnë zonat e hyrjeve në park, e krijojnë një identitet të caktuar të këtyre zonave apo një strukturë të caktuar hapësinore. Funksionet e këtyre zonave apo hyrjeve janë mundësimi i hyrjes së vizitorëve në park me mjete motorike, informimi dhe udhëzimi i tyre, ofrimi i ndonjë shërbimi në funksion të rekreimit të vizitorëve, monitorimi i hyrje-daljeve dhe sigurimi i mjeteve financiare nga pagesat për hyrje të vizitorëve. Rrjedhimisht, planifikimi hapësinor i këtyre zonave është i orientuar në realizimin e këtyre funksioneve, i cili përveç tjerash, konsiston edhe në ndërtimin e objekteve të caktuara për këto funksione.

#### Zona e interesit të veçantë "Beteja e Koshares"

Zona e Koshares shtrihet në pjesën jugore të Parkut e cila në aspektin e mbrojtjes e tëra i takon zonës së dytë të mbrojtjes. Pjesa qendrore e saj, në të cilën janë paraparë zhvillimet kryesore i takon zonës së tretë të zhvillimit. Në fillim të vitit 2014, Kuvendi i Kosovës e ka aprovuar planin e zhvillimit hapësinor për zonën e Koshares, i cili fillon dhe mbaron në pikën qendrore (Zona 1), në varrezat e dëshmorëve që njëherit paraqet përmbajtjen më të rëndësishme të të gjithë zonës. Aty qëndron themeli i të gjitha zhvillimeve dhe aty gërshetohen rrugët që e lidhin vet zonën me përmbajtjet dhe zhvillimet hapësinore përreth saj.

Në aspektin hapësinor Zona e gjerë e Koshares ka një pozitë strategjike, e rrethuar me disa nga përmbajtjet që kanë një rëndësi të veçantë jo vetëm për rajonin ku ndodhen, por rëndësia e tyre i tejkalon edhe kufijtë më të gjerë. Ky është edhe argumenti kryesor që, plani i zhvillimit hapësinor për zonën e Koshares bazohet pikërisht në raportin në mes përmbajtjeve përkatëse dhe konsiston në shfrytëzimin maksimal të ndërveprimeve që mund të ndërtohen në mes këtyre përmbajtjeve dhe vet zonës së Koshares.

Prandaj, duke i pasur parasysh elementet e mësipërme, Zona e Koshares me të gjitha përmbajtjet që shtrihen përreth saj, duhet të shndërrohet në një atraksion turistik të qëndrueshëm, me ndikim në zhvillimin e të gjithë rajonit, duke i përfshirë edhe përmbajtjet që janë në anën tjetër të kufirit. Ajo që është me rëndësi të theksohet është se, një zhvillim i tillë do të ndikojë në ruajtjen dhe promovimin e vlerave natyrore dhe historike që ka kjo zonë për shqiptarët në përgjithësi.



→ Beteja e Koshares – Strategjia e zhvillimit hapësinor<sup>18</sup>


<sup>18</sup> Harta e dokumentit të aprovuar në Kuvendin e Kosovës "Plani Hapësinor për ZIV Beteja e Koshares"






### 3.2. SKENARËT E ZHVILLIMIT

Në proces të zhvillimit të konceptit janë trajtuar tre skenarë të zhvillimit. Njëri skenar është orjentuar në zhvillimin e Parkut, sipas të cilit është propozuar rritja maksimale e zonës së tretë. Një zgjidhje e tillë është vlerësuar me ndikim shumë negativ në mjedis, me rrezik të madh në humbjen e karakteristikave themelore të Parkut e në këtë drejtim edhe të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit.



Vlerësimi i skenarit të zhvillimit maksimal		
Synimi	Ndikimi në arritjen e synimit	Përshkrimi i ndikimit
Administrimi, menaxhimi efikas i parkut dhe bashkëpunimi në shërbim të parkut	Pozitiv	
	Negativ	
	Neutral	Nuk duket që ky skenar të ketë ndonjë ndikim pozitiv apo negativ në arritjen e këtij synimi. Arritja e tij kryesisht varet nga përgatitja, profesionalizmi dhe përkushtimi i stafit menaxherial e poashtu nga gatishmëria për bashkëpunim.
Mbrojtje, ruajtje dhe shfrytëzim racional i vlerave të trashëgimisë natyrore e kulturore në park dhe për rreth tij	Pozitiv	
	Negativ	Ky skenar konsiston në shtrirjen maksimale të zonës së tretë të parkut duke përfshirë kështu edhe pjesët ku janë përqëndruar vlerat e trashëgimisë natyrore, të cilat duhet t'u takojnë zonës së dytë dhe të parë. Meqenëse në zonën e tretë regjimi i mbrojtjes është më pak rigoroz se në tjerat, vlerat natyrore që do të hynin në këtë zonë do të ishin dukshëm më pak të mbrojtura.
	Neutral	
Zhvillimi i turizmit dhe ngritja ekonomike e parkut	Pozitiv	Zgjerimi i zonës së tretë ka ndikim pozitiv në arritjen e këtij synimi sepse do të thotë më shumë hapësirë për ndërtime në funksion të ngritjes ekonomike të parkut.
	Negativ	Hapësira më e madhe për ndërtime mund të ketë edhe ndikim negativ në këtë synim. Sa më shumë vlera të natyrës që humbin për shkak të shndërrimeve të tokës në tokë ndërtimore aq më pak atraktiv bëhet parku edhe për turistë.
	Neutral	
Zhvillimi socio-demografik në vendbanimet brenda dhe për rreth parkut	Pozitiv	Ky skenar siguron hapësira për ndërtime ku do të ketë edhe aso që janë në funksion të zhvillimit socio-demografik e kjo do të thotë se ndikon pozitivisht në arritjen e këtij synimi.
	Negativ	
	Neutral	
Sigurimi i qasjes dhe i shërbimeve publike në park	Pozitiv	Sigurimi i hapësirës për ndërtime, pra siguron edhe hapësirën për ndërtimin e infrastrukturës që mundëson arritjen e synimit.
	Negativ	
	Neutral	

Skenari tjetër i trajtuar është skenari i mbrojtjes maksimale, sipas të cilit është rritë në maksimum zona e mbrojtjes strikte. Për dallim nga skenari i zhvillimit, skenari i mbrojtjes maksimale është vlerësuar i paqëndrueshëm për faktin e kufizimeve të mëdha të zhvillimit, pa të cilin është e pamundur mbrojtja e qëndrueshme e mjedisit. Me një skenar të tillë është e pamundur të zhvillohet turizmi dhe degët e saj, si një fushë e fuqishme e zhvillimit jo vetëm për zonën në fjalë.





Vlerësimi i skenarit të mbrojtjes maksimale		
Synimi	Ndikimi në arritjen e synimit	Përshkrimi i ndikimit
Administrim, menaxhimi efikas i parkut dhe bashkëpunimi në shërbim të parkut	Pozitiv	
	Negativ	
	Neutral	Nuk duket që ky skenar të ketë ndonjë ndikim pozitiv apo negativ në arritjen e këtij synimi. Arritja e tij kryesisht varet nga përgatitja, profesionalizmi dhe përkushtimi i stafit menaxherial e poashtu nga gatishmëria për bashkëpunim.
Mbrojtje, ruajtje dhe shfrytëzim racional i vlerave të trashëgimisë natyrore e kulturore në park dhe për rreth tij	Pozitiv	Ky skenar konsiston në rritjen sa më të madhe të zonës së parë të parkut ku aplikohet regjimi i mbrojtjes strikte të vlerave të parkut, prandaj ndikimi i tij sa i përket ruajtjes është mjaft pozitiv.
	Negativ	Skenari ka edhe ndikim negativ në këtë synim, sepse aty ku nuk lejohen aktivitetet njerëzore, vlerat e trashëgimisë natyrore e kulturore mbeten të pashfrytëzuara, të pashijuar.
	Neutral	
Ngritja ekonomike e parkut dhe zhvillimi i turizmit	Pozitiv	
	Negativ	Zgjerimi i madh i zonës strikte do t'i zvogëlonte shumë hapësirat në park ku do të mund të investohej në ndërtimin e kapaciteteve turistike e rrjedhimisht zhvillimin e turizmit e poashtu ku do të mund të zhvilloheshin edhe aktivitetet tjera ekonomike.
	Neutral	
Zhvillimi socio-demografik në vendbanimet brenda dhe për rreth parkut	Pozitiv	
	Negativ	Kufizimi i aktiviteteve ekonomike, sidomos i turizmit do të ndikonte negativisht në zhvillimin socio-demografik, i cili varet nga ngritja ekonomike e parkut.
	Neutral	
Sigurimi i qasjes dhe i shërbimeve publike në park	Pozitiv	
	Negativ	Ky skenar e pamundëson qasjen me automjete në disa vende-stane të cilët sipas këtij skenari i mbulon zona e parë ku nuk mund të ketë ndërtim të rrugëve.
	Neutral	

Vlerësimi i skenarit të kompromisit		
Synimi	Ndikimi në arritjen e synimit	Përshkrimi i ndikimit
Administrimi, menaxhimi efikas i parkut dhe bashkëpunimi në shërbim të parkut	Pozitiv	
	Negativ	
	Neutral	Nuk duket që ky skenar të ketë ndonjë ndikim pozitiv apo negativ në arritjen e këtij synimi. Arritja e tij kryesisht varet nga përgatitja, profesionalizmi dhe përkushtimi i stafit menaxherial e poashtu nga gatishmëria për bashkëpunim.
Mbrojtje, ruajtje dhe shfrytëzim racional i vlerave të trashëgimisë natyrore e kulturore në park dhe për rreth tij	Pozitiv	Sipas këtij skenari, zonimi i parkut është bërë në mënyrë të balancuar, pra nuk ka zgjerim të ndonjë zone në dëm të tjetrës. Me këtë rast i është kushtuar rëndësia e duhur si mbrojtjes së vlerave natyrore e kulturore të parkut, ashtu edhe zhvillimit ekonomik të tij.
	Negativ	
	Neutral	
Ngritja ekonomike e parkut dhe zhvillimi i turizmit	Pozitiv	Ky skenar parasheh hapësirë të mjaftueshme për zonën e tretë të parkut ku do të përqendrohen aktivitetet për ngritjen ekonomike të parkut.
	Negativ	
	Neutral	
Zhvillimi socio-demografik në vendbanimet brenda dhe për rreth parkut	Pozitiv	Ky skenar siguron edhe hapësira ku do të ketë edhe ndërtime që janë në funksion të zhvillimit socio-demografik e kjo do të thotë se ndikon pozitivisht në arritjen e këtij synimi.
	Negativ	
	Neutral	
Sigurimi i qasjes dhe i shërbimeve publike në park	Pozitiv	Sigurimi i hapësirës së mjaftueshme për zonat II dhe III të parkut, siguron edhe hapësirën për ndërtimin e infrastrukturës që mundëson arritjen e synimit.
	Negativ	
	Neutral	

Dhe në fund, është trajtuar skenari i tretë ose skenari i "kompromisit", i cili paraqet përmbledhjen e ideve dhe propozimeve nga dy skenarët tjerë. Skenari i kompromisit është vlerësuar si më i përshtatshmi dhe në harmoni me kërkesat e përgjithshme që do të kenë ndikim maksimal në zhvillimin e qëndrueshëm të Parkut. Sipas këtij skenari, në përgjithësi, koncepti i zhvillimit hapësinor i Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" konsiston në mbrojtjen maksimale të vlerave natyrore ekzistuese dhe zhvillimin e kontrolluar. I gjithë territori i Parkut duke iu referuar rregullave në fuqi, është ndarë në disa zona, të cilat për kriter kryesor e kanë nivelin dhe mënyrën e mbrojtjes dhe shfrytëzimit. Bazuar në këto rregulla, territori i Parkut do të përbëhet nga zona të nivelit strik të mbrojtjes (Zona e I-rë), të cilat dallohen për nga përmbajtja e vlerave natyrore, shkalla e mbrojtjes maksimale dhe niveli minimal i shfrytëzimit. Siparfaqja më e madhe e Parkut do të mbulohet nga Zona e II-të ose zona më e lirë e shfrytëzimit, e cila kryesisht përbëhet nga kullosat dhe disa pyjeve të ulëta. Shkalla më liberale e shfrytëzimit në këto zona mundeson realizimin e disa aktiviteteve që duhet të jenë në harmoni me rregullat dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit. Në kuadër të këtij zonimi hynë Zona e III-të ose zona e zhvillimit, e cila për nga sipërfaqja është zona më e vogël, ndërsa për nga hapësira zonë e shtrirë në të gjitha komunat pjesëmarrëse në Park. Në aspektin e mbrojtjes zona në fjalë ka më pak kufizime dhe më shumë mundësi për zhvillim, i cili duhet të jetë i kontrolluar dhe në përputhje me mjedisin. Zona e fundit është zona e ndikimit, në të cilën përfshihen të gjitha vendbanimet që shtrihen në afërsi të Parkut. Ndikimi i kësaj zone do të jetë i madh për faktin se do të jetë bariera e parë në parandalimin e keqpërdorimeve të mundshme në Park. Në aspektin zhvillimor zona e ndikimit ka potencial të madh. Nga ndihma financiare që planifikohet të ofrohet përmes donatorëve dhe programeve qeveritare, do të krijohen kushte për ngritjen e ofertës për turizëm ekologjik rural, si njëra nga degët më në trend të zhvillimit të turizmit. Kjo zonë do të jetë ndërlidhja e Parkut dhe vlerave të tij natyrore me trashëgimin kulturore të bollshme të rajonit në përgjithësi. Fuqizimi i kësaj lidhjeje do të bëhet përmes zhvillimit të agjendave, itinerareve dhe paketave të ndryshme turistike, të cilat do të realizohen në bashkëpunim me të gjithë pjesëmarrësit.


Komunikimi si veprimtari e rëndësishme në Park do të zhvillohet përmes rrugëve automobilistike, në të cilat në maksimum do të ulet shfrytëzimi i tyre nga automjetet e rënda. Në masë të madhe përparësi do ti ipet shtigjeve që do të përdoren nga këmbësorë, biciklistë dhe mjete të lehta motoristike dhe si të tilla do të jenë lidhja më e natyrshme e përmbajtjeve kryesore në Park.

Qëllimi kryesor i konceptit është që, respektimi i normave dhe rregullave mjedisore të jetë kushti themelor që kjo zonë të shndërrohet në atraksion turistik përtej kërkesave vendore. Zhvillimi i pa kontrolluar duke përfshirë prerjen e pa kontrolluar të pyjeve dhe ndërtimet e pa planifikuara, duhet të zëvendësohet me një qasje më mike ndaj mjedisit. Turizmi si veprimtari më e levërdishme ekonomike do të jetë baza themelore për zhvillim, në kuadër të të cilit duhet të ketë vend për të gjithë, duke e përfshirë komunitetin lokal, sektorin e biznesit dhe vendimarrjen lokale dhe qendrore.



→ Koncepti i zhvillimit hapësinor  
 – bazuar në skenarin e “kompromisit”

Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”  
 Koncepti i zhvillimit hapësinor





## IV

## STRATEGJIA DHE VEPRIMET PËR ZBATIM

### 4. STRATEGJIA DHE VEPRIMET PËR ZBATIM

Strategjia është një pako e masave, aktiviteteve, veprimeve apo projekteve konkrete me realizimin e të cilave tentohet të arrihen synimet dhe objektivat që janë përcaktuar për parkun kombëtar. Për secilin objektiv veç e veç janë të caktuar projektet apo veprimet konkrete të nevojshme për arritjen e këtyre objektivave. Synimet dhe objektivat që dëshirohet të arrihen në park kanë të bëjnë me çështje dhe fusha të ndryshme si: administrimi dhe menaxhimi i parkut, mjedisi, trashëgimia kulturore, popullësia, zhvillimi social, zhvillimi ekonomik dhe infrastruktura fizike.

#### 4.1. SYNIMI 1 – ADMINISTRIMI, MENAXHIMI EFIKAS I PARKUT DHE BASHKËPUNIMI NË SHËRBIM TË PARKUT

Objektivat me arritjen e të cilëve do të mund të arrihej ky synim janë:

- 4.1.1. Objektivi – Administrimi i mirë dhe transparent** – Është e kuptueshme që një administrim i mirë dhe transparent i parkut e mundëson një funksionim të mirë të tij, prandaj edhe është caktuar si objektivi i rëndësishëm për t'u arritur në të ardhmen. Ky administrim nënkupton që vendimet dhe aktivitetet që i ndërmerr organi administrues të jenë të drejta, të duhura dhe transparente. Veprimet apo aktivitetet e nevojshme që ky objektivi të arrihet janë:
- Hartimi rregullores për administrim dhe menaxhim të parkut;
  - Kompletimi i stafit dhe pajisjeve të nevojshme për administrim dhe menaxhim të parkut;
- 4.1.2. Objektivi – Menaxhimi efikas i zhvillimeve** – Ky objektivi nënkupton që të gjitha zhvillimet që ndodhin në park të jenë nën kontroll dhe të planifikuar. Zhvillimet e planifikuara do të thonë njëherit edhe ruajtje e parkut, gjë që nuk do të mund të ndodhte me zhvillime stihike. Barra kryesore për këtë i bie subjektit i cili e administron parkun kombëtar e kuptohet edhe njësisë tjera përgjegjëse të ministrisë kompetente. Janë disa veprime konkrete që e mundësojnë arritjen e këtij objektivi si:
- Hartimi i planit për menaxhimin e parkut;
  - Kontrolli (inspektimi) i zhvillimeve i bazuar në legjislacionin dhe planet në fuqi dhe masa ndëshkuese për tejkalimet në shfrytëzim dhe për aktivitetet ilegale
- 4.1.3. Objektivi – Bashkëpunimi vendor dhe ndërkombëtar, si dhe lidhja e produktit turistik me rrjetet turistike ndërkombëtare** – Bashkëpunimi në mes të institucioneve apo subjekteve qeveritare dhe joqeveritare vendor, si dhe bashkëpunimi ndërkombëtar rreth parkut, me ç'rast do të shkëmbeheshin përvojat dhe do të ndërmerreshin aktivitete të përbashkëta, është në favor të promovimit, ruajtjes dhe zhvillimit të parkut kombëtar. Bashkëpunimi ndërkombëtar në përgjithësi dhe ai ndërkufitar në veçanti krijon mundësi për qasje në fonde të ndryshme ndërkombëtare, për projekte të përbashkëta me mundësi të përmirësimit dhe avansimit të infrastrukturës së nevojshme për zhvillimin e zonave ndërkufitare. E gjithë kjo ka ndikim në rritjen ekonomike. Me këtë objektivi, poashtu tentohet të arrihet njohja ndërkombëtare e parkut. Njohja ndërkombëtare mundëson, informimin e çdo vendi në botë për resurset, veçoritë natyrore dhe gjeofizike të PK "Bjeshkët e Nemuna". Ajo ndikon pozitivisht në ratifikimin e konventave mjedisore, në mbrojtjen e vazhdueshme të vlerave specifike natyrore, në propagandimin e këtyre vlerave dhe

interesimin për të vizituar parkun. Disa nga veprimet me të cilët mund të arrihet ky objektivi janë:

- Organizimi i konferencave për arritjen e partneritetit në mes të ekspertëve vendor dhe ndërkombëtar;
- Organizimi i vizitave studimore dhe trajnimeve brenda dhe jashtë vendit me qëllim të shkëmbimit të përvojave;
- Organizimi i kampanjave për vetëdijësimin dhe informimin e komunitetit mbi rolin dhe rëndësinë e vlerave të parkut kombëtar;
- Plotësimi i kushteve për njohjen ndërkombëtare të Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" dhe më pas njohja e tij;
- Në bashkëpunim me Shqipërinë dhe Malin e Zi, të inicohet hapja dhe rregullimi i vendkalimeve kufitare;
- Inicimi i hartimit për projekte të përbashkëta për:
  - Ngritjen e qendrave turistike në zonat ndërkufitare me Shqipërinë dhe Malin e Zi;
  - Trajtimin e mbeturinave;
  - Trashëgiminë kulturore, etj

#### 4.2. SYNIMI 2 – MBROJTJE, RUAJTJE DHE SHFRYTËZIM RACIONAL I VLERAVE TË TRASHËGIMISË NATYRORE E KULTURORE NË PARK DHE PËR RRETH TIJ

Janë caktuar disa objektiva me të cilat arrihet ky synim:

- 4.2.1. Objektivi – Vetëdijësimi dhe informimi për Parkun** – Synimi është që vlerat e parkut kombëtar të ruhen dhe të shfrytëzohen në mënyrë të qëndrueshme. Një hap i mirë në këtë drejtim do të ishte arritja e objektivit për vetëdijësim dhe informim. Është me rëndësi që tek popullata në përgjithësi të ekzistojë një vetëdije për rëndësinë që e ka parku kombëtar, për nevojën që ai të ruhet dhe të zhvillohet. Pa këtë vetëdije, vështirë se do të kishte përpjekje të vendosura që synimi të arrihet. Një vetëdije e tillë do të mund të krijohej apo forcohej pas një informimi të mirë për vlerat që i ka parku. Veprimet e nevojshme për arritjen e këtij objektivi janë:
- Hartimi i programit vjetor për komunikim me publikun/marketing/, promovimin e vlerave të parkut;
  - Puna me autoritetet e arsimit për të rritur ndërgjegjësimin rreth zonave të mbrojtura përmes programeve shkollore dhe aktiviteteve në park;
  - Përgatitja e librit dhe broshurave me informatat për parkun kombëtar;
- 4.2.2. Objektivi – Inventarizimi i biodiversitetit** – Si një hap i domosdoshëm në mbrojtjen e biodiversitetit është inventarizimi i tij. Ky është një objektivi tjetër për parkun që konsiston në njohjen, renditjen, katalogimin dhe vënjen në hartë gjatë një periudhe të caktuar të njësive si: gjini, individë, popullata, lloje, habitate, peisazhe dhe ekosisteme. Objektivi mund të arrihet me:
- Krijimin e bazës së të dhënave hapësinore për parkun kombëtar e cila do të shërbejë si një vegël administrative për menaxhim dhe hulumtim e ku përfshihen informacionet për zhvillimin fizik, transportin, biodiversitetin, shfrytëzimin e tokës, zonimin në park etj.
- 4.2.3. Objektivi – Publikimi i llojeve specifike natyrore** – Llojet specifike duhet të jenë në qendër të vëmendjes, duke marrë parasysh



rëndësinë që e kanë në pikëpamje ekologjike dhe shkencore. Llojet e tilla duhet të cilësohen si lloje prioritare që duhet të monitorohen. Në mënyrë që llojet specifike natyrore të publikohen duhet:

a. Plani i menaxhimit të parkut t'i përmbajë dispozitat për raportimin vjetor sa i përket statusit të llojeve të veçanta natyrore dhe çfarëdo ndryshimeve të rëndësishme gjatë vitit

Aktiviteti mundëson regjistrimin e pranisë së llojeve specifike brenda parkut me qëllim të monitorimit, për të siguruar mbrojtjen adekuate të tyre.

#### 4.2.4. Objektivi – Mbrojtja dhe ruajtja e llojeve bimore në përgjithësi dhe e bimëve relikte, endemorelikte, endemike autoktone të parkut dhe endemike të Ballkanit në veçanti

– Parku kombëtar vlerësohet në bazë të pasurisë së tij me lloje bimore, sidomos me bimë relikte, endemorelikte dhe endemike autoktone. Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" e ka një pasuri të tillë dhe objektivi është që ajo të mbrohet dhe të ruhet sepse kështu ruhen vlerat e parkut e me këtë edhe rëndësia dhe atraktiviteti i parkut. Është e nevojshme të kryhen disa veprime në mënyrë që ky objektivi të arrihet e ato janë:

- Identifikimi brenda bazës së të dhënave hapësinore të PK i llojeve të rëndësishme të bimëve që duhet të përfshihen në listën e Mbrojtjes Ndërkombëtare të Bimësisë. Identifikimi dhe vlerësimi i tyre ju mundëson menagjereve të parkut t'i përcaktojnë vendet për konservim.
- Hartimi i pjesës së dytë të Librit të Kuq të Florës Vaskulare të Kosovës. Ky veprim mundëson identifikimin e habitateve brenda parkut dhe llojeve të bimëve vaskulare të cilat janë të rrezikuara dhe kërkojnë menagjim të shpejtë dhe efikas.

#### 4.2.5. Objektivi – Ruajtja e faunës në përgjithësi dhe llojeve të gjitarëve dhe shpezëve endemike, relikte në veçanti

– Parku kombëtar, poashtu vlerësohet në bazë të pasurisë me lloje të faunës, pra me lloje të gjitarëve dhe shpezëve endemike dhe relikte. Një pasuri të tillë Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" e posedon dhe natyrisht objektivi është që ajo të ruhet në mënyrë që kështu të ruhen vlerat e parkut e me këtë edhe rëndësia dhe atraktiviteti i parkut. Në mënyrë që ky objektivi të arrihet, duhet të kryhen disa veprime:

- Krijimi i inventarit të gjithave si pjesë e bazës së të dhënave hapësinore, duke përfshirë habitatet dhe rruget e migrimit;
- Krijimi i rrjetit të monitorimit për karnivoret, veçanërisht për llojet që janë të kërcenuar me zhdukje;

#### 4.2.6. Objektivi – Ruajtja e llojeve të shpezëve që janë në Librin e Kuq të Evropës

– Ky objektivi pra fokusohet në ruajtjen e llojeve të shpezëve që gjenden në regjistrin e Librit të Kuq të Evropës. Veprimet apo aktivitetet që duhet të ndërmerren për arritjen e këtij objektivi janë:

- Hartimi i Librit të Kuq të Kosovës për ornitofaunën - ky aktivitet mundëson identifikimin e habitateve dhe llojeve të ornitofaunës që janë në rrezik të zhdukjes dhe të cilat kërkojnë menagjim të shpejtë dhe efikas.
- Vendosja e rrjetit afatgjatë për monitorimin e shpendeve – me vendosjen e rrjetit krijohet një platformë për monitorim siq është monitorimi dinamik sezonal dhe monitorimi i ritmit biologjik.

**4.2.7. Objektivi – Mbrojtja e të gjitha llojeve të vegjetacionit pyjor nga degradimi dhe prerja ilegale e tyre** – Fatkeqësisht sot në park ka prerje ilegale të pyjeve. Përkundër kësaj, parku ende është i pasur me pyje, por nëse kjo dukuri do të vazhdonte edhe në të ardhmen, parku do të rrezikohej seriozisht. Që kjo të mos ndodhë, është caktuar ky objektivi për mbrojtjen e të gjitha llojeve të vegjetacionit pyjor. Ky objektivi do të mund të arrihet përmes veprimeve:

- Prerja e kontrolluar fito-sanitare e pyjeve – Prerja e kontrolluar e pyjeve, si diçka e domosdoshme, duhet të bëhet në zonën e dytë dhe atë tretë të parkut në mënyrë që ta kemi një zhvillimin normal të tyre.
- Identifikimi i lokacioneve në zonën e dytë për qëllim të ripyllezimit dhe ndertimit të ujembledhësve për mbrojtjen e pyllit;
- Integrimi i një kadastrit modern të pyjeve brenda bazës së të dhënave hapësinore të PK, i cili do të dokumentojë dhe azhurnojë pasurinë pyjore, jo vetëm si sipërfaqe dhe vëllim, por edhe si vlerë dhe pronesi në të gjitha nivelet e administrimit

#### 4.2.8. Objektivi – Mbrojtja e elementeve mjedisore (ajri, uji dhe toka) nga ndohta dhe degradimi

– Nuk kemi rezultate të cilësisë së ajrit të monitoruar në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", mirëpo si zonë larg ndikimeve urbane, industriale dhe të transportit, konsiderohet si zonë me ajër të pastër. Monitorimi aktual i cilësisë së ujërave sipërfaqësore është i pamjaftueshëm për të paraqitur një vlerësim të plotë të situatës. Sa i përket tokës, është prezente dukuria e degradimit të saj përmes prerjes ilegale të pyjeve që shkakton rritjen e shkallës së erozionit apo rrëshqitjen e dheut. Në mënyrë që të arrihet objektivi për mbrojtjen e ajrit, ujit dhe tokës, është e nevojshme:

- Integrimi i të dhënave për burimet e ndotjes në bazën e të dhënave hapësinore për parkun kombëtar
- Ndërtimi i stacionit hidrometeorologjik në lumin Erenik dhe atij afër gurrës së Radavcit dhe në Boge. – Të dy këto stacione ndërtohen pas përcaktimit paraprak të pikave nga ekspertët e hidrologjisë.
- Monitorimi vazhdueshëm i burimeve ujore, pellgjeve lumore, liqeneve, zonave pyjore, kullosave, pasazheve dhe dukurive morfologjike (shpellave, cirqeve, gurrave, kanjoneve etj);
- Monitorimi i vazhdueshëm në lokacionet ku shfrytëzohet uji për pije dhe për hidro-energji;
- Raportimi i vazhdueshëm nga personat përgjegjës për monitorim nga Drejtoria e Parkut tek Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës;
- Vendosja e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza;
- Rikuperimi në sipërfaqet tokësore të dëmtuara nga ndërtimi i infrastrukturës;
- Menaxhimi i mbeturinave;
- Ndërmarrja e masave antierozive si:
  - Ndërtimi i tarracave, gardianeve, dhe pendëve;
  - Mbrojtja e pyjeve ekzistuese nga prerjet e pakontrolluara dhe zjarri;

- Krijimi i brezave të gjelbra në ato vise ku shkalla e erozionit është e lartë;
- Pyllëzimi i viseve të zhveshura dhe atyre të degraduara

#### 4.2.9. Objektivi – Mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore dhe të shkaktuara nga faktori njeri

– Fatkeqësitë natyrore dhe të shkaktuara nga faktori njeri janë rreziqe që ndikojnë negativisht në mjedis, ekonomi dhe në jetën sociale. Për këtë arsye, njëri nga objektivat për parkun kombëtar është edhe mbrojtja nga këto fatkeqësi. Ky objektivi mund të arrihet përmes këtyre veprimeve:

- Hartimi i planit emergjent për parkun;
- Përgatitja e hartave të rreziqeve nga ekspertet e fushave të ndryshme – Përgatitja e këtyre hartave ka për qëllim mbrojtjen dhe ruajtjen e vlerave të natyrës, si dhe njeriun me veprimtaritë socio-ekonomike. Në hartë paraqitet pasqyrë e përafërt për situatat të rrezikshme sipas kalendarit dhe sipas hapësirave në Bjeshkët e Nemuna. Aty tregohen zonat e rrezikshme varësisht nga stina e vitit, tërësia hapësinore dhe elementi rrezikues. Hartat që duhet të bëhen janë:
  - harta për zonat që kanë rrezikshmëri nga ertiqet;
  - harta për zonat që kanë rrezikshmëri nga rrëshqitjet e dheut;
  - harta për zonat që kanë rrezikshmëri nga erozionet e rrezikshme;
  - harta për zonat që kanë rrezikshmëri sizmike;
  - harta për zonat shteguese me pjerrtësi shumë të mëdha;
  - harta për zonat që kanë rrezikshmëri nga kafshët e egra;
  - harta për zonat me potencial rreziku për zjarre;
- Bashkëpunimi dhe mbajtja e ushtrimeve të përbashkëta në mes të Drejtorisë së Parkut, komunave, institucioneve relevante dhe forcave të reagimit (njësitë e zjarrfikësve, policia, ndihma e parë, mbrojtja civile, FSK, KFOR si dhe shoqëria civile).

#### 4.2.10. Objektivi – Aplikimi i regjimit të shfrytëzimit të resurseve dhe vlerave të Parkut

– Për të gjitha resurset e parkut duhet të aplikohet regjimi i shfrytëzimit në mënyrë që të krijohen kushte të volitshme për mbrojtjen e tyre. Poashtu duhet të bëhet ndarja e përgjegjësisë për përkujdesjen dhe ndërmarrjen e masave dhe veprimeve adekuate. Për arritjen e këtij objektivi janë të nevojshme këto veprime:

- Plani menaxhues për parkun përcakton regjimin e shfrytëzimit – Regjimi i shfrytëzimit ka të bëjë me shfrytëzimin e tokës bujqësore, kullosave, livadheve, fryteve malore, bimëve mjeksore, kërkudhave, si dhe trupave ujore.
- Monitorimi i aplikimit të regjimit të shfrytëzimit dhe raportimi i vazhdueshëm për këtë tek Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës

#### 4.2.11. Objektivi – Vetëdijësimi dhe informimi mbi rolin dhe rëndësinë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore

– Organizimi i kampanjave të ndryshme për vetëdijësim dhe informim të banorëve që jetojnë në park, për turistët që vizitojnë parkun, për institucionet parashkollëre, shkollëre, për institucionet vendimmarrëse dhe për



të gjithë ata që dëshirojnë t'a vizitojnë parkun, është komponentë shumë e rëndësishme dhe primare për qëndrueshmërinë e parkut. Informimi për kategoritë e mbrojtjes së zonave, për aktivitetet që lejohen dhe nuk lejohen në park, si dhe vlerat e resurseve natyrore dhe kulturore, është një element shumë i rëndësishëm i këtij objekti.

Aktivitetet me të cilat do të arrihet objekti janë:

- a. Trashëgimia kulturore e Kosovës (arkeologjike, arkitekturore, e luajtshme dhe shpirtërore) të përfshihet në planprogramet shkollorë;
- b. Specializimi i ciceronëve për vlerat natyrore, historike dhe kulturore të parkut të Bjeshkëve të Nemuna;
- c. Prgatitja e hartave, fletëpalosjeve dhe broshurave për pasuritë natyrore dhe kulturore që posedon parku;
- d. Programet dokumentare për parkun, emitimi në ditët e caktuara të manifestimeve vjetore;
- e. Organizimi vjetor i ekskursioneve shkollorë, vizitë objekteve natyrore dhe kulturore.

**4.2.12. Objekti – Shfrytëzim racional i vlerave të trashëgimisë natyrore e kulturore të Parkut** – Objekti konsiston në atë që vlerat e trashëgimisë natyrore e kulturore të mbrohen nga keqpërdorimi dhe të shfrytëzohen në mënyrë të qëndrueshme në mënyrë që ato vlera të ruhen dhe t'i trashëgojnë edhe gjeneratat e ardhshme. Ky objekt do të mund të arrihet duke i ndërmarrë veprimet si:

- a. Përfshirja e trashëgimisë kulturore (arkeologjike, arkitekturore, të luajtshme, shpirtërore dhe peisazhet) në planet e nivelit lokal si: PZHK, HZKom dhe PRrH-në që përfshin zonën me trashëgimi kulturore, ku njëherit do të bëhet kontrollimi i zhvillimeve të ardhshme në këto zona.
- b. Hartimi i planeve të konservimit dhe menaxhimit për zonat me trashëgimi kulturore për komunat që janë pjesë e parkut;
- c. Gjetja e formave të partneritetit publiko-privat të cilat do të ofronin mundësi të konservimit, përfshirë mirëmbajtjen e objekteve me vlera kulturore

**4.2.13. Objekti – Sigurimi i infrastrukturës mbështetëse për zonat dhe objektet e TK** – Ky objekt ka të bëjë me sigurimin e informacionit të nevojshëm në park për orientimin e vizitorëve, por edhe me promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të parkut. Mbrojtja e objekteve me vlera kulturore, ku secili nga ata ka një histori në vehte, ruajtja e autenticitetit dhe vlerës së tyre është një objekt parësor. Me rikonstruktimin dhe funksionalizimin e tyre do të mbrohet e kaluara dhe identiteti ynë dhe njëkohësisht do të shfrytëzohet dhe ruhet për gjeneratat e ardhshme. Veprimet apo aktivitetet me të cilat mund të arrihet ky objekt janë:

- a. Krijimi i një sistemi të shenjëzimit për vlerat e trashëgimisë kulturore e natyrore;
- b. Plani për menaxhimin e parkut, duhet ta promovojë trashëgiminë kulturore, shtëpitë kullë në formë bujtinash, si njësi akomodimi, kishat, xhamitë, teqet etj.
- c. Identifikimi i objekteve dhe nevojave për rikonstruktim dhe caktimi i prioriteteve;
- d. Rindërtimi i objektit të mullirit tradicional në Zonën Kadastrale – Decan.

**4.2.14. Objekti – Bashkëpunimi ndërinstitucional në mes të organizatave qeveritare dhe joqeveritare të nivelit qendror dhe lokal** – Rëndësi të veçantë për parkun ka bashkëpunimi ndërinstitucional, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal, duke i respektuar detyrat, obligimet dhe përgjegjësitë që i takojnë secilit institucion në veçanti si dhe koordinimi i të gjitha aktiviteteve që dalin nga objektivat e përcaktuara më parë. Pozita gjeografike e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", kufizimi me shtetin e Shqipërisë dhe të Malit të Zi, ofron mundësi të lidhjes dhe bashkëpunimit ndërkufitar përmes projekteve që kanë të bëjnë me promovimin e trashëgimisë natyrore objekteve kulturore, peisazheve të ndryshme si dhe ushqimit tradicional të fshatrave që përfshihen në këtë trekëndësh parqesh ndërshtetëror. Në mënyrë që ky objekt i bashkëpunimit të arrihet, është e nevojshme të kryhen aktivitetet si:

- a. Mbështetje nga ana e nivelit shtetëror mbi rolin dhe rëndësinë e vlerave të trashëgimisë natyrore dhe kulturore të parkut, përmes politikave zhvillimore, që do të jenë bazë për arritjen e qëllimit tonë që është mbrojtja e TK dhe TN nga degradimi i vazhdueshëm;
- b. Harmonizimi i planeve zhvillimore që kanë të bëjnë me zhvillimin e turizmit të Bjeshkëve të Nemuna, që i takojnë Shqipërisë dhe Malit të Zi, ku do të klasifikoheshin zonat dhe lokalitetet turistike;
- c. Promovimi i vlerave natyrore dhe kulturore të secilit shtet, organizimi i ekskursioneve të përbashkëta turistike duke i'u dhënë rëndësi datave të caktuara vjetore (të organizohen në të gjitha stinët e vitit)

**4.2.15. Objekti – Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë së luajtshme dhe shpirtërore** – Duke e ditur se trashëgimia kulturore në tërësi e sidomos ajo shpirtërore, pra forma e shprehjes kulturore, e kaluara historike, traditat, ushqimi, vallet, veshjet, ritet etj paraqet identitetin e kësaj treve, me këtë objekt dëshirohet që ky identitet të ruhet dhe të përcillet tek gjeneratat e ardhshme. Aktivitetet me të cilat do të arrihet ky objekt janë:

- a. Organizimi i aktiviteteve në formë të ekspozitave, panairëve, koncerteve, festave apo tjetër ku mund të prezantohet trashëgimia kulturore përfshirë atë shpirtërore (zakonet, doket, ritet, vallet, muzika, kënga dhe shprehjet artistike-artizanatet, zejjet etj);
- b. Promovimi i trashëgimisë shpirtërore dhe të luajtshme duke organizuar gara të ndryshme në shkolla, ekskurziona në fundvit ekspozita të vizatimeve, fotografive dhe aktivitete tjera shkollorë;
- c. Ndërtimi i një muzeu etnologjik i "parkut" në të cilin do të prezantohen veshjet, armët, enët që janë përdorur për ushqim, elementet dekorative të qëndisura, veglat e punës, ato muzikore dhe veglat e shtëpisë të gdhendura nga druri, si dhe ushqimi tradicional i këtyre anëve;
- d. Përkrahja e projekteve që stimulimojnë zhvillimin e veprimtarisë artizanale dhe kultivimin e gastronomisë tradicionale.

### 4.3. SYNIMI 3 – ZHVILLIMI SOCIO-DEMOGRAFIK NË VENDBANIMET BRENDA DHE PËR RRETH PARKUT

Realizimi i këtij synimi do të bëhet i mundshëm përmes zbatimit të objektivave si në vazhdim:

**4.3.1. Objekti – Ngritja e cilësisë së edukimit – arsimimit** – Një numër i konsiderueshëm i vendbanimeve rurale është shpopulluar, një pjesë e tyre është shpopulluar pjesërisht ose ka të tilla ku kanë ngelur pak familje me banim të përhershëm. Duhet të bëhet përpjekje institucionale që banorëve t'u sigurohet qasja në sistemin e edukimit dhe arsimimit dhe të ngritet cilësia. Ky objekt do të mund të arrihet me disa veprime si:

- a. **Ndërtimi i objekteve shkollorë ose sigurimi i transportit për nxënësit** – Në ato raste (vendbanime) ku numri i nxënësve është i mjaftueshëm (sipas ligjit) për të patur një objekt shkollor në vendbanimin e tyre, të ndërtohet objekti shkollor sipas standardeve, në të kundërtën duhet të sigurohet transporti për bartjen e nxënësve shtëpi – shkollë dhe anasjelltas (për në vendbanimin më të afërt).
- b. **Ndërtimi i objekteve edukative – kopshteve për fëmijë** – Duke ditur se ndërtimi i objekteve edukative për secilin vendbanim është i kushtueshëm dhe në shumicën e vendbanimeve ka fare pak familje, po ashtu, familjet i takojnë tipit tradicional (me shumë anëtarë për familje), është e panevojshme të kemi për secilin vendbanim, prandaj do të duhej të ndërtonim objekte edukative në qendra të caktuara, objekte që do të mund t'i shfrytëzonin dy e më shumë vendbanime.
- c. **Organizimi i programeve edukative për popullatën** – Në mënyrë që të rinjtë dhe moshat madhore të kësaj anë të jenë në hap me kohën sikur në pjesën tjetër të vendit, së paku dy herë në vit do të duhej të organizoheshin programe edukative, kurse nga fusha të ndryshme si: përvetësimi i softverëve, mësimi i gjuhëve të huaja etj. OJQ-të profesionale do të mund të angazhoheshin në këtë drejtim.

**4.3.2. Objekti – Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore** – Shumica e vendbanimeve të kësaj ane nuk kanë shtëpi shëndeti. Meqenëse sipas ligjit nuk i plotësojnë kriteret për të pasur një shtëpi shëndeti, atëherë duhet shikuar mundësin e formave të tjera të ofrimit të shërbimeve shëndetësore për qytetarët e kësaj ane. Aktivitetet apo veprimet për arritjen e këtij objekti janë:

- a. **Ndërtimi i shtëpive shëndetësore** – Të ndërtohen shtëpi shëndeti, ambulanca në qendër të vendbanimeve, ku lidhen dy e më shumë vendbanime sipas standardeve, e të cilat do të mundësojnë ofrimin e shërbimeve shëndetësore më afër banorëve dhe më cilësore.
- b. **Ofrimi i shërbimeve shëndetësore me autoambulancë** – Meqenëse shumica e vendbanimeve nuk i plotësojnë kriteret (sipas ligjit) për të pasur një shtëpi shëndeti, atëherë duhet të ofrohen shërbime me autoambulancë së paku dy herë në javë për qytetarët e zakonshëm, ndërkaq për qytetarët me nevoja të veçanta të ofrohen shërbime sipas nevojës (sipas ligjit).

**4.3.3. Objekti – Rigjallërimi i vendbanimeve të shpopulluara** – Një numër i konsiderueshëm i vendbanimeve (9 vb.) brenda por edhe në afërsi të parkut janë shpopulluar tërësisht, disa prej vendbanimeve pjesërisht dhe ka tendenca që edhe më tej migrimi i popullsisë nga viset e kësaj ane të vazhdojë. Në mënyrë që t'i rigjallërojmë këto vendbanime të zbrazura dhe t'i mbajmë të populluara vendbanimet me tendencë të zbrazjes, do të duhej të ndërmerren disa iniciativa,



projekte me qëllim të joshjes për jetë dhe punë të qytetarëve të kësaj ane në këtë pjesë të bukur të vendit. Disa prej tyre janë:

- a. **Subvencionim në edukim dhe arsimim sipas grup – moshave dhe gjinisë** – Në mënyrë që kjo hapësirë me atraksione të veçanta dhe me mundësi zhvillimi të veprimtarive ekonomike nga më të ndryshmet të rigjallërohet, duhet të subvencionohet edukimi, arsimimi i të rinjve dhe të organizohen (subvencionohen) aftësimet profesionale nga institucionet publike.
- b. **Qasje për të gjithë dhe marketing për parkun** – Rigjallërimi i vendbanimeve të parkut mund të arrihet përmes shtrirjes së infrastrukturës fizike në to dhe në vendet me potenciale zhvillimi. Duhet të krijohen lehtësira të të bërit biznes në këtë trevë dhe të ketë marketing për joshjen e investimeve nga banorët e saj por edhe nga investitorët e jashtëm.
- c. **Java tradicionale e Rugovës** – Përcaktimi i javës tradicionale të Rugovës do të ndihmojë në kthimin e vëmendjes së banorëve të kësaj ane në organizimin e ngjarjeve tradicionale, me qëllim përfitimi dhe do të tërheqë vizitorët dhe turistët lokal dhe të huaj. Me këtë, kjo trevë do të rigjallërohet dhe bëhet më joshëse nga dita në ditë për të jetuar apo/ose edhe investuar në veprimtari të ndryshme.

#### 4.4. SYNIMI 4 – NGRITJA EKONOMIKE E PARKUT DHE ZHVILLIMI I TURIZMIT

Objektivat me arritjen e të cilëve do të mund të arrihej synimi për ngritjen ekonomike të parkut janë:

**4.4.1. Objektiv – Zhvillimi i bujqësisë tradicionale/blegtorisë dhe bletarisë me qëllim të përfitimit ekonomik dhe zhvillimit të ekoturizmit** – Ky objektiv ka për qëllim ndërgjegjësimin e fermerëve për përfitime ekonomike nga kultivimi ekologjik i prodhimeve me metoda tradicionale organike, që njëherit si rrezultat do të ketë promovimin e kulturës dhe tradites së zonës, zgjon interesimin e turistëve dhe rritë atraktivitetin turistik në zonë.

Kontrolli, shfrytëzimi i kullsave dhe livadheve për blegtori, do bëhet në mënyrë të organizuar sipas etapave kohore sezonale dhe sipërfaqeve të destinuara.

Ky objektiv arrihet me këto masa/veprime/projekte /aktivitete:

- a. Hartimi i programit për ngritjen e vetëdijes së banorëve për mundësitë e kultivimit të bujqësisë organike në zonat brenda dhe për rreth parkut (Rugovë, Istog, Deçan, etj), sipas dispozitave të parapara në PMP;
- b. Krijimin e lehtësirave për kultivimin e blegtorisë dhe hapjen e fermave;
- c. Ngritja e pikave grumbulluese në kuadër të parkut me gjithë infrastrukturën e nevojshme;
- d. Përcaktimi i një lokacioni të vetëm për tregun e agro-turizmit. Lokacioni i mundshëm përcaktohet në bashkëpunim me komunën përkatëse, drejtorinë e parkut dhe ekspertët e sektorit përkatës;

**4.4.2. Objektiv – Shfrytëzimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore, BMA (bimëve mjekuëse dhe aromatike) dhe PFE (pemëve frutore të egra) për përfitime ekonomike** – Me këtë objektiv arrihet kontrolli i shfrytëzimit të kullotave, livadheve për blegtori dhe për vjeljen e BMA dhe PFE, në mënyrë ekologjike dhe të organizuar sipas etapave

kohore sezonale dhe përcaktimin e sipërfaqeve të vjeljes që rezultojnë në mbrojtjen e mjediseve të pasura, mënyrën e shfrytëzimit të tyre, menaxhimin e mirë dhe me përfitime ekonomike.

Ky objektiv arrihet me këto veprime, aktivitete të cilat në mënyrë të detajuar duhet të parashihen dhe përcaktohen në kuadër të planit për menaxhimin e parkut:

- a. Hartimi i rregullores për shfrytëzimin e qëndrueshëm të sipërfaqeve të caktuara, për mbledhjen e BMA dhe PFE si dhe afatin kohorë të vjeljes, e cila duhet të përfshihet në PMP;
- b. Hartimi i strategjisë për krijimin e një brendi për të gjitha produktet e prodhuara në Bjeshkët e Nemuna, qofshin bimë mjekuëse, fruta të egra, apo produkte bujqësore, blegtorale etj. Kjo do të jetë pjesë e PMP dhe do të mundësojë që këto produkte të konkurojnë brenda dhe jashtë vendit, si produkte ekologjike me standarde ndërkombëtare.

**4.4.3. Objektiv – Planifikimi i zhvillimeve sipas regjimit të mbrojtjes, për zonat brenda dhe rreth parkut** – Me këtë objektiv tentohet të arrihet kontrolli i zhvillimeve sipas regjimit të mbrojtjes për zonat brenda dhe përreth parkut. Zonat ku planifikohen zhvillimet në park, do të propozohen në bazë të kategorisë së mbrojtjes së zonave, në bazë të të cilave do të përcaktohet edhe lokacioni më i përshtatshëm për të gjitha veprimtaritë dhe aktivitetet. Bazuar në konceptin e zhvillimit hapësinor, në zonën e parë të mbrojtjes parashihen masat e mbrojtjes strikte. Zona e dytë ose zona e menaxhimit aktiv përfshinë pjesët e territoit të parkut ku mund të ushtrohen veprimtari të cilat nuk janë në kundërshtim me mbrojtjen e natyrës, zhvillimi i ekoturizmit dhe bujqësia tradicionale. Zona e tretë përfshinë pjesë të territorit të parkut ku parashihen: ndërtimi, rindërtimi dhe sipërfaqet rekreative sportive.

Planifikimi i zhvillimeve në park do ti jep prioritet projekteve në zonat ku janë duke ndodhur zhvillimet, ndërsa lokalitetet tjera si potenciale turistike do të zhvillohen në fazat e më vonshme, në bazë të prioriteteve të cilat i përcakton Drejtoria e Parkut në bashkëpunim me përfaqësuesit e komunave pjesëmarrëse në park:

- o Lokaliteti i Kozhnjerit, Lokaliteti i Bjeshkëve të Strellicit;
- o Lokaliteti Bjeshka e Belegut, Prejlepit, Roshkodolit, Milishevcit, Zllonopoja, Baballoqi, Dervishkomi;
- o Lokaliteti Bjeshka, Zalli i Rupës, Carrabregu, Deçani, Pllaqica e Vokshit, Stanishta e Zogut, Dobroshit, Kurvalla etj;
- o Lokaliteti Lugu i Gatë dhe Rrasa e Zogut;
- o Lokaliteti Lugu i Butë;
- o Lokaliteti Zharra - Qendra rekreative-rehabilituese;
- o Zonën e Grykës së Erenikut, duke përfshirë lokalitetet: Gradinë, Jedovë, Burimi Erenikut, Liqejtë e Gjeravicës dhe Rrasa e Zogut;
- o Zonën Gryka e Batushës, ku përfshihen lokalitetet Gjocaj, Jasiq, Rrasa Koshares;
- o Qendrat Rehabilituese Sportive tek kilometri 6;
- o Qendër Rehabilituese Shëndetësore tek kilometri 6;

Me planifikimin e zhvillimeve parashihen hyrjet - daljet në park në mënyrë që të bëhet monitorimi, informimi i vizitorëve, si dhe grumbullimi i të hyrave në park, të cilat do të shfrytëzohen për nevojat e parkut.

Për venbanimet brenda parkut mund të hartohen planet rregulluese si dhe vëmendje të posaqme gjatë zhvillimit të parkut do ti kushtohet ruajtjes së strukturës së staneve dhe menyrës autoktone të ndërtimit.

Zona e ndikimit apo vendbanimet për rreth parkut do të shërbejnë për parandalimin e ndikimeve të dëmshme në park. Do ti kushtohet rendësi përmirsimit të kushteve infrastrukturore dhe vetëdijësimit të popullatës për ruajtjen e vlerave natyrore.

Projektet me të cilat do të mund të arrihet ky objektiv janë:

- a. Marrëveshje e partneritet publiko-privat për investime;
- b. Ngritja e hyrjeve - daljeve në park me përmbajtjet përcjellëse:
  - o **Hyrja kryesore:** Pejë - Rugovë e cila do të ketë këtë përmbajtje: simbolin e parkut, tabelat informuese, parkingun, ndërtesën e administartës së parkut, në të cilën është edhe zyra e informimit turistik, kioskën për shitjen e biletave për hyrje në park afër së cilës është rampa për vetura, muzeun e natyrës, shërbime tregtare furnizuese me prodhime të vendbanimeve për rreth, shitjen e gjësendeve artizanale, toaleta publike, si dhe sipas nevojës shërbime të tjera. Hapësira për shërbime tregtare mund t'i ketë disa shitore dhe disa tezga të hapura, të realizuara në formë të një mini pazari të tipit tradicional. Të gjitha këto duhet të rregullohen me një plan rregullues të hollësishtëm, i cili i përfshinë edhe hapësirat ku janë akumulimi ujqor për ujtitje i njohur me emrin "Diga Italiane" pastaj burimi i ujit të pijshëm "Uji i Zi" dhe i cili plan poashtu parasheh edhe largimin e kiosqeve e tezgave të paautorizuara ekzistuese dhe adreson çështjen e restorantit të paautorizuar, si dhe atë të mbrojtjes së akumulimit dhe burimit ujqor nga ndotja me ujërat e zeza që dalin nga ndërtesat në afërsi.
  - o **Hyrjet sekondare:** Istog (Vrellë - Lugu i Butë), Deçan (Deçan - Manstiri i Deçanit), Junik (Moronicë- Bjeshka) dhe Gjakovë (Batushë - Koshare), që do të kenë këtë përmbajtje: pjesën hyrëse me simbolin e PK, zyren e informimit, tabelat informuese, tualeteve publike dhe parkingun;
  - o **Ngritja e pikave kontrolluese** në rrugën magjistrale Pejë - Rozhajë në hyrje të hapësirës së PK, që shërben për kontrollin e lëvizjes së automjeteve të cilat hyjnë në park, sipas rregullores së menaxhimit të parkut;
- c. Studimi i fizibilitetit dhe hartimi i projekteve të reja, si dhe harmonizimi i projekteve ekzistuese duke mos qenë në kundërshtim me dispozitat për zbatim të parapara në PHPK"BN" si:
  - o Projekti "Teleferikut Pejë - Kopraniq";
  - o Projekti i "Qendrës Turistike Kopraniq"-Pejë;
  - o Projekti "Qendra e skijimit në Bjeshkët e Belegut (Hartuar nga Instituti për Urbanizëm i Kroacisë - vitet e tetëdhjeta);
  - o Projekti për Qendrën Rekreative - Turistike Bogë;
  - o Projekti për zhvillimin e "Qendrës kulturore rekreative në Shkrel";
  - o Hartimi i projektit për "Qendrën Rezidenciale Qeveritare" - Lokaliteti Boja e Kuqe te Lugu i Gatë (me sipërfaqe rrethë 40 ha);
  - o Projekti për teleferikun që lidh Deçanin me Bjeshkët e Belegut;
  - o Projekti për "Qendrën rekreative-rehabilituese" - Lokaliteti Zharra;



- Projekti për renovimin dhe revitalizimin e “Pushimores së fëmijëve dhe rinisë” në Deçan;
  - Projekti për renovimin dhe riaktivizimin e kompleksit Pushimorja e Femijeve dhe rinisë” në Deçan;
  - Projekti për Shtëpinë e Shoqatës së Bjeshkatarëve “Shkëlzen Haradinaj” në Komunën e Deçanit.
- d. Plane rregulluese të hollësishme mund të hartohen për vendbanimet brenda parkut të cilat do të ofrojnë turizëm fshatar siq janë: Bogë, Belle, Drelaj, Shtupeq, Reka e Allagës, Lipë, Malaj, Jasiq, Gjocaj;
- e. Përcaktimi i zonave dhe sipërfaqeve të kampeve në bashkëpunim me përfaqësuesit e komunave përkatëse, Drejtorinë e Parkut dhe ekspertët relevant;
- Hartimi i projekteve për kampet sipas dispozitave për zbatim të këtij plani hapësinor;
  - Kampi veror për fëmijë dhe rini në fshatin Haxhaj;
  - Kampi te Laku i Kryqes dhe Livadhi i Mark Gegës;
  - Rregullimi sipas standardeve të kampeve ekzistuese (Liqeni Kuqishtë, Lutovë, Malaj, Tëbanet e Lumbardhit) sipas dispozitave për zbatim të këtij plani;

**4.4.4. Objektivi – Edukimi dhe trajnimi i burimeve njerëzore për industrinë turistike dhe për mundësitë e përfitimit ekonomik për banorët lokal** – Qëllimi i objektivit është që të identifikojë dhe të planifikojë zhvillimin e vlerave ekzistuese dhe mundësitë për rritjen e të ardhurave të komunitetit duke ruajtur resurset natyrore dhe traditën kulturore. Përfshirja e banorëve lokal në zhvillimin e turizmit do të luajë rol kyç në ndërgjegjësimin dhe në gjenerimin e mbështetjes së drejtpërdrejtë apo të tërthortë për ruajtjen e këtyre vlerave dhe gjenerimin e begatisë ekonomike. Përfshirja e popullatës në përgatitjen e kuadrove me kualifikime përkatëse për sektorin e turizmit, ofron mundësi të shumta për punësim të njerëzve të çdo moshe dhe aftësie.

Planet zhvillimore komunale duhet ta konsiderojnë turizmin si sektor ekonomik kyç për ZHEL, duke promovuar vlerat dhe identitetin e zonës për qëllime marketingu, me qëllim të krijimit të ardhurave nga ky sektor i cili kontribuon në krijimin e vendeve të reja të punës.

Ky objektivi do të arrihet përmes këtyre masave/aktiviteteve dhe projekteve:

- a. Mbështetje institucionale (subvencionimi) për banorët e venbanimeve brenda dhe rreth parkut për turizëm rural;
- b. Identifikimi dhe adaptimi shtëpive individuale për turizëm rural;

**4.4.5. Objektivi – Krijimi i imazhit të parkut dhe promovimi i turizmit** – Me këtë objektivi tentohet të arrihet krijimi i imazhit të parkut duke paraparë programe dhe aktivitete për marketing, duke promovuar vlerat unike të parkut dhe mënyrën e plasimit në treg, të produktit turistik të parkut me të gjitha kapacitetet e ofertës turistike nga organi kompetent i menaxhimit të parkut në bashkëpunim me komunat në të cilat shtrihet parku. Funksionimi i parkut si kompleks modern duhet të publikohet përmes mediave të shkruara dhe elektronike i cili do të ndikojë në zhvillimin e ardhshëm të parkut. Projektet me të cilat do të mund të arrihet ky objektivi janë:

- a. Hapja e zyrave turistike në qendrat lokale dhe pikat kufitare për informacion turistik, si dhe hapja e zyrave përfaqësuese në tregjet kryesore ndërkombëtare dhe bashkëpunimi me diasporën shqiptare;
- b. Krijimi i një strukture të përhershme financiare që siguron një buxhet të vazhdueshëm marketingu për:
  - Promovimin turistik përmes veprimtarive promovuese siç janë: konferencat, panairët ndërkombëtare, spotet, reklamat turistike;
  - Fushata informuese në lidhje me ofertat turistike përmes katalogjeve, broshurave, DVD-ve, programeve turistike specifike, rrjeteve sociale si dhe organizmi i udhëtimeve familiarizuese për gazetarë dhe agjensione turistike në park
- c. Investimet në kulturë për të rritur zhvillimin e turizmit
  - Krijimi i mekanizmave financiarë afatgjatë për ruajtjen e objekteve të trashigimisë kulturore;
  - Promovimi i objekteve të trashëgimisë kulturore, kullat në formë bujtinash si njësi akomoduese;
  - Promovimi i objekteve të trashëgimisë së kultit: kisha, xhami, teqe;
  - Mbështetja, rivlerësimi dhe publikimi i ngjarjeve kulturore dhe i festivaleve folklorik.


#### **4.5. SYNIMI 5 – SIGURIMI I QASJES DHE SHËRBIMEVE PUBLIKE NË PARK**

Ky synim mund të arrihet duke i arritur objektivat si më poshtë:

**4.5.1. Objektivi – Sigurimi i infrastrukturës rrugore dhe transportit** – Njëra nga komponentat e infrastrukturës fizike që duhet të sigurohet në park është infrastruktura rrugore. Me anë të rrugëve lehtë të kalueshme për automjete dhe shtigjeve për këmbësorë, duhet të sigurohet qasja tek fshatrat brenda parkut dhe tek përmbajtjet tjera që janë në funksion të pushimit, sportit, rekreacionit dhe prodhimit. Sigurimi i një rrjeti të mirë rrugor e mundëson zhvillimin e transportit publik që është një mundësi më shumë për ti përjetuar vlerat natyrore në park, ndërkaq banorëve të parkut ua lehtëson lëvizjen në relacionet fshat-fshat dhe fshat-qytet. Objektivi i sigurimit të infrastrukturës rrugore dhe transportit do të arrihet duke i kryer veprimet apo realizuar projektet si më poshtë:

- a. Asfaltimi i rrugës në relacionin Deçan – kufiri me Malin e Zi me gjatësi 23 km. Traseja përfundi-mtare e rrugës duhet të përcaktohet në bazë të marrëveshjes së palëve të interesit;
- b. Ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për funksionalizimin e plotë të vendkalimeve kufitare me Malin e Zi, në Rrugën Rajonale ekzistuese R108 dhe Rrugën Nacionale ekzistuese N9; dhe Shqipërinë në afërsi të Kompleksit të Koshares;
- c. Ndërtimi i rrugës së Milishevcit me gjërësi adekuate, me karakter transporti të limituar në pjesën jugore e cila e lidh qytetin e Pejës me Podin e Jezercit dhe Milishevcin dhe dalje në Zllano Pojë;





Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"

Legjenda:

- Kufiri i Kosovës
- Kufiri komunal
- Kufiri i PK Bjeshkët e Nemuna
- Rrugët ekzistuese
- Rrugët e planifikuara
- Lumenjtë
- - - Shtigjet për ecje
- - - Linjat e transmisionit
- - - Largpërcuesit
- Zona e I - të
- Zona e II - të
- Zona e III - të
- ZVM

Plani Hapësinor PK "Bjeshkët e Nemuna"

**Infrastruktura**

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit  
 Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës  
 Instituti për Planifikim Hapësinor



P= 1:120,000





- d. Ndërtimi i rrugës që e lidhë Jabllanicen me Istogun, me gjërësi adekuatë, me karakter transporti të limituar;
- e. Ndërtimi i rrugës në relacionin Junik – Lugu i Gjatë;
- f. Zbatimi i projektit për rregullimin e rrugëve malore për automjete të lehta motorike dhe të zjarrfikësve në zonën e Memorialit;
- g. Vendosja e teleferikut në zonën EST, respektivisht në drejtim të zonës turistike Kopranik;
- h. Zbatimi i projektit për ndërtimin e teleferikut nga Kompleksi Memorial deri në Rrasë të Koshares;
- i. Ndërtimi i shtigjeve për këmbësorë që e mundësojnë qasjen e vizitorëve në vendet më atraktive të parkut kombëtar:
  - o Përmirësimi i shtigjeve ekzistuese në pjesën veriore dhe në pjesën jugore (Pjesa e Pejës);
  - o Ndërtimi i shtigjeve të reja për ecje në pjesën veriore dhe në pjesën jugore (Pjesa e Pejës);
  - o Përmirësimi i shtigjeve kulturore dhe ndërtimi i shtigjeve të reja;
  - o Zhvillimi i shtigjeve ekstreme për çiklizëm;
  - o Zhvillimi i shtigjeve për kalërim;
  - o Hapja e shtigjeve për skijim;
- j. Ndërtimi i pikave të pushimit në çdo kilometër përgjatë shtigjeve për këmbësorë;
- k. Ndërtimi i parkingjeve në hyrjet kryesore të parkut dhe në vendet me kapacitete turistike;
- l. Vendosja e linjave të rregullta të transportit publik deri tek të gjitha vendbanimet brenda parkut dhe tek të gjitha hapësirat tjera me përmbajtje të rëndësishme siç mund të jenë ski qendrat me hotele dhe infrastrukturë përcjellëse;
- m. Ndërtimi i infrastrukturës teknike shtesë, të nevojshme për përmirësimin e kualitetit të jetës në përgjithësi.

**4.5.2. Objektivi – Sigurimi i infrastrukturës së energjisë elektrike** – Për zhvillimin ekonomik të parkut kombëtar, është i domosdoshëm sigurimi i furnizimit të rregullt dhe të duhur me energji elektrike. Vendbanimet dhe të gjitha përmbajtjet tjera në park kanë nevojë për këtë, në mënyrë që të mund të funksionojnë. Kjo shtrun nevojën që infrastruktura e tanishme e energjisë elektrike të përmirësohet, sepse nuk është në nivel të kënaqshëm. Duhet të përmirësohet rrjeti i shpërndarjes së energjisë elektrike duke përfshirë edhe instalimin e trafove të rinj nëse është e nevojshme. Në mënyrë që të arrihet objektivi i sigurimit të infrastrukturës së nevojshme për furnizim me energji elektrike duhet të realizohen projektet apo veprimet konkrete si:

- a. Realizimi i një studimi me parashikimin për sasinë e energjisë elektrike të nevojshme për furnizimin e parkut në 10 vjetët e ardhshëm duke i përfshirë këtu edhe veprimet e nevojshme për sigurimin e kësaj sasive;
- b. Realizimi i një studimi për gjetjen dhe shfrytëzimin e burimeve alternative, të ripërtërishtme të energjisë;
- c. Ndërtimi i linjave të reja furnizuese 10 kV gjegjësisht 0.4 kV me trafostacione përcjellës;
- d. Zëvendësimi i linjave ajrore me ato kabllorë nëntokësore;

- e. Rekonstruktimi-përmirësimi i rrjetit të shpërndarjes dhe trafove ekzistues, vendosja-instalimi i trafove të rinj, të gjitha në bazë të studimit nën pikën 1;
- f. Vendosja e shtyllave për ndriçim publik të fshatrave brenda parkut dhe hapësirave me përmbajtje në funksion të turizmit.

**4.5.3. Objektivi – Sigurimi i infrastrukturës ujore** – Momentalisht, prej 20 vendbanimeve sa janë brenda parkut, vetëm në dy janë të instaluar sistemet publik të ujësjellësit, ndërkaq sisteme publik të kanalizimit të ujërave të zeza dhe impiant për pastrimin e këtyre ujërave nuk ka në asnjërin nga këto vendbanime. Kjo flet për një nivel jo të lartë të jetesës brenda parkut, mungesën e kushteve elementare për zhvillimin e turizmit dhe rrjedhimisht për nevojën e investimit në sigurimin e infrastrukturës ujore. Objektivi për ta ndërtuar këtë infrastrukturë mundëson furnizimin e të gjithëve në park me ujë të pijshëm, i kanalizon ujërat e zeza dhe duke i pastruar këto ujëra, i mbron lumenjt nga ndotja. Ky objektivi do të arrihet duke i plotësuar mungesat që u përmendën më lartë pra me:

- a. Realizimin e një studimi për sasinë e ujit të pijshëm të nevojshëm për furnizimin e parkut gjatë 10 vjetëve të ardhshëm duke përfshirë edhe trajtimin e ujërave të zeza;
- b. Realizimi i studimit për burimet e ujërave nëntokësor në mënyrë që të konstatohet se cilët nga burimet ekzistues do të mund të shfrytëzoheshin për furnizimin e parkut me ujë të pijshëm;
- c. Hulumtimi i burimeve të reja të ujërave nëntokësor;
- d. Instalimin e rrjeteve publik të ujësjellësit me kapacitet në bazë të studimit të lartpërmendur në të gjitha vendbanimet dhe përmbajtjet tjera brenda parkut, qofshin ato turistike, prodhuese apo të tjera;
- e. Instalimin e rrjeteve publik të kanalizimit të ujërave të zeza në bazë të studimit të lartpërmendur në të gjitha vendbanimet dhe përmbajtjet tjera brenda parkut, qofshin ato turistike, prodhuese apo të tjera;
- f. Ndërtimi i impianteve për pastrimin e ujërave të zeza dhe i kolektorëve që mbledhin ujërat e zeza dhe i dërgojnë deri tek impianti;
- g. Me kushte të veçanta dhe pas studimit përkatës të arsyeshmërisë, të lejohet ndërtimi i ujmbledhësit në Grykën e Lloqanit.

**4.5.4. Objektivi – Sigurimi i infrastrukturës së telekomunikacionit** – Sot bota nuk mund të paramendohet pa telekomunikacion, pra pa ekzistencën e mjeteve të komunikimit ndërmjet njerëzve. Gjendja e sotme në park tregon se ai vetëm pjesërisht apo në mënyrë jo të kënaqshme është i përfshirë në shërbimet e telekomunikacionit. Kështu është për arsye se zhvillimi i infrastrukturës së telekomunikacionit nuk është në nivel të duhur. Mundësia që në park njerëzit të komunikojnë në formë të ndryshme, është njëri prej kushteve për zhvillimin e dëshiruar të turizmit atje dhe një indikator për nivelin e jetesës brenda parkut. Nga këto fakte që u përmendën ka dalur objektivi që të sigurohet infrastruktura e telekomunikacionit, e cila mundëson që parku të mbulohet plotësisht nga sinjali i telefonisë mobile GSM, që atje të ketë edhe telefoni fikse,

pastaj Internet, që të mbulohet nga sinjali televiziv ajror, të ketë televizion kabllor dhe kështu të mundësohet komunikimi ndërmjet njerëzve. Ky objektivi arrihet duke i kryer veprimet si:

- a. Vendosja e antenave për ta mbuluar tërë hapësirën e parkut kombëtar me signalin e telefonisë mobile;
- b. Instalimi i linjës telefonike kabllorë nëntokësore për sjelljen e signalit të telefonisë fikse tek ndërtesat nëpër fshatra, kapacitetet turistike dhe tek Kompleksi i Memorialit të Betejës së Koshares;
- c. Vendosja e pajisjeve që mundëson qasjen pa tela (ëireless) në rrjetin e Internetit në të gjitha kapacitetet turistike, në fshatra dhe në Kompleksin e Memorialit;
- d. Përforcimi i signalit televiziv ajror për fshatrat, vendet me kapacitetet turistike dhe për zonën e Betejës së Koshares, si dhe instalimi i kabllorëve në ndërtesa për televizionin kabllor dhe Internetin;
- e. Vendosja e punkteve postare në vendet me kapacitetet turistike.

**4.5.5. Objektivi – Sigurimi i infrastrukturës për menaxhimin e mbeturinave**


– Imazhi i një parku të pastër, të liruar nga mbeturinat është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e turizmit. Është e kuptueshme që një park ku mbeturinat do të shpërndaheshin gjithandej, nuk do të ishte tërheqës për vizitorët dhe rrjedhimisht zhvillimi i turizmit do të vëhej në pikëpyetje. Për këtë arsye, në park duhet të sigurohet infrastruktura për mbeturinat në mënyrë që parku të mbahet i pastër. Sigurimi i kësaj infrastrukture paraqet objektivin e radhës dhe ai konsiston në kryerjen e disa veprimeve konkrete si:

- a. Kontraktimi i operatorit që do të menaxhojë me mbeturinat në park;
- b. Vendosja e kontejnerëve të mbeturinave në fshatra, në vendet ku ka kapacitete turistike dhe në zonën e Betejës së Koshares, si dhe vendosja e shportave për mbeturina në vende të caktuara pranë shtigjeve për këmbësorë dhe në të gjitha pjesët që frekuentohen nga vizitorët;
- c. Vendosja e tabelave njoftuese për gjomat që pasojnë pas hedhjes pa vend të mbeturinave në park;



→ Strategjia e zhvillimit hapësinor në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"

### Strategjia e zhvillimit hapësinor



#### Legjenda

- █ Kufiri i Kosovës
- █ Kufiri i Parkut
- █ Kufiri komunal
- █ Zona e I-rë
- █ Zona e II-të
- █ Zona e III-të
- ⊕ Kalim ndërkuftitar
- ⊕ Kalim kryesore
- ⊕ Hyrje sekondare
- ⊕ Teleferik
- Qender turistike
- Qender rekreative
- Zonë e përshtatshme
- Parkingu
- Punkti informues
- Memorial historik
- Zonë e bashkëpunimit
- Lumi

#### Disa nga veprimet - projektet

**Ngritja e hyrjeve** - Daljeve në Park:  
 Hyrja k 1 – në afërsi të Patrikanës së Pejës;  
 Hyrja k 2 – në afërsi të Manastirit të Deçanit;  
 Hyrja s 1 – në grykën e Lumit Uloqan;  
 Hyrja s 2 – në rrugën që e lidhë qytetin e Junikut ;  
 Hyrja s 3 – në rrugën që e lidhë qytetin e Istogut ;  
 Hyrja s 4 – në rrugën që e lidhë Istogun me Parkun;  
 Hyrja s 5 – në afërsi të fshatit Batushë;

**Ndërtimi i qendrave rekreative turistike:**  
 Qendra turistike Kopranik;  
 Qendra e skllimit në Bjeshkët e Belegut;  
 Qendra Rekreative - Turistike Bogë;  
 Qendra kulturore rekreative në Shkrel;  
 Qendra Rezidenciale Qeveritare - Lokaliteti Zharrë;  
 Qendra rekreative-rehabilituese - Lokaliteti Zharrë;  
 Kampi veror për fëmijë dhe rini në fshatin Haxhaj;  
 Rregullimi i kampeve ekzistuese: Lqem Kugishtë, Lutovë, Malaj, Tebanet e Lumbardhit;

**Infrastruktura:**  
 Asfaltimi i rrugës R108;  
 Ndërtimi i rrugës së Peklënës;  
 Ndërtimi i rrugës së Mllshëvci;  
 Ndërtimi i rrugës në relacionin Junik – Lugu i Gjatë;  
 Rregullimi i rrugës Batushë – Memoriali i Koshares;  
 Rregullimi i rrugës Junik – Memoriali i Koshares;  
 Rregullimi i rrugës dytësore për në Karakoll dhe në R. e Shqipërisë;  
 Vëndosja e teleferikut në drejtim të zonës turistike Kopranik;  
 Ndërtimi i teleferikut nga Kompleksi Memorial deri në Rrasë të Koshares;  
 Ndërtimi i shigjeve për fëmbsore në vendet më atraktive të parkur kombëtar;  
 Përmirësimi i shigjeve ekzistuese në veri dhe në jug të Pejës;  
 Ndërtimi i shigjeve të reja për ecje në veri dhe në jug të Pejës;  
 Përmirësimi i shigjeve kulturore dhe ndërtimi i shigjeve të reja;  
 Zhvillimi i shigjeve ekstreme për çiklizëm;  
 Zhvillimi i shigjeve për kalërim;  
 Ndërtimi i parkingjeve të nevojshme;  
 Vëndosja e linjave të rregullta të transportit publik;  
 Instalimi i rrjeteve publik të ujësjellës në të gjitha vendbanimet;  
 Instalimi i rrjeteve publik të kanalizimit të ujërave të zeza në të gjitha;

### Plani Hapësinor PK "Bjeshkët e Nemuna"

**Strategjia e zhvillimit hapësinor**

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit  
 Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës  
 Instituti për Planifikim Hapësinor





## DISPOZITAT PËR ZBATIM

### 5. DISPOZITAT PËR ZBATIM

Dispozitat për zbatim përmbajnë kushtet dhe masat me karakter obligativ që respektivisht duhet të plotësohen dhe të ndërmerren gjatë zbatimit të planit hapësinor. Këto dispozita e drejtojnë zbatimin e planit.

#### 1.1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1. Plani Hapësinor i Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" (në tekstin e mëtejshëm: Plani) i definon caqet e rregullimit/planifikimit të territorit/hapësirës, organizimit dhe destinimit të territorit/hapësirës, i përcakton kushtet dhe masat e shfrytëzimit, rregullimit dhe mbrojtjes së Parkut;
2. Plani Hapësinor për PK "Bjeshkët e Nemuna" mbulon periudhën kohore prej minimum dhjetë viteve nga aprovimi përfundimtar në Kuvendin e Kosovës;
3. Rishikimi i Planit bëhet në çdo pesë vjet, por mund të bëhet edhe në periudhë më të shkurtër varësisht nga kërkesa esenciale për ndryshime në terren;
4. Përgjegjës për revidimin e Planit është Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit/Instituti për Planifikim Hapësinor (në tekstin e mëtejshëm: Ministria);
5. Me dispozitat për zbatim të Planit definohet mënyra e rregullimit të hapësirës dhe e ndërtimit në territorin/sipërfaqen e Parkut;
6. Në pajtim me ligjet në fuqi, kushtet dhe kriteret e ndërtimit dhe shfrytëzimit të parcelave që ndodhen brenda zonës së tretë të Parkut mund të përcaktohen edhe në kuadër të procesit të partneritetit publiko privat për ndërtimin dhe zhvillimin e qendrave turistike në zonën e tretë;
7. Të gjitha planet tjera të niveleve më të ulëta me ndikim në territorin e Parkut, i nënshtrohen Planit Hapësinor për PK "Bjeshkët e Nemuna";
8. Ky dokument hyn në fuqi pasi të jetë miratuar nga Qeveria e Kosovës dhe aprovuar nga Kuvendi i Kosovës.

#### Sipërfaqja dhe kufiri i Parkut

Sipas Ligjit për PK "Bjeshkët e Nemuna" të aprovuar më 13 Dhjetor 2012, sipërfaqja e Parkut prej 62.488Ha ka pësuar ndryshimet e nevojshme për shkak se: matjet që janë bërë në kohën kur është punuar arsyeshmëria për shpalljen e territorit të "Bjeshkëve të Nemuna" Park Kombëtar, kanë qenë rezultat i problemeve teknike që kanë rezultuar me informata të pasakta për kufirin e aprovuar të Parkut. Gjatë procesit të hartimit të Planit Hapësinor për Parkun, nga Agjencia Kadastrale e Kosovës janë siguruar kufijtë zyrtarë të Republikës së Kosovës, sipas të cilëve, sipërfaqja e saktë e Parkut është 63.028Ha, e cila është përdorë si bazë e llogaritjeve në të gjitha fazat e Planit.

Në fazën që po e bëjmë përmbylljen e dokumentit, në proces është duke u realizuar demarkacioni i kufirit në mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Malit të Zi, një pjesë e të cilit përputhet edhe me kufirin e Parkut. Rezultatet e këtij procesi, me një vendim të autoriteteve përkatëse të Qeverisë, do të ndikojnë në definimin përfundimtarë të sipërfaqës dhe vijës kufitare të Parkut. Ndryshimet eventuale të sipërfaqes dhe kufirit, nuk do të kenë ndikim substancial në planin e mbrojtjes dhe zhvillimit hapësinor të Parkut.

#### Prona në Park

Prona nuk është subjekt i trajtimit në dokument, kjo çështje rregullohet me Ligjet përkatëse në fuqi, me të cilat definohen të drejtat dhe përgjegjësitë për pronën, rrespektimi i të cilave do të krijojë kushte për zhvillimin e qëndrueshëm të Parkut.

#### 1.2. DISPOZITAT PËR PËRGJEGJËSITË E MINISTRISË

1. Ministria është përgjegjëse për hartimin, monitorimin dhe zbatimin e Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna";
2. Ministria përcakton autoritetin përgjegjës për administrimin e parkut, e përcakton përbërjen dhe buxhetin e nevojshëm për funksionimin e autoritetit;
3. Ministria është përgjegjëse për ndarjen e fondeve për ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme për funksionimin e Drejtorisë së Parkut;
4. Ministria është përgjegjëse për nxjerrjen e rregullores për rendin e brendshëm të funksionimit për Parkun Kombëtar;
5. Ministria është përgjegjëse për dhënien e lejeve të ndërtimit në të gjithë territorin e Parkut, përpos objekteve familjare kur ato ndërtohen në zonën e III-të A (vendbanim/fshat);
6. Ministria është përgjegjëse për aprovimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme ose zgjidhjes urbane të propozuar nga investitori kur ato hartohen brenda zonës së III-të (B dhe C);
7. Ministria është përgjegjëse për dhënien e pëlqimit për Planet Rregulluese të Hollësishme ose zgjidhjet urbane të propozuar nga investitori kur ato hartohen brenda zonës së III-të (A), para se të njëjtat të aprovohen nga autoritetet përkatëse komunale;

#### 1.3. DISPOZITAT PËR PËRGJEGJËSITË E AUTORITETEVE KOMUNALE

1. Autoritetet komunale që përfshihen në territorin e Parkut (Peja, Deçani, Juniku, Istogu dhe Gjakova), përpos përgjegjëseve të parapara në bazën ligjore në fuqi, janë përgjegjëse edhe për:
  - a. Pjesëmarrje aktive në mbrojtjen dhe promovimin e vlerave të Parkut;
  - b. Respektimin e rregullave të parapara dhe të nxjerra nga autoritetet qendrore, duke e përfshirë edhe rregullat e nxjerra nga Drejtoria e Parkut;
  - c. Lëshimin e lejeve të ndërtimit në zonën e III-të (A,P) të zhvillimit (vendbanimet/fshatrat) në përputhje me kompetencat, rregullat dhe dispozitat për zbatim në fuqi;
  - d. Aprovimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme dhe zgjidhjeve urbane të propozuara nga investitori, pasi paraprakisht të paisein me pëlqim nga Ministria;

#### 1.4. DISPOZITAT PËR PËRGJEGJËSITË E AUTORITETIT PËRGJEGJËS PËR ADMINISTRIMIN E PARKUT

1. Autoritet përgjegjës për administrimin e parkut është Drejtoria e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" (në vazhdim: Drejtoria e Parkut);
2. Përpos përgjegjëseve që dalin nga baza ligjore në fuqi, Drejtoria e Parkut është përgjegjëse edhe për:
  - a. Zbatimin e Planit Hapësinor të Parkut duke përfshirë masat për mbrojtjen e resurseve natyrore dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të parkut;
  - b. Përkujdesje ndaj mbrojtjes dhe mirëmbajtjes së parkut duke e plotësuar rregullisht dokumentin (kronikën) e parkut, e cila përmban kryesisht të dhëna mbi faktorët natyrorë, llojin dhe vëllimin e punimeve në park, gjendjen dhe ndryshimet në florë dhe faunë, qarkullimin pikniko – turistik, si dhe organizimin dhe drejtimin e faktorëve tjerë domethënës për parkun;
  - c. Nxitjen dhe krijimin e përmbajtjeve natyrore-shkencore, koleksioneve etnografike, kopshtit botanik, nxitë hulumtimit shkencore dhe udhëheq punën edukative-arsimore me të rinjtë gjatë ekskursioneve të prirë nga ekspertë profesional;
  - d. Nxitjen e revitalizimit të vendbanimeve rurale dhe ndihmon përfshirjen e banorëve autokton në ngritjen e ofertës turistike të parkut, në pajtim me orientimet e këtij plani;
  - e. Përgatitjen e ofertës turistike për zonën në të cilën specifikohen: kushtet për vizitat, vizitat e kontrolluara, orientimi për lëvizjen nëpër shtigjet e këmbësorëve, informatat për vlerat e parkut dhe për ruajtjen e tyre;
  - f. Ngritjen dhe zhvillimin e sistemit të plotë informativ për tërë zonën, të dizajnuar në mënyrë të veçantë në përputhje me kërkesat dhe specifikat;
  - g. Inicimin dhe hartimin e planit për menaxhimin e Parkut, në përputhje me rregullat dhe ligjet në fuqi;
  - h. Përcaktimin e Simbolit (shenjës/logos) mbrojtës të Parkut, i cili duhet të prezantojë elementet karakteristike të Parkut dhe përmbajtjet kryesore të tij, duke përfshirë edhe elementet shumë të njohura tradicionale që e bëjnë këtë zonë shumë të veçantë.




### 1.5. DISPOZITAT DHE KUSHTET PËR PËRCAKTIMIN DHE PËRKUFIZIMIN E HAPËSIRAVE/OBJEKTEVE PUBLIKE.

1. Caktimi i hapësirave/objekteve publike duhet të jetë në harmoni me kushtet e mbrojtjes së mjedisit, ngritjes së kualitetit të jetesës, mos rrezikimit të shëndetit të popullatës dhe shfrytëzimit racional të territorit dhe të resurseve natyrore;
2. Në kuadër të këtyre sipërfaqeve bëjnë pjesë: objektet shkollore, objektet shëndetësore (të cilat kryesisht duhet të caktohen në zonën e tretë sipas regjimit të mbrojtjes në Park), rrugët e niveleve të ndryshme, shtigje për ecje, çiklizëm apo kalërim, shtigje për skijim, ski-lifta dhe teleferikë, shtyllat për transmisionin e valëve të telefonisë mobile, parkingjet e përbashkëta dhe hapësirat tjera që janë në shërbim të përgjithshëm, të cilat mund të planifikohen edhe në zonën e dytë;
3. Objektet e arsimit fillor duhet të vendosen brenda sipërfaqeve të destinuara për banim ose në afërsi të tyre, në përputhje me normat dhe standardet në fuqi. Hapësirat ku janë të vendosura këto objekte duhet të kufizohen me breza mbrojtës dhe të jenë të arritshme nga transporti publik; Ngastrat e dedikuara për këto objekte duhet t'i plotësojnë kriteret e mëposhtme:
  - a. Institucionet parashkollore 20 - 40 m<sup>2</sup>/fëmijë;
  - b. Shkollat fillore 20 - 50 m<sup>2</sup>/fëmijë.
4. Në kuadër të oborrit shkollor duhet të sigurohet hapësirë e lirë e mjaftueshme, në përputhje me normat dhe standardet në fuqi;
5. Sipërfaqet që destinohen për veprimtari tregtare – furnizim të popullatës me mallra të konsumit të përditshëm, duhet të jenë brenda hapësirave të destinuara për banim ose fare pranë tyre;
6. Përparësi në përcaktimin e lokacionit për hapësirat/objektet publike kanë zonat ku ekziston infrastruktura e domosdoshme teknike si: qasja e lehtë përmes rrugës, energjia elektrike, ujësjellësi dhe kanalizimi dhe shërbimet tjera;
7. Ndërtimi në sipërfaqet publike dhe në ato me destinime tjera duhet të bëhet sipas parametrave urbanistik, arkitektonik dhe teknik që caktohen me këtë plan hapësinor, me planet rregulluese të hollësishme dhe në bazë të zgjidhjeve urbanistike/arkitektonike të ofruara nga investitorët.

### 1.6. NDARJA E ZONAVE

1. Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” është ndarë në tri zona të shfrytëzimit, në ndarjen e të cilave përpos kriterëve në fuqi të mbrojtjes së mjedisit është shfrytëzuar maksimalisht edhe kriteri i pronës:
  - **Zona e parë** – përfshinë pjesët e territorit të Parkut Kombëtar me veçori natyrore të jashtëzakonshme, me lloje të rralla, të rrezikuara të bimëve dhe shtazëve dhe tipave të vendbanimeve në kushte të natyrës së egër. Kjo zonë gëzon karakterin e mbrojtjes strikte. Zona ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 8.425 Ha ose 13.3% të sipërfaqes së përgjithshme të Parkut. Përgjegjëse për monitorimin e kësaj zone është MEA me institucionet e veta përkatëse; Në përfundim të procesit për hartimin e Planit Hapësinor për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, në lokacionin në mes fshatrave Pepaj dhe Dugajevë në vendin e quajtur “Gropat e

thella” nga monitorimi i vazhdueshëm më anë të kamerave kurthe është konstatuar për herë të parë prezenca e Rrëqebullit Ballkanik (*Lynx lynx*). Pasi që Rrëqebulli është lloj i eger vendor strikt i mbrojtur dhe gjithashtu renditet në Listën e Kuqe të llojeve të rrezikuara të Evropës, rekomandojmë që kjo zonë në të ardhmen të shpallet zone strikte e mbrojtur.



Harta – Zona që është propozuar për zonë strikte të mbrojtur

- **Zona e dytë** – ose zona e menaxhimi aktiv – përfshinë pjesët e territorit të Parkut Kombëtar që karakterizohen me ekosisteme, vlera peizazhore dhe vlera tjera të natyrës ku mund të ushtrohen eko-turizmi, bujqësia tradicionale dhe veprimtari tjera duke e përfshirë: blegtorinë me infrastrukturën e saj; shfrytëzimin e kullosave, si dhe shfrytëzimin e burimeve ujore për furnizim me ujë të pijes, të cilat nuk janë në kundërshtim me normat dhe standardet për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara me ligjet në fuqi. Në këtë zonë me kushte specifike të ndërtimit mund të ndërtohen edhe shtyllat e teleferikëve, shtyllat për shpërndarjen e energjisë elektrike dhe antenat për transmetimin e valëve të telefonisë mobile, duke respektuar maksimalisht rregullat për mbrojtjen e mjedisit. Në zonën e dytë mund të planifikohet dhe të ndërtohet infrastrukturë shtesë teknike, duke përfshirë edhe rrugët e nivelit lokal, që do të shfrytëzohen për shërbime më të mirë të banorëve/vizitorëve dhe ngritjen e kualitetit jetësor në përgjithësi. Zona ka një sipërfaqe prej 40.962 Ha ose 65.0% të sipërfaqes së përgjithshme të Parkut. Përgjegjëse për monitorimin dhe zhvillimin e kësaj zone është MEA me institucionet e veta përkatëse;
- **Zona e tretë (A, B, C dhe P)** – ose zona e shfrytëzimit të qëndrueshëm, përfshinë pjesët e territorit të Parkut Kombëtar ku

mund të bëhet: ndërtim, rindërtim, mbrojtja e objekteve tradicionale dhe rekreacioni, turizmi, shfrytëzimi i kullosave dhe shfrytëzim ekonomik i të mirave të natyrës, duke përfshirë edhe infrastrukturën e tyre elementare (punëtori për përpunimin e drurit; për grumbullimin dhe përpunimin e frutave/bimëve të imëta; për prodhimin e ujit të pijes; për grumbullimin dhe prodhimin e produkteve të qumështit) e cila duhet të jetë në harmoni me normat dhe standardet mjedisore në fuqi. Zona e tretë ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 12.891 Ha ose 20.5% të sipërfaqes së përgjithshme të Parkut. Përgjegjëse për monitorimin e kësaj zone është MEA me institucionet e veta përkatëse dhe përkatësisht autoritetet komunale;

- **Zona e tretë A** – është zona e vendbanimeve me sipërfaqe prej 3.641 Ha ose 5.8% të sipërfaqes së përgjithshme të Parkut. Në këtë zonë është përfshirë e gjithë prona private e banorëve autokton e identifikuar deri në momentin e përfundimit të Planit. Pjesë e kësaj zone duhet të bëhen edhe parcelat që dëshmohen si pronë private, edhe pas aprovimit të dokumentit. Pjesë e këtyre zonave do të bëhen gjithashtu edhe pronat publike, të cilat me procedurë formale shndërrohen në prona komunale. Autoritetet komunale janë përgjegjëse për lëshimin e lejeve të ndërtimit, sipas dispozitave/kushteve të ndërtimit të përcaktuara në këtë Plan. Në rast se dispozitat/kushtet e ndërtimit nuk janë të mjaftueshme, Ministria me përkrahjen e komunave mund të fillojnë iniciativën e hartimit të Planit Rregullues të Hollësishëm ose kushtet shtesë mund të plotësohen edhe në bazë të zgjidhjes urbane që propozohet nga investitori. Në të dy rastet, PRrH dhe zgjidhja urbane e ofruar nga investitori duhet të pisen me pëlqim nga Ministria, para se të bëhet aprovimi i tyre përfundimtar nga komunat përkatëse;
- **Zona e tretë B** – është zona me sipërfaqe prej 2.499 Ha ose 4.0% të sipërfaqes së përgjithshme të Parkut, në të cilën zhvillimet janë të kufizuara dhe ndërlidhen vetëm me bujqësinë përkatësisht blegtorinë. Kjo zonë i dedikohet staneve dhe të gjitha ndërtimet që janë në favor të zhvillimit të bujqësisë përkatësisht blegtorisë dhe zhvillimit të turizmit rural. Janë zona të cilat kryesisht shtrihen në pronësi publike, të cilat tradicionalisht janë shfrytëzuar për qëllime bujqësore/blegtorale. Një traditë e tillë do të vazhdohet edhe më tutje, objektet ekzistuese do të vazhdojnë të shfrytëzohen për të njëjtat qëllime, ndërsa sipas nevojës, bazuar në kërkesat, argumentet e qarta dhe dokumentacionin e duhur teknik, mund të lejohet edhe ndërtimi i objekteve të reja. Përgjegjës për monitorimin dhe zhvillimin e këtyre zonave do të jetë Ministria me institucionet e veta përkatëse;
- **Zona e tretë C** – është zona e zhvillimit me sipërfaqe prej 2.083 Ha ose 3.3% të sipërfaqes së përgjithshme të Parkut, e cila kryesisht shtrihet jashtë vendbanimeve, në të cilat zhvillimi duhet të bëhet në bazë të Planeve Rregulluese të Hollësishme ose zgjidhjeve urbanistike të propozuara nga investitorët e



mundshëm. Përgjegjës për aprovimin e PRRH-së dhe zgjidhjeve urbanistike duke përfshirë edhe lejet e ndërtimit është Ministria;

- **Zona e tretë P** – zonë pyjore me sip. 4.668 Ha ose 7.4% të sipërfaqes së përgjithshme të Parkut, është zonë e zhvillimit të kontrolluar, në të cilën kushtet e ndërtimit dallojnë nga zonat tjera (A, B, C). Ndërtimi apo zhvillimi mund të realizohet vetëm në parcela për të cilat dëshmohet se ndërhyrja e planifikuar nuk do të ketë ndikim negativ në vegjetacion. Zhvillimi apo ndërtimi mund të ndodhë nëse dëshmohet se në kuadër të zonës pyjore ka hapësirë të mjaftueshme për ndërtimin apo zhvillimin e planifikuar. Për të gjitha ndërtimet apo zhvillimet e planifikuar në këtë zonë, përpara se të merret leja e ndërtimit nga komuna përkatëse, duhet të sigurohen të gjitha pëlqimet e nevojshme nga Ministria (kushtet ndërtimore, pëlqimi ujqor, pëlqimi mjedisor, etj.) Në këtë zonë është përfshirë e gjithë prona private e identifikuar deri në momentin e përfundimit të Planit. Pjesë e kësaj zone duhet të bëhen edhe parcelat që dëshmojnë si pronë private, edhe pas aprovimit të dokumentit;

- **Zonat e Vecanta të Mbrojtura** – Zona të trashëgimisë kulturore të cilat në kuadër të Parkut mbulojnë sip. prej 750 Ha ose 1.2% të sipërfaqes së përgjithshme të Parkut, janë zona të përcaktuara me Ligjin për Zonat e Vecanta të Mbrojtura. Në kuadër të ZVM "Manastiri i Decanit" i cili mbulon sip. prej 639 Ha, 58 Ha janë Z3P dhe 8.8 Ha janë Z3A. Ndërsa në ZVM "Patrikana e Pejes e cila mbulon sip. prej 111 Ha, 13 Ha janë Z3P dhe 0.7 Ha Z3C. Zhvillimet e parapara në kuadër të këtyre zonave duhet të jenë në përputhje me kërkesat që dalin nga Ligji për ZVM-të.

- Në të gjitha rastet (A, B, C dhe P), përcaktimi final i kufirit dhe sipërfaqes së zonës, për të cilën duhet të bëhet PRRH ose të ofrohet zgjidhja urbane nga investitori, bëhet pas matjeve detaje gjeodezike dhe gjeomekanike të terrenit.
2. Ndryshimi i kategorisë së zonave është i mundshëm në rastet kur kërkohet zbatimi i ndonjë projekti me interes të veçantë për Qeverinë e Kosovës. Vendimi për ndryshimin e kategorisë së zonave dhe sipërfaqen e nevojshme për zhvillimin e projektit propozohet nga Qeveria dhe aprovohet nga Kuvendi i Kosovës, përkatësisht autoriteti përgjegjës i emëruar nga Kuvendi. Ndryshimi eventual automatikisht duhet të bëhet pjesë e hartës së zonimit në dokument;

#### 1.7. PROCEDURA PËR MARRJEN E LEJES SË NDËRTIMIT

1. Plani Hapësinor për Zonën e Veçantë i aprovuar në Kuvendin e Kosovës, me shkresë përcjellëse i dorëzohet të gjitha komunave pjesëmarrëse, territori i të cilave është pjesë e kësaj zone. Të dhënat e dokumentit duke i përfshirë edhe hartat përkatëse do të shfrytëzohen nga autoritetet komunale për përcaktimin e kushteve dhe dhënien e lejeve përkatëse të ndërtimit;
2. Hapi i parë është shqyrtimi i kërkesës për ndërtim e cila bëhet sipas kompetencave:

- **Ministria** për të gjitha objektet që ndërtohen në Zonën e III-të (B, C) jashtë vendbanimeve/fshatrave; dhe
  - **Komuna** për objektet që ndërtohen në vendbanime/fshatra në zonën e III-të (A, P), të përcaktuar me hartën e zonimit në këtë Plan Hapësinor.
3. Autoritetet përgjegjëse si në nivelin qendror dhe atë lokal duhet të dallojnë nëse kërkesa është nën kompetencën e tyre, në mënyrë që e njëjta të drejtohet në adresën adekuate, nga Komuna në Ministri ose anasjelltas nga Ministria në Komunën përkatëse;
  4. Nëse kushtet ndërtimore të përcaktuara me këtë Plan Hapësinor në fuqi janë të mjaftueshme, ka informata të qarta për të realizuar projekt idenë, nga aplikuesi kërkohet të verifikohet nëse për projekt idenë duhet të hartohet raporti për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM);
  5. Nëse PO, investitori obligohet të hartojë raportin e kërkuar dhe për të njëjtin të kërkojë pëlqim/aprovim nga Ministria;
  6. Nëse JO, vazhdohet me hapat më tutje;
  7. Në ndërkohë investitori duhet të aplikojë dhe të pajiset me të gjitha lejet dhe pëlqimet tjera të nevojshme për projektin, të cilat janë parakusht përfundimtar për tu pajisur me Lejen e Ndërtimit brenda Parkut nga:
    - **Ministria** – Për objektet e kategorisë së III-të dhe për objektet e kategorisë I-rë dhe të II-të në Zonën e III-të (B, C) jashtë vendbanimeve/fshatrave; dhe
    - **Komuna** – Për objektet e kategorisë I-rë dhe të II-të në Zonën e III-të (A, P) të vendbanimeve/fshatrave.
  8. Në rastet kur për një zonë përkatëse kushtet e përcaktuara me këtë Plan Hapësinor në fuqi nuk janë të mjaftueshme, e poashtu për atë zonë nuk ka Plan Rregullues të Hollësishëm, investitori i propozon kushtet ndërtimore për parcelën e vet, duke e përfshirë edhe zonën me diametër prej 50m' nga kufijtë e parcelës;
  9. Sipas nevojës, kushtet ndërtimore duhet të kërkohen edhe nga sektorët tjerë relevant (infrastruktura rrugore, energjia, uji, bujqësia, pylltaria, trashëgimia kulturore dhe natyrore, etj.);
  10. Bazë për fillimin e hartimit të PRRH ose zgjidhjes së propozuar nga investitori, duhet të jenë Dispozitat për Zbatim të këtij Plani;
  11. Planet Rregulluese të Hollësishme ose zgjidhjet e propozuara nga investitori përgatiten për zonat e kategorisë së III-të, të përcaktuara me këtë Plan Hapësinor të Parkut;
  12. Plani Rregullues i Hollësishëm ose zgjidhja e propozuar nga investitori për zonat jashtë vendbanimeve/fshatrave aprovohen në Ministri;
  13. Plani Rregullues i Hollësishëm ose zgjidhja e propozuar nga investitori për zonat e vendbanimeve/fshatrave aprovohen në kuvendin komunal të komunës përkatëse;
  14. Para aprovimit, Plani Rregullues i Hollësishëm ose zgjidhja e propozuar nga investitori për zonat e vendbanimeve/fshatrave duhet të merr pëlqimin nga Ministria;
  15. Pëlqimi për PRRH merret, pasi Ministria të bëjë verifikimin nëse PRRH ose zgjidhja e propozuar nga investitori është në harmoni me synimet, objektivat dhe dispozitat për zbatim të këtij Plani Hapësinor për Parkun;

16. Pas aprovimit të kushteve ndërtimore dhe marrjes së të gjitha lejeve dhe pëlqimeve tjera të nevojshme, mund të lëshohet leja e ndërtimit brenda Parkut Kombëtar nga:
  - Ministria – Për objektet e kategorisë së III-të dhe për objektet e kategorisë I-rë dhe të II-të në Zonën e III-të (B, C) jashtë vendbanimeve/fshatrave;
  - Komuna – Për objektet e kategorisë I-rë dhe të II-të në Zonën e III-të (A, P) të vendbanimeve/fshatrave.

#### 1.8. PROCEDURAT PËR MARRJEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS PUBLIKE

Me rregulloren për funksionimin e brendshëm të Parkut Kombëtarë, do të përcaktohen procedurat për shfrytëzim të pronës publike për personat fizik dhe juridik. Rregullorja në fjalë në mes tjerash do të përmbajë: aktivitetin që do të ushtrojnë personat fizik dhe juridik në pronën e paluajtshme publike; Përshkrimin e pronës se paluajtshme të dhënë në shfrytëzim; Periudhën kohore dhe lokacionin e pronës së dhënë në shfrytëzim; Ndërprerjen e mundshme të parakohshme të marrëveshjes për shfrytëzim; Obligimet e palëve të pronës së paluajtshme pas afatit të shfrytëzimit; etj.;

#### 1.9. DISPOZITAT DHE KUSHTET E NDËRTIMIT

1. Për zonat ku lejohet ndërtimi (Zona e III-të) Plani Hapësinor në fuqi i përcakton kushtet ndërtimore specifike, të cilat janë obliguese për autoritetet përgjegjëse me rastin e aplikimit dhe lëshimit të lejeve të ndërtimit:
  - **Ministria** për zonat e III-ta (B, C) që janë jashtë vendbanimeve / fshatrave; dhe
  - **Komunat** për vendbanimet / fshatrat në zonat e III-ta (A, P).

#### 1.10. NDËRTIMET EKZISTUESE

Ndërtimet ekzistuese në kuadër të Parkut të identifikuar në ortofoto dhe në bazë të raporteve të hartuara nga Drejtoria e Parkut, do të jenë subjekt i ligjeve përkatëse duke përfshirë edhe ligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje.


#### 1.11. KUSHTET SPECIFIKE TË NDËRTIMIT

1. Sipërfaqja e ngastrës apo parcelës së re ndërtimore në Park për objektet familjare nuk mund të jetë më e vogël se 500m<sup>2</sup>, ndërsa për objektet hoteliere sipërfaqja e ngastrës përcaktohet me PRRH ose me kushte të përcaktuara nga investitori;
2. Sipërfaqja e ndërtuar e parcelës mund të jetë deri në 20% nga sipërfaqja e përgjithshme e ngastrës ndërtimore;
3. Fasadat e ndërtesave në park duhet të jenë të punuara nga guri, druri, tullat dhe materiale tjera natyrore;
4. Ndërtimi i rrethojave për përkufizimin e parcelës duhet të bëhet nga materialet natyrore (druri dhe guri) duke mënjanuar hekurin dhe betonin si mundësi;
5. Në rastet e rindërtimit nuk lejohet ndryshimi i gabariteve në kundërshtim me planin rregullues të hollësishëm ose të lejes ekzistuese të ndërtimit;
6. Në park mund të ketë rekonstruktime në kuptim të përmirësimit të kushteve të jetës dhe të punës, sikurse që janë ripërtëritja e amvisërive fshatare, të bujqësisë tradicionale për involvim në turizëm rural;



7. Rekonstruktimi i objekteve individuale dhe të amvisërisë, duhet t'i nënshtrohet procedurave të njëjta sikur ato për ndërtime të reja;
8. Përveç ndërtesave publike, tek të tjerat rekomandohet që kulmet të jenë dyujorësh, me rënie prej 30 - 60 shkallë, me strehë të mbështjellë me dërrasa, shindër apo ndonjë material të ngjashëm nga të gjitha anët;
9. Në varësi të hyrjes në objekt (ekuivalente me kotën zero), lartësia maksimale e objekteve familjare duhet të jetë B+P+NK për terrenet me pjerrësi të vogël (maksimum dy etazhe mbitokësore duke përfshirë edhe nënkulmin), ndërsa për terrenet me pjerrësi të madhe lartësia maksimale duhet të jetë B+S+P+NK si në skicën e mëposhtme.

**Objektet familjare**



**Objektet hoteliere**



**Skica – Rregullat për etazhitetin e objekteve**

Kurse, lartësia maksimale e objekteve hoteliere duhet të jetë: për terrenet me pjerrësi të vogël B+P+2+NK, ndërsa për terrenet me pjerrësi të madhe B+S+P+1+NK dhe B+S+P+3+NK në rastet kur objekti është i vendosur në mënyrë terrasore si në skicën e mëposhtme (maksimum pesë etazhe mbitokësore duke përfshirë edhe nënkulmin). Në të gjitha rastet lartësia e bodrumit do të varet nga pjerrësia e terrenit. Sa më e madhe pjerrësia aq më e lartë do të jetë lartësia e bodrumit, por jo më shumë se dy etazhe, njëra nga të cilat mund të shfrytëzohet si suterren (S)<sup>19</sup>;

10. Vendorsja e objekteve të bëhet në distancë jo më të vogël se 3,5m' nga vija kufizuese e parcelës ndërtimore. Në rastet kur kjo dispozitë nuk është e mundur duhet të aplikohen kushtet e përcaktuara me plan paraprak;
11. Në rast të rekonstruktimit të objekteve ekzistuese të banimit është i mundur ndërrimi i destinimit në funksion të parkut kombëtar dhe/ose për nevoja të turizmit rural. Objektet ekzistuese mund të rekonstruktohen dhe zëvendësohen në pajtim me normat e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, të cilat nënkuptojnë përdorimin e materialeve dhe formësimit të hapësirave në mënyrë tradicionale autoktone duke ruajtur tiparet burimore;
12. Me rekonstruktimit të objekteve të lartpërmendura, sipas dispozitave nënkuptohet: rindërtim i objektit të banimit, rindërtimi i objektit të stallës, rindërtimi i pjesës konstruktive të vjetër të objektit, adaptimi dhe rindërtimi i hapësirave sanitare, ndërtimi i gropës septike të padepërtueshme, riorganizimi funksional i brendshëm i objektit të banimit dhe riorganizimi funksional i pjesëve ndihmëse të objektit të banimit;
13. Të gjitha objektet publike mund të rekonstruktohen në gabaritin dhe formën arkitektonike ekzistuese, bazuar në projektin e aprovuar. Rekonstruktimi duhet t'i nënshtrohet procedurave të njëjta sikur ato për ndërtime të reja;
14. Kushtet e tjera të nevojshme mund të caktohen në bazë të PRRH ose të propozohen nga investitorët, të aprovuar nga komuna përkatëse, pas marrjes së pëlqimit nga MEA.

**1.12. JO – KONFORMITETET**

Jo-konformiteti është një shfrytëzim, një ndërtim, ose parcelë kadastrale që ka ekzistuar para miratimit të Planit Hapësinor për Parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna dhe nuk është në përputhje me shfrytëzimet dhe kushtet zhvillimore të vendosura në këtë plan. Jo-konformitetet në Parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna do të trajtohen si më poshtë:

**1. Zona I-rë:**

- 1.1. Shfrytëzimet jo-konforme nuk janë të lejuara në Zonën e I-rë dhe duhet të ndalohen menjëherë;
- 1.2. Ndërtimet jo-konforme nuk janë të lejuara në Zonën e I-rë dhe do të mënjanohen;
- 1.3. Ndërtimet eventuale në Zonën e I-rë do të trajtohen me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës.

**2. Zona e II-të:**

- 2.1. Shfrytëzimet jo-konforme nuk janë të lejuara në Zonën e II-të dhe duhet të ndalohen menjëherë;

- 2.2. Ndërtimet jo-konforme mund të qëndrojnë në Zonën e II-të nëse ndërtimi përputhet me ligjet tjera të aplikueshme dhe udhëzimet administrative në fuqi. Ndërtimet jo-konforme në Zonën e II-të nuk do të lejohen të zgjerohen, ndryshohen ose rindërtohen përpos në rastet kur arsye për këto ndryshime është forca madhore.

**3. Zona e III-të:**

- 3.1. Shfrytëzimi jo-konform mund të vazhdojë në Zonën e III-të nëse një shfrytëzim i tillë është në përputhje me ligjet dhe aktet tjera në fuqi duke përfshirë edhe kushtet e parapara në lejet e mëhershme të ndërtimit. Lejet mund të mos ripërtërihen për shfrytëzimet jo-konforme. Ndryshimet eventuale në shfrytëzim duhet të përputhen me kërkesat e Planit Hapësinor në fuqi;
- 3.2. Ndërtimet jo-konforme mund të qëndrojnë në Zonën e III-të nëse ndërtimet përputhen me ligjet dhe aktet tjera në fuqi. Kushtet e zhvillimit të parapara në planin hapësinor do të respektohen vetëm në rastet kur për ndërtimet jo-konforme kërkohet zgjerim përmbajtësor, kërkohet ndryshim ose rindërtim për të gjitha rastet përveç arsyeve të krijuara nga forca madhore;

**1.13. QENDRA TURISTIKE/REKREATIVE**

Organizimi i hapësirës dhe ndërtimi i Qendrave Turistike/Rekreative duhet të bëhet duke siguruar kushtet për realizimin e parimeve themelore të zhvillimit të qëndrueshëm të zonës. Kjo nënkupton planifikimin dhe përdorimin e kufizuar të resurseve të përgjithshme të zonës për realizimin e produktit të përshtatshëm dhe atraktiv turistik.

1. Në planifikimin e këtyre zonave, vëmendje e veçantë duhet ti kushtohet pozitës së objekteve e në veçanti objekteve kryesor që e përbëjnë zonën në fjalë. Të gjitha përmbajtjet duhet maksimalisht të përshtaten me natyrën përreth, të ndërtuara me forma bashkëkohore dhe materiale natyrore. Lartësia maksimale e këtyre objekteve duhet të jetë: për terrenet me pjerrësi të vogël B+P+2+NK (katër etazhe mbitokësore), ndërsa për terrenet me pjerrësi të madhe B+S+P+1+NK dhe B+S+P+3+NK në rastet kur objekti është i vendosur në mënyrë terrasore si në skicën e mësipërme (maksimum pesë etazhe mbitokësore duke përfshirë edhe nënkulmin). Forma e jashtme e objekteve duhet të jetë në harmoni maksimale me traditën e ndërtimit në zonën përkatëse, e veçanërisht për objektet përcjellëse si: objektet shërbyese, objektet ndihmëse, strehët e ndryshme kundër shiut dhe diellit, shitoret, objektet e veçanta sanitare, elementet për pushim/ulje dhe përjetim etj. Për të gjitha këto objekte duhet të shfrytëzohen materialet natyrore rrethore si guri druri dhe materiale tjera karakteristike për zonën. Kujdes i veçantë duhet ti kushtohet gjelbërimit, gjatë trajtimit të të cilit nuk duhet të përdoren lloje të florës që nuk janë autoktone me rrethinën.

**1.14. FSHATRAT TURISTIK**

1. Fshatrat turistik janë struktura të organizuara në formë fshati, me objekte hoteliere specifike, të ndërtuara në zona rurale turistike, të

<sup>19</sup> Suterren – është etazhi i cili me më pak se ½ e lartësisë është vendosur nën tokë.



- cilat brenda një perimetri unik të kufizuar ofrojnë shërbime të vendosjes, pushimit, rekreacionit dhe shërbime tjera;
2. Planifikimi i lokacionit për zhvillimin e fshatrave turistike bëhet në kuadër të zonave të treta të zhvillimit, me Plan Rregullues të Hollësishëm ose me zgjidhje urbanistike të propozuar nga investitori;
  3. Dizajni i komplekseve turistike – hotele apo fshatra turistike, duhet t'i përshtatet peizazhit natyror rrethues;
  4. Fshatrat turistike mund të jenë: fshatra me vila dhe fshatra me bungallou.
    - Fshatrat me vila janë njësi hoteliere për akomodim me arkitekturë të veçantë, në përshtatje me vendndodhjen, jo më shumë se 2 kate (P+NK), të përbëra prej apartamentesh, me hyrje të pavarura, të ndara ose brenda së njëjtës njësi.
    - Fshatrat me bungallou janë njësi hoteliere për vendosje-akomodim të përshtatshëm dhe të ndërtuara nga druri ose materiale të tjera karakteristike të zonës.
  5. Përcaktimi i kategorisë së Fshatit Turistik bëhet në bazë të normave dhe standardeve në fuqi, sipas të cilave Fshatrat Turistik ndahen në fshatra me: "1 yll", "2 yje", "3 yje", dhe "4 yje"; dhe varësisht nga kategoria përcaktohen edhe përmbajtjet tjera:
    - Fshati me "1 yll" me bungallou duhet t'i ketë minimum 7 njësi me sip. min. për dy persona 28m<sup>2</sup>, min. 3m<sup>2</sup> shtesë për një person, jo më shumë se katër persona;
    - Fshati me "1 yll" me vila duhet ta ketë kapacitetin min. 7 apartamente me sip. min. për dy persona 35m<sup>2</sup>, min. 8m<sup>2</sup> shtesë për person, por jo më shumë se katër persona;
    - Fshati me "2 yje" duhet t'i plotësojë të gjitha kriteret e fshatrave turistike me "1 yll", plus:
      - Me bungallou duhet ta ketë sipërfaqen minimale 32 m<sup>2</sup>;
      - Me vila duhet ta ketë sipërfaqen minimale 40 m<sup>2</sup>.
    - Fshati me "3 yje", përveç kërkesave të fshatit turistike me "2 yje", duhet t'i plotësojë:
      - Me bungallou – sip. min. 35 m<sup>2</sup>;
      - Me vila – sip. Min. 45 m<sup>2</sup>.
    - Fshati me "4 yje" përveç kërkesave të fshatit turistike me "3 yje", duhet të ketë:
      - Parking të mjaftueshëm në hyrje të fshatit;
      - Sipërfaqe të lirë min. 40% të sipërfaqes totale, etj.

#### 1.15. VEND KAMPINGJET

1. Lokacioni i vend-kampingut duhet të planifikohet në kuadër të zonave të treta të zhvillimit;
2. Madhësia, forma dhe lokacioni caktohet me Plan Rregullues të Hollësishëm ose me zgjidhje urbanistike të propozuar nga investitori;
3. Kampet janë bashkësi funksionale të rregulluara, të cilat ofrojnë kushte për vendosje të mysafirëve në hapësirat e jashtme me auto-shtëpiza dhe tenda, duke plotësuar nevojat elementare dhe shërbimet tjera për pushim dhe rekreim;
4. Vend-kampingu është hapësirë në të cilën parcelat mund të dimensionohen si të veçanta dhe të grupuara;
5. Çdo parcelë duhet të ketë qasje direkte në rrjetin e furnizimit me energji elektrike, ujësjellësit dhe kanalizimit;

6. Hapësira e nevojshme për organizimin e kampingut mund të përfshijë 10% të sipërfaqes së planifikuar për zhvillim;
7. Për një njësi parcele në kamp duhet të sigurohen minimum 60m<sup>2</sup>;
8. Shërbime tjera përcjellëse: ndriçimi i vendit të kampit, sanitaret e përbashkëta me gardëroba, gropa septike për ujërat e zeza, hapësirat higjienike, depo ushqimore, depo për rekuizita tavolina, karrige, shtretër mobilë dhe rekuizita sportive; hapësirat rekreative (fushë tenisi, futboll, volejball, basketboll, ping-pong, etj.);
9. Hapësirat (ndërtesat) përcjellëse të kampit duhet të jenë njëkatëshe dhe më kulme dy ujore, me lartësi 4,5m' nga pika më e ulët e terrenit (prej kuotës më të ulët deri te maja e kulmit); Është i obligueshëm përdorimi i sistemit montazh nga materialet natyrore (guri, druri etj.) dhe përshtatja me konfiguracion të terrenit, duke i ruajtur vlerat e peizazhit të zonës;
10. Recepcioni duhet të jetë në brendi të kampit ose para hyrjes në kamp, me shërbime përcjellëse për komunikim, marketing. Në kamp mund të parashihen edhe objekte tjera të shërbimeve të ndryshme (tregtare, furnizuese dhe shërbyese restorante, nevoja të tjera të domosdoshme, si: njësi postare, bankomat, etj.);
11. Kampet duhet të kenë rrethoja të sigurt dhe natyrore, të kenë qasje në infrastrukturë të jashtme rrugore dhe hapësirë adekuate të parkingut;
12. Rrugët brenda kampit duhet të mundësojnë qasjen e automjeteve dhe këmbësorëve deri te njësia e vendparkimit. Rruga kryesore i lidhë të gjitha rrugët anësore në drejtim të recepcionit dhe me infrastrukturën jashtë kampit;
13. Kampet duhet të jenë të furnizuara me ujë të pijshëm nga rrjeti publik ose ndonjë burim tjetër i kontrolluar;
14. Largimi i ujërave të zeza nga kampet duhet të sigurohet me sistem të mbyllur, në pajtueshmëri me normat dhe standardet për parqet kombëtare;
15. Kampet duhet të jenë të lidhur në rrjetin publik ose në ndonjë burim tjetër alternativ të energjisë elektrike. Rrugët kryesore si dhe rrugët tjera të cilat çojnë te restoranti, përmbajtjet e objekteve shërbyese dhe sanitare duhet të jenë të ndriçuara;
16. Kampet duhet të jenë të mbuluar nga sinjali i telefonisë mobile GSM dhe Interneti;
17. Kampet duhet të përmbajnë shenjat orientuese për hyrje-dalje nga kampi në raste të rrezikut, ato duhet të kenë dalje ndihmëse. Në kampe duhet të sigurohen mjetet për dhënien e ndihmës së parë.
18. Hapësirat sanitare në kampe duhet të jenë të përbashkëta;
19. Kampet duhet t'i kenë njësitë e veçanta të përbashkëta – hapësirat për larjen e enëve, hapësirat e ftohta për ruajtjen e ushqimit dhe frigoriferët, utiliti i përbashkët (larja, tharja dhe hekurrosja e rrobave) dhe hapësirat për higjienë të kafshëve shtëpiake;
20. Përcaktimi i kategorisë së Kampit bëhet sipas normave dhe standardeve në fuqi, sipas të cilave ekzistojnë kampet me "1 yll", "2 yje" dhe "3 yje", dhe varësisht nga kategoria përcaktohen edhe përmbajtjet tjera.

#### 1.16. OBJEKTET HOTELIERE

1. Lokacioni i objekteve hoteliere duhet të planifikohet në kuadër të zonave të treta të zhvillimit;

2. Ngastra e ndërtimit të objektit hotelier përcaktohet me Plan Rregullues të Hollësishëm ose me zgjidhje urbanistike që mund të propozohet nga investitori;
3. Numri maksimal i njërive tek hotelet duhet të jetë 40 njësi;
4. Lartësia maksimale e objekteve hoteliere duhet të jetë: për terrenet me pjerrësi të vogël B+P+2+NK, ndërsa për terrenet me pjerrësi të madhe B+S+P+1+NK dhe B+S+P+3+NK në rastet kur objekti është i vendosur në mënyrë terrasore si në skicën e mësipërme (maksimum pesë etazhe mbitokësore duke përfshirë edhe nënkulmin).
5. Përcaktimi i kategorisë së objekteve hoteliere bëhet sipas normave dhe standardeve në fuqi të përcaktuara nga MTI/Departamenti i Turizmit;
6. Varësisht nga kategoria përcaktohen edhe përmbajtjet tjera që duhet të jenë në përputhje me normat teknike dhe në harmoni me mbrojtjen e natyrës.
7. Dizajni i hoteleve duhet të jetë në përputhje maksimale me peizazhin natyror rrethues;

#### 1.17. MOTELET

1. Motelet janë të destinuar për t'u shërbyer personave të motorizuar që janë në kalim. Në to ofrohen shërbimet e të ushqyerit, fjetjes dhe rekreimit. Motelet në çdo rast duhet të jenë pranë rrugëve automobilistike e poashtu mund të jenë edhe në afërsi të qendrave turistike, historike, kulturore dhe sportive;
2. Në vartësi të vendndodhjes dhe kapacitetit, motelet mund të kenë edhe përmbajtje tjera si kënde lojërash për fëmijë, fushë për lojra të ndryshme etj;
3. Rekomandohet që të shmanget ndërtimi i dhomave në katin përdhës të motelit;
4. Kapaciteti për vendosje duhet të jetë minimum 7 dhoma;
5. Lartësia e objektit të jetë deri në 10m' ose tri etazhe mbi sipërfaqen e tokës duke përfshirë përdhësen, katin dhe nënkulmin (B+P+1+Nk);
6. Vendparkingjet duhet ta mbulojnë 100% kapacitetin e motelit për vendosje;
7. Sipërfaqja minimale e dhomave në motele, pa përfshirë paradhomën dhe tualetin duhet të jetë: dhomë me një shtrat 9 m<sup>2</sup>; dhe dhomë me shtrat çift 11 m<sup>2</sup>.

#### 1.18. VEND PIKNIKËT

1. Lokacioni për piknik duhet të caktohen në vendet e përshtatshme nga aspekti i sigurisë nga zjarri, në pjesët e relievit të rrafshët pa pjerrtësi të madhe dhe sa më largë zonave strikte të mbrojtjes;
2. Madhësia, forma dhe lokacioni caktohet me Plan Rregullues të Hollësishëm ose me zgjidhje urbanistike të propozuar nga investitori;
3. Rregullat për sjellje dhe shfrytëzimin e vend-piknikut përcaktohen nga Drejtoria e Parkut;
4. Vendpikniqet duhet të kenë sipërfaqe të mjaftueshme nën hije natyrore të krijuara nga drunjtë e lartë. Burimi i ujit është i improvizuar artificial;
5. Varësisht nga madhësia e hapësirës – vendpiknikut, duhet të parashihen punktet e sanitareve të përhershme apo mobile si dhe kontejneri i mbeturinave;





6. Pajisjet në vendpikniqe si ulëset, tavolinat etj. duhet të jenë të punuara nga materialet natyrore, druri, guri, në harmoni me ambientin rrethues;
7. Në largësi optimal nga vendpikniku duhet të jetë parkingu i veturave;
8. Pas çdo intervenimi në rregullimin e vendpiknikut duhet të rregullohet rrethina, mbjellja dhe kultivimi i gjelbërimit, bazuar në peizazhin rrethues;
9. Vendpikniqet duhet t'i kenë tabelat informative lidhur me kushtet për shfrytëzimin e hapësirës, mbrojtjen e botës bimore dhe shtazore etj.;
10. Regjistrimi i shfrytëzuesve të vendpiknikut mund të bëhet në punktin hyrës të parkut ose të parashihet recepcioni improvizues në hapësirën e vendpiknikut, për kontroll dhe pagesa eventuale;
11. Çdo shfrytëzues obligohet për mirëmbajtje maksimale të vendpiknikut dhe për moszbatim të kësaj pason gjobitja për të cilën shfrytëzuesi paraprakisht njoftohet.

### 1.19. STANET

1. Stanet janë objektet më domethënëse të Parkut, dhe si të tilla duhet të trajtohen në mënyrë të veçantë. Ekziston një numër i madh i staneve të cilat kryesisht janë të vendosura në pronë publike, dhe një pjesë e konsiderueshme aktualisht përdoren për rekreacion. Fatmirësisht ka edhe një numër të konsiderueshëm të staneve që përdoren për nevoja të bujqësisë, me theks të veçantë në blegtori. Kjo është edhe arsyeja kryesore që në Plan është paraparë aktivizimi i staneve të vjetra dhe sipas nevojës zhvillimi i staneve të reja me qëllim bazik zhvillimin e blegtorisë. Në këtë drejtim janë përcaktuar kushtet e ndërtimit sipas të cilave:
  - Një objekt stani edhe pse është i ndërtuar në pronë publike mund të ekzistojë edhe më tutje, nëse dëshmohet se objekti shfrytëzohet vetëm për nevoja të bujqësisë përkatësisht blegtorisë;
  - Stanet ekzistuese dhe zonat përreth duhet të ruajnë funksionin primar të tyre, duke përfshirë banimin, strehimin e bagëtisë, përgatitjen dhe ruajtjen e bulmetit;
  - Me rastin e ndërtimit të ri apo rikonstruktimit të staneve ekzistuese, duhet të ofrohen informata dhe argumente të mjaftueshme, të cilat dëshmojnë qëllimin e ndërtimit të stanit. Kushti kryesorë për të gjitha rastet është se, maksimalisht duhet të respektohet mënyra tradicionale e ndërtimit: guri, druri dhe mbulesa prej kashte, rrasa prej gurëve ose ndonjë mbulesë tjetër natyrore; dhe se madhësia e objektit kryesor dhe objekteve tjera përciellëse duhet të jetë në përputhje me kriteret për ushtrimin e veprimtarisë bujqësore/blegtorale. Sipas këtyre kriterëve madhësia e objekteve dhe hapësirës së nevojshme është:
    - Torishta – rrethimi me gardh prej druri dhe guri; sipërfaqja maksimale 5m<sup>2</sup>/kokë bagëtie;
    - Objekti i banimit – sipërfaqja e shfrytëzueshme prej maksimum 60m<sup>2</sup>, me lartësi maksimale B+P+Nk;
    - Objekti përciellës (depo) – sipërfaqja maksimale prej 0.2m<sup>2</sup>/kokë bagëtie, me lartësi maksimale P;
    - Materiali – në përgjithësi material natyror/rrethanor (guri, druri ose derivatet e tyre);

- Kushtet e mësipërme nuk janë të vlefshme për qëllime tjera.

### Sipërfaqja e nevojshme:

#### Për shtalla:

- lopët dhe kuajt – 7.0-9.0 m<sup>2</sup>/kokë bagëtie;
- delet dhe dhitë – 2.0-2.5 m<sup>2</sup>/kokë bagëtie

#### Për kotece:

- pula – 0.3-0.4 m<sup>2</sup>/kokë;
- çura (gjeldeti) – 0.5-0.6 m<sup>2</sup>/kokë

### 1.20. HYRJET NË PARK

1. Në territorin e Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” ekzistojnë shtatë hyrje zyrtare, prej të cilave dy hyrje janë kryesore dhe të tjerat janë hyrje sekondare.
  - Hyrja kryesore 1 – në afërsi të Patrikanës së Pejës, në rrugën Pejë – Kuqishtë; dhe
  - Hyrja kryesore 2 – në afërsi të Manastirit të Deçanit, në rrugën që e lidhë qytetin me brendinë e Parkut;
  - Hyrja sekondare 1 – në grukën e Lumit Lloqan në rrugën në ndërtim që e lidhë zonën urbane të Decanit me brendinë e Parkut;
  - Hyrja sekondare 2 – në rrugën që e lidhë qytetin e Junikut me brendësinë e Parkut;
  - Hyrja sekondare 3 – e vendosur në rrugën që e lidhë qytetin e Istogut me brendinë e Pakut;
  - Hyrja sekondare 4 – e vendosur në rrugën që e lidhë pjesën perëndimore të komunës së Istogut me brendinë e Parkut;
  - Hyrja sekondare 5 – e vendosur në pjesën perëndimore të komunës së Gjakovës, në afërsi të fshatit Batushë.
2. Në hyrjen kryesore 1 duhet të vendoset objekti i Drejtorisë së Parkut me administratën dhe zyrën e informimit, me sipërfaqe deri në 100m<sup>2</sup> dhe etazhitet P+NK me lartësi dysHEME – dysHEME 2.8m;
3. Në hyrjen kryesore 2 dhe në hyrjet sekondare 1,2,3,4,5 duhet të vendosen zyrat e kontrollit dhe informimit me sipërfaqe maksimale prej 9m<sup>2</sup> me lartësi dysHEME – dysHEME 2.6m;
4. Objektet që parashihen në hyrjet e parkut duhet të ndërtohen me materialet natyrore duke përfshirë drurin, gurin dhe materialet tjera natyrore. Rekomandohet që ndërtimi të bëhet në sistemin montazh dhe me kulm dy ujor me pjerrtësi minimale 30%;
5. Pjesë e hyrjeve mund të jenë edhe objektet shërbyese me sipërfaqe maksimale prej 12 m<sup>2</sup> dhe me lartësi (dysHEME – tavan) 2.6m;
6. Në hyrjet e parkut duhet të vendoset simboli i parkut i punuar nga druri dhe i dizajnuar me elemente karakteristike të parkut. Ai poashtu duhet të vendoset, në përmasa më të vogla, pranë rrugëve automobilistike që të çojnë në hyrjet kryesore të parkut, nga dy simbole, njëri 2 km dhe tjetri 4 km larg hyrjes;
7. Në hyrje të Parkut duhet të parashihen parkingje të mjaftueshme për të gjitha llojet e automjeteve. Lokacioni, numri i nevojshëm i vendparkingjeve dhe përmbajtjeve tjera, përcaktohet me Plan Rregullues të Hollësishëm;
8. Hyrjet në Park rekomandohen të jenë të dizajnuara me stilin tradicional.

### 1.21. INFRASTRUKTURA FIZIKE

1. E gjithë infrastruktura fizike ekzistuese dhe e planifikuar duhet të jetë në harmoni me rregullat e mbrojtjes së mjedisit. Varësisht nga niveli i tyre parashihet edhe përgjegjësia e ekzekutimit, e cila në të gjitha rastet mbikëqyret nga Ministria, përkatësisht Drejtoria e Parkut;
2. Trasetë përfundimtare të rrugëve të planifikuara të prezantuar në hartën e infrastrukturës, mund të ndryshohen dhe plotësohen pas analizave detaje dhe marrëveshjeve të palëve të interesit;
3. Shtigjet për këmbësorë duhet të ndërtohen me gurë apo me materialet tjera që i përshtaten dhe janë në harmoni me rrethinën në të cilën ndërtohen;
4. Gjerësia e shtigjeve për këmbësorë në Park varësisht nga terreni, duhet të jetë maksimum 1.5 metra;
5. Elementet për ulje tek pikat e pushimit që ndodhen përgjatë shtigjeve për këmbësorë duhet të ndërtohen nga druri ose materialet tjera të ngjashme natyrore;
6. Në pjesët ku shtegu është i rrezikshëm për lëvizje, duhet të parashihen rrethoja që do të ndikojnë në ngritjen e sigurisë së vizitorëve;
7. Në vendet e duhura, si aty ku fillon territori i Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” dhe përgjatë rrugëve e shtigjeve për këmbësorë, duhet të vendosen tabelat me informatat e nevojshme për vizitorët;
8. Duhet të respektohet brezi mbrojtës rrugor i cili paraqet sipërfaqen në të dy anët e autoudhëve, rrugëve nacionale, regionale dhe lokale, gjerësia e të cilit është e përcaktuar me Ligjin për Rrugët;
9. Gjatë intervenimit (ndërtim i ri apo përmirësim i rrugëve) në rrugët automobilistike, duhet të respektohen rregullat mbi kriteret teknike (gjerësia, pjerrtësia, shtresat dhe trashësia e tyre) për ndërtimin e tyre të përcaktuara me rregullat e nxjerra nga Ministria e Infrastrukturës;
10. Përgjatë rrugëve automobilistike në park duhet të vendosen të gjitha shenjat e nevojshme të komunikacionit;
11. Peshat dhe dimensionet e automjeteve që qarkullojnë nëpër rrugët automobilistike të Parkut duhet të jenë në pajtueshmëri me rregullat dhe normat e përcaktuara me rregullat e veçanta të nxjerra nga Ministria e Infrastrukturës dhe kufizimet që parashihen me rregullat mjedisore;
12. Qarkullimi i automjeteve për transportin e mallrave në rrugët e Parkut duhet të jetë nën monitorimin e pandërprerë të Drejtorisë së Parkut, në mënyrë që të parandalohet transporti ilegal i masës drusore dhe produkteve të tjera të parkut;
13. Transporti publik i udhëtarëve duhet të realizohet nga operatorët e licencuar;
14. Për shkaqe sigurie, automjetet transportuese duhet t'i plotësojnë të gjitha kushtet teknike të përcaktuara me ligjet përkatëse në fuqi të nxjerra nga Ministria e Infrastrukturës;
15. Gjatë ndërtimit të parkingjeve duhet të respektohen rregullat teknike të përcaktuara me kriteret teknike për ndërtimin e tyre, të nxjerra nga Ministria e Infrastrukturës;
16. Numrin e parkingjeve, vendin e tyre në hapësirë dhe standardet për parkingje i përcakton plani rregullues i hollësishëm për zonën e



caktuar ose zgjidhja urbanistike e propozuar nga investitori. Në vazhdim janë dhënë disa standarde për numrin e nevojshëm të parkingjeve:

- a. Shërbime – 1 vend parkim (VP) për 3 të punësuar;
  - b. Restorante – 1 VP për 1 tavolinë;
  - c. Hotele – 1 VP për 1 dhomë;
  - d. Zyre – 1 VP në 75m<sup>2</sup> btto zone;
  - e. Dyqane – 1 VP në 50m<sup>2</sup> btto zone.
17. Gjatë projektimit, ndërtimit dhe vënies në shfrytëzim të teleferikëve, duhet që respektivisht të zbatohen dhe të plotësohen në tërësi rregullat teknike dhe kërkesat që gjenden në udhëzimin administrativ të nxjerrë nga MTI;
  18. Ndërmarrjet ndërtimore të angazhuara në kuadër të Parkut duhet të jenë të paisura me licenca përkatëse;
  19. Ndërmarrjet e energjisë që do t'i kryejnë punët e distribuimit dhe të furnizimit të qytetarëve me energji elektrike duhet të jenë të pajisura me licencë nga ZRRE;
  20. Punët në ndërtimin apo zgjerimin e rrjetit të distribuimit të energjisë elektrike, ngrohjes ose gazit natyror duhet të kryhen në përputhshmëri të plotë me kodet teknik që i përpilojnë ndërmarrjet e energjisë dhe të cilët i miraton ZRRE;
  21. Për ndërtimin e sistemeve publik të ujësjellësve dhe kanalizimeve të ujërave të zeza, duhet të merret leja nga institucionet përkatëse në MEA;
  22. Sipas Nevojes lejohet ndërtimi i impiantit për pastrimin e ujërave të zeza dhe të kolektorëve përkatës, për të cilat duhet të merret leja nga institucionet përkatëse në MEA;
  23. Ekipe profesionale që do t'i realizojnë studimet dhe hulumtimet të cilat janë paraparë me këtë plan tek kapitulli i strategjisë, pjesa për infrastrukturën teknike, duhet t'i plotësojnë kushtet:
    - o Të kenë përgatitjet adekuate profesionale (shkollimi adekuat);
    - o Të kenë përvojë nga e kaluara në studime të natyrës së njëjtë.
  24. Në mënyrë që të mund të ushtrojë veprimtarinë e vet në park dhe në vendbanimet rreth tij, ofruesi i shërbimeve të telefonisë fikse, asaj mobile, Internetit dhe televizionit kabllor, kompania publike apo private duhet të jetë e pajisur me licencë nga Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit (ART);
  25. Përveç licencës që merret nga ART, për vendosjen e antenave në terren, operatori i telefonisë mobile duhet të marrë edhe pëlqimin mjedisor nga MEA;
  26. Është rreptësisht e ndaluar vendosja e antenave dhe pajisjeve përcjellëse në zonën e parë (rezervatet strikt të natyrës);
  27. Të drejtën për administrimin me mbeturinat në park dhe në vendbanimet rreth tij e kanë vetëm operatorët për administrimin e mbeturinave që janë të pajisur me licencë nga MEA.
  28. Në pika të caktuara të infrastrukturës rrugore duhet të ndërtohen mbikalime (ura), të cilat do të mundësojnë dhe ruajnë qarkullimin e lirë të faunës. Përzgjedhja e lokacionit dhe ndërtimi i këtyre mbikalimeve duhet të bëhet sipas rregullave dhe normave të njohura ndërkombëtare;

## 1.22. TRASHËGIMIA NATYRORE

1. Të gjitha aktivitetet, projektet dhe masat e parapara në Planë duhet të jenë në harmoni me rregullat për mbrojtjen e natyrës, sipas të cilave, ndalohen të gjitha veprimet që shkaktojnë ndotjen e ajrit, tokës, ujërave nëntokësore dhe mbitokësore, duke e përfshirë edhe ndërrimin e shtretërve të lumenjve;
2. Në parkun kombëtar duhet të ndërmerren masat për mbrojtjen e ajrit, ujit dhe tokës sipas të cilave duhet të bëhet:
  - o Ndalimi i ndërtimit të kapaciteteve industriale që ndotin ajrin, ujin dhe tokën;
  - o Për ndërtimet e kategorisë së parë, të bëhet derdhja e detyrueshme e ujërave të zeza në gropat septike të padepërtueshme;
  - o Për ndërtimet e kategorisë së dytë dhe të tretë të aplikohet vendosja e impianteve për pastrimin e ujërave të zeza;
  - o Të vendoset sistemi i rregullt grumbullimit dhe i largimit të mbeturinave;
3. MEA është përgjegjëse për monitorim të vazhdueshëm të zhvillimeve hapësinore në parkun kombëtar dhe për shkeljet eventuale përmes Drejtorisë së Parkut merr masat në përputhje me rregullat në fuqi;
4. Në park ndalohen çfarëdo ndryshimesh në kundërshtim me këtë plan, pasqerisht ndryshimet që ndikojnë në bashkësitë e pyjeve, majat e maleve dhe ujërrjedhat;
5. Pas çdo ndërtimi me leje, duhet të rregullohet rrethina, mbjellja dhe kultivimi i gjelbërimit bazuar në peizazhin autokton;
6. Nuk lejohet vendosja e antenave difuzive dhe të kontejnerëve për mbeturina në hapësira dhe lokalitete me vlera të peizazhit, larmisë biologjike dhe trashëgimisë natyrore e kulturore;
7. Ndalohen të gjitha veprimet që ndikojnë në ndryshimin e morfologjisë ekzistuese të terrenit duke përfshirë terrenet tek: Gryka e Rugovës, shpellat karstike, liqenet malorë dhe zonave tjera (Zonat e I-ra) të shpallura me rëndësi të veçantë natyrore;
8. Ndalohet prerja ilegale e pyjeve. Prerja e pyjeve lejohet vetëm sipas Planit Menaxhues të Parkut dhe Rregullores së MEA për Rendin e Brendshëm të PK "Bjeshkët e Nemuna";
9. Ndalohet shfrytëzimi i llojeve bimore endemike, përveç shfrytëzimit të tyre për rastet e kërkimeve shkencore;
10. Me qëllim të ruajtjes së bilancit ekologjik në Park, resurset natyrore duhet të shfrytëzohen në mënyrë të qëndrueshme. Ky shfrytëzim më hollësisht rregullohet me planin e menaxhimit të parkut dhe me Rregulloren e MEA për Rendin e Brendshëm të PK "Bjeshkët e Nemuna";
11. Ndalohet nxjerrja e zhavorrit nga lumenjtë pa leje paraprake;
12. Ndalohet kaptimi i burimeve ujore pa leje paraprake;
13. Burimet ujore mbrohen me Ligjin për Ujërat dhe me masa për shfrytëzim të kufizuar të tyre, të cilat caktohen me planin menaxhues të Parkut;
14. Ndalohen veprimtaritë që për bazë kanë shfrytëzimin e inerteve duke përfshirë edhe gurthyesit e paautorizuar;
15. Ndalohen të gjitha veprimtaritë (gërmimet, mihjet sipërfaqësore, shpyllëzimi etj.) që ndikojnë në rritjen e erozionit;
16. Lejohet ndërtimi i akumulacioneve ujore me sipërfaqe deri në 25m<sup>2</sup> në shtretërit e lumenjve, (lokacioni përcaktohet në bashkëpunim me

Drejtorinë e Parkut) me qëllim të sigurimit të ujit që do të shfrytëzohet për blegtori dhe për rastet e zjarreve që mund të ndodhin në park;

17. Ndalohet ndërtimi i objekteve në largësi së paku tridhjetë (30) metra, nga vija e plotave të larta të ujë rrjedhave, me përjashtim të objekteve që shërbejnë për mbrojtjen nga përmbytjet;
18. Nuk lejohet transportimi i derivateve dhe materieve të tjera të dëmshme në Park;
19. Kositja e livadheve (përpos në zonën e parë) është e lejuar dhe duhet të realizohet sipas kriterëve të përcaktuara nga Drejtoria e Parkut, të cilat janë në favor të mbrojtjes dhe ripërtëritjes së tyre;
20. Në Park është e ndaluar gjuetia, e cila lejohet nga Drejtoria e Parkut vetëm në rastet e jashtëzakonshme, kur ndonjë lloj i kafshëve paraqet rrezik për Parkun apo për vendbanimet përreth;
21. Ndalohet peshkimi në të gjitha rrjedhat ujore brenda Parkut;
22. Gjatë zhvillimit të çfarëdo aktiviteti në park duhet të zbatohen kriteret për minimizimin e zhurmës;
23. Për shkak të rrethanave të ndryshuara (shpallja e territorit Park Kombëtar), për operatorët ekonomik që merren me shfrytëzimin dhe eksploatimin e inerteve në brendi të territorit të Parkut, pas aprovimit të Planit duhet të iniciohet shqyrtimi i lejeve për vazhdimin e veprimtarisë në lokacionin përkatës. Rezultat i këtij shqyrtimi do të jetë ndërprerja ose vazhdimi i aktivitetit, duke respektuar kufizimet në kuadër të të cilave: do të përcaktohet afati kohor i ushtrimit të veprimtarisë; lokacioni (sipërfaqja e përcaktuar në hartën e zonimit) ku ushtrohet veprimtaria duhet të kufizohet me një tampon mbrojtës (dy rende drunj të mbjellë që përshtaten me mjedisin); dhe pas përfundimit të veprimtarisë, lokacioni të rehabilitohet sipas rregullave të njohura mjedisore;
24. Në kuadër të Parkut aktualisht operojnë disa impiante hidroenergjetike, të cilat aktivitetin e tyre e kanë filluar para shpalljes së Parkut Kombëtar. Zhvillimi dhe operimi i mëtutjeshëm i tyre duhet të harmonizohet maksimalisht me rregullat dhe dispozitat në fuqi për trajtimin e duhur të mjedisit. Ndërsa, sa i përket kërkesave për ndërtimin e impianteve të reja hidroenergjetike, duke u bazuar në: Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës; Raportin e Shqyrtimit Publik; Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe në bazë të diskutimeve e rekomandimeve të grupit punues ndërministror, është marrë qëndrim që të ndalohet dhënia e lejeve të reja.

## 1.23. TRASHËGIMIA KULTURORE

1. Objektet e trashëgimisë kulturore të përfshira në listën e mbrojtjes së përkohshme brenda parkut (Murgorja e Zojës së Bekuar; Kisha katolike; Kalaja dhe Kisha e Shën Katarinës; Fortifikim; Shpella e murgjve në grykën e Rugovës; Ujëvara në Grykën e Rugovës dhe Përmendorja e LNÇ) duhet të trajtohen me Ligjin për Trashëgimi Kulturor nr.02/L-88, sipas të cilit monumentet arkitekturale kanë një zonë mbrojtëse prej 50m' nga perimetri i "monumentit", ndërsa për lokalitetet arkeologjike zona mbrojtëse është 100m' nga perimetri i "lokalitetit";
2. Sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 04L-174, objektet e listuara më sipër janë "Sipërfaqet e mbrojtura" për të cilat vlen:



- Ndalimi i ndërtimit të rrugëve magjistrale dhe regjionale dhe ndërtesave më të larta se "monumenti";
  - Ndërtesat që ngriten afër të jenë në harmoni me "monumentin";
  - Ndalohet zhvillimi i veprimtarisë së industrisë së rëndë, instalimi mbitokësor i furnizimit me rrymë elektrike, telekomunikacion dhe përçues digjital;
  - Ndalohen veprimtaritë dhe ndërtimet që ndikojnë në shpyllëzim / ndotje të mjedisit dhe tjetërsim të zonës ku ndodhet objekti.
3. Rekonstruimi i objekteve me vlerë të trashëgimisë arkitekturore brenda parkut dhe në afërsi të tij duhet të realizohet sipas standardeve dhe kritereve të ndërtimit, duke përdorur forma dhe materiale vendore nga guri, druri dhe materiale tjera vendore, por gjithnjë duke e ruajtur trashëgiminë autoktone kulturore, tradicionale, fshatare si dhe duke ruajtur origjinalitetin e objektit dhe peizazhit që e rrethon;
  4. Zonat e veçanta të mbrojtura siç janë Manastiri i Deçanit dhe Patrikana e Pejës trajtohen dhe mbrohen me Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura (Ligji nr. 03/L-039). Në kuadër të ligjit janë të listuar aktivitetet e ndaluara dhe të kufizuara për zonat e veçanta të mbrojtura të cilat duhet të respektohen nga të gjithë;
  5. Zhvillimet në kuadër të ZVM-ve, duhet të jenë në harmoni me kërkesat që dalin nga Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura (Ligji nr. 03/L-039), në të cilin janë të listuara aktivitetet që lejohen ose ndalohen brenda zonës.

#### 1.24. TRAJTIMI I MBETURINAVE

1. Menaxhimi i mbeturinave duhet të bëhet në bazë të një sistemi të vendosur dhe të aprovuar nga Drejtoria e Parkut;
2. Mbeturinat duhet të jenë nën administrimin e operatorëve të licencuar (person fizik apo juridik) që paraprakisht përcaktohen nga Drejtoria e Parkut;
3. Operatorët përgjegjës për administrimin e mbeturinave duhet t'i përmbushin detyrimet që janë të rregulluara me Ligjin Nr. 02/L-30 për Mbeturinat;
4. Aktivitetet që duhet t'i kryejnë operatorët përgjegjës për administrimin e mbeturinave janë të rregulluara me Ligjin Nr. 02/L-30 për Mbeturinat;
5. Operatorët përgjegjës për administrimin e mbeturinave duhet të jenë të pajisur me licenca të cilat i lëshon MEA;
6. Ligji Nr. 02/L-30 për Mbeturinat obligon mbikëqyrjen inspektuese të aktiviteteve për administrimin e mbeturinave.

#### 1.25. NDIKIMET SOCIALE

1. Zbatimi i synimeve dhe objektivave të parapara në Planin Hapësinor të PK "Bjeshkët e Nemuna" duhet të jenë në harmoni të plotë me ngritjen e mirëqenies sociale në përgjithësi. Aktivitetet, projektet dhe masat e parapara në strategjinë e zhvillimit hapësinor të Parkut kanë për qëllim krijimin e kushteve, nga të cilat përfitimin e drejtpërdrejtë duhet ta kenë fillimisht banorët dhe vendbanimet brenda territorit të Parkut. Kjo nënkupton se përparësi në pjesëmarrje, në aktivitete, në ngritje të kapaciteteve, në përfitimin e donacioneve, në punësim dhe në aktivitete tjera duhet të kenë banorët vendas;

2. Për të gjitha aktivitetet, projektet dhe masat e parapara, duhet të aplikohen normat dhe standardet për personat me nevoja të veçanta sipas rregullave në fuqi.

#### 1.26. ZBATIMI I PLANIT

1. Plani Hapësinor për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" është dokument që përcakton zhvillimin hapësinor të një zone me rëndësi për Qeverinë e Kosovës, i aprovuar në Kuvendin e Kosovës dhe si i tillë është obligues për të gjitha komunat pjesëmarrëse. Përpos zbatimit të drejtpërdrejtë, zbatimi i Planit bëhet edhe përmes planeve tjera si: Plani Menaxhues i Parkut Kombëtar, Planet Zhvillimore Komunale, Planet Rregulluese të Hollësishme si dhe Harta Zonale e Kosovës dhe Harta Zonale e Komunës përkatëse.

#### 1.27. HULUMTIMET E MËTUTJESHME

1. Duke qenë se Parku është një territor i gjërë me biodiversitet të pasur, me pasuri të shumta natyrore dhe kulturore, është e domosdoshme realizimi i hulumtimeve, të cilat do të ndihmojnë në pasqyrimin real dhe përmbajtësor të gjendjes ekzistuese të tij. Fushat me prioritet të hulumtimit janë: inventarizimi i përmbajtjeve duke përfshirë identifikimin e gjinive, individëve, popullatave, llojeve, habitateve, peisazheve dhe ekosistemeve, identifikimi i përhapjes së tyre gjeografike, renditja, katalogimi dhe paraqitja e tyre në hartë; hulumtimi i shpellave, inventarizimi, prezantimi dhe promovimi i tyre; hulumtimi i pasurive nëntokësore dhe fusha tjera të ngjashme. Të gjitha hulumtimet duhet të realizohen sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi.

**PJESËMARRËSIT NË HARTIMIN E PLANIT****Hartues:** Instituti për Planifikimin Hapësinor

Luan NUSHI, drejtor (arkitekt planer)

**Përgjegjës të fushave dhe temave përkatëse:**

Arbën RRECAJ (arkitekt planer), Faton DEVA (arkitekt planer),  
 Elvida PALLASKA (arkitekt planere), Shpend AGAJ (gjeograf planer),  
 Nexhmije KAMBERI (biolog planere), Besim GOLLOPENI (sociolog planer),  
 Zana MEHMETI (arkitekt planere), Festa NELA (arkitekt planer/GIS),  
 Gëzime Grajqevci (arkitekt planere), Riza MURSELI (gjeograf planer/GIS),  
 Mimoza KALLABA (gjeograf planere) dhe Hasim KRYEZIU (gjeograf/GIS).

**Anëtarët e Grupit Punues Ndërmisor – GPNM**

**MEA:** Arbën RRECAJ, (IPH) koordinator  
 Rizah MURSELI, (IPH) zëvendës koordinator  
 Fatmir MORINA, (DPKBN) anëtar  
 Fadil BAJRAKTARI, (IKMN) anëtar  
 Ismail HETEMI, (DMM) anëtar  
 Hazir QADRAKU, (DU) anëtar  
 Fatmir AZEMI, (DPHBN) anëtar  
 Abedin BALAJ, (DPKBN) anëtar  
 Hidajete ZHURI, (DPHBN) anëtare  
 Abdurrahman VERBOVCI, (DPHBN) anëtar

**MI:** Naser ZHJEQI, anëtar**MZHE:** Lulzim KORENICA, anëtar**MBPZHR:** Hasan UKAJ, anëtar**MTI:** Halil BAJRAMI, Xhemajl PLLANA, anëtar**Komunat**

**Pejë:** Modest GASHI, anëtar  
 Mirjeta RIZVANOLLI, anëtare  
 Fehmi GEÇI, anëtar

**Decan:** Shkelzen SHEHU, Mirsat NIMONAJ, anëtar**Junik:** Xhemë SHEHU, anëtar**Istog:** Januz KABASHI, anëtar**Gjakovë:** Agron GOJANI, anëtar**Përkrahja teknike dhe profesionale****UN-Habitat – Kosova**

Catarina CAMARINHAS,  
 Peter ENGSTROM,  
 Arijeta HIMADUNA,  
 Doruntinë REXHEPI

**Konsultant:** Darren ENNS, senior planer

Davide GENELETTI, VSM ekspert

**Shoqata e Bjeshkëtarëve “Pashtriku”:** Skender SINA**Ekipi i ekspertëve për zonimin e Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”**

**AMMK:** Ilir MORINA, koordinator  
 Rizah MURSELI, (IPH) zëvendës koordinator  
 Nail KRYEZIU, (DPKSh) anëtar  
 Fadil BAJRAKTARI, (IKMN) anëtar  
 Luan NUSHI, (IPH) anëtar  
 Xhavit MALA, (DPKSh) anëtar  
 Sami SINANI, (DMM) anëtar  
 Qenan MAXHUNI, (IKMN) anëtar

**Universiteti i Prishtinës:**

Vahdet PRUTHI, (DGj) anëtar  
 Behxhet MUSTAFA, (DB) anëtar  
 Ferdije ZHUSHI, (DB) anëtare  
 Fadil MILLAKU, (DB) anëtar  
 Agim GASHI, (DB) anëtar  
 Linda GRAPCI, (DB) anëtare  
 Zeqir VESELAJ, (FE) anëtar  
 Elez KRASNIQI, (DB) anëtar  
 Frorim ISUFI, (DGj) anëtar

**OJQ “Era”:** Fatos LAJQI, anëtar**Përgatitja teknike:**

INSTITUTI PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR



## LITERATURA

1. Parks Canada, project team. (2010). *Banff National Park. Management Plan*. Parks Canada.
2. National Park Service, Yosemite National Park, project team. (2012). *A sense of place. Design guidelines for Yosemite National Park*. Washington DC: National Park Service.
3. Parc national des Cévennes, project team. (1999). *Atlas du Parc national des Cévennes*. Parc national des Cévennes.
4. KK Pejë, DHV. (2006). *Plani zhvillimor komunal Pejë*. Pejë: KK Pejë., DHV.
5. Urban Plus. (2008). *Plani zhvillimor komunal Istog*. Prishtinë: Urban Plus.
6. Terrasystems Austrian Geotechnik. (2008). *Plani zhvillimor komunal Deçan*. Deçan: Terrasystems Austrian Geotechnik.
7. KK Junik, UN Habitat, CHwB, IPH. (2011). *Plani zhvillimor komunal i Junikut 2010-2023*. Junik: KK Junik.
8. CHËB. (2007). *Plani i konservimit dhe zhvillimit të Junikut*. Prishtinë: CHËB.
9. CHËB.
10. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. (2012). *Lista e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme*. Prishtinë: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
11. Fletushka Peja - *Shtegu i monumenteve kulturore*.
12. Fletushka *Plani Regjional i trashëgimisë për Kosovën Perëndimore 2012-2015*.
13. KK Pejë, Zyra për informim turistik. Fletushka për Rugovën.
14. Fletushka *Juniku - Tourist guide*.
15. KK Pejë. *Informatori turistik*.
16. Millaku, F. (2009). *Inventari Bimët Mjekësore Aromatike dhe Pemët Frutore të Egra në Kosovë*. Prishtinë: Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore/Departamenti i Biologjisë.
17. Rexhepi, F. (1994). *Vegjetacioni i Kosovës*. Prishtinë: Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore/Departamenti i Biologjisë.
18. Hoxha, E. Mustafa, B. (2004). *Biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura*. Prishtinë: Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore/Departamenti i Biologjisë.
19. Rexhepi, F. Millaku, F. Mala, Xh. Berisha, B. (2012). *Atllasi i bimëve të Kosovës*. Prizren: Siprint.
20. Bino, T. Zoto, H. Bego, F. (2006). *Shpendët dhe gjitarët e Shqipërisë*. Tiranë.
21. Ramadani, N. Lecaj, I. *Në kërkim të zogjve*. Prishtinë: FINCH., AMMK.
22. Ahmetaj, I. (1980). *Gjeomorfologjia e Sharrit dhe Brezovicës*. Prishtinë: Revista shkencore *Përparimi*.
23. Antonijević, R. Paviq, J. Karoviq, J. Menković, L. (1978). *Teksti sqarues i hartës gjeologjike 1:100.000 plansheti K34-53 Pejë dhe K-34-65 Kukës*. Beograd.
24. Antonijević, I. Karoviq, J. Paviq. (1968). *Harta gjeologjike plansheti Pejë (1:100000)*. Beograd.
25. Ahmetaj, I. (1977). *Furnizimi me ujë dhe shpërndarja e ujërave nëntokësore në Kosovë*. Prishtinë: Revista Shkencore *Përparimi*.
26. Çadraku, H., Beqiraj, A. (2013). *Veçoritë Hidrogeologjike të Basenit të Dukagjinit, Kosovë*. Prishtinë: Buletini shkencor gjeologjik.
27. Çukiq, D. (1979). *Këshillimi mbi parqet nacionale dhe regjionale të Jugosllavisë*. Brezovicë.
28. Elezaj, Z., Kodra, A. (2008). *Gjeologjia e Kosovës*. Tekst universitar. Prishtinë: CIP.
29. Instituti për Hidroekonomi "Jarosllav Çerni". (1983). *Pasqyra e Bazës së Hidroekonomisë së KSA të Kosovës*. Prishtinë.
30. Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës. (2014). *Të dhënat hidrometeorologjike*. Prishtinë.
31. Labus, D. (1979). *Kërkime Gjeografike*. Bilanci i ujqor i pellgut të lumit Drini i Bardhë. Prishtinë: Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore/Departamenti i Gjeografisë.
32. Menković, Lj. (1995). *Morfologjia sipërfaqësore e karstit të Moknës dhe Zhlebit*. Beograd.
33. Micevski, E., Zhogorski, G. (1983). *Raport i hulumtimeve hidrogeologjike në Istog*. Shkup: Instituti Gjeologjik.
34. Pllana, R. (1991). *Kërkime Gjeografike*. Prishtinë: Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore/Departamenti i Gjeografisë.
35. Talani, R. (2000). *Morfologjia dhe morfometria e luginave në Alpet e Shqipërisë*. Monografi. Shkodër.
36. Vilimonović, J. (1973). *Studimet regjionale hidrogeologjike në Kosovë*. Beograd: Fondi i Gjeozavodit.
37. Bogdani, R. *Vallja e Rugovës*.
38. Çavolli, R. (1997). *Gjeografia regjionale e Kosovës*. Prishtinë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës.
39. Islami, H. (2008). *Studime demografike*. 100 vjet të zhvillimit demografik të Kosovës. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës.
40. Egis International., Ministria e Infrastrukturës., SNCF INTERNATIONAL. (2012). *Strategjia e Transportit Multimodal dhe Plani i Veprimit*. Përkrahja në zbatimin e marrëveshjes së komunitetit të transportit EU-TCA. Prishtinë: Egis International.
41. Agjencia e Statistikave të Kosovës. (2008). *Popullsia Ekonomitë Familjare sipas Vendbanimeve dhe Organizimi Territorial i Kosovës deri në vitin 2008*. Prishtinë: Agjencia e Statistikave të Kosovës.
42. Agjencia e Statistikave të Kosovës. (2011). *Regjistrimi i Popullsisë Ekonomike Familjare dhe Banesave 2011*. Prishtinë: Agjencia e Statistikave të Kosovës.
43. Agjencia e Statistikave të Kosovës. (2011). *Statistikat e lindjeve në Kosovë*. Prishtinë: Agjencia e Statistikave të Kosovës.
44. Agjencia e Statistikave të Kosovës. (2011). *Statistikat e vdekjeve në Kosovë*. Prishtinë: Agjencia e Statistikave të Kosovës.
45. Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, Instituti për Planifikim Hapësinor. (2013). *Parku Kombëtar "Sharri"*. Plani Hapësinor. Prishtinë: Instituti për Planifikim Hapësinor.
46. Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, Instituti për Planifikim Hapësinor. (2013). *Monumenti i Natyrës me Rëndësi të Veçantë "Ujëvarat e Mirushës"*. Plani Hapësinor. Prishtinë: Instituti për Planifikim Hapësinor.
47. UNDP. (2012). *Biodiversity\_list\_40 – Dragash*. Prishtinë: UNDP.
48. Fondacioni Zhvillimor Maqedonas për Ndërmarrjet. (2012). *Kosova Perëndimore më pranë se kurrë*. Shkup: Fondacioni Zhvillimor Maqedonas për Ndërmarrjet.
49. MEA, IKMN. (2003). *Studimi mbi arsyeshmërinë e shpalljes së territorit të Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional*. Prishtinë: IKMN.
50. KK Istog. (2012). *Plani Lokal i Veprimit në Mjedis Komuna e Istogut 2012/2017*. Istog: KK Istog.
51. KK Junik. (2012). *Plani Lokal i Veprimit në Mjedis Komuna e Junikut 2012/2017*. Junik: KK Junik.
52. KK Deçan. (2012). *Plani Lokal i Veprimit në Mjedis Komuna e Deçanit 2012/2017*. Deçan: KK Deçan.
53. MTI, GTZ. (2008). *Projektet e Produktit Turistik në Rajonin Turistik të Bjeshkëve të Nemuna (Alpet Shqiptare)*. Prishtinë: MTI
54. [http://kk.rks-gov.net/peje/getattachment/Services/Plani-zhvillimor-komunal/Plani-zhvillimor-komunal\\_shqip.pdf.aspxPzhk](http://kk.rks-gov.net/peje/getattachment/Services/Plani-zhvillimor-komunal/Plani-zhvillimor-komunal_shqip.pdf.aspxPzhk)
55. <http://kk.rks-gov.net/gjakove/>
56. <http://www.majet.org/>
57. <http://www.majet.org/bjeshket.php?id=4>
58. <http://www.rugovaexperience.org/index.aspx?SID=5&LID=2&AID=59&Ctype=1&CatID=3>
59. <http://m.telegrafi.com/ekonomi/program-per-bimet-mjekesore-dhe-aromatike-46-11783.html>
60. <http://whc.unesco.org/en/list/724/>
61. [www.thethi-guide](http://www.thethi-guide.com)
62. Shumica e fotove dhe materialeve filmike të prezantuara, janë origjinale dhe të realizuara në terren nga zyrtarët e IPH-së.

### Falënderim

Në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, përkatësisht Institutit për Planifikim Hapësinor, falënderojmë të gjithë pjesëmarrësit, institucionet publike, private, shoqërinë civile dhe në veçanti anëtarët e grupit punues ndërmarrës dhe komunitetin, të cilët na ndihmuan me të dhëna, informacione dhe përvijën e tyre deri në realizimin final të Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna".



Shtojca 1

PLANI I VEPRIMIT<sup>20</sup>

Synimi Administrimi, menaxhimi efikas i parkut dhe bashkëpunimi në shërbim të Parkut							
Objektivi	Aktiviteti/ Masa/ Projekti	Akterët vendimmar rës	Akterët e zbatimit	Afati kohor	Burimi financiar	Implikimi financiar	
Administrimi i mirë dhe transparent	1	Hartimi rregullores për administrim dhe menaxhim të parkut	MEA AMMK	AMMK/DPKBN	*	BK	I ultë
	2	Kompletimi i stafit dhe pajisjeve të nevojshme për administrim dhe menaxhim të parkut	MEA AMMK	AMMK/DPKBN	*	BK	I ultë
Menaxhimi efikas i zhvillimeve	1	Hartimi i planit për menaxhimin e parkut	MEA AMMK	AMMK/DPKBN	**	BK	I ultë
	2	Kontrolli (inspektimi) i zhvillimeve	MEA AMMK	MEA/ Inspektorati DPKBN	Në vazhdimësi	BK	I ultë
Bashkëpunimi vendor dhe ndërkombëtar, si dhe lidhja e produktit turistik me rrjetet turistike ndërkombëtare	1	Organizimi i konferencave për arritjen e partneritetit në mes të ekspertëve vendor dhe ndërkombëtar	MEA AMMK, Institucione t ndërkombëtare	MEA/ AMMK	Në vazhdimësi	BK	I ultë
	2	Organizimi i vizitave studimore dhe trajnimeve brenda dhe jashtë vendit	MEA AMMK	MEA/AMMK	Në vazhdimësi	BK	I ultë
	3	Organizimi i kampanjave për vetëdijësimin dhe informimin e komunitetit	MEA AMMK	MEA AMMK, Mediat	***	BK	I ultë
	4	Plotësimi i kushteve për njohjen ndërkombëtare të Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" dhe më pas njohja e tij	MEA AMMK	MEA/AMMK, Policia, Organi- zatat ndërkombëtare	***	BK	I mesëm
	5	Inicimi i hartimit të projekteve të përbashkëta: o Ngritjen e qendrave turistike në zonat ndërkufitare me Shqipërinë dhe Malin e Zi; o Trajtimin e mbeturinave; o Trashëgimia kulturore, etj.	MEA, MTI, MKRS	MEA, MTI, MKRS, Firma private	***	BK, Investitori privat	I lartë
Synimi Mbrotjtja, ruajtja dhe shfrytëzimi racional i vlerave të trashëgimisë natyrore e kulturore në Park dhe për rreth tij							
Objektivi	Aktiviteti/Masa/Projekti	Akterët vendimmar rës	Akterët e zbatimit	Afati kohor	Burimi financiar	Implikimi financiar	
Vetëdijësimi dhe informimi për parkun kombëtar	1	Hartimi i programit vjetor për komunikim me publikun/marketing/, promovimin e vlerave të parkut	MEA, AMMK, DPKBN	AMMK, DPKBN, Komunat	*	BK, Donatorët	I ultë
	2	Puna me autoritetet e arsimit për të rritur ndërgjegjësimin rreth zonave të mbrotjtura	AMMK DMM	DP, MASHT, Komunat	*	BK, Donatorët	I ultë
	3	Përgatitja e librit dhe broshurave me informatat për parkun	DPKBN	DP, Komunat	*	BK, Donatorët	I ultë

Inventarizimi i biodiversitetit	1	Krijimi i bazës së të dhënave hapësinore për parkun kombëtar	MEA, AMMK, DPKBN	AMMK, DPKBN, Komunat	***	BK, Donatorët	I ultë
Publikimi i llojeve specifike natyrore	1	Plani i menaxhimit të parkut t'i përmbajë dispozitat për raportimin vjetor	MEA AMMK, DPKBN	AMMK/DPKBN	**	BK, Donatorët	I mesëm
Mbrotjtja dhe ruajtja e llojeve bimore në përgjithësi dhe e bimëve relikte, endemike, autoktone të parkut dhe endemike të Ballkanit në veçanti	1	Identifikimi brenda bazës së të dhënave hapësinore të PK i llojeve të rendesishme të bimëve që duhet të përfshihen në listën e Mbrotjtjes Ndërkombëtare të Bimësisë.	AMMK IKMN DMM, DPKBN	AMMK/IKMN/ DMM, DPKBN	***	BK, Donatoërt	I mesëm
	2	Hartimi i pjesës së dytë të Librit të Kuq të Florës Vaskulare të Kosovës	AMMK/IKM N/DMM/DP KBN	AMMK/IKMN/ DMM, DPKBN	***	BK, Donatoërt	I mesëm
Ruajtja e faunës në përgjithësi dhe llojeve të gjitarëve dhe shpezëve endemike, relikte në veçanti	1	Krijimi i inventarit të gjitarëve si pjesë e bazës së të dhënave hapësinore, duke përfshirë habitatet dhe rruget e migrimit	AMMK/IKM N/DMM/DP KBN	AMMK IKMN/DMMD PKBN	***	BK, Donatoërt	I mesëm
	2	Krijimi i rrjetit të monitorimit për karnivoret, veçanërisht për llojet që janë të kërcënuar me zhdukje	AMMK/IKM N/DMM/DP KBN	AMMK/IKMN/ DMM, DPKBN	***	BK, Donatoërt	I mesëm
Ruajtja e llojeve të shpezëve që janë në Librin e Kuq të Evropës	1	Hartimi i Librit të Kuq të Kosovës për ornitofaunen	AMMK/IKM N/DMM/DP KBN	AMMK/IKMN/ DMM/DPKBN	***	BK, Donatoërt	I mesëm
	2	Vendosja e rrjetit afatgjatë për monitorimin e shpendeve	AMMK/IKM N/DMM/DP KBN	AMMK/IKMN/ DMM/DPKBN	***	BK, Donatoërt	I mesëm
Mbrotjtja e të gjitha llojeve të vegjetacionit pyjor nga degradimi dhe prerja ilegale e tyre	1	Prerja e kontrolluar fito-sanitare e pyjeve	AMMK DPKBN	DPKBN	*	-	-
	2	Identifikimi i lokacioneve në zonën e dytë për qëllim të ripullesimit dhe ndertimit të ujembledhësve për mbrotjtjen e pyllit	MEA DPKBN	DPKBN	*	BK	I ultë
	3	Integrimi i nje kadastrit modern të pyjeve brenda bazës së të dhënave hapësinore të PK	MEA DPKBN	DPKBN	*	BK	I ultë
Mbrotjtja e elementeve mjedisore (ajri, uji dhe toka) nga ndohta dhe degradimi	1	Integrimi i të dhënave për burimet e ndotjes në bazën e të dhënave hapësinore	MEA IHMK DPKBN	IHMK DPKBN	*	BK	I ultë
	2	Ndërtimi i stacionit hidrometeorologjik në lumin Erenik dhe atij afër gurrës së Radavcit, si dhe stacionit meteorologjik në Boge.	MEA IHMK DPKBN	IHMK DPKBN	*	BK	I ultë
	3	Monitorimi vazhdueshëm i burimeve ujore, pellgjeve lumore, liqeneve, zonave pyjore, kullosave, pasazheve dhe dukurive morfologjike.	MEA AMMK IHMK DPKBN	IHMK DPKBN	*	BK	I ultë
	4	Monitorimi i vazhdueshëm në lokacionet ku shfrytëzohet uji për pije dhe për hidro-energji	AMMK	AMMK	*	-	-
	5	Raportimi i vazhdueshëm nga personat përgjegjës për monitorim	AMMK DPKBN	AMMK DPKBN	*	-	-

<sup>20</sup> Projektet konkrete të parapara në këtë plan nuk përmbajnë obligim për financim nga organizatat buxhetore, por me shume janë si orientime për të ardhmen e të cilat mund të realizohen vetëm nëse kanë ndarje buxhetore përkatëse në buxhetin e shtetit.



	6	Vendosja e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza	MEA/AMM K	MEA/AMM K, S. privat	**	BK, Invest. privat	I mesëm
	7	Rikuperimi në sipërfaqet tokësore të dëmtuara nga ndërtimi i infrastrukturës	MEA/AMM K	MEA, MBPZHR	***	BK	I mesëm
	8	Menaxhimi i mbeturinave	MEA AMMK	MEA AMMK, Operatori	*	BK	I ultë
	9	Ndërmarrja e masave antierozive	AMMK	AMMK DPKBN	Vazhdueshëm	BK	I mesëm
<b>Mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore dhe të shkaktuara nga faktori njeri</b>	1	Hartimi i planit emergjent për parkun	AMMK	AMMK	**	BK	I mesëm
	2	Përgatitja e hartave të rreziqeve të fushave të ndryshme (zjarri, ortiqet, vërshimet etj.)	MEA	MEA, Universiteti Kompania private	*	BK	I ultë
	3	Bashkëpunimi dhe mbajtja e ushtrimeve të përbashkëta në mes të Drejtorisë së Parkut, komunave, institucioneve relevante dhe forcave të reagimit	MEA AMMK, MFA	AMMK	*	BK	I ultë
<b>Aplikimi i regjimit të shfrytëzimit të resurseve dhe vlerave të parkut</b>	1	Hartimi i planit për regjimin e shfrytëzimit tokës bujqësore, kullosave, livadheve, fryteve malore, bimëve mjeksore, kërkudhave, si dhe trupave ujore	MEA AMMK	AMMK	**	BK	I mesëm
	2	Monitorimi i aplikimit të regjimit të shfrytëzimit dhe raportimi i vazhdueshëm	AMMK	DPKBN	*	BK	I ultë
<b>Vetëdijësimi dhe informimi mbi rolin dhe rëndësinë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore</b>	1	Trashëgimia kulturore e Kosovës të përfshihet në planprogramet shkollore	MASHT	MASHT, UP	*	BK	I ultë
	2	Specializimi i ciceronëve për vlerat natyrore, historike dhe kulturore të parkut të Bjeshkëve të Nemuna	AMMK DPKBN, MTI DT, MKRS DTK	AMMK/DPKBN, MTI/DT, MKRS/DTK, Institucioni i specializimit	**	BK	i ultë
	3	Përgatitja e hartave, fletëpalosjeve dhe broshurave për pasuritë natyrore dhe kulturore që posedon parku	AMMK/DPKBN, DMM, MBPZHR/APK	AMMK/DPKBN, DMM, MBPZHR APK	**	BK	I ultë
	4	Programet dokumentare për parkun, emitimi në ditët e caktuara të manifestimeve vjetore	AMMK/DPKBN, MTI/DT, MKRS/DK	AMMK/DPKBN, MTI/DTMKRS/DK, OJQ, Mediat	**	BK, Sek. privat, Donatorët	I ultë
	5	Organizimi vjetor i ekskursioneve shkollore, vizitë objekteve natyrore dhe kulturore	MASHT, Drejtoritë komunale të arsimit	MASHT, Drejtorit komunale të arsimit, DPKBN	**	BK	I ultë
<b>Shfrytëzim racional i vlerave të trashëgimisë natyrore e kulturore të parkut</b>	1	Përfshirja e trashëgimisë kulturore në planet e nivelit lokal	MEA/DP, IPH, Komunitat	Drejtoritë e urbanizmit të komunave	*	BK	I mesëm
	2	Hartimi i planeve të konservimit dhe menaxhimit për zonat me trashëgimi kulturore	MKRS	MKRS/DTK	***	BK	I ultë
	3	Gjetja e formave të partneritetit publiko-privat të cilat do të ofronin mundësi të konservimit, përfshirë mirëmbajtjen e objekteve me vlera kulturore	MEA, MKRS	MKRS/DTK, Firma private	***	PPP	Varësisht nga objekti

<b>Sigurimi i infrastrukturës mbështetëse për zonat dhe objektet e TK</b>	1	Krijimi i një sistemi të shenjzimit për vlerat e trashëgimisë kulturore e natyrore	AMMK/DPKBN, MKRS/DTK	AMMK/DPKBN, MKRS/DTK	*	BK	I ultë
	2	Hartimi i planit për menaxhimin e parkut, i cili duhet ta promovojë trashëgiminë kulturore, shtëpitë kullë në formë bujtinash, si njësi akomodimi, kishat, xhamitë, teqet etj	MEA	DPKBN	*	BK	I ultë
	3	Identifikimi i objekteve dhe nevojave për rikonstruktim dhe caktimi i prioriteteve	MKRS	MKRS/DTK, Drejtoritë e kult. dhe urbanizmit	**	BK	i mesëm
<b>Bashkëpunimi ndërinstitucional në mes të organizatave qeveritare dhe joqeveritare të nivelit qendror dhe lokal</b>	1	Mbështetje nga ana e nivelit shtetëror mbi rolin dhe rëndësinë e vlerave të trashëgimisë natyrore dhe kulturore të parkut	Qeveria e Kosovës, MKRS	MKRS, Komunitat	**	BK	I ultë
	2	Promovimi i vlerave natyrore dhe kulturore të secilit shtet, organizimi i ekskursioneve të përbashkëta turistike duke i'u dhënë rëndësi datave të caktuara vjetore	MEA/AMMK, MKRS/DTK, QRTK	MEA/AMMK, MKRS/DTK, QRTK Komunitat	*	BK	I ultë
<b>Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë së luajtshme dhe shpirtërore</b>	1	Organizimi i aktiviteteve në formë të ekspozitave, panairëve, koncerteve, festave apo tjetër ku mund të prezantohet trashëgimia kulturore përfshirë atë shpirtërore	MKRS/DTK	DPKBN, QRTK, Komunitat	Vazhdimsi		I ultë
	2	Promovimi i trashëgimisë shpirtërore dhe të luajtshme duke organizuar gara të ndryshme në shkolla, ekskurzione në fundvit ekspozita të vizatimeve, fotografive dhe aktivitete tjera shkollore	MKRS, MASHT, Komunitat	Komunitat	Vazhdimsi	BK	I ultë
	3	Ndërtimi i një muzeu etnologjik në të cilin do të prezantohen veshjet, armët, enët që janë përdorur për ushqim, elementet dekorative të qëndisura, veglat e punës, ato muzikore dhe veglat e shtëpisë të gdhendura nga druri, si dhe ushqimi tradicional i këtyre anëve	MEA, MKRS, MBPZHR	DPKBN, QRTK	**	BK	I ultë
	4	Përkrahja e projekteve që stimulojnë zhvillimin e veprimtarisë artizanale dhe kultivimin e gastronomisë tradicionale	MKRS, MBPZHR	Komunitat OJQ, Donatorët	*	BK, Donatorët	I ultë
<b>Synimi Zhvillimi socio-demografik në vendbanimet brenda dhe për rreth Parkut</b>							
<b>Objektivi</b>	<b>Aktiviteti/Masa/Projekti</b>		<b>Akterët vendimarrës</b>	<b>Akterët e zbatimit</b>	<b>Afati kohor</b>	<b>Burimi financiar</b>	<b>Implikimi financiar</b>
<b>Ngritja e cilësisë së edukimit – arsimimit</b>	1	Ndërtimi i objekteve shkollore ose sigurimi i transportit për nxënësit	KK, MASHT	KK	**	BK	I ultë
	2	Ndërtimi i objekteve edukative – kopshteve për fëmijë	KK, MASHT	KK	**	BK, Donatorët	I ultë
	3	Organizimi i programeve edukative për popullatën	KK, OJQ, MASHT	KK, OJQ, Donatorët	**	BK, Donatorët	I ultë
	1	Ndërtimi i shtëpive shëndetësore	KK, MSH	KK, MSH, Donatorët	**	BK, Donatorët	I ultë



<b>Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore</b>	2	Ofrimi i shërbimeve shëndetësore me autoambulancë	KK, MSH	KK, MSH, Donatorët	**	BK, Donatorët	I ultë
<b>Rigjallërimi i vendbanimeve të shpopulluara</b>	1	Subvencionim në edukim dhe arsimim sipas grup – moshave dhe gjinisë	KK, MSH	KK, MSH, Donatorët	**	BK, Donatorët	I ultë
	2	Qasje për të gjithë dhe marketing për parkun	KK, MEA, MTI	KK, MEA, MTI	*	BK	I ultë
	3	Organizimi i Javës tradicionale të Rugovës	KK, MEA, MTI	KK, MEA, MTI	*	BK	I ultë
<b>Synimi</b> Zhvillimi i turizmit dhe ngritja ekonomike e Parkut							
<b>Objektivi</b>	<b>Aktiviteti/Masa/Projekti</b>		<b>Akterët vendimmar rës</b>	<b>Akterët e zbatimit</b>	<b>Afati kohor</b>	<b>Burimi financiar</b>	<b>Implikimi financiar</b>
<b>Zhvillimi i bujqësisë tradicionale/blegtorisë dhe bletarisë me qëllim të përfitimit ekonomik dhe zhvillimit të ekoturizmit</b>	1	Hartimi i programit për ngritjen e vetëdijes së banorëve për mundësitë e kultivimit të bujqësisë organike në zonat brenda dhe për rreth parkut	DPKBN, MBPZHR	DPKBN	*	BK	I ultë
	2	Ngritja e pikave grumbulluese në kuadër të parkut me gjithë infrastrukturën e nevojshme (PMP)	DPKBN, MBPZHR, Komuna	DPKBN, Komuna	*	BK, PPP	I mesëm
	3	Përcaktimi i lokacionit për tregun e agro-turizmit (PMP)	DPKBN, MBPZHR, MTI/DT & Komuna	Komuna përkatëse	*	BK, PPP	I ultë
<b>Shfrytëzimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore, BMA (bimëve mjekuese dhe aromatike) dhe PFE (pemëve frutore të egra) për përfitime ekonomike</b>	1	Hartimi i rregullores për shfrytëzimin e qëndrueshëm të sipërfaqeve të caktuara, për mbledhjen e BMA dhe PFE	MBPZHR & MEA, DPKBN	DPKBN, Komunat	*	BK	I ultë
	2	Hartimi i projektit për krijimin e një brendi për të gjitha produktet e prodhuara në Bjeshkët e Nemuna.	MBPZHR, DPKBN	MBPZHR, DPKBN	**	BK	I ultë
<b>Planifikimi i zhvillimeve sipas regjimit të mbrojtjes, për zonat brenda dhe rreth parkut</b>	1	Marrëveshje e partneritet publiko-privat për investime në park	DPKBN, Komuna, Investitori	DPKBN, Komuna, Investitori	**	BK, investitori	
	2	Hartimi i projektit dhe ngritja e hyrjeve - daljeve në park të parapara sipas dispozitave për zbatim	MEA, DPKBN	MEA, DPKBN	*	BK	I mesëm
	3	Studimi i fizibilitetit dhe hartimi i projektit për teleferikun Pejë – Kopranik	MEA, Komuna	MEA, Komuna, Investitori	**	BK, Investitori	I mesëm
	4	Studimi i fizibilitetit si dhe harmonizimi i projektit ekzistues "Qendra Turistike Kopranik" me dispozitat për zbatim të parapara në PHPKBN	MEA, Komuna	MEA, Komuna, Firma private	**	BK, Investitori privat	I mesëm
	5	Studimi i fizibilitetit si dhe harmonizimi i projektit ekzistues "Qendra e skijimit në Bjeshkët e Belegut" (Hartuar nga Instituti për Urbanizëm i Kroacisë - vitet e tetëdhjeta) me dispozitat për zbatim të parapara në PHPKBN	MEA, Komuna	MEA, Komuna, Firma private	**	BK, Investitori privat	I mesëm

<b>Edukimi dhe trajnimi i burimeve njerëzore për industrinë turistike dhe për mundësitë e përfitimit ekonomik për banorët lokal</b>	6	Studimi i fizibilitetit dhe hartimi i projektit për Qendrën Rekreative - Turistike Bogë sipas dispozitave për zbatim të parapara në PHPKBN	Komuna	Komuna, Firma private	**	BK, Investitori privat	I mesëm	
	7	Studimi i fizibilitetit dhe hartimi i projektit për zhvillimin e "Qendrës kulturore rekreative në Shkrel"	Komuna	Komuna, Investitori	**	BK, Investitori	I mesëm	
	8	Studimi i fizibilitetit dhe hartimi i projektit "Qendra Rezidenciale Qeveritare" - Lokaliteti Boja e Kuqe te Lugu i Gatë	Qeveria	Qeveria	**	BK	I mesëm	
	9	Studimi i fizibilitetit dhe hartimi i projektit për teleferikun që lidhë Deçanin me Bjeshkët e Belegut	MEA, Komuna	MEA, Komuna, Firma private	***	BK, Investitori privat	I mesëm	
	10	Studimi i fizibilitetit dhe hartimi i projektit "Qendra rekreative-rehabilituese"- Lokaliteti Zharrë	MEA, Komuna	MEA, Komuna, Firma private	***	BK, Investitori privat	I mesëm	
	11	Hartimi i projektit dhe studimi i fizibilitetit për riaktivizimin e kompleksit "Pushimorja e fëmijëve dhe rinisë" në Deçan	Komuna	Komuna, Firma private	***	BK, Investitori privat	I mesëm	
	12	Hartimi i projektit dhe studimi i fizibilitetit për riaktivizimin e kompleksit të hoteleve të vjetra mbi pushimorën e Deçanit	Komuna	Komuna, Firma private	***	BK, Investitori privat	I mesëm	
	13	Plane rregulluese të hollësishme për vendbanimet brenda parkut siq janë: Bogë, Belle, Drelaj, Shtupeq, Reka e Allagës, Lipë, Malaj, Jasiq, Gjocaj, etj.	Komuna	Komuna	**	BK	I mesëm	
	14	Hartimi i projekteve për kampet	Komuna	Komuna, Firma private	**	PPP	I ultë	
	15	Përcaktimi i zonave dhe sipërfaqeve të kampeve	MEA, Komunat	DPKBN	*	BK	I ultë	
	16	Kampi veror për fëmijë dhe rini në fshatin Haxhaj	Komuna	Komuna, Firma private	*	PPP	I ultë	
	17	Rregullimi sipas standardeve i kampeve ekzistuese (Liqeni Kuqishtë, Lutovë, Malaj, Tëbanet e Lumbardhit)	MEA, Komuna	MEA, Komuna, Pronarët	*	BK, Pronarët	I ultë	
	<b>Krijimi i imazhit të parkut dhe promovimi i turizmit</b>	1	Mbështetje institucionale për banorët e vendbanimeve brenda dhe rreth parkut për turizëm rural	MTI/DT, Komuna	MTI/DT, Komuna	**	BK	I mesëm
		2	Identifikimi dhe adaptimi shtëpive individuale për turizëm rural	Komunat, Pronarët	Pronarët	**	BK, Pronarët	I ultë
	<b>Krijimi i imazhit të parkut dhe promovimi i turizmit</b>	1	Hapja e zyrave turistike në qendrat lokale dhe pikat kufitare për informacion turistik, si dhe hapja e zyrave përfaqësuese në tregjet kryesore ndërkombëtare dhe bashkëpunimi me diasporën shqiptare	MTI/DT, MEA/ DPKBN, MD	MTI/DT, MEA, DPKBN, MD, Komunat Doganat	**	BK	I ultë
		2	Përgatitja e hartave tematike turistike	MTI/DT, MEA, DPKBN	MTI/DT, MEA, DPKBN	*	BK	I ultë





	3	Krijimi i një strukture të përhershme financiare që siguron një buxhet të vazhdueshëm marketingu	MTI/DT, MEA DPKBN	MTI/DT MEA DPKBN	***	BK	I mesëm
	4	Investimet në kulturë për të rritur zhvillimin e turizmit	MKRS/DTK, MTI/DT, Komuna	MKRS/DTK, Komuna	**	BK	I mesëm
<b>Synimi</b> Sigurimi i qasjes dhe i shërbimeve publike në Park							
<b>Objektivi</b>	<b>Aktiviteti/Masa/Projekti</b>	<b>Akterët vendimarrës</b>	<b>Akterët e zbatimit</b>	<b>Afati kohor</b>	<b>Burimi financiar</b>	<b>Implikimi financiar</b>	
<b>Sigurimi i infrastrukturës rrugore dhe transportit</b>	1	Zgjerimi dhe asfaltimi i rrugës regionale R108 në relacionin Deçan – kufiri me Malin e Zi me gjatësi 23 km	Qeveria (MI)	MI; Kompania për rrugë	**	BK	I lartë
	2	Ndërtimi i rrugës së Milishevcit me gjërësi adekuate, me karakter transporti të limituar në pjesën jugore e cila e lidh qytetin e Pejës me Podin e Jezercit dhe Milishevcin dhe dalje në Zllano Pojë	Qeveria (MI); Komuna	MI; Komuna; Kompania për rrugë	**	BK	I mesëm
	3	Ndërtimi i rrugës që e lidhë Jabllanicen me Istogun, me gjërësi adekuate, me karakter transporti të limituar	Qeveria (MI); Komuna	MI; Komuna; Kompania për rrugë	*	BK	I mesëm
	4	Ndërtimi i rrugës në relacionin Junik – Lugu i Gjatë	Qeveria (MI); Komuna	MI; Komuna; Kompania për rrugë	**	BK	I mesëm
	5	Zbatimi i projektit për ndërtimin e teleferikut nga Kompleksi Memorial deri në Rrasë të Koshares	Qeveria (MEA, MTI); Komuna	MEA, MTI; Komuna; Investitori privat; Kompania ndërtues	***	BK; Investitori privat	I mesëm
	6	Ndërtimi i shtigjeve për këmbësorë që e mundësojnë qasjen e vizitorëve në vendet më atraktive të parkut	Qeveria (MEA); Komuna	Komuna; Investitori privat; Kompania për rrugë	***	BK; Investitori privat	I lartë
	7	Ndërtimi i pikave të pushimit në çdo kilometër përgjatë shtigjeve për këmbësorë	Qeveria (MEA); Komuna	Komuna; Investitori privat; Kompania	***	BK; Investitori privat	I ultë
	8	Ndërtimi i parkingjeve në hyrjet kryesore të parkut dhe në vendet me kapacitete turistike	Qeveria (MEA); Komuna	Komuna; Investitori privat; Kompania	**	BK; Investitori privat	I ultë
	9	Vendosja e linjave të rregullta të transportit publik deri tek të gjitha vendbanimet brenda parkut dhe tek të gjitha hapësirat tjera me përmbajtje të rëndësishme	Qeveria (MI); Komuna	MI; Komuna; Operatori i transportit	***	BK; Investitori privat	I mesëm
<b>Sigurimi i infrastrukturës së energjisë elektrike</b>	1	Realizimi i një studimi me parashikimin për sasinë e energjisë elektrike të nevojshme për furnizimin e qendrueshëm të Parkut	Qeveria MZHE, MEA	MZHE; KEK; Kompania private	**	BK; Investitori	I ultë
	2	Realizimi i një studimi për gjetjen dhe shfrytëzimin e burimeve alternative, të ripërtërishe të energjisë	Qeveria (MZHE, MEA)	MZHE; KEK; Kompania private	**	BK; Investitori	I ultë

	3	Ndërtimi i linjave të reja furnizuese 10 kV gjegjësisht 0.4 kV me trafostacione përcjellës	Qeveria (MZHE), ZRRE	MZHE; Ndërmarrja e EE	***	BK; Investitori	I mesëm
	4	Zëvendësimi i linjave ajrore me ato kabllore nëntokësore	Qeveria (MZHE), ZRRE	MZHE; Ndërmarrja e EE	**	BK; Investitori	I ultë
	5	Rekonstruktimi-përmirësimi i rrjetit të shpërndarjes dhe trafove ekzistues, vendosja-instalimi i trafove të rinj (sipas pikës 1)	Qeveria (MZHE), ZRRE	MZHE; Ndërmarrja e EE	***	BK; Investitori	I lartë
	6	Vendosja e shtyllave për ndriçim publik të fshatrave brenda parkut dhe hapësirave me përmbajtje në funksion të turizmit	Qeveria (MZHE), ZRRE, Komunat	MZHE, Komunat Ndërmarrja e energjisë elektrike	**	BK	I ultë
<b>Sigurimi i infrastrukturës ujore</b>	1	Realizimi i një studimi për sasinë e ujit të pijshëm të nevojshëm për furnizimin e parkut gjatë 10 vjetëve të ardhshëm dhe për nevojat për kanalizimin e ujërave të zeza	Qeveria (MEA), Komunat	MEA, Komunat Kompania private	**	BK; Investitori privat	I ultë
	2	Realizimi i studimit për burimet e ujërave nëntokësor	Qeveria (MEA)	MEA, Kompania private	**	BK; Investitori	I ultë
	3	Hulumtimi i burimeve të reja të ujërave nëntokësor	Qeveria (MEA)	MEA, Kompania private	**	BK; Investitori	I ultë
	4	Instalimi i rrjeteve publik të ujësjellësit me kapacitet në bazë të studimit të lartpërmendur në të gjitha vendbanimet dhe përmbajtjet tjera brenda parkut	Qeveria (MEA); Autoriteti i Pellgut Lumor; Komunat	MEA, Komunat, Operatori i shërbimit publik	**	BK	I ultë
	5	Instalimii i rrjeteve publik të kanalizimit të ujërave të zeza në bazë të studimit të lartpërmendur në të gjitha vendbanimet dhe përmbajtjet tjera brenda parkut, qofshin ato turistike, prodhuese apo të tjera	Qeveria (MEA); Autoriteti e Pellgjeve, Komunat	MEA, Komunat, Operatori i publik	**	BK	I ultë
	6	Ndërtimi i impianteve për pastrimin e ujërave të zeza dhe i kolektorëve që mbledhin ujërat e zeza dhe i dërgojnë deri tek impianti	Qeveria MEA AMMK	MEA, Operatori i shërbimit, Kompania	**	BK; Investitori privat	I mesëm
<b>Sigurimi i infrastrukturës së telekomunikacionit</b>	1	Vendosja e antenave për ta mbuluar tërë hapësirën e parkut kombëtar me signalin e telefonisë mobile	MEA	Ndërmarrja publike PTK, Kompania private	**	Ndërmarrja publike PTK, Investitori	I ultë
	2	Instalimi i linjës telefonike kabllore nëntokësore për sjelljen e signalit të telefonisë fikse tek ndërtesat nëpër fshatra, kapacitetet turistike dhe tek Kompleksi i Memorialit të Betejës së Koshares	MEA	Ndërmarrja publike PTK, Kompania private	**	BK, Ndërmarrja publike PTK, Investitori	I ultë
	3	Vendosja e pajisjeve që mundëson qasjen pa tela (ëireless) në rrjetin e Internetit në të gjitha kapacitetet turistike, në fshatra dhe në Kompleksin e Memorialit	MEA	Ndërmarrja publike PTK, Kompania private	**	BK, Ndërmarrja publike PTK, Investitori	I ultë
	4	Përforcimi i signalit televiziv ajror për fshatrat, vendet me kapacitetet turistike dhe për zonën e Betejës së Koshares, si	MEA	Ndërmarrja publike RTK, Kompania private	**	BK, Ndërmarrja publike RTK, Investitori	I ultë



		dhe instalimi i kabllove në ndërtesa për televizionin kabllor dhe Internetin					
	5	Vendosja e punkteve postare në vendet me kapacitetet turistike	MEA	Ndërmarrja publike PTK	**	BK, Ndërmarrja publike PTK	I ultë
Sigurimi i infrastrukturës për menaxhimin e mbeturinave	1	Kontraktimi i operatorit që do të menaxhojë me mbeturinat në park	MEA, Komuna	MEA, Komuna	*	BK	I ultë
	2	Vendosja e kontejnerëve të mbeturinave në të gjitha pjesët që frekuentohen nga vizitorët	MEA, Komuna	Operatori për administrimin e mbeturinav.	*	BK	I ultë

	3	Vendosja e tabelave njoftuese për gjobat që pasojnë pas hedhjes pa vend të mbeturinave në park	MEA, Komuna	MEA, Komuna	*	BK	I ultë
--	---	--	-------------	-------------	---	----	--------

**Vërejtje:** Implikimi financiar mund të jetë: I ultë – deri në 400.000 €; I mesëm – 400.000 deri në 1.000.000 €; dhe I lartë – mbi 1.000.000 €; ndërsa afati kohor është paraparë: \*(0-2 vite); \*\* (2-5 vite); dhe \*\*\* (mbi 5 vite).



Shtojca 2

Tabela me kuotat e brendëshme të kufirit sipas komunave

Nr.rendor i kuotave	Nr. rendor i kuotes komunale	Komuna	Kuota_X	Kuota_Y
1	1	Kuotat në komunën e Gjakovës	7438611.62	4703294.63
2	2		7438611.78	4703196.98
3	3		7438540.09	4703155.44
4	4		7438492.28	4703144.03
5	5		7438492.34	4703101.31
6	6		7438593.99	4703099.62
7	7		7438743.55	4703060.52
8	8		7438791.49	4702992.60
9	9		7438821.57	4702882.24
10	10		7438887.57	4702740.78
11	11		7438887.72	4702649.22
12	12		7438923.72	4702569.28
13	13		7439001.64	4702458.14
14	14		7438983.74	4702427.92
15	15		7438924.00	4702392.29
16	16		7438834.35	4702369.37
17	17		7438726.76	4702346.73
18	18		7438643.22	4702238.25
19	19		7438583.49	4702193.47
20	20		7438496.90	4702124.71
21	21		7438398.25	4702123.29
22	22		7438374.35	4702108.43
23	23		7438374.42	4702065.71
24	24		7438335.60	4702035.83
25	25		7438281.80	4702024.51
26	26		7438230.99	4702016.20
27	27		7438180.22	4701983.48
28	28		7438150.37	4701953.46
29	29		7438114.50	4701954.05
30	30		7438032.19	4701884.37
31	31		7438078.50	4701816.80
32	32		7438092.00	4701798.89
33	33		7438107.43	4701778.99
34	34		7438122.87	4701761.05
35	35		7438132.52	4701747.14
36	36		7438141.85	4701730.16
37	37		7438132.85	4701697.41
38	38		7438174.69	4701702.82
39	39		7438231.50	4701704.93
40	40		7438375.01	4701699.50
41	41		7438467.75	4701661.35
42	42		7438515.69	4701599.52
43	43		7438599.43	4701582.88
44	44		7438617.46	4701524.60
45	45		7438650.39	4701499.64
46	46		7438644.56	4701408.19
47	47		7438791.11	4701369.15

48	48	7438868.91	4701328.19
49	49	7438937.75	4701284.33
50	50	7438982.67	4701234.76
51	51	7439021.59	4701206.65
52	52	7439102.31	4701205.31
53	53	7439165.08	4701216.48
54	54	7439218.90	4701215.59
55	55	7439281.72	4701196.24
56	56	7439368.56	4701145.92
57	57	7439432.72	4701123.05
58	58	7439454.18	4701068.15
59	59	7439539.87	4700946.74
60	60	7439550.61	4700913.84
61	61	7439518.65	4700848.92
62	62	7439486.66	4700805.82
63	63	7439411.94	4700752.52
64	64	7439251.71	4700711.54
65	65	7438995.36	4700628.52
66	66	7438952.66	4700596.49
67	67	7438685.64	4700502.75
68	68	7438589.52	4700471.61
69	69	7438514.78	4700429.22
70	70	7438461.39	4700397.38
71	71	7438354.60	4700355.51
72	72	7438226.38	4700335.82
73	73	7438151.52	4700369.78
74	74	7438087.42	4700359.93
75	75	7437969.93	4700318.25
76	76	7437927.27	4700264.41
77	77	7437863.19	4700243.65
78	78	7437788.45	4700201.26
79	79	7437735.01	4700202.15
80	80	7437692.33	4700159.22
81	81	7437628.27	4700127.56
82	82	7437521.34	4700162.04
83	83	7437489.42	4700075.31
84	84	7437425.35	4700043.65
85	85	7437329.21	4700023.42
86	86	7437275.91	4699937.04
87	87	7437243.89	4699915.76
88	88	7437190.54	4699862.10
89	89	7437169.23	4699818.82
90	90	7437137.28	4699753.90
91	91	7437062.57	4699689.69
92	92	7437051.96	4699646.23
93	93	7437073.45	4699569.53
94	94	7437062.82	4699536.97
95	95	7437052.17	4699515.34
96	96	7437041.53	4699482.79
97	97	7437009.48	4699472.42
98	98	7436923.97	4699484.74
99	99	7436924.08	4699419.28
100	100	7436902.76	4699386.92
101	101	7436870.75	4699354.72

102	102	7436806.72	4699301.24
103	103	7436721.22	4699302.65
104	104	7436689.27	4699237.73
105	105	7436646.53	4699227.53
106	106	7436614.58	4699162.62
107	107	7436614.70	4699086.26
108	108	7436625.48	4699031.54
109	109	7436636.27	4698965.92
110	110	7436615.00	4698900.82
111	111	7436540.28	4698847.52
112	112	7436486.97	4698772.05
113	113	7436465.61	4698761.49
114	114	7436422.90	4698740.39
115	115	7436401.68	4698642.56
116	116	7436306.85	4698557.27
117	117	7436306.57	4698556.02
118	1	7440441.78	4706737.09
119	2	7440435.94	4706651.74
120	3	7440424.13	4706554.28
121	4	7440382.36	4706500.04
122	5	7440322.59	4706488.82
123	6	7440328.65	4706433.80
124	7	7440346.67	4706384.67
125	8	7440436.40	4706364.87
126	9	7440490.32	4706290.74
127	10	7440466.60	4706169.07
128	11	7440400.92	4706115.23
129	12	7440371.14	4706036.38
130	13	7440347.31	4705987.95
131	14	7440239.76	4705940.90
132	15	7440197.81	4705990.43
133	16	7440191.75	4706045.45
134	17	7440149.84	4706076.66
135	18	7440137.74	4706162.31
136	19	7440137.55	4706284.37
137	20	7440125.45	4706370.02
138	21	7440095.44	4706443.76
139	22	7440017.55	4706542.70
140	23	7439963.85	4706464.24
141	24	7439975.96	4706372.49
142	25	7439952.18	4706287.44
143	26	7439976.14	4706262.63
144	27	7439994.29	4706134.17
145	28	7439910.76	4706013.49
146	29	7439910.98	4705879.20
147	30	7439965.03	4705731.84
148	31	7439917.24	4705708.22
149	32	7439869.46	4705672.38
150	33	7439749.90	4705656.05
151	34	7439570.49	4705671.22
152	35	7439481.23	4705398.06
153	36	7439481.32	4705349.23
154	37	7439463.44	4705306.81
155	38	7439425.83	4705199.70



156	39	7439326.35	4705034.43	210	18	7441478.61	4715645.77	264	72	7440981.99	4713446.70
157	40	7439380.33	4704935.88	211	19	7441431.58	4715722.49	265	73	7440915.81	4713399.39
158	41	7439332.64	4704845.12	212	20	7441345.87	4715737.51	266	74	7440856.14	4713411.84
159	42	7439356.59	4704820.32	213	21	7441269.25	4715699.96	267	75	7440802.59	4713442.19
160	43	7439416.46	4704776.61	214	22	7441183.21	4715676.81	268	76	7440748.98	4713466.56
161	44	7439416.59	4704697.26	215	23	7441159.03	4715638.84	269	77	7440695.69	4713526.81
162	45	7439398.78	4704618.21	216	24	7441144.40	4715600.79	270	78	7440695.13	4713461.02
163	46	7439357.02	4704557.88	217	25	7441192.04	4715595.63	271	79	7440706.11	4713347.27
164	47	7439375.04	4704502.64	218	26	7441282.61	4715590.11	272	80	7440669.92	4713311.67
165	48	7439357.19	4704454.12	219	27	7441377.60	4715546.40	273	81	7440680.95	4713203.91
166	49	7439315.41	4704405.98	220	28	7441401.12	4715508.03	274	82	7440650.71	4713162.29
167	50	7439315.48	4704357.16	221	29	7441410.04	4715436.39	275	83	7440548.55	4713103.30
168	51	7439321.60	4704277.71	222	30	7441428.74	4715393.29	276	84	7440440.58	4713062.31
169	52	7439303.73	4704229.17	223	31	7441433.18	4715355.09	277	85	7440362.66	4713039.03
170	53	7439220.10	4704181.74	224	32	7441465.75	4715259.40	278	86	7440285.30	4713081.53
171	54	7439184.24	4704164.02	225	33	7441512.52	4715154.05	279	87	7440284.93	4713039.66
172	55	7439196.27	4704127.21	226	34	7441507.30	4715101.60	280	88	7440332.56	4713015.34
173	56	7439232.24	4704065.58	227	35	7441473.59	4715063.71	281	89	7440380.23	4712997.00
174	57	7439232.34	4704004.54	228	36	7441473.66	4714997.97	282	90	7440457.69	4712966.46
175	58	7439178.64	4703938.30	229	37	7441485.26	4714956.01	283	91	7440541.44	4712971.76
176	59	7439190.65	4703901.47	230	38	7441484.64	4714884.23	284	92	7440649.10	4712976.86
177	60	7439250.54	4703839.46	231	39	7441460.43	4714848.54	285	93	7440726.56	4712946.32
178	61	7439250.60	4703802.83	232	40	7441412.54	4714842.95	286	94	7440755.79	4712868.31
179	62	7439250.75	4703711.28	233	41	7441406.20	4714801.13	287	95	7440695.59	4712820.94
180	63	7439274.87	4703588.82	234	42	7441405.85	4714759.26	288	96	7440593.60	4712779.91
181	64	7439281.10	4703430.04	235	43	7441363.68	4714723.71	289	97	7440557.57	4712762.26
182	65	7439263.37	4703302.16	236	44	7441297.87	4714718.27	290	98	7440598.96	4712708.08
183	66	7439191.68	4703266.72	237	45	7441201.91	4714683.16	291	99	7440646.47	4712671.80
184	67	7439078.05	4703274.71	238	46	7441315.14	4714640.36	292	100	7440687.50	4712575.75
185	68	7439024.29	4703245.08	239	47	7441344.67	4714598.25	293	101	7440669.36	4712551.98
186	69	7438946.54	4703252.47	240	48	7441409.86	4714531.91	294	102	7440627.51	4712552.32
187	70	7438910.73	4703210.34	241	49	7441403.47	4714484.11	295	103	7440556.18	4712600.75
188	71	7438862.89	4703211.14	242	50	7441325.34	4714436.89	296	104	7440496.40	4712601.24
189	72	7438815.04	4703218.03	243	51	7441378.27	4714334.77	297	105	7440431.09	4712655.62
190	73	7438749.22	4703249.63	244	52	7441389.56	4714256.91	298	106	7440377.45	4712674.00
191	74	7438719.25	4703298.96	245	53	7441388.43	4714125.32	299	107	7440311.16	4712614.72
192	75	7438665.42	4703305.95	246	54	7441316.01	4714048.14	300	108	7440148.87	4712514.36
193	1	7441711.98	4716717.40	247	55	7441298.13	4714054.27	301	109	7440083.21	4712526.87
194	2	7441711.49	4716660.15	248	56	7441220.25	4714036.96	302	110	7439981.58	4712527.70
195	3	7441710.95	4716598.13	249	57	7441154.69	4714061.42	303	111	7439898.19	4712564.27
196	4	7441696.24	4716550.53	250	58	7441095.22	4714097.81	304	112	7439814.49	4712564.96
197	5	7441695.70	4716488.51	251	59	7441023.74	4714128.30	305	113	7439723.78	4712446.06
198	6	7441704.78	4716435.95	252	60	7441058.89	4714044.26	306	114	7439616.17	4712446.94
199	7	7441732.86	4716373.70	253	61	7441099.81	4713936.25	307	115	7439412.49	4712400.75
200	8	7441750.99	4716263.81	254	62	7441159.39	4713911.84	308	116	7439328.74	4712395.45
201	9	7441707.54	4716202.13	255	63	7441206.86	4713869.58	309	117	7439238.86	4712372.26
202	10	7441669.10	4716169.05	256	64	7441259.74	4713761.48	310	118	7439167.63	4712432.67
203	11	7441597.54	4716164.87	257	65	7441247.16	4713689.79	311	119	7439096.35	4712487.09
204	12	7441525.80	4716141.60	258	66	7441150.73	4713600.85	312	120	7439036.98	4712535.43
205	13	7441449.26	4716113.59	259	67	7441108.98	4713613.16	313	121	7438935.55	4712560.19
206	14	7441495.96	4715998.70	260	68	7441055.28	4713625.56	314	122	7438839.69	4712537.05
207	15	7441585.86	4715916.85	261	69	7441031.16	4713601.83	315	123	7438839.38	4712501.15
208	16	7441604.36	4715849.91	262	70	7441042.71	4713553.89	316	124	7438946.48	4712440.46
209	17	7441507.22	4715645.54	263	71	7441024.30	4713500.19	317	125	7438976.07	4712404.32

Kuotat në komunën e Deqanit



318	126	7439046.93	4712302.05	372	9	7445638.74	4737068.88	426	63	7442730.14	4735931.39
319	127	7439211.76	4712271.82	373	10	7445597.28	4737041.98	427	64	7442618.56	4735804.51
320	128	7439182.63	4712091.57	374	11	7445555.05	4736960.21	428	65	7442722.87	4735738.97
321	129	7439287.46	4711767.69	375	12	7445533.07	4736857.61	429	66	7442875.91	4735558.19
322	130	7439343.43	4711324.57	376	13	7445456.41	4736762.58	430	67	7442872.86	4735420.77
323	131	7439304.98	4711025.79	377	14	7445407.82	4736715.19	431	68	7442856.34	4735271.89
324	132	7439328.17	4710941.85	378	15	7445386.61	4736667.46	432	69	7442830.03	4735095.46
325	133	7439326.42	4710738.48	379	16	7445385.84	4736612.58	433	70	7443101.30	4734661.40
326	134	7439303.79	4710526.30	380	17	7445391.25	4736509.61	434	71	7443331.14	4734167.10
327	135	7439263.96	4710427.93	381	18	7445383.73	4736461.69	435	72	7443306.55	4734081.42
328	136	7439215.31	4710332.62	382	19	7445396.37	4736386.06	436	73	7443406.03	4734004.26
329	137	7439165.73	4710129.64	383	20	7445388.66	4736324.42	437	74	7443486.07	4733884.32
330	138	7439070.72	4709813.08	384	21	7445367.26	4736262.97	438	75	7443599.16	4733725.94
331	139	7439078.42	4709711.62	385	22	7445360.03	4736235.62	439	76	7443712.25	4733567.56
332	140	7439113.67	4709639.55	386	23	7445326.47	4736284.08	440	77	7443592.83	4733544.69
333	141	7439184.59	4709543.26	387	24	7445279.50	4736353.30	441	78	7443582.39	4733439.81
334	142	7439302.51	4709350.87	388	25	7445238.90	4736388.14	442	79	7443457.83	4733374.02
335	143	7439325.08	4709195.15	389	26	7445211.51	4736388.50	443	80	7443304.91	4733337.11
336	144	7439419.30	4709026.89	390	27	7445170.92	4736423.33	444	81	7443175.83	4733299.99
337	145	7439418.16	4708895.30	391	28	7445157.41	4736437.22	445	82	7443127.40	4733214.50
338	146	7439250.15	4708824.89	392	29	7445130.99	4736506.18	446	83	7443126.74	4733138.17
339	147	7439285.71	4708788.71	393	30	7445118.16	4736568.09	447	84	7443125.76	4733023.66
340	148	7439440.64	4708727.62	394	31	7445077.85	4736623.50	448	85	7443082.27	4732957.22
341	149	7439439.29	4708572.10	395	32	7445009.38	4736624.40	449	86	7443062.78	4732909.67
342	150	7439331.48	4708549.05	396	33	7444996.08	4736652.02	450	87	7443038.61	4732871.70
343	151	7439198.29	4708398.84	397	34	7444935.03	4736693.98	451	88	7442981.19	4732848.31
344	152	7439209.95	4708322.74	398	35	7444866.57	4736694.88	452	89	7442909.49	4732829.82
345	153	7439328.69	4708226.05	399	36	7444791.25	4736695.87	453	90	7442842.56	4732811.27
346	154	7439232.32	4708143.09	400	37	7444764.16	4736716.81	454	91	7442899.54	4732782.18
347	155	7439339.10	4708046.51	401	38	7444710.16	4736772.40	455	92	7442985.13	4732752.85
348	156	7439373.94	4707926.58	402	39	7444662.80	4736814.18	456	93	7443061.05	4732709.28
349	157	7439348.90	4707795.19	403	40	7444588.16	4736863.19	457	94	7443141.99	4732694.31
350	158	7439407.86	4707699.00	404	41	7444394.31	4737009.99	458	95	7443218.04	4732665.06
351	159	7439335.19	4707591.92	405	42	7444224.31	4737177.98	459	96	7443207.93	4732598.34
352	160	7439250.66	4707496.90	406	43	7444032.19	4737242.66	460	97	7443173.95	4732486.89
353	161	7439130.68	4707450.03	407	44	7443976.58	4737208.86	461	98	7443087.02	4732526.03
354	162	7439154.18	4707401.98	408	45	7443881.04	4737279.19	462	99	7443082.73	4732470.79
355	163	7439237.78	4707389.33	409	46	7443768.26	4737101.11	463	100	7443063.07	4732389.59
356	164	7439260.97	4707305.39	410	47	7443644.09	4737095.84	464	101	7443059.59	4732351.72
357	165	7439284.58	4707269.31	411	48	7443679.32	4737150.62	465	102	7442922.88	4732289.82
358	166	7439391.98	4707244.50	412	49	7443660.38	4737275.19	466	103	7442932.83	4732154.76
359	167	7439607.41	4707266.67	413	50	7443583.31	4737186.42	467	104	7442925.54	4732027.28
360	168	7439822.02	4707193.12	414	51	7443527.12	4737111.19	468	105	7442926.58	4731983.04
361	169	7440106.82	4706939.55	415	52	7443408.49	4737009.16	469	106	7442944.83	4731887.48
362	170	7440262.67	4706986.13	416	53	7443264.71	4737080.12	470	107	7442953.10	4731739.49
363	171	7440310.19	4706949.85	417	54	7443139.40	4736991.98	471	108	7442975.58	4731581.86
364	1	7445927.77	4736680.91	418	55	7442979.61	4736904.31	472	109	7443048.05	4731524.60
365	2	7445907.80	4736722.33	419	56	7443025.64	4736744.85	473	110	7443151.72	4731420.56
366	3	7445860.65	4736777.83	420	57	7442997.39	4736696.89	474	111	7443197.21	4731353.12
367	4	7445834.03	4736833.06	421	58	7442983.12	4736662.55	475	112	7443249.21	4731300.22
368	5	7445800.47	4736881.53	422	59	7442954.78	4736607.67	476	113	7443320.10	4731279.60
369	6	7445746.46	4736937.11	423	60	7442926.15	4736532.07	477	114	7443363.01	4731249.51
370	7	7445705.77	4736965.10	424	61	7442863.64	4736498.37	478	115	7443348.48	4731199.21
371	8	7445678.86	4736999.75	425	62	7442821.42	4736436.76	479	116	7443310.05	4731166.13

Kuotat në komunën e Pejë



480	117	7443266.84	4731133.07	534	171	7442387.91	4727642.91	588	225	7439818.49	4726652.43
481	118	7443190.50	4731128.93	535	172	7442425.74	4727604.43	589	226	7439780.09	4726624.12
482	119	7443171.39	4731124.31	536	173	7442534.96	4727551.05	590	227	7439765.38	4726576.52
483	120	7443175.54	4731052.71	537	174	7442572.45	4727474.40	591	228	7439702.69	4726495.92
484	121	7443160.95	4730941.42	538	175	7442566.73	4727364.71	592	229	7439692.42	4726410.13
485	122	7442934.22	4730901.33	539	176	7442556.78	4727317.07	593	230	7439726.74	4726369.25
486	123	7442829.26	4730807.46	540	177	7442513.62	4727288.80	594	231	7439715.60	4726333.60
487	124	7442800.54	4730769.81	541	178	7442441.27	4727193.97	595	232	7439662.94	4726310.17
488	125	7442722.81	4730709.35	542	179	7442416.56	4727093.97	596	233	7439590.88	4726248.73
489	126	7442741.01	4730615.38	543	180	7442387.79	4727075.13	597	234	7439504.63	4726201.73
490	127	7442812.85	4730499.29	544	181	7442282.80	4727066.44	598	235	7439447.16	4726173.57
491	128	7442806.63	4730301.86	545	182	7442215.58	4727014.50	599	236	7439399.11	4726131.02
492	129	7442782.18	4730230.50	546	183	7442182.24	4727019.56	600	237	7439398.65	4726078.54
493	130	7442748.38	4730183.06	547	184	7442148.62	4726991.20	601	238	7439427.02	4726049.68
494	131	7442700.21	4730126.20	548	185	7442105.42	4726958.16	602	239	7439497.97	4725982.31
495	132	7442666.13	4730045.37	549	186	7442038.66	4726958.70	603	240	7439507.10	4725934.51
496	133	7442603.40	4729960.00	550	187	7441905.35	4726983.65	604	241	7439440.26	4725925.52
497	134	7442521.51	4729865.24	551	188	7441838.50	4726974.65	605	242	7439411.52	4725911.44
498	135	7442473.21	4729794.06	552	189	7441780.42	4726874.93	606	243	7439354.22	4725902.37
499	136	7442472.39	4729698.64	553	190	7441665.93	4726871.10	607	244	7439306.66	4725917.07
500	137	7442438.64	4729655.98	554	191	7441608.71	4726871.57	608	245	7439278.33	4725950.70
501	138	7442410.03	4729656.22	555	192	7441508.57	4726872.39	609	246	7439220.94	4725932.09
502	139	7442357.82	4729685.27	556	193	7441432.15	4726858.70	610	247	7439178.36	4725970.60
503	140	7442301.69	4729672.04	557	194	7441380.27	4726925.93	611	248	7439130.88	4725994.85
504	141	7442270.13	4729687.27	558	195	7441251.52	4726926.98	612	249	7439107.03	4725995.05
505	142	7442234.13	4729681.11	559	196	7441218.26	4726941.56	613	250	7439044.63	4725947.84
506	143	7442209.41	4729671.76	560	197	7441166.51	4727023.10	614	251	7439001.64	4725938.65
507	144	7442188.03	4729661.74	561	198	7441142.67	4727023.30	615	252	7438939.60	4725934.39
508	145	7442136.33	4729635.01	562	199	7441123.59	4727023.45	616	253	7438844.23	4725935.17
509	146	7442019.60	4729562.01	563	200	7441104.60	4727033.15	617	254	7438815.45	4725916.32
510	147	7441869.01	4729407.77	564	201	7441085.77	4727061.93	618	255	7438781.83	4725887.97
511	148	7441888.56	4729255.92	565	202	7441043.47	4727133.85	619	256	7438762.51	4725859.50
512	149	7441924.34	4729187.83	566	203	7440977.25	4727196.41	620	257	7438714.66	4725840.80
513	150	7441933.54	4729149.59	567	204	7440886.40	4727168.53	621	258	7438676.35	4725822.03
514	151	7442009.10	4729063.08	568	205	7440794.81	4727054.77	622	259	7438676.10	4725793.41
515	152	7442155.49	4728894.90	569	206	7440784.78	4726997.59	623	260	7438661.51	4725760.12
516	153	7442268.53	4728731.74	570	207	7440755.84	4726959.66	624	261	7438632.61	4725726.97
517	154	7442334.67	4728659.63	571	208	7440679.01	4726898.26	625	262	7438527.28	4725680.12
518	155	7442362.87	4728611.69	572	209	7440654.47	4726817.36	626	263	7438468.79	4725532.68
519	156	7442391.45	4728606.68	573	210	7440630.62	4726817.55	627	264	7438410.78	4725442.50
520	157	7442410.36	4728587.45	574	211	7440587.91	4726841.76	628	265	7438395.53	4725332.89
521	158	7442452.49	4728496.45	575	212	7440569.09	4726870.54	629	266	7438347.44	4725285.57
522	159	7442470.91	4728419.95	576	213	7440541.70	4727013.89	630	267	7438265.84	4725224.21
523	160	7442489.86	4728405.48	577	214	7440532.04	4726999.66	631	268	7438336.59	4725132.97
524	161	7442551.65	4728381.12	578	215	7440507.88	4726961.69	632	269	7438593.02	4725006.82
525	162	7442603.81	4728347.29	579	216	7440488.59	4726938.00	633	270	7438797.61	4724952.67
526	163	7442664.94	4728246.59	580	217	7440431.13	4726909.83	634	271	7438836.65	4724885.61
527	164	7442721.42	4728160.26	581	218	7440325.39	4726815.28	635	272	7438910.94	4724822.91
528	165	7442777.58	4728035.73	582	219	7440162.20	4726692.55	636	273	7439053.63	4724778.80
529	166	7442795.62	4727916.30	583	220	7440124.05	4726692.87	637	274	7439120.39	4724778.26
530	167	7442742.76	4727869.03	584	221	7440038.58	4726736.51	638	275	7439196.36	4724739.47
531	168	7442594.27	4727793.90	585	222	7439952.79	4726741.99	639	276	7439248.81	4724739.04
532	169	7442536.60	4727741.88	586	223	7439881.05	4726718.72	640	277	7439310.35	4724686.04
533	170	7442459.77	4727680.49	587	224	7439847.39	4726685.59	641	278	7439462.58	4724641.86



642	279	7439499.00	4724441.17	696	333	7440609.37	4722690.55	750	387	7440884.22	4719167.08
643	280	7439541.71	4724416.95	697	334	7440580.43	4722652.61	751	388	7440850.31	4719105.33
644	281	7439640.95	4724311.17	698	335	7440532.42	4722614.84	752	389	7440849.70	4719033.76
645	282	7439769.25	4724257.64	699	336	7440484.73	4722615.23	753	390	7440849.12	4718966.98
646	283	7439887.72	4724170.79	700	337	7440379.99	4722635.17	754	391	7440839.09	4718909.80
647	284	7439954.48	4724170.24	701	338	7440260.98	4722660.00	755	392	7440857.55	4718838.08
648	285	7440064.16	4724169.34	702	339	7440175.35	4722684.56	756	393	7440857.26	4718804.68
649	286	7440073.82	4724183.58	703	340	7440141.97	4722684.84	757	394	7440842.09	4718704.61
650	287	7440112.30	4724221.44	704	341	7440099.06	4722685.19	758	395	7440798.35	4718609.54
651	288	7440165.32	4724287.80	705	342	7440098.65	4722637.47	759	396	7440764.10	4718509.62
652	289	7440198.75	4724292.29	706	343	7440117.60	4722623.01	760	397	7440763.70	4718461.92
653	290	7440250.91	4724258.47	707	344	7440179.21	4722579.56	761	398	7440667.62	4718381.59
654	291	7440303.32	4724253.27	708	345	7440226.54	4722536.23	762	399	7440638.65	4718338.89
655	292	7440341.26	4724229.11	709	346	7440250.08	4722502.64	763	400	7440637.94	4718257.78
656	293	7440355.04	4724166.96	710	347	7440306.49	4722406.75	764	401	7440618.75	4718243.62
657	294	7440349.90	4724124.07	711	348	7440329.80	4722344.53	765	402	7440575.42	4718196.26
658	295	7440316.06	4724071.86	712	349	7440390.76	4722224.75	766	403	7440618.26	4718186.37
659	296	7440310.88	4724024.19	713	350	7440361.41	4722139.10	767	404	7440675.76	4718219.30
660	297	7440281.62	4723948.09	714	351	7440317.75	4722053.59	768	405	7440718.80	4718233.26
661	298	7440285.89	4723890.79	715	352	7440255.39	4722011.15	769	406	7440786.02	4718285.19
662	299	7440309.74	4723890.60	716	353	7440269.37	4721972.87	770	407	7440833.41	4718251.41
663	300	7440357.71	4723923.61	717	354	7440254.37	4721891.88	771	408	7440842.67	4718217.94
664	301	7440395.90	4723928.07	718	355	7440191.35	4721773.11	772	409	7440851.42	4718127.21
665	302	7440453.16	4723932.37	719	356	7440113.48	4721592.44	773	410	7440908.56	4718117.20
666	303	7440467.55	4723941.79	720	357	7440140.04	4721409.56	774	411	7440993.98	4718068.78
667	304	7440486.95	4723979.80	721	358	7440235.45	4721357.65	775	412	7441045.78	4717992.01
668	305	7440539.57	4723998.45	722	359	7440444.12	4721222.35	776	413	7441116.20	4717862.62
669	306	7440572.95	4723998.18	723	360	7440458.06	4721179.28	777	414	7441248.20	4717684.99
670	307	7440586.72	4723936.05	724	361	7440500.52	4721126.46	778	415	7441276.48	4717646.60
671	308	7440567.16	4723878.95	725	362	7440542.90	4721064.08	779	416	7441332.88	4717550.71
672	309	7440590.38	4723807.19	726	363	7440537.97	4721045.04	780	417	7441384.02	4717397.61
673	310	7440666.51	4723787.48	727	364	7440537.15	4720949.62	781	418	7441412.02	4717325.81
674	311	7440684.89	4723706.22	728	365	7440536.41	4720863.74	782	419	7441411.77	4717297.19
675	312	7440568.68	4723502.01	729	366	7440626.11	4720758.04	783	420	7441444.61	4717234.89
676	313	7440511.13	4723464.30	730	367	7440610.86	4720648.42	784	421	7441491.27	4717115.22
677	314	7440506.03	4723426.18	731	368	7440610.45	4720600.72	785	422	7441490.53	4717029.35
678	315	7440534.07	4723359.15	732	369	7440643.04	4720509.79	786	423	7441490.16	4716986.41
679	316	7440552.97	4723339.91	733	370	7440628.16	4720443.11	787	424	7441523.38	4716967.05
680	317	7440581.30	4723306.28	734	371	7440636.67	4720323.76	788	425	7441561.07	4716914.26
681	318	7440609.29	4723234.48	735	372	7440636.14	4720261.74	789	426	7441603.58	4716866.20
682	319	7440637.49	4723186.54	736	373	7440649.95	4720204.37	790	427	7441646.24	4716837.22
683	320	7440655.83	4723100.50	737	374	7440678.06	4720146.88	791	428	7441679.21	4716789.24
684	321	7440636.63	4723086.35	738	375	7440715.68	4720084.55	792	1	7452599.53	4744846.32
685	322	7440626.76	4723048.25	739	376	7440762.79	4720017.37	793	2	7452507.62	4744679.06
686	323	7440650.23	4723005.12	740	377	7440795.84	4719978.93	794	3	7452482.15	4744563.02
687	324	7440678.44	4722957.17	741	378	7440823.80	4719902.36	795	4	7452475.45	4744302.59
688	325	7440663.68	4722904.81	742	379	7440837.12	4719787.74	796	5	7452471.39	4744073.59
689	326	7440677.53	4722852.21	743	380	7440855.57	4719716.01	797	6	7452833.66	4743532.77
690	327	7440681.97	4722814.01	744	381	7440864.00	4719587.12	798	7	7452932.66	4743424.49
691	328	7440705.77	4722809.04	745	382	7440858.78	4719534.68	799	8	7453196.10	4743025.13
692	329	7440729.53	4722799.31	746	383	7440844.02	4719482.32	800	9	7453187.47	4742958.79
693	330	7440729.20	4722761.13	747	384	7440824.29	4719406.14	801	10	7453120.86	4742909.31
694	331	7440709.92	4722737.44	748	385	7440813.81	4719296.48	802	11	7453037.44	4742818.41
695	332	7440652.54	4722718.82	749	386	7440837.12	4719234.26	803	12	7452954.19	4742760.69

Kuotat në komunën e Istogut



804	13	7452928.93	4742686.14
805	14	7452903.34	4742545.21
806	15	7452927.93	4742487.04
807	16	7452894.00	4742337.85
808	17	7452892.91	4742122.15
809	18	7452916.95	4741956.13
810	19	7452965.97	4741806.58
811	20	7453031.33	4741607.18
812	21	7453022.49	4741499.37
813	22	7453021.91	4741383.23
814	23	7453054.50	4741266.94
815	24	7453103.69	4741150.58
816	25	7453235.36	4740942.61
817	26	7453276.42	4740859.46
818	27	7453300.81	4740759.80
819	28	7453308.60	4740660.22
820	29	7453399.39	4740568.56
821	30	7453498.22	4740427.10
822	31	7453514.68	4740402.15
823	32	7453547.66	4740360.52
824	33	7453630.15	4740268.90
825	34	7453646.07	4740136.09
826	35	7453811.43	4740027.53
827	36	7453794.51	4739961.23
828	37	7453793.88	4739836.79
829	38	7453810.35	4739811.83
830	39	7453834.60	4739687.29
831	40	7453850.53	4739554.48
832	41	7453883.12	4739438.18
833	42	7453923.59	4739238.90
834	43	7453964.57	4739139.18
835	44	7453947.27	4738998.21
836	45	7453986.19	4738874.80
837	46	7453888.57	4738874.02
838	47	7453921.42	4738807.50
839	48	7453995.83	4738757.41
840	49	7454045.35	4738707.41
841	50	7454078.15	4738632.61
842	51	7454085.69	4738483.24
843	52	7454027.38	4738433.72
844	53	7453886.35	4738434.33
845	54	7453786.81	4738434.76
846	55	7453703.78	4738418.53
847	56	7453604.19	4738410.66
848	57	7453496.35	4738411.13
849	58	7453413.40	4738411.49
850	59	7453372.13	4738453.15
851	60	7453297.51	4738461.76
852	61	7453247.53	4738420.50
853	62	7453181.17	4738420.79
854	63	7453106.51	4738421.11
855	64	7453006.97	4738421.54
856	65	7452932.68	4738496.52
857	66	7452899.09	4738413.71

858	67	7452832.34	4738339.33
859	68	7452815.63	4738314.52
860	69	7452840.22	4738256.33
861	70	7452790.28	4738223.37
862	71	7452682.28	4738190.64
863	72	7452657.39	4738190.75
864	73	7452575.07	4738315.56
865	74	7452558.43	4738307.34
866	75	7452508.08	4738191.40
867	76	7452466.31	4738133.51
868	77	7452349.96	4738092.53
869	78	7452300.19	4738092.74
870	79	7452242.29	4738126.18
871	80	7452200.98	4738159.54
872	81	7452167.96	4738192.87
873	82	7452167.63	4738126.51
874	83	7452117.61	4738076.94
875	84	7452009.69	4738060.81
876	85	7451926.73	4738061.17
877	86	7451843.70	4738044.94
878	87	7451719.14	4738020.59
879	88	7451661.07	4738020.84
880	89	7451619.47	4737996.13
881	90	7451561.11	4737938.31
882	91	7451469.82	4737930.41
883	92	7451353.68	4737930.91
884	93	7451212.58	4737914.93
885	94	7451154.52	4737915.18
886	95	7451113.20	4737948.54
887	96	7451088.19	4737923.77
888	97	7451079.61	4737865.72
889	98	7451079.27	4737799.36
890	99	7451062.34	4737733.06
891	100	7451037.25	4737691.69
892	101	7450970.80	4737675.38
893	102	7450904.15	4737665.06
894	103	7450840.10	4737665.90
895	104	7450743.03	4737966.31
896	105	7450660.54	4737897.39
897	106	7450613.15	4737839.67
898	107	7450554.84	4737834.61
899	108	7450484.90	4737829.70
900	109	7450339.09	4737814.12
901	110	7450286.85	4737826.47
902	111	7450235.19	4737879.65
903	112	7450193.77	4737833.53
904	113	7450176.23	4737827.93
905	114	7450123.91	4737834.45
906	115	7450048.38	4737847.11
907	116	7449995.81	4737836.14
908	117	7449913.89	4737808.05
909	118	7449855.66	4737808.81
910	119	7449809.42	4737832.76
911	120	7449704.78	4737845.80

912	121	7449641.30	4737887.47
913	122	7449623.59	4737870.20
914	123	7449581.94	4737806.58
915	124	7449569.39	4737742.57
916	125	7449510.51	4737696.68
917	126	7449428.35	4737651.08
918	127	7449399.89	4737698.14
919	128	7449289.26	4737699.59
920	129	7449167.23	4737718.70
921	130	7448872.37	4737945.52
922	131	7448547.07	4737807.20
923	132	7448314.23	4737810.26
924	133	7448029.88	4737889.26
925	134	7447856.08	4737816.30
926	135	7447666.73	4737705.91
927	136	7447530.59	4737639.96
928	137	7447550.81	4737474.13
929	138	7447468.20	4737475.22
930	139	7447417.44	4737334.12
931	140	7447350.10	4737335.00
932	141	7447261.35	4737181.93
933	142	7447144.41	4737077.43
934	143	7447036.42	4737040.00
935	144	7446760.12	4736951.21
936	145	7446726.18	4736972.24
937	146	7446685.19	4736979.64
938	147	7446630.52	4736987.22
939	148	7446631.71	4736944.98
940	149	7446663.12	4736870.17
941	150	7446635.16	4736829.37
942	151	7446551.37	4736713.86
943	152	7446483.10	4736728.47
944	153	7446395.06	4736798.24
945	154	7446394.38	4736750.22
946	155	7446373.55	4736729.92
947	156	7446325.05	4736689.40
948	157	7446256.39	4736676.58
949	158	7446120.24	4736733.25
950	159	7446119.47	4736678.39
951	160	7446070.77	4736624.14
952	161	7446036.16	4736597.16
953	162	7445988.42	4736611.51
954	163	7445947.92	4736653.21
955	164	7452599.53	4744846.32





**QEVERIA E KOSOVËS**  
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit

**PLANI HAPËSINOR**

**PARKU KOMBËTAR**  
**“Bjeshkët e Nemuna”**



Dokument i hartuar nga:



**INSTITUTI PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR**

në bashkëpunim me strukturat relevante  
të sektorëve të Qeverisë së Kosovës,  
qeverive komunale dhe strukturave dhe  
niveleve të ndryshme të shoqërisë kosovare.

Prishtinë  
Shtator, 2020